




MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR





INSTITUTI PËR PLANIFIKIM HAPËSINOR

# INDIKATORËT PËR PLANIFIKIM HAPËSINOR NË KOSOVË



Prishtinë

Qershor, 2017



**INDIKATORËT  
PËR PLANIFIKIM HAPËSINOR NË KOSOVË**

Qershor, 2017

Prishtinë

Ky dokument i hartuar nga Instituti për Planifikim Hapësinor paraqet indikatorë për fushën e planifikimit hapësinor. Përmbajtja dhe rezultatet e indikatorëve janë të bazuar në të dhënat aktuale të sektorëve relevant të Qeverisë së Kosovës, dhe të dhënat nga burime të ndryshme kredibile për fushat përkatëse. Pjesa e konsiderueshme e analizave, grafikëve, tabelave, hartave dhe fotove të prezantuara në dokument janë origjinale, janë produkt i angazhimit të zyrtarëve përgjegjës për temat përkatëse.

Dokumenti është i natyrës së hapur, i cili gjatë gjithë kohës do të plotësohet me informata dhe analiza të përditësuara për indikatorët e trajtuar. Të gjitha këto informata do të publikohen në Ueb-faqen e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe do të jenë të qasshme për të gjithë të interesuarit, me fokus të veçantë në komunitetin e planerëve, duke përfshirë edhe përgjegjësit e të dy niveleve të planifikimit hapësinor në Kosovë.

HYRJE .....	5
PLANIFIKIMI HAPËSINOR I BAZUAR NË DËSHMI / FAKTE .....	5
DËSHMITË DHE MONITORIMI PËRMES INDIKATORËVE .....	6
LISTA E INDIKATORËVE THEMELOR PËR PLANIFIKIM HAPËSINOR DHE URBAN .....	8
MBULIMI I TERRITORIT TË KOSOVËS ME PLANE HAPËSINORE / ZHVILLIMORE KOMUNALE .....	12
POPULLSIA, VENDBANIMET DHE NJËSITË E ORGANIZUARA TERRITORIALE .....	15
DENDËSIA E POPULLSISË DHE SHPËRNDARJA E SAJ .....	18
SHTRIRJA E VENDBANIMEVE DHE POPULLSISË SIPAS LARTËSISË MBIDETARE .....	21
LËVIZJET E POPULLSISË - MIGRIMET E JASHTME .....	25
KAPACITETI DHE SHTRIRJA E OBJEKTEVE EDUKATIVE – ARSIMORE .....	32
KAPACITETI DHE SHTRIRJA E OBJEKTEVE PËR SHËRBIME SHËNDETËSORE .....	35
SHKALLA E VARFËRISË .....	38
SHKALLA E PAPUNËSISË .....	41
BRUTO PRODHIMI VENDOR PËR KOKË BANORI (BPV/B) .....	44
PJESËMARRJA E SEKTORËVE NË BPV (BUJQËSI, INDUSTRI & SHËRBIME) .....	46
VLERA E EKSPORT-IMPORTIT DHE BILANCI TREGTAR .....	48
NUMRI I VIZITORËVE TË JASHTËM E VENDOR DHE BUJTJET E TYRE .....	50
NDËRMARRJET BUJQËSORE SI AKTIVITETE EKONOMIKE NË NIVEL VENDI .....	52
NUMRI DHE SHTRIRJA E ZONAVE EKONOMIKE .....	55
REMITENCAT NGA DIASPORA NË KOSOVË .....	58
NDARJA E BUXHETIT DHE SHPENZIMET KAPITALE SIPAS SEKTORËVE / KOMUNAVE .....	61
RAPORTI I PRODHIMIT DHE KONSUMIT VJETOR TË ENERGJISË ELEKTRIKE .....	66
RAPORTI I PRODHIMIT TË EE NGA THËNGJILLI DHE BURIME RIPËRTËRITËSE .....	68
FURNIZIMI I POPULLSISË ME UJË TË PIJSHËM .....	72
VB DHE POPULLSIA E PËRFSHIRË NË SHËRBIMET E LARGIMIT TË MBETURINAVE .....	74
VB DHE POPULLSIA QË PËRDORIN SISTEMIN PUBLIK TË NGROHJES .....	77
TERRITORI DHE POPULLSIA QË MBULOHEM NGA SHËRBIMET E TELEKOMUNIKIMIT .....	80
MBULIMI I TERRITORIT TË KOSOVËS NGA SHËRBIMET E TRANSPORTIT PUBLIK .....	85
PËRQINDJA E RRUGËVE TË ASFALTUARA NË RRJETIN RRUGOR .....	89
DENDËSIA E RRJETIT RRUGOR TË ASFALTUAR .....	91
DENDËSIA E RRJETIT HEKURUDHOR (KM/KM <sup>2</sup> ) .....	93
KLASIFIKIMI DHE RAPORTI I PËRDORIMEVE TË SIPËRFAQES SË TOKËS .....	95
PYLLËZIMI DHE RIPPYLLËZIMI SI MASA ANTIEROZION .....	98
POTENCIALI I TOKËS SË KLASIFIKUAR BUJQËSORE (PTB) .....	100
KAPACITETI I SHFRYTËZUAR I TOKËS BUJQËSORE .....	103
POTENCIALI I TOKËS NDËRTIMORE (PZN PA KUFIZIME) .....	106
NUMRI DHE SHTRIRJA E VENDBANIMEVE JOFORMALE .....	110
NDËRTIMET PA LEJE NË KOSOVË / KOMUNA .....	112
NUMRI I NJËSIVE TË BANIMIT .....	116
NUMRI I KËRKESAVE PËR BANIM .....	122

SASIA E RESURSEVE UJORE (SASIA E UJIT PËR KOKË BANORI) .....	125
CILËSIA (KUALITETI) UJËRAVE SIPËRFAQËSORE .....	128
DEGRADIMI I SHTRËTËRVE TË LUMENJVE DHE RREZIKU NGA VËRSHIMET .....	131
ZONAT NËN RREZIK TË VËRSHIMEVE .....	134
CILËSIA (KUALITETI) AJRIT .....	139
PROGRESI NË MENAXHIMIN E HOT-SPOTEVE .....	142
LARMIA E LLOJEVE BIMORE (FITODIVERSITETI) .....	144
ZONAVE ME VLERA TË MBROJTURA NATYRORE .....	146
VLERA E BUXHETIT TË NDARË PËR MBROJTJE DHE ZHVILLIM TË TK-SË .....	148
NUMRI I MONUMENTEVE TË TRASHËGIMISË KULTURORE .....	151
PËRGJEGJËS TË ZHVILLIMIT TË INDIKATORËVE .....	154
LITERATURA DHE REFERENCAT PËR INDIKATORIT E TRAJTUAR .....	155

### PLANIFIKIMI HAPËSINOR I BAZUAR NË DËSHMI / FAKTE

Përkufizimi më i hershëm në Evropë për planifikimin hapësinor, vjen nga ‘Karta e Torremolinos’, e miratuar në vitin 1983 nga CEMAT (Konferenca Evropiane e Ministrave përgjegjës për Planifikim Hapësinor Rajonal):

*"Planifikimi rajonal/hapësinor jep shprehje gjeografike politikave ekonomike, shoqërore, kulturore dhe ekologjike të shoqërisë. Ai, njëkohësisht është një disiplinë shkencore, një teknikë administrative dhe një politikë e zhvilluar si një qasje ndërdisiplinore dhe gjithëpërfshirëse e drejtuar kah një zhvillim i balancuar rajonal dhe organizim fizik i hapësirës sipas një strategjie të përgjithshme".*

**Planifikimi Hapësinor është funksion** “rregullator dhe zhvillimor” i sektorit publik, që zhvillohet në një proces me cikle të përsëritshme qarkore dhe me fushë-veprimtarinë e vet shumë-sektoriale dhe duke u bazuar në dëshmi (fakte) të rezultuara nga analiza e hulumtime gjegjëse, pasqyron zhvillimin aktual hapësinor të territorit caktuar dhe koordinon shpërndarjen e aktiviteteve të ardhshme me qëllim të përmirësimit të gjendjes së krijuar nga veprimet dhe ndikimet e politikave tjera sektoriale.

**Planifikimi Hapësinor është mekanizëm** me kompetenca dhe karakter:

- Zhvillimor, sepse autoritetet qeverisëse (në nivel lokal, rajonal ose kombëtar) duhet të hartojnë, zbatojnë, monitorojnë dhe vlerësojnë realizimin e instrumenteve zhvillimore (kornizave strategjike) që ofrojnë zhvillime në shërbime dhe infrastrukturë, vendosin kahet e zhvillimit urban/rural, ruajnë burimet dhe pasuritë kombëtare, krijojnë iniciativa nxitëse për investime, etj., dhe
- Rregullator, sepse autoritetet vendim-marrëse (në nivel lokal, rajonal ose kombëtar) duhet të miratojnë/aprovojnë politikat dhe instrumentet strategjike zhvillimore, normative e teknike.

**Planifikimi Hapësinor është sektor përgjegjës** për hartimin, monitorimin dhe vlerësimin e zbatimin të strategjive zhvillimore për territorin e caktuar dhe më gjerë, duke u bazuar në të dhëna konkrete ose dëshmi (fakte) të rezultuara nga analiza, hulumtime, raporte e strategji gjegjëse të autoriteteve përkatëse publike.

**Planifikimi Hapësinor ka mandat** për mbarëvajtje të procesit të hulumtim-kërkimit, grumbullimit, përpunimit dhe ruajtjes së informatave konkrete në bazën e të dhënave, të krijimit të platformës bazë, e cila do të mundësojë së pari paraqitjen, analizën dhe vlerësimin e gjendjes aktuale të zhvillimit hapësinor dhe më pas nxitjen, planifikimin dhe koordinimin e zbatimit të zhvillimeve të ardhshme.

**Planifikimi Hapësinor ka për qëllim** organizimin dhe menaxhimin e hapësirës së caktuar territoriale përmes shfrytëzimit sa më racional e të ndërlidhur të përdorimeve të tokës, duke synuar arritjen e një zhvillimi të balancuar socio-ekonomik, me ruajtje të vlerave mjedisore e të trashëguara.

**Planifikimi Hapësinor ka rol** të mirënjohur të ndërmjetësuesit, integruetit dhe koordinuesit të të gjitha ndërhyrjeve sektoriale në hapësirën e caktuar territoriale me qëllim të:

- Shmangies së përpjekjeve e ndërhyrjeve të dyfishta nga aktorë të ndryshëm;
- Zgjidhjes së problemeve (konflikteve) të shkaktuara nga politika të ndryshme sektoriale; dhe
- Avancimit të zhvillimeve bashkërenduese (sinergjitë) ndër-sektoriale.

**Planifikimi Hapësinor është përkrahës** i denjë dhe relevant i promovimit të investimeve që ofrojnë përfitime në zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe përmirësim të cilësisë së mjedisit jetësor.

**Planifikimi Hapësinor është proces** që zhvillohet në cikle të përsëritshme qarkore, me faza kryesore, duke përfshirë funksione dhe veprime që duhet ndërmarrë për të dhënë përgjigje pyetjeve në vijim:

- **Ku jemi?** - Hartimi i Profilimit, për pasqyrim të gjendjes aktuale të zhvillimit hapësinor, të bazuar në dëshmi / fakte të ofruara nga analiza dhe vlerësime të rezultateve të prodhuara të Indikatorëve;
- **Ku dëshirojmë të shkojmë?** - Hartimi i Kornizës Strategjike, për planifikim të zhvillimit të dëshiruar të bazuar në vizion, caqe dhe prioritete strategjike me qëllim të përmirësimit të gjendjes aktuale;
- **Si të shkohet?** - Hartimi i Planit Veprimit, me renditjen e veprimeve zhvillimore që do të ndikonin në zbatimin e objektivave e qëllimeve strategjike dhe në ndryshim të vlerave të rezultuara të Indikatorëve;
- **Sa është arritur?** – Hartimi i Raporteve Monitoruese, për raportimin e shkallës së arritur të zbatimit strategjisë, të bazuar në monitorim, matje dhe vlerësim të rezultateve të arritura vjetore dhe periodike (4 - 5 ose 8 - 10 vjeçare).

Vlerësimi i shkallës së arritur të zbatimit të zhvillimeve të planifikuara, mundësohet nga rezultate të prodhuara drejtpërdrejtë (vlerë numerike) ose vlerësime rezultues (konkluzione të nxjerra) për indikatorë të trajtuar dhe është përcaktuesi kryesor për mënyrën e vazhdimin të procesit të planifikimit hapësinor në ciklin tjetër, përmes Revidimit (plotësim/ndryshimit) apo Hartimit të një strategjie të Re.

**Planifikimi Hapësinor është sistem unik** ku fuqia dhe efektshmëria e të cilit varet nga disa faktorëve të rëndësishëm si:

- Angazhimi i hershëm i aktorëve kyç në proces të planifikimit dhe në komunikim e dialog të vazhdueshëm;
- Pajtueshmëria për parime, objektiva dhe strategji të zhvillimit hapësinor, për të cilat edhe nuk kërkohet qasje e detajuar dhe e fiksuar për zonën e përcaktuar;
- Zhvillimi i një planifikimi hapësinor të bazuar në dëshmi e fakte, për të siguruar një themel të fortë për politikë-bërjen dhe vendim-marrjen;
- Përdorimi i procedurave ferr, reale dhe të qëndrueshme, që sigurojnë se edhe çështjet e influencuara kanë qasje në procesin e vendim-marrjes;
- Hartimi i një plani-kornizë të thjeshtë, që ofron siguri dhe mundësi për një fleksibilitet në fushat që janë objekt i ndryshimeve të mëdha;
- Përnjohja dhe përfshirja e kushteve lokale, në një proces fleksibil, për trajtim të pasojave të paparashikuara dhe propozimin e zgjidhjeve të qëndrueshme;
- Aplikimi i analizave vlerësuese dhe të teknikave të arsyetimit, për të vlerësuar ndikimet potenciale (të mundshme) të politikave alternative;
- Integrimi i strategjive urbane dhe rurale, që sigurojnë se punët dhe interesat sektoriale janë në ujdi dhe bashkëpunim të ndërsjellë;
- Bashkë-udhëheqja, strategjia dhe koordinimi i të gjitha resurseve (të kapaciteteve dhe burimeve e pasurive: natyrore, njerëzore, financiare, teknike etj.), që janë themelet kryesore të zbatimit.

### Dëshmitë dhe monitorimi përmes indikatorëve<sup>1</sup>

Ofrimi i informacionit është një mjet tepër i rëndësishëm për planifikim dhe menaxhim të zhvillimit hapësinor e urban, i cili për të qenë efikas duhet të jetë edhe shumë i kujdesshëm, sepse:

- Rrezikon shtyrjen e politikë-bërjes së rëndësishme për shkak të përqendrimit vetëm në mbledhjen e të dhënave nga burime të sigurta (meqë studim-hulumtimi dhe analiza duhet t'i paraprijë planit).
- Nevojitet të zhvillohet një proces ndërveprues dhe përsëritës, që mund të përdor plane dhe politika të përkohshme, përderisa baza e fakteve/dëshmimeve të jetë në zhvillim e sipër.

<sup>1</sup> UN Economic Commission for Europe Geneva, *SPATIAL PLANNING: Key Instruments for Development and Effective Governance* (with Special Reference to Countries in Transition, page 27 – 28), New York and Geneva 2008.

- Informatat duhet të mbahen në një bazë të përbashkët të dhënash që është e mbështetur së paku nga një sistem të thjeshtë të informacionit gjeografik (GIS).
- Baza e të dhënave duhet të mbështesë dhe të ruaj regjistrimin e ndryshimeve hapësinore, si për: përdorimin dhe pronësinë e tokës, rritjen dhe shpërndarjen demografike, aktivitetet dhe zhvillimet sociale dhe ekonomike, qasjet dhe shërbimet në infrastrukturë si dhe në cilësinë e mjedisit dhe të ndërtimeve duke përfshirë edhe rreziqet natyrore e njerëzore, etj.
- Është shumë me rëndësi të kuptohet se: ku, si dhe çfarë ndryshimesh po ndodhin, dhe se kush janë shkaktarët apo drejtuesit që ndikuan në efekte ose pasoja të prodhuara.
- Qasja fillestare duhet të jetë e orientuar kah problemi në mënyrë që çështjet dhe proceset kyçe të identifikuar të shërbejnë për pika referuese të ndërhyrjes së menjëhershme dhe potenciale të mundshme për ndryshime të ardhshme.

Qëllimet dhe rezultatet e Indikatorëve janë komponentë thelbësore në procesin e planifikimit dhe gjerësisht po përdoren çdo ditë e më shumë për të ndihmuar jo vetëm planerët por edhe politikëbërjen dhe vendim-marrjen, në formulimin dhe hartimin e politikave, të planeve strategjike dhe në vlerësimin e rishikimin e tyre. Kështu që, procesi i planifikimit hapësinor, duhet të integroj dhe të mundësojë një përdorim sa më të lehtë të informatave të krijuara edhe nga organizatat tjera publike dhe private.

Për këtë arsye edhe themelohet një mekanizëm përgjegjës i mbikëqyrjes së të dhënave hapësinore, i cili punon për interesa të një numri të konsiderueshëm të hisedarëve sektorial, që grumbullon, përzgjedhë, ndërlihdh, ndërton dhe ruan të dhënat e përgjithshme, për të mundësuar edhe analiza të ndryshme në nivelin rajonal e lokal. Prandaj ana më madhore e këtij zhvillimi është dhe përnjohja me organizimin hapësinor dhe të funksionimit të territorit, e posaçërisht të veprimtarive për strehim e punësim, sikurse edhe të trendit për transport dhe qasshmëri.

Bazuar në Ligjin për Planifikim Hapësinor (LPH) Nr. 04/L-174, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), si pjesë e ekzekutivit të qeverisjes qendrore, është instanca më e lartë dhe përgjegjëse për profilizim të gjendjes, planifikim të ardhshëm, monitorim e raportim si dhe vlerësim të zbatimit të zhvillimeve hapësinore për territorin e Kosovës, përderisa në nivelin lokal, këtë përgjegjësi për tërë territorin komunal e bartë Drejtoria për Planifikim dhe Urbanizëm<sup>2</sup>.

## Indikatorët

Indikatorët janë informata me rezultate të prodhuara (vlera numerike dhe njësi matëse ose përfundim i rezultuar) që përdoren për të treguar gjendjen ose ndryshimin e një situatë, të një progresi apo efekti të arritur nga zhvillimi i një aktiviteti, projekti ose programi të planifikuar. Indikatorët janë instrumentet esenciale për monitorim dhe vlerësim të gjendjes së zhvilluar. Prandaj, duhet pasur shumë kujdes në lidhjen e ngushtë të tyre me Objektivat dhe Qëllimet e rreshtuara në strategjitë e hartuara të PH, sepse përmes vlerave numerike dhe konkluzioneve të rezultuara për indikatorët gjegjës mundësohet edhe matja dhe vlerësimi i zbatimit tyre.

**Indikatorët sipas paraqitjes (performance indicators)** - tregojnë për rezultatet e fituara që janë të afërta në relacion me procesin e planifikimit hapësinor sipas çdo niveli – hallke të "zinxhirit të rezultateve": në formë të dhënash hyrëse, të prodhuara nga proceset, të drejtpërdrejta, të shkaktuara dhe/ose të ndikuara.

- **Indikatorët me rezultate/të dhëna hyrëse (Input Indicators)** - Tregojnë për masën sasiore, cilësore apo/dhe kohore, për kapacitete dhe burime njerëzore, financiare dhe materiale (teknike, teknologjike dhe informative), që janë të dhëna bazike për planifikim të një aktiviteti, projekti apo plan-programi.

<sup>2</sup> Shënim: Drejtoritë nëpër komuna kanë emërtime të ndryshme, ky përveç urbanizmit, mund të figurojnë edhe planifikimi, mjedisi, kadastrri, etj.

- **Indikatorët me rezultate që dalin nga proceset (Process Indicators)** - Tregojnë për masën e progresit të arritur si rezultate të prodhuara nga zhvillimi i aktiviteteve në një projekt - program si dhe rruga e mënyra e realizimit tyre.
- **Indikatorët me rezultate të drejtpërdrejta (Output Indicators)** - Tregojnë për masën sasiore, cilësore apo/dhe kohore të prodhimeve, mallrave e shërbimeve, që janë rezultate afatshkurta me të dala të drejtpërdrejta nga një aktivitet - projekt – program i zhvilluar.
- **Indikatorët me rezultate të shkaktuara (Outcome Indicators)** - Tregojnë për përmasat dhe përfundimet (konkluzionet) e nxjerra si rezultate të ndërmjetme (afatmesme) të prodhuara me të dala në formë efektsh / pasojash të shkaktuara nga një program i zhvilluar.
- **Indikatorët me rezultate të ndikuara (Impact Indicators)** - Tregojnë për përmasat e cilësisë apo të sasisë si rezultate afatgjata të prodhuara nga ndikimi i një programi të caktuar (p.sh. të ndryshimeve të matshme në cilësinë e jetës, të reduktimit të sëmundjeve dhe vdekshmërisë së fëmijëve, etj).

**Rezultatet e fituara për Indikatorë** - kanë dy forma të paraqitjes, si:

- **Rezultate me vlera numerike të drejtpërdrejta** - që tregojnë për paraqitjen e shpejtë të nivelit të arritur zhvillimor, ku vlerat e prezantuara numerike për indikatorët e përzgjedhur, shërbejnë për të pasqyruar shkallën e zhvillimit tyre në formë grafike dhe gjithashtu mundësojnë edhe krahasime të ndryshme, si të brendshme (me vlera e matura nëpër periudha të ndryshme kohore brenda vendit) ashtu edhe të jashtme (me vlerat e fituara nga vendet tjera), me qëllim të nxjerrjes së përfundimeve / konkluzioneve për nivelin e zhvillimit.
- **Konkluzione të dala nga efektet/pasojat e prodhuara** - që janë të dhëna rezultuese apo konkluzione përfundimtare, që rrjedhin si efekte apo pasoja të shkaktuara nën ndikimin e realizimit të projektit – programit ndërlidhës me objektivat, qëllimet dhe politikat e synuara strategjike, që qojnë drejtë ngritjes pozitive të vlerës së indikatorit, gjegjësisht të përmirësimit gjendjes aktuale dhe të vet jetës së qytetarit.

### Lista e indikatorëve themelor për planifikim hapësinor/urban

Instituti për Planifikim Hapësinor në kuadër të MMPH-së, ka marrë përsipër hartimin e një dokumenti Liste-kornizë “Indikatorët Themelor për Planifikim Hapësinor”, me qëllim të krijimit të një instrumenti bazik e shumë të nevojshëm për sektorin. Prandaj, kjo platformë bazë që po ndërtohet, me rezultate të prodhuara për indikatorët e trajtuar, është një hallkë e rëndësishme që do ta lehtësojë procesin e planifikimit. Kjo listë do të jetë në shërbim të politikë-bërësve, planerëve dhe profesionistëve tjerë, të nivelit qendror e lokal, që të mbështesin vendim-marrjen e tyre në fakte (dëshmi) të bazuara në vlera të prodhuara dhe vlerësime të rezultuara të tyre:

- për të vlerësuar gjendjen aktuale të zhvillimit hapësinor për kohë dhe territor të caktuar, përmes pasqyrimit dhe krahasimit (të brendshëm e të jashtëm) të vlerave të rezultuara;
- për të hartuar strategji të zhvillimit të ardhshëm hapësinor, me vizion, politika, qëllime e objektiva (PZHK), dhe me veprime: masa, aktivitete e projekte (HZK); dhe
- për të argumentuar nivelin e arritur zhvillimor – përmes monitorimit vjetor dhe vlerësimit periodik të zbatimit të veprimeve, projekteve, plan-programeve, objektivave dhe qëllimeve në instrumentet e PH.

Gjithashtu, me këtë Listë – kornizë, jepet mundësi e njëjtë, për të gjitha palët e interesit, për krahasime të jashtme e të brendshme (dhe me përcaktim të trendit) të vlerave të rezultuara për indikatorët e trajtuar, ku:

- **Krahasimi i brendshëm** - është krahasimi i vlerave të fituara për indikatorë të caktuar, nga matja e tyre nëpër periudha të ndryshme kohore, që tregojnë për ndryshimet e krahasueshme të niveleve zhvillimore përbrenda një vendi, rajoni apo komune; dhe



- **Krahasimi i jashtëm** - është krahasimi i vlerave të fituara për indikatorë të caktuar, nga matja e tyre aktuale, që tregojnë për nivelin e zhvillimit të një vendi, rajoni apo komune në krahasim me nivelin e zhvillimit të vendeve, rajoneve apo komunave tjera përreth dhe më gjerë.

Hartimi i Listes me indikatorë themelorë për planifikim hapësinor, është i domosdoshëm për kohën dhe do të shërbejë si instrument bazë për matje dhe vlerësim vjetor dhe periodik të zhvillimit, deri në vendosjen e një sistemi të mirëfilltë raportues për monitorim të zhvillimeve dhe vlerësim të zbatimit të planeve. Ky veprim është në harmoni me Direktivën 2007/2 të Këshillit të Evropës dhe Parlamentit të Evropës - INSPIRE, për Informata Hapësinore dhe Infrastrukturore të komunitetit Evropian dhe me listat e indikatorëve të Agjencive Evropiane për Statistika - EUROSTAT dhe asaj për Mjedis – EEA, si dhe të Rrjetit Mbikëqyrës për Planifikim Hapësinor Evropian - ESPON<sup>3</sup> (që trajton dhe pasqyron vlerat e rezultuara për regionet statistikore të nivelit NUTS 2 e NUTS 3 në BE).

**Grupimi dhe kriteret për përzgjedhjen e Indikatorëve** - Në Kosovë, varësisht nga nevoja e trajtimit të çështjeve të ngritura, duhet bërë edhe përzgjedhjen e Indikatorëve, të cilët japin prodhim me rezultat të veçantë, por edhe mund të japin konkluzione me prodhime të rezultuara, kur ata zhvillohen në kombinim apo të grupuar nëpër fusha tematike të preferuara, si:

1. Demografia dhe zhvillimi social;
2. Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik;
3. Qasja dhe përfshirja e Komuniteteve në infrastrukturë dhe shërbime;
4. Shfrytëzimi racional dhe efikas i resurseve për zhvillim cilësor;
5. Mbrojtja, ruajtja dhe përmirësimi i mjedisit natyror e kulturor – historik;

Kriteret kyçe për përzgjedhjen e Indikatorëve themelor janë:

- Lista-Kornizë me Indikatorët e përzgjedhur duhet të shërbejë për platformë bazë edhe për palët tjera të interesit (komunat dhe sektorët tjerë) që të zhvillojnë kornizat e tyre me Indikatorë hapësinor e urban dhe sektorial për nevoja e interesa të veta;
- Lista-Kornizë duhet të jetë e përshtatshme për gjithë Kosovën / Regjionin / Komunën dhe të formojnë një shtyllë të fortë për monitorimin e zhvillimit të politikave nga sektorët tjerë;
- Lista-Kornizë duhet të ndihmojë në sigurimin e qasjes së lehtë të komunikimit dhe të përsëritjes së monitorimit, të cilën, me kohë, duhet mbjellë drejtë e në thelb të procesit të krijimit të politikave.
- Analizat zhvillimore duhet të përfshijnë aspektin hapësinor duke theksuar rëndësinë e funksionimit të qasjes dhe të ndërlidhjes me zonat për rreth;
- Analizat zhvillimore nuk duhet të përqendrohen vetëm në vlerën e thjeshtë të Indikatorëve por më shumë në mënyrën e kombinimit të tyre për të nxjerrë politika adekuate;
- Fokusimi në shfrytëzimin e konkluzioneve që dalin nga Indikatorët, ndihmon planerët dhe palët e interesit të modifikojnë edhe politika, qëllime dhe veprime tjera në adresë të çështjeve të reja të identifikuar;

<sup>3</sup> ESPON: The European Spatial Planning Observation Network (në gjuhën shqipe: Rrjeti Mbikëqyrës i Planifikimit Hapësinor Evropian).

LISTA E INDIKATORËVE THEMELOR PËR PLANIFIKIM HAPËSINOR ME SIMBOLET IDENTIFIKUESE

N.R.	Emërtimi Indikatorëve themelor për PH në Kosovë	Simboli
<b>1. Demografia dhe zhvillimi social</b>		
001.	Mbulimi i territorit të Kosovës me plane hapësinore / zhvillimore	iphk 001/1.01
002.	Popullsia, vendbanimet dhe njësitë e organizuara territoriale	iphk 002/1.02
003.	Dendësia e popullsisë	iphk 003/1.03
004.	Shtrirja e vendbanimeve dhe popullsia sipas LMD	iphk 004/1.04
005.	Raporti në mes popullsisë urbane dhe rurale (në %)	iphk 005/1.05
006.	Lëvizjet e popullsisë - Migrimet e jashtme	iphk 006/1.06
007.	Kapaciteti dhe shtrirja e objekteve edukative - arsimore	iphk 007/1.07
008.	Kapaciteti dhe shtrirja e objekteve për shërbime shëndetësore	iphk 008/1.08
009.	Shkalla e Varfërisë	iphk 009/1.09
010.	Shkalla e papunësisë	iphk 010/1.10
<b>2. Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik</b>		
011.	Bruto Prodhimi Vendor për kokë banori (BPV/b)	iphk 011/2.01
012.	Pjesëmarrja e sektorëve në BPV (Bujqësi, Industri & Shërbime)	iphk 012/2.02
013.	Vlera e Eksport-Importit dhe bilanci tregtar	iphk 013/2.03
014.	Numri i vizitorëve të jashtëm e vendor dhe bujtjet e tyre	iphk 014/2.04
015.	Ndërmarrjet Bujqësore si aktivitete ekonomike në nivel vendi	iphk 015/2.05
016.	Numri dhe shtrirja e zonave ekonomike	iphk 016/2.06
017.	Remitencat nga diaspora në Kosovë	iphk 017/2.07
018.	Ndarja e Buxhetit dhe shpenzimet kapitale sipas sektorëve / komunave	iphk 018/2.08
019.	Raporti i prodhimit dhe konsumit vjetor të Energjisë elektrike	iphk 019/2.09
020.	Raporti i prodhimit të EE nga thëngjilli dhe burime ripërtëritëse	iphk 020/2.10
<b>3. Qasja dhe përfshirja e komuniteteve në infrastrukturë dhe shërbime</b>		
021.	Furnizimi i popullsisë me ujë të pijshëm	iphk021/3.01
022.	VB dhe popullsia e përfshirë në shërbimet e largimit të mbeturinave	iphk 022/3.02
023.	VB dhe popullsia që përdorin sistemin publik të ngrohjes	iphk 023/3.03
024.	Territori dhe popullsia që mbulohet nga shërbimet e telekomunikimit	iphk 024/3.04
025.	Mbulimi i territorit të Kosovës nga shërbimet e transportit publik	iphk 025/3.05
026.	Përqindja e rrugëve të asfaltuara në rrjetin rrugor	iphk 026/3.06
027.	Dendësia e rrjetit rrugor të asfaltuar	iphk 027/3.07
028.	Dendësia e rrjetit hekurudhor (km/km <sup>2</sup> )	iphk 028/3.08
<b>4. Shfrytëzimi racional dhe efikas i resurseve për zhvillim cilësor</b>		
029.	Klasifikimi dhe raporti i Përdorimeve të sipërfaqes së Tokës a) Pyjore b) Bujqësore c) Ndërtimore d) Ujore	iphk 029/4.01

030.	Pyllëzimi dhe ripyllëzimi si masa antierozion	iphk 030/4.02
031.	Potenciali i Tokës së klasifikuar Bujqësore (PTB)	iphk 031/4.03
032.	Kapaciteti i shfrytëzuar i Tokës Bujqësore	iphk 032/4.04
033.	Potenciali i Tokës Ndërtimore (PZN pa kufizime)	iphk 033/4.05
034.	Numri dhe shtrirja e Vendbanimeve joformale	iphk 034/4.06
035.	Ndërtimet pa leje në Kosovë / Komuna	iphk 035/4.07
036.	Numri i njësive të banimit me Indikatorit banor / njësi dhe <ul style="list-style-type: none"> <li>• Njësitë e banimit sipas statusit të shfrytëzimit</li> <li>• Njësitë e banimit sipas tipologjisë së VB urban / rural</li> <li>• Shtrirja e dendësisë së banesave</li> </ul>	iphk 036/4.08
037.	Numri i kërkesave për Banim	iphk 037/4.09
038.	Sasia e Resurseve ujore ( <i>Sasia e ujit për kokë banori</i> )	iphk 038/4.10
<b>5. Mbrojtja dhe përmirësimi i mjedisit natyror e kulturor – historik</b>		
039.	Cilësia (kualiteti) ujërave sipërfaqësore	iphk 039/ 5.01
040.	Degradimi i shtretërve të lumenjve dhe rreziku nga vërshimet	iphk 040/5.02
041.	Zonat nën rrezik të vërshimeve	iphk 041/5.03
042.	Cilësia (kualiteti) ajrit	iphk 042/5.04
043.	Progresi në menaxhimin e hot-spotëve	iphk 043/5.05
044.	Larmia e llojeve bimore (fitodiversiteti)	iphk 044/5.06
045.	Zonave me vlera të mbrojtura natyrore	iphk 045/5.07
046.	Vlera e buxhetit të ndarë për mbrojtje dhe zhvillim të TK-së	iphk 046/5.08
047.	Numri i Monumenteve të Trashëgimisë Kulturore	iphk 047/5.09

Iphk  
001/1.01

**Indikatori:** MBULIMI I TERRITORIT TË KOSOVËS ME PLANE HAPËSINORE / ZHVILLIMORE KOMUNALE

**Synimi:** ZHVILLIMI I BALANCUAR DHE KOHEZION TERRITORIAL

**Objektivi:** PLANIFIKIMI DHE MENAXHIMI I KONTRROLLUAR I ZHVILLIMEVE HAPËSINORE


**Përshkrimi i Indikatorit:** Me anë të këtij Indikatorit do të kemi një pasqyrë reale për sasinë e territorit të mbuluar me plane hapësinore të nivelit qendror dhe atij lokal, si dhe raportin e respektimit, ndikimit, harmonizimit dhe të plotësimit të hierarkisë së planeve “nga lartë-poshtë”.

**Mënyra e matjes së Indikatorit:** është bërë përmes paraqitjes së numrit të planeve hapësinore dhe planeve zhvillimore komunale, të hartuara e të aprovuara sipas legjislacionit në fuqi, me të për territorin e Republikës së Kosovës,

**Burimi informatës/ave:** Burimi i informacioneve të sakta për Indikatorin është Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) si institucion i nivelit qendror - Departamenti dhe Instituti për Planifikim Hapësinor (DBNPH dhe IPH) dhe për nivelin lokal janë Drejtoritë e Urbanizimit ... (DU).

**Kufizimet për matjen e Indikatorit:** Për Indikatorin në fjalë nuk kemi kufizime, përveç pjesës veriore të territorit të Kosovës gjegjësisht komunave Lepsaviq, Zveçan dhe Zubin Potok të cilat nuk i përgjigjen kërkesave legjislative si në këtë rast obligimit për përgatitjen e Planeve zhvillimore komunale.

**Rëndësia e Indikatorit për zhvillimin hapësinor:** Mbulimi i territorit të Kosovës me Plane hapësinore dhe Plane zhvillimore komunale është i rëndësishëm si për plotësimin e obligimit ligjor ashtu edhe në aspektin e zhvillimit hapësinor, që nënkupton harmonizimin e tyre në raport me respektimin horizontal dhe vertikal të planeve hapësinore. Me zbatimin e këtyre planeve, të nivelit lokal dhe qendror, mundësohet monitorimi më efikas i zhvillimeve të qëndrueshme, të cilat duhet të jenë në përputhshmëri me Planin Hapësinor të Kosovës.



Vendimet e miratuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës për dokumentet e hartuara nga IPH			
Nr.	Dokumentet	Miratimi Kuvendit	Data
1	Plani Hapësinor i Republikës së Kosovës 2010-2020+	Vendimi Nr.04-V-82	16.06.2011
2	PH i Zonës me interes të veçantë ekonomik "Fusha e mihjes së Re" 2010-2020	Vendimi Nr.04-V-206	07.10.2011
3	PH i Zonës me interes të veçantë "Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së në Kleçkë dhe Divjakë"	Vendimi Nr.04-V-332	06.04.2012
4	PH për Parkun Kombëtar "Sharri"	Vendimi Nr.04-V-772	11.02.2014
5	PH i Zonës së Mbrojtur me Interes të Veçantë "Beteja e Koshares"	Vendimi Nr.04-V-796	14.03.2014
6	PH i Monumentit të natyrës me rëndësi të veçantë "Ujëvarat e Mirushës"	Vendimi Nr.04-V-795	14.03.2014
7	PH për Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna"	Vendimi Nr.04-V-797 (Për hartimin e PH PKBN)	14.03.2014

Fig. 1 Harta dhe tabela me zona të dala nga PHK dhe të shpallura nga Qeveria (sipas kufijve në PH për ZV) në Kosovë. Burimi: IPH / MMPH.

**Gjendja e Indikatorit dhe krahasimi:** Kuvendi i Republikës së Kosovës, përveç hartimit dhe aprovimit të Planit Hapësinor të Kosovës (PHK, që mbulon tërë territorin e saj), ka hartuar dhe aprovuar dhe Planet Hapësinore për Zona të Veçanta (territore me veçori dhe karakteristika të veçanta, shih tabelën dhe hartën në fig. 1), të cilat janë dokumente të planifikimit hapësinor të nivelit qendror në zbatim të PHK-së.




Fig. 2 Harta e mbulimit të territorit të Kosovës me PZHK. Burimi: IPH / MMPH.

Momentalisht, territori i Kosovës përbëhet nga 38 komuna, prej të cilave: 31 komuna e kanë të hartuar dhe aprovuar Planin Zhvillimore Komunale, 4 komuna janë në proces të hartimit dhe 3 komuna tjera mbeten akoma pa këto plane. Me llogaritjen e përqindjes tyre, del se, mbi 80 % e komunave, që e mbulojnë territorin e vet me Plane Zhvillimore Komunale, përbëjnë 9.1 % të sipërfaqes së përgjithshme të territorit të Kosovës. Me Planin Hapësinor të Kosovës, synohet që mbulimi i territorit të Kosovës të arrijë në 100 %, përmes hartimi, aprovimit dhe zbatimit të këtij instrumenti të planifikimit hapësinor që mundëson një koordinim, harmonizim dhe kontrollim më të lehtë të zhvillimeve, në nivelin lokal të qeverisjes.

### **Konkluzione dhe rekomandime:**

- Mbulimi i tërë territorit të Kosovës me Plane zhvillimore komunale, do të mundësojë kontrollin e zhvillimeve të planifikuara dhe të harmonizuara me Planin Hapësinor të Kosovës;
- Me rritjen e numrit të zonave të veçanta, për të cilat hartohen planet hapësinore rritet edhe sipërfaqja e përbashkët territoriale në të cilat do të ketë zhvillim më të qëndrueshëm, të kontrolluar dhe të harmonizuar hapësinor;
- Ngritja e nivelit të bashkëpunimit dhe koordinimit horizontal dhe vertikal është e domosdoshme për të mënjanuar konfliktet eventuale në mes të planeve të ndryshme përkatësish zhvillimeve të ardhshme hapësinore;
- Hartimi i planeve në të gjitha nivelet e planifikimit nuk duhet të kuptohet vetëm si kërkesë ligjore, por si një kornizë zhvillimore me synime, objektiva dhe veprime strategjike, të cilat ndikojnë në arritjen e qëllimit themelor - ngritjen e kualitetit të jetesës në përgjithësi.

Prandaj, është e nevojshme që:

- sa më shpejtë të finalizohet procesi i hartimit dhe aprovimit të planeve zhvillimore komunale dhe instrumenteve tjera hapësinore, në mënyrë që të arrihet synimi i mbulimit të tërë (100 %) territorit të Kosovës.

**Përshkrimi i Indikatorit:** Ky indikator paraqet të dhënat për shtrirjen e sipërfaqeve dhe numrin e përbashkët të popullsisë nëpër njësitë më të gjera territoriale – Regjione të Propozuara Statistike, që formohen me grupimin e disa njësive më të vogla territoriale – Njësitë Administrative Lokale (Fig. 1 & 3), me qëllim të krahasimit të brendshëm e të jashtëm, të vlerave mbi gjendjen e arritur të zhvillimeve në mes të regjioneve të rangut të njëjtë, në Kosovë, EJT dhe BE.




Fig. 1. Harta me Njësi të Propozuara Territoriale të Kosovës. Burimi: IPH – Plani Hapësinor i Kosovës 2010-2020+

**Mënyra e matjes së Indikatorit:** Për të llogaritur numrin e popullsisë nëpër Njësitë e Propozuara Territoriale – Regjione Statistike, fillimisht duhet ditur numrin e popullsisë nëpër njësitë e organizuara territoriale, të secilës Komunë pjesëmarrëse në të apo të Bashkësive Lokale në Kryeqytet. Vlera e rezultuar për numrin e popullsisë nëpër secilën Njësi të Propozuar Territoriale (Regjione Statistike) duhet të krahasohet me vlerat e vendosura nga Eurostat, për klasifikimin e tyre sipas kriterëve të nomenklaturës për përkatësinë e njësisë territoriale statistikore, të emërtuar me shkurtësën NUTS (Nomenclature of territorial units for statistics, ku regjionet NUTS 3 kanë 150.000 – 800.000 banorë, kurse ato NUTS 2 kanë 800.000 – 3.000.000 banorë).

**Burimi informatës/ave:** Për burimi më të sigurt, të përdorura për të dhënat mbi sasinë e sipërfaqeve dhe numrin e popullsisë, nëpër Njësitë e Propozuara Territoriale (Regjionet Statistike), janë Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)<sup>4</sup> si dhe Komuna e Prishtinës<sup>5</sup>.

<sup>4</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK): Atlasi i Regjistrimit të Popullsisë Kosovë 2011, Prishtinë 2013

<sup>5</sup> Komuna Prishtinë: Plani Zhvillimor Urban-Prishtina 2012-2022, Shtator 2013

**Kufizimet për matjen e Indikatorit:** Në Kosovë, organizimi territorial nuk ka qenë i definuar saktë dhe si i tillë ka pësuar ndryshime gjatë periudhave kohore, përderisa tani përcaktimi i vendbanimeve realizohet në bazë të vendimeve administrative të komunave përkatëse. Territorin e Republikës së Kosovës, deri në vitin 1999 e përbënin 30 komuna, përderisa nga viti 2008 ishin 37 me 1467 vendbanime (shih fig. 2) dhe tani me shtimin e komunës Mitrovica e Veriut, në vitin 2015 janë 38 komuna me 1468 vendbanime. Këto vlera nuk mund të jenë edhe aq reale, meqë nuk kishte koncepte të qarta të përdorura gjatë regjistrimit të popullsisë dhe se numër i konsiderueshëm i popullsisë që jetonin në vendbanimet urbane ishin regjistruar si banor të vendbanimeve rurale, me çka edhe rritet dyshimi dhe diferenca mes popullsisë urbane/rurale në Kosovë.

**Rëndësia e Indikatorit për zhvillimin hapësinor:** Ky tregues është shumë i rëndësishëm sepse na mundëson krahasimin e zhvillimeve socio-ekonomike aktuale nëpër këto Njësi të Propozuara Territoriale (Regjione Statistike) me ato në të kaluarën dhe në të ardhmen. Analizat e mirëfillta të zhvillimeve hapësinore, gjatë procesit të hartimit të planeve hapësinore, zhvillimore dhe atyre rregulluese të hollësishme për vendbanimet urbane e rurale, do të drejtojnë dhe parapërgatitshin politikë-bërjen dhe planerët, për një shfrytëzim sa më racional të tokës e të mjedisit jetësor për të strehuar e vepruar një numër i madh i banorëve në një sipërfaqe të vogël. Rrjedhimisht, duhet përzgjedhur zgjidhja, që ofron kushte më të mira dhe hapësira më komode për të vendosur kapacitetet e nevojshme të banimit, punës (ekonomike, administrative, tregtare, etj), të infrastrukturës dhe shërbimeve teknike, sociale, publike, kulturore dhe rekreative.

Regjionet e propozuara statistike	Komunat përbërëse	Sipërfaqja (në km <sup>2</sup> )	Numri i popullsisë	% e sipërfaqes në Kosovë (10.906 km <sup>2</sup> )	% e popullsisë në Kosovë (1.780.021 b.)
<b>R. i Qytetit të Prishtinës</b>	20 Bashkësitë Lokale	33.5	161.751	0.3	9.1
<b>R. Prishtinës</b>	Prishtinë (pa qytetin), Podujevë, Glllogoc, Lipjan, Fushë Kosovë, Obiliq, Graçanicë	2.047.5	308.832	18.7	17.3
<b>R. Mitrovicës</b>	Mitrovicë, Vushtrri, Skenderaj, Lepsaciç, Zveçan, Zubin Potok	2.051.0	232.833	18.8	13.1
<b>R. Pejës</b>	Pejë, Deçan, Istog, Klinë	1.660.0	214.254	15.2	12.0
<b>R. Gjakovës</b>	Gjakovë, Rahovec, Malishevë, Junik	1.247.0	211.461	11.4	11.9
<b>R. Prizrenit</b>	Prizren, Suharekë, Dragash, Mamushë	1.433.0	277.007	13.1	15.6
<b>R. Ferizajt</b>	Ferizaj, Kaçanik, Shtime, Hani Elezit, Shtërpçë	1.021.0	185.695	9.4	10.4
<b>R. Gjilanit</b>	Gjilan, Kamenicë, Viti, Novoberdë, Ranillugë, Klllokot, Partesh	1.413.0	188.188	13.0	10.6

Fig. 2. Tabela me sipërfaqe dhe numër të popullsisë nëpër regjione statistike. Burimi: IPH – Plani Hapësinor i Kosovës dhe nga të dhënat e ASK dhe PZHU Prishtinë

**Gjendja e Indikatorit dhe krahasimi:** Sipas Regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë në Kosovë, të realizuar në vitin 2011, del se Kosova ka një popullsi prej 1.780.021 banorë që jetojnë në zonat urbane dhe në zonat rurale. Në fig. 3, shihen sasitë e sipërfaqeve me numrin e popullsisë dhe % përkatëse nëpër Njësitë e Propozuara Territoriale (Regjionet Statistike) të formuara me grumbullimin e Njësave të Organizuar Territoriale - Komunave pjesëmarrjes dhe të Bashkësive Lokale të Kryeqytetit Prishtinës.




Nga vlerat e rezultuara për numrin e përgjithshëm të popullsisë, vërehet se, të gjitha Regjionet Statistike të propozuara për Kosovën janë brenda kriterit (150 000 - 800 000 banorësh) të Eurostat-it dhe i përkasin klasifikimit të **Regjioneve NUTS 3**.

#### **Konkluzione dhe rekomandime:**


- Ndarje e propozuar e Regjioneve Statistike në Kosovë nuk është ndarje administrative, është ndarje e cila ka për qëllim grumbullimin e të dhënave statistikore dhe pasqyrimin e gjendjes zhvillimore para dhe pas realizimit të ndonjë projekti apo aktiviteti. Fondet për realizimin e këtyre projekteve mund të jenë të siguruara nga buxheti i Kosovës apo nga politikat dhe programet regjionale të BE-së;
- Në të shumtën e rasteve një ndarje e tillë është parakusht dhe kriter vendimtar për tërheqjen e fondeve dhe përfshirjen e vendit tonë në projekte dhe programe regjionale evropiane;
- Të gjitha Njësitë e Propozuara Territoriale në Kosovë (8 regjione) për grumbullimin e të dhënave statistikore janë të grupuara sipas afërsisë së Njërive të Organizuara Territoriale (Njësitë Administrative Lokale ose LAU – Local Administrative Units), dhe hyjnë në kategorinë e Regjioneve të klasifikuara **NUTS 3** (me 150 000 – 800 000 banorë);
- Sa i përket madhësisë së sipërfaqeve dhe numrit të popullsisë, të gjitha Njësitë e Propozuara Territoriale (Regjionet Statistike) janë të baraspeshuara dhe pa diferenca të mëdha;
- Bazë për propozimin e regjioneve statistikore është Plani Hapësinor i Kosovës 2010-2020+, sipas të cilit territori i Kosovës është i ndarë në shtatë rajone që kanë karakteristika dhe potenciale të ngjashme zhvillimore. Këtyre rajoneve i është shtuar edhe zona urbane e Komunës së Prishtinës (Qyteti i Prishtinës) i përcaktuar si Kryeqendra e Kosovës, e cila për nga përmbajtja dhe madhësia i përgjigjet kategorisë NUTS 3;
- Prandaj, duke i pasur parasysh konkluzionet e mësipërme rekomandohet që gjatë procesit të anëtarësimit të Kosovës në BE, në kuadër të angazhimeve në arritjen dhe plotësimin e kërkesave dhe të kriterëve, të shtohen përpjekjet edhe në plotësimin e kriterit për ndarjen regjionale statistikore të Kosovës.

**Përshkrimi i Indikatorit:** Sipas EUROSTAT-it (Agjencisë Evropiane për Statistika), dendësia e popullsisë paraqet raportin mes numrit të popullsisë për njësi të sipërfaqes së një territori për kohën e caktuar. Zakonisht tregon numrin e banorëve të përhershëm në një kilometër katror (b/km<sup>2</sup>) për njësinë territoriale.



**Mënyra e matjes së Indikatorit:** Në Kosovë, nga regjistrimi i fundit më 2011 dhe publikimi i rezultateve zyrtare më 2013 nga ASK<sup>6</sup>, vlera mesatare për dendësi të popullsisë është 163.2 b/km<sup>2</sup>, e fituar nga përpjesëtimi i numrit të përgjithshëm të popullsisë (1.780.021 b.) për sipërfaqen e përgjithshme (10.906 km<sup>2</sup>). Ndërsa, në kontekst të njësisë më të madhe territoriale, ajo tregon për shpërndarjen hapësinore dhe dendësinë e popullsisë së përgjithshme nëpër njësitë më të vogla territoriale.

**Fig. 1.** Hartat për zhvillimin e trendit të dendësisë së popullsisë nëpër komuna të Kosovës. Burimi: ASK 2013.



**Fig. 2.** Harta për dendësinë e popullsisë në Kosovë sipas grid-it. Burimi: ASK 2013

**Burimi informatës/ave:** Burimi kryesor i informatare për këtë tregues është Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK). ASK-ja ka publikuar hartën me të dhëna për njësi hapësinore edhe më të vogël se ajo komunale, në nivel Rrjeti (grid) me Raster prej 1.000 x 1.000 m, e cila mundëson një imazh më të saktë për shpërndarje, dendësi dhe qartësim të dallimeve në mes të popullsisë rurale dhe urbane.


**Kufizimet për matjen e Indikatorit:** Për shkak të lëvizjeve të pa regjistruara mekanike dhe të faktorëve tjerë gjatë fillimit shek. XXI në Kosovë, janë bërë vlerësime të ndryshme vendore e ndërkombëtare. Mbi këto vlerësime, që ishin burim informatash me vlera të ndryshme për dendësinë e popullsisë prej 220 -245 b/km<sup>2</sup>, janë prodhuar edhe shumë dokumente të rëndësishme zhvillimore për vendin.

Për shkak të planifikimit të zhvillimeve të ardhshme si dhe të ndarjes së investimeve të

<sup>6</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK): Atlasi i Regjistrimit të Popullsisë Kosovë 2011, Prishtinë 2013.

përgjithshme, të dhënat për dendësinë dhe shpërndarjen e popullsisë duhet të shqyrtohen si çështje të veçanta. Është shumë me rëndësi, që të bëhen edhe analiza të ndryshme për dendësinë, lëvizjet dhe shpërndarjen e popullsisë, të cilat përdoren në varësi të llojit dhe nivelit të planifikimit, kurse, me raste mund të zbatohen edhe indekse të veçanta për popullsinë urbane dhe rurale.

**Rëndësia e Indikatorit për zhvillimin hapësinor:** Indikatorit i dendësisë së popullsisë është i një rëndësie të veçantë për planifikimin e zhvillimeve të ardhshme hapësinore, meqë përmes shqyrtimit të komponentëve social, ekonomik e të tjerë, mundësohen edhe informata bazë mbi të cilat planifikohen zhvillimet e ardhshme. Në bazë të parametrave dhe trendit të këtij Indikatorit bëhen edhe planifikimet hapësinore si për ndërtime të objekteve shkollore, shëndetësore, kulturore, të banimit, të infrastrukturës dhe shërbimeve teknike, të organizimeve territoriale, të hapësirave të përbashkëta, etj.




**Gjendja e Indikatorit dhe krahasimi:**

Kosova, me vlerën mesatare për dendësinë e popullsisë prej 163.2 b/km², është prijëse në renditjen e vendeve të rajonit, të Evropës Jug-Lindore (Fig. 3), përdërisa vlerat mesatare nëpër komuna, janë të ndryshme. Komunit, me shkallë më të ulët të dendësisë së popullsisë, janë Zubin Potoku me 20 b/km², Laposaviqi 26 b/km², Shtërpçë 28 b/km², Novobërdë 33 b/km², etj. Ndërsa, komunit me shkallë më të lartë të dendësisë së popullsisë, janë Mamusha me 500 b/km², Fushë Kosova me 414 b/km², Prishtina me 380 b/km², Ferizaj me 315 b/km², etj.

Fig. 3. Grafiku i dendësisë së popullsisë në vendet e Ballkanit. Burimi: ASK 2013 dhe <http://en.wikipedia.org/wiki/Balkans>.

Fig. 4. Harta e shpërndarjes së dendësisë së popullsisë në rajon. Burimi: "Balkan vital Graphics", koleksioni nga



<http://www.grida.no/publications/vg/balkan>.

### **Konkluzione dhe rekomandime:**

- Vlera mesatare e dendësisë së popullsisë në Kosovë (163 b/km<sup>2</sup>), që është me e ulët se në vlerësimet e deritanishme por që ngelet më e larta në EJT (në Ballkan), është si pasojë e numrit të madh të popullsisë që jeton në një territor të vogël;
- Si në vendet e Evropës, e të rajonit edhe Kosova ka zonat me dendësi të popullsisë prej mbi 5000 b/km<sup>2</sup> (shih fig. 2). Këtu, përveç zonës së kryeqytetit vërehen edhe gjashtë qytete tjera dhe se këto 7 qendra të mëdha urbane si: Prishtina, Mitrovica, Peja, Gjakova, Prizreni, Ferizaj dhe Gjiçani, siç nënvizohet edhe në PHK-në 2010 – 2020+, i plotësojnë kushtet për kryeqendra regjionale (që përputhen me kriteret e kategorisë së regjioneve statistikore - NUTS 3) përbrenda territorit të Kosovës;
- Komunitet që kryesisht janë me territor të madh dhe numër të vogël të popullsisë, me sipërfaqe të pa banuar malore, që i përkasin brezit kufitar ose janë të banuara me komunitet pakicë, kanë dendësi më të vogël, me nën 50 b/km<sup>2</sup>. Kurse, komunitet me territor të vogël, që shtrihen në pjesë më të rrafshëta e qendrore të vendit, në tokat bujqësore, afër rrjedhave lumore e të korridoreve rrugore dhe që ndikohen nga grupimet e bizneseve të mëdha, të qendrave universitare e shëndetësore, të selive ndërkombëtare, etj, kanë shkallë më të lartë të dendësisë, me mbi 200 b/km<sup>2</sup>;
- Prandaj, gjatë hartimit të politikave të reja hapësinore dhe urbane kërkohet vëmendje e shtuar në krijimin e kushteve të barabarta jetësore në të gjithë territorin e vendit, të cilat do të ndikojnë në mënyrë direkte në zbutjen e dallimit të vendeve me dendësi shumë të madhe nga ato me shumë pak banorë për km<sup>2</sup>;

**Përshkrimi i Indikatorit:** Vendbanimet janë elemente mjaft të rëndësishme të hapësirës gjeografike. Ato përfaqësojnë atë pjesë të territorit të rregulluar për të jetuar një numër i caktuar banorësh. Mënyra se si organizohet një vendbanim, pamja që ai merr, funksionet që kryen, etj, janë tipare që shprehin edhe shkallën e zhvillimit të një vendi. Lartësia mbidetare kushtëzon dhe vështirëson zhvillimet socio-ekonomik, p.sh. sa më e madhe të jetë lartësia mbidetare, aq më pak tokë pune ka, terreni ka shkallë të lartë të përthyeshmërisë, qendrat e mëdha arrihen me vështirësi si dhe zhvillimet inovative janë më të ngadalësuara.

Relievi i copëtuar me format e tij shumë të larmishme ofron kushte të përshtatshme, por edhe më pak të përshtatshme për shtrirjen e vendbanimeve dhe zhvillimin ekonomik të tyre, prandaj, për t'i shfrytëzuar ato siç duhet, është e domosdoshme që të njihen mirë këto kushte.

**Mënyra e matjes së Indikatorit:** Analizat janë bërë në nivel të vendbanimeve, ashtu siç janë paraqitur nga regjistrimi i fundit i popullsisë së Kosovës (ASK, 2011), ndërkaq baza hispometrrike është siguruar nga EUDEM (*Modeli Digjital Relievor për Evropë*) me rezolucion 25 x 25 m, i siguruar nga programi "Copernicus" i Komisionit Evropian. Vendbanimet janë analizuar në nivelin e tyre të prezantimit si pikë apo siç njihen në terminologjinë e GIS-it si "Centroid".

**Burimi i informatës/ave:** Për paraqitjen e këtij Indikatorit janë përdorë informata nga Agjencia e Statistikave të Kosovës dhe nga EUDEM (*Modeli Digjital Relievor për Evropë*).

**Kufizimet për matjen e Indikatorit:** Konsiderohet se nuk ka ndonjë kufizim për matjen e vendbanimeve sipas lartësisë mbidetare pasi që informatat për vendbanimet dhe popullsinë janë siguruar nga ASK-ja, ndërsa baza hispometrrike është siguruar nga Modeli Digjital Relievor.

**Gjendja e Indikatorit dhe krahasimi:** Për të parë shtrirjen e vendbanimeve sipas lartësisë mbidetare në Kosovë, është bërë ndarja në katër (4) grupe hipsometrike:

1. Vendbanimet nga 0-499 m (*vendbanimet me lartësi të vogël mbidetare*),
2. Vendbanimet nga 500-699 m (*vendbanimet me lartësi të mesme mbidetare*),
3. Vendbanimet nga 700-899 m (*vendbanimet me lartësi të lartë mbidetare*) dhe
4. Vendbanimet mbi 900 m (*vendbanimet me lartësi shumë të lartë mbidetare*).

**Shtrirja e sipërfaqes së Kosovës sipas lartësisë mbidetare.** Pjesa më e madhe e sipërfaqes në Kosovë shtrihet në lartësinë mbidetare prej 500-699 m, me një pjesëmarrje prej 41.98 % të sipërfaqes së përgjithshme të Kosovës. Po ashtu, sipërfaqe e konsiderueshme shtrihet në lartësinë mbidetare prej 300-499 m me 20.42 % të sipërfaqes së përgjithshme të Kosovës. Në lartësinë mbidetare prej 700-899 m shtrihet 19.64 % e sipërfaqes së përgjithshme, ndërsa në lartësinë mbi 900 m shtrihet 17.96 % e sipërfaqes së përgjithshme të Kosovës.

**Lartësia mbidetare e vendbanimeve në Kosovë.** Nga analiza e vlerave të shtrirjes së vendbanimeve në Kosovë sipas lartësisë mbidetare shohim se në lartësinë mbidetare prej 0-500 m shtrihet një numër i konsiderueshëm i vendbanimeve, me një pjesëmarrje prej 24.6 % të vendbanimeve në Kosovë. Në lartësinë mbidetare prej 500-699 m shtrihet pjesa dërmuese e vendbanimeve të Kosovës me 47.3 % të vendbanimeve. Në lartësinë nga 700-899 m shtrihen 16.1 % të vendbanimeve, ndërsa në atë mbi 900 m shtrihen 12 % e vendbanimeve në Kosovë.

Mesatarja e lartësisë mbidetare të vendbanimeve në Kosovë është 635 m, ku pjesa dërmuese e vendbanimeve 922 apo 62.8 % kanë lartësi mesatare mbidetare më të ulët sesa mesatarja nacionale e vendbanimeve dhe 546 apo 37.2 % janë mbi lartësinë nacionale mesatare mbidetare të

vendbanimeve. Pika më e ulët mbidetare në Kosovë është 295 m (*pika e Liqenit të Vërmicës*) dhe vetëm disa metra mbi këtë nivel (14 m) është i vendosur vendbanimi me lartësinë më të ulët në Kosovë prej 309 m (*fshati Piranë në komunën e Prizrenit*).

Vendbanimi, i cili shtrihet në lartësinë më të madhe mbidetare është vendbanimi Pepaj, i cili shtrihet në 1558 m të l.m.d. Vendbanime tjera të cilat shtrihen në lartësi të mëdha mbidetare janë Shtupeq i Vogël (1471 m), Bellobaq (1424 m), Koshutan (1398 m), Shkrel (1396 m), Brod (1389 m) etj.




Fig. 1. Harta me zonim vertikal dhe lartësi mbidetare të qendrave komunale të Kosovës. Burimi: GIS-IPH /MMPH

**Lartësia mbidetare e qendrave komunale.** Në hartë janë dhënë pikat e qendrave komunale sipas lartësive mbidetare. Qendra komunale me lartësi më të vogël mbidetare është Mamusha, e cila shtrihet në 332 m lartësi mbidetare. Pas saj vjen Gjakova me 366 m, Hani i Elezit me 374 m, Klina 381 m, Suhareka 397 m, Prizreni 410 m lartësi mbidetare etj. Ndërsa Dragashi me 1026 m lartësi mbidetare është qendra komunale që shtrihet në lartësinë më të madhe mbidetare.

**Lartësia mesatare mbidetare e territorit të komunave.** - Komuna e Mamushës me 350 m është komuna me lartësinë më të vogël mbidetare në Kosovë. Komuna e Rahovecit, po ashtu ka një lartësi mesatare të vogël mbidetare me rreth 472 m, pastaj vjen Klina me 483 m, Gjakova me 514 m dhe Klllokoti 516 m. Komuna e Dragashit është komuna me lartësinë mesatare më të madhe mbidetare prej 1602m, më pas vjen komuna e Shtërpçës me 1328m dhe Junikut me 1286m lartësi mesatare mbidetare. Lartësi të madhe mbidetare kanë po ashtu edhe komuna e Deçanit me 1127m dhe e Pejës me 1062 m lartësi mbidetare.

**Shtrirja e popullsisë sipas lartësisë mbidetare.** Pjesa dërmuese e popullsisë së Kosovës jeton në lartësinë mbidetare prej 500-699 m, me një pjesëmarrje prej më shumë se 64 % të popullsisë së Kosovës, d.m.th popullsia është e koncentruar në terrenet e ulëta ose fushore. Po ashtu, edhe në

lartësinë mbidetare prej 300-499 m jeton një numër i konsiderueshëm i popullsisë me një pjesëmarrje prej më shumë se 28 % të popullsisë. Në lartësinë mbidetare mbi 700-899 m jeton 4.2 % e popullsisë, ndërsa në atë mbi 900m (viset kodrinoro malore) jeton 2.9 % e popullsisë së përgjithshme të Kosovës.

Nga analiza e vlerave të shtrirjes së popullsisë sipas lartësisë mbidetare shohim se rreth 93 % e popullsisë së Kosovës është e koncentruar në lartësinë mbidetare prej 0- 699 m.




Fig. 2. Grafiku me lartësitë mesatare mbidetare të komunave në Kosovë. Burimi: IPH /MMPH.

Rreth 50 vendbanime të Kosovës nuk kanë asnjë banorë rezident, pra janë vendbanime të shpopulluara. Mbi 40 vendbanime kanë më pak se 10 banorë rezident. Po ashtu, pesë (5) vendbanime janë të banuara me nga vetëm 2 banorë rezident. Vendbanimi me numrin më të vogël të popullsisë rezidente është fshati Vërnez i komunës së Vitisë, që është i banuar nga vetëm një banorë, ndërsa në regjistrimin e popullsisë të vitit 1981 ky vendbanim kishte 686 banorë, ndërsa në vlerësimin e vitit 1991 kishte 928 banorë. Ky vendbanim paraqet një rast tipik të shpërnguljes masive nga vendbanimet kodrinore-malore në vendet e ulëta, kryesisht në ato urbane apo sub urbane.

**Raporti i sipërfaqes, vendbanimeve dhe popullsisë sipas lartësisë mbidetare.** Nga të dhënat e paraqitura më lartë mund të konkludohet se në përgjithësi ka përputhje deri në lartësi të caktuara (nën 700 m) ndërmjet numrit të vendbanimeve, sipërfaqes dhe popullsisë sipas lartësisë mbidetare. Duke filluar nga lartësia mbidetare prej 700 m kemi një rënie të theksuar të popullsisë, ndërsa sipërfaqja e territorit dhe numri i vendbanimeve kanë një rënie më të lehtë.




Fig. 3. Raporti në mes të vendbanimeve, sipërfaqes dhe popullsisë sipas lartësisë mbidetare (në %). Burimi: IPH / MMPH.

### **Konkluzionet dhe rekomandimet:**

Lëvizjet e popullsisë në Kosovë në tri dekadat e fundit e sidomos pas luftës së fundit në Kosovë (1999) ndikuan që shumë vendbanime kodrinore-malore të mbesin pa popullsi me një tendence që edhe shumë prej tyre të depopullohen. Vendet kodrinore-malore, kryesisht ato kufitare kanë pasur një shpërngulje të theksuar të popullsisë. Vendosija e popullsisë së shpërngulur u bë kryesisht në vendbanimet e ulëta, sidomos përreth zonave urbane dhe sub-urbane.

Bazuar në dinamikën e depopullimit/shpopullimit të vendbanimeve, mund të pritët që në dy dekadat e ardhshme, vendbanimet me numër të vogël të popullsisë, sidomos ato me më pak se 50-100 banorë mund të mbeten të pabanuara, sikurse që është rasti me 50 vendbanime që tani më nuk kanë banorë rezident.

Në bazë të analizave që janë bërë mund të konkludohet se dendësia e banorëve në territorin e Kosovës nuk është e njëjtë. Për dallim nga zonat kodrinore-malore, zonat e ulëta dhe fushore janë më atraktive për banim dhe jetesë. Arsye për këtë dallim është zhvillimi i pabarabart hapësinor dhe ekonomik. Mungesa e infrastrukturës teknike dhe shërbimeve publike janë pengesat kryesore për shkak të të cilave shumica e këtyre banorëve vendosin për ndërrimin e vendbanimit.


Prandaj, duke i pasur parasysh analizat e mësipërme rekomandohet që:

- Të insistojmë në planifikimin e balancuar hapësinor dhe ekonomik për të gjithë territorin e Kosovës, përkthësisht territorin e komunave;
- Të hartohen politika dhe programe që do të ndokojnë në uljen e migrimit të brendshëm përmes:
  - o Subvencionimit të projekteve lokale për zhvillimin e bujësisë dhe turizmit rural;
  - o Ndërtimit të infrastrukturës teknike;
  - o Ngitjen e nivelit të shërbimeve komunale;
  - o Etj.



**Përshkrimi i indikatorit:** Ky indikator paraqet numrin ose % në mes së popullsisë që jeton në vendbanimet urbane dhe atyre rurale në raport me numrin e përgjithshëm të popullsisë për territorin e caktuar (Kosovë / Komunë). Për përcaktimin urban apo rural të një vendbanimi, përdoren kriteret e ndryshme.

Fig. 1. – Harta e popullsisë urbane nëpër komunat e Kosovës. Burimi: ASK 2013



**Mënyra e matjes së Indikatorit:**

Për të llogaritur përqindjen (%) e popullsisë urbane në raport me atë rurale, fillimisht duhet përcaktuar shkallën e urbanizimit të vendbanimit ose të njësisë territoriale, që varet nga kriteret për: dendësinë e popullsisë, të zhvillimit të veprimtarive ekonomike dhe të shërbimeve që ofrohen në të. Sipas prof. I. Ramadani, vendbanim urban është vendbanimi që ka minimum 2.000 banorë dhe ku 1/3 e të punësuarve punon në veprimtaritë terciare<sup>7</sup>. Kurse, nga Eurostat-i janë përcaktuar këto kriteret e për ndarjen e vendbanimeve në:

a) vendbanim rural (fshat), - që ka dendësi të popullsisë deri në 100 b/km<sup>2</sup> apo kur më shumë se 50% e popullsisë jeton në fshat dhe merret me veprimtari bujqësore,  
 b) vendbanim periferik (para-lagje), - që ka dendësi të popullsisë prej 100-300 b/km<sup>2</sup> ose së paku 5.000 banorë, dhe c) vendbanim urban (qytet), - që ka dendësi të popullsisë prej 1.500 b/km<sup>2</sup> dhe së paku me popullsi prej 50.000 banorë<sup>8</sup>.

**Burimi informatës/ave:** Burim i të dhënave më të sigurt, për popullsinë, dendësinë si dhe për klasifikimin e saj, sipas zonave përkatëse të para-përcaktuara, në popullsi urbane dhe rurale, është Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK).

<sup>7</sup> Ramadani I, "Planifikimi Hapësinor dhe Urban", Prishtinë 2013.

<sup>8</sup> [http://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php/Glossary:Revision\\_of\\_the\\_degree\\_of\\_urbanisation](http://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php/Glossary:Revision_of_the_degree_of_urbanisation)

**Kufizimet për matjen e Indiktorit:** Në Kosovë, organizimi territorial nuk ka qenë i definuar saktë dhe si i tillë ka pësuar ndryshime gjatë periudhave kohore, përderisa tani përcaktimi i vendbanimeve urbane realizohet në bazë të vendimeve administrative nga komunat përkatëse<sup>9</sup>. Territorin e Republikës së Kosovës, deri në vitin 1999 e përbënin 30 komuna, përderisa nga viti 2008 ishin 37 me 1467 vendbanime (shih fig. 2) dhe tani me shtimin e komunës Mitrovica e Veriut, në vitin 2015 janë 38 komuna me 1468 vendbanime. Meqë nuk kishte koncepte të qarta të përdorura gjatë regjistrimit të popullsisë dhe se numër i konsiderueshëm i popullsisë që jetonin në vendbanimet urbane ishin regjistruar si banor të vendbanimeve rurale, këto vlera nuk janë edhe aq reale, me çka rritet dyshimi dhe zvogëlohet diferenca në raportin e popullsisë urbane – rurale në Kosovë.

Kodi komunës Municipal code	Emri i komunës Name of municipality	Banorë Inhabitants	Sipërfaqja në km <sup>2</sup> Area in km <sup>2</sup>	Dendësia Density	Popullsia urbane Urban population	Popullsia rurale Rural population	Numri i vendbanimeve Number of settlements
01	Deçan	40019	294	136,1	3 803	36 216	37
02	Gjakovë	94556	587	161,1	40 827	53 729	88
03	Glllogoc	58531	276	212,1	6 143	52 388	35
04	Gjilan	90178	392	230,0	54 239	35 939	49
05	Dragash	33997	434	78,3	1 098	32 899	36
06	Istog	39289	454	86,5	5 115	34 174	50
07	Kaçanik	33409	211	158,3	10 393	23 016	31
08	Klinë	38496	309	124,6	5 908	32 588	54
09	Fushë Kosovë	34827	84	414,6	18 515	16 312	16
10	Kamenicë	36085	417	86,5	7 331	28 754	58
11	Mitrovicë	84235	336	250,7	58 458	25 777	47
12	Leposaviq	13773	539	25,6	5 505	8 268	75
13	Lipjan	57605	338	170,4	6 870	50 735	62
14	Novobërdë	6729	204	33,0	0	6 729	26
15	Obiliq	21549	105	205,2	6 864	14 685	20
16	Rahovec	56208	276	203,7	15 892	40 316	36
17	Pejë	96450	603	160,0	48 962	47 488	79
18	Podujevë	88499	633	139,8	23 453	65 046	77
19	Prishtinë	198897	523	380,3	161 751	37 146	43
20	Prizren	177781	627	283,5	94 517	83 264	76
21	Skenderaj	50858	374	136,0	6 612	44 246	49
22	Shtime	27324	134	203,9	7 255	20 069	23
23	Shtërpçë	6949	248	28,0	1 265	5 684	16
24	Suharekë	59722	361	165,4	10 422	49 300	41
25	Ferizaj	108610	345	314,8	42 628	65 982	45
26	Viti	46987	270	174,0	4 924	42 063	39
27	Vushtrri	69870	345	202,5	27 272	42 598	67
28	Zubin Potok	6616	334	19,8	1 724	4 895	61
29	Zveçan	7481	123	60,8	1 297	6 184	35
30	Malishevë	54613	306	178,5	3 395	51 218	44
31	Junik	6084	78	78,0	0	6 084	3
32	Mamushë	5507	11	500,6	0	5 507	1
33	Hani i Elezit	9403	83	113,3	0	9 403	11
34	Graçanicë	10675	122	87,5	0	10 675	17
35	Ranillugë	3866	78	49,6	0	3 866	13
36	Partesh	1787	29	61,6	0	1 787	3
37	Kilokot	2556	23	111,1	0	2 556	4
	<b>Kosovë</b>	<b>1780021</b>	<b>10906</b>	<b>163,2</b>	<b>682 438</b>	<b>1 097 586</b>	<b>1467</b>

Fig. 2. Tabela me të dhëna statistikore sipas komunave në Kosovë. Burimi: ASK 2013.

**Rëndësia e Indiktorit për zhvillimin hapësinor:** Indiktorit i raportit të popullsisë urbane dhe rurale është shumë i rëndësishëm dhe se duhet të analizohet me kujdes gjatë hartimit të planeve hapësinore, zhvillimore e sidomos atyre rregulluese të hollësishme për vendbanimet. Analiza dhe informatat e

<sup>9</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK): Atlasi i Regjistrimit të Popullsisë Kosovë 2011, Prishtinë 2013.

sakta për indikatorin në fjalë do të ndikojnë në ndrrimin e qasjes tonë për sa i përket aspektit urban. Në këtë mënyrë do të na bëhen më të qarta nevojat, arsyet dhe prioritetet për zhvillim hapësinor dhe urban.

**Gjendja e Indikatorit dhe krahasimi:** Sipas Regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë në Kosovë, të realizuar në vitin 2011, del se 682.438 banorë që përbëjnë 38 % të popullsisë së përgjithshme janë popullsi që jetojnë në zonat urbane, ndërsa 1.097.586 banorë apo 62 % janë popullsi që jetojnë në zonat rurale (shih fig. 3). Gjithashtu, nga tabela në fig. 2, mund të shihet sipërfaqja, numri i vendbanimeve si dhe numri i popullsisë përgjithshme dhe asaj urbane e rurale për secilën komunë, prej nga edhe nxirren raporte të ndryshme për popullsinë urbane, duke filluar nga më e ulëta prej 3.2 % në Komunën e Dragashit e deri tek më e larta prej 81.3 % në Komunën e Prishtinës.


Regjistrimi popullsisë 2011	Nr. Popullsisë urbane	% e Popullsisë urbane	Nr. Popullsisë rurale	% e Popullsisë rurale
Republika e Kosovës	682.438	38	1.097.586	62
Qendrat tjera komunale	180.872	10	795.749	45
7 Qendrat Regjionale	501.566	28	301.837	17
Prishtina	161.751	81.32	37.146	18.67
Prizreni	94.517	56.13	83.264	46.83
Mitrovica	58.458	69.39	25.777	30.60
Gjilani	54.423	60.35	35.939	39.85
Peja	48.962	50.76	47.488	49.23
Ferizaji	42.628	39.24	65.982	60.75
Gjakova	40.827	43.17	53.729	58.62

Fig. 3. Tabela me raportet e popullsisë urbane e rurale në Kosovë dhe qendrat regjionale. Burimi: IPH me të dhëna të ASK.

Nga analiza për numrin e përgjithshëm, përqindjet dhe raportet mes popullsisë urbane dhe rurale në Kosovë (shih tabelën e fig. 3), vërehet se: të shtatë qendrat më të mëdha urbane të Kosovës (përndryshe 7 qendrat regjionale sipas PHK-së të aprovuar më 2011), Prishtina, Prizreni, Peja, Mitrovica, Gjilani, Ferizaj dhe Gjakova, që janë qytete qysh nga vitet e 40-ta të shekullit të kaluar, kanë numër më të lartë të popullsisë urbane. Këto 7 qendra urbane, me gjithsejtë 501.566 banorë, përbëjnë 28 % të popullsisë së përgjithshme urbane të vendit, ndërsa pjesa tjetër prej 10 % ose 301.837 banorë, përbëjnë popullsinë urbane prej të gjitha qendrave urbane të komunave tjera. Në ndërkohë, vetëm në kryeqendrën e Kosovës - Prishtinë, jetojnë rreth 9.5 % e popullsisë së përgjithshme urbane, vlerë kjo e cila përbëni gati 90 % të popullsisë urbane që jetojnë në 23 qendrat urbane të komunave tjera, të cilat nuk janë qendra regjionale.

Kurse, krahasimi i vlerës së raportit urban / rural prej 38/62 % në favor të popullsisë rurale, me vlerat e raporteve të vendeve tjerë të rajonit në vitin 2005 (shih fig. 4), tregon për nivelin më të ulët të popullsisë urbane në raport me atë rurale në Kosovë.

Fig. 4. Grafiku për raportin e popullsisë urbane – rurale në vendet e rajonit.



### **Konkluzione dhe rekomandime:**

- Regjistrimi i fundit në Kosovë më 2011, tregon për zvogëlim (nga 40/60 % në 38/62 %) dhe de-balancim të raportit urban / rural si dhe mungesë të urbanizimit të vendbanimeve;
- Rritja e numrit të komunave, sidomos atyre me qendra komunale që i përkasin vendbanimeve rurale (ose që nuk i plotësojnë kriteret për të qenë vendbanime urbane), kanë shkaktuar edhe ndryshime tjera në strukturën e komunave fqinje, duke ia zvogëluar sipërfaqen e territorit në një anë dhe në anën tjetër duke ia shtuar dendësinë e popullsisë, përfshirë edhe % e popullsisë urbane;
- Urbanizimi assesi nuk mund të kufizohet vetëm në rritjen e numrit të popullsisë së qyteteve, por ai është një proces kompleks, i cili, përveç rritjes demografike të qyteteve, para së gjithash nga komponenti imigrues, nënkupton edhe transformimin e përbërjes sociale-ekonomike të popullsisë dhe të mënyrës së jetesës në përgjithësi;
- Është e nevojshme që të gjitha pjesët e qendrave komunale të pa-urbanizuara, sub-qendrat e përcaktuara me PZhK-të përkatëse si dhe vendbanimet tjera (të mëdha e të mesme rurale) nëpër komuna të kompaktësohen (me dendësim më të madh të popullsisë) e të urbanizohen;
- Për shkak të territorit të vogël të vendit dhe me qëllim të ruajtjes së tokës bujqësore, duhet të krijohen dhe zbatohen politika të orientuara drejt zhvillimit më të koncentruar dhe kompakt të vendbanimeve, përkundër trendit apo të vendbanimeve (lagjeve) të shpërndara;
- Bazuar në informatat dhe konstatimet e mësipërme është e domosdoshme që:
  - Të hartohen politika dhe programe për zhvillim të qëndrueshëm të zonave rurale;
  - Zonat rurale të jenë pjesë e instrumenteve të planifikimit hapësinor të të gjitha niveleve;
  - Prioritet për të gjitha nivelet e vendimarrjes duhet të jetë zhvillimi i mirëfillt urban i zonave rurale, përmes planeve adekuate në të cilat pjesëmarrja e komuniteteve duhet të jetë e domosdoshme;

<b>Indikator:</b>	<b>LËVIZJET E POPULLSISË - MIGRIMET E JASHTME</b>
<b>Synimi:</b>	NGRITJA E NIVELIT TË ZHVILLIMIT DHE KOHEZIONIT SOCIAL
<b>Objektivi:</b>	PARANDALIMI DHE ZVOGËLIMI I EMIGRACIONIT NË VEND DHE NËPËR KOMUNA

**Përshkrimi i Indikatorit:** Migrimet paraqesin lëvizjen në hapësirë të popullsisë apo të ndërrimit të vendbanimit nga shteti ëmë në një shtet tjetër. Sipas definicioneve dhe standardeve mbi migrimin ndërkombëtar: një person është Emigrant nëse ai/ ajo ka lënë vendin e tij/saj të lindjes në mënyrë që të vendoset në një shtet tjetër pa marrë parasysh nëse ka ndonjë status të veçantë në vendin në të cilin ka emigruar. Personi që ka migruar (vendosur) është person rezident i atij vendi (Shteti ku personi jeton, që do të thotë, shteti ku ai/ajo ka një vend për të jetuar, ku kalon periudhën ditore të pushimit. Udhëtimet e përkohshme jashtë atij vendit për: pushime, vizita tek miqtë apo të afërmit, për biznes, trajtim mjekësor apo pelegrinazh fetar, nuk e ndryshojnë vendin e qëndrimit të zakonshëm të personit)<sup>10</sup>.

**Mënyra e matjes së Indikatorit:** Shumë-dimensionaliteti dhe ndërlikueshmëria e migrameve hapësinore horizontale dhe sociale-vertikale e popullsisë imponojnë nevojën e studimit shkencor të të gjitha formave, drejtimeve, distancës territoriale, aspektit kohor, vëllimit, karakterit etnik, gjuhësor e të konfesionit dhe veçanërisht të shkaqeve dhe pasojave të tyre. Të dhënat janë përlogaritur në dy variante si: a) numri i popullsisë migruese në raport me popullsinë rezidente dhe b) numri i popullsisë migruese në raport me popullsinë e përgjithshme të vendit të origjinës.


**Burimi informatës/ave:** Të dhënat a) parësore për numrin e emigrantëve jashtë vendit sigurohen nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, b) sekondare sigurohen nga raporte hulumtuese të organizatave lokale dhe ndërkombëtare dhe c) terciare sigurohen nga studime individuale.

**Kufizimet për matjen e Indikatorit:** Mungesa e të dhënave në njësi administrative më të vogla hapësinore / territoriale, veçanërisht mungesa e të dhënave në kontekstin rural – urban, vështirëson edhe kryerjen e një analize më të thellë, për njohjen me gjendjen reale hapësinore dhe masat apo aktivitetet që duhet ndërmerren në përmirësimin e gjendjes në përgjithësi. Arsyet nxitëse, pse njerëzit migrojnë apo lëvizin duke ndërruar vendbanimin e tyre të mëparshëm me një vendbanim tjetër të ri, të komunës apo shtetit tjetër, janë të shumta, të cilat nga ekspertët e fushës ndahen, në faktorët: a) Shtytës dhe b) Tërheqës.

Ndërsa, zbrërthimi i këtyre faktorëve dhe shkaqet për migrim janë : i) *Sigurimi i ekonomisë familjare në të ardhmen* (kur një vend tjetër ofron mundësi punësimi, paga më të larta dhe mënyrë të mirë të jetesës, është faktorë shtytës që nxitë migrim nga vendet më pak të zhvilluara siç është Kosova); ii) *Standardi më i lartë i jetesës* (kur ofrohen kushte që sigurojnë një perspektivë karriere, shërbime më të mira sociale e shëndetësore dhe mënyrë më të mirë të jetesës edhe për fëmijët e tyre të cilat nuk ofrohen nga vendet e tyre të origjinës); iii) *Arsimim profesional* (kur vendi i origjinës nuk ofron përzgjedhje të profileve të ndryshme profesionale dhe ky faktorë bëhet një impuls për gjeneratat e reja me mundësi të emigrimit); iv) *Arsyet politike* (kur në vendin e origjinës ekzistojnë përndjekjet politike, kundërshtime për sistemin qeverisës dhe ka kufizim të lirisë së shprehjes, emigrimi bëhet me qellim të mos rrezikimit të jetës dhe se në shumë rasteve këtyre personave iu ofrohet edhe siguri personale, hapësirë për zhvillimin e aktiviteteve politike dhe lobim për vendin e tyre, etj); v) *Bashkim familjar* (kur anëtarët e familjes së ngushtë apo të gjerë nga vendi i origjinës bashkohen me anëtarët tjerë në vendin e ri të emigrimit, si dhe vi) *Arsye të tjera*<sup>11</sup>.

<sup>10</sup> Organizata Ndërkombëtare për Migracion: E drejta migratore ndërkombëtare: Fjalorth i terminologjisë migratore

<sup>11</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK): Migrimi kosovar , Prishtinë 2014



Në Kosovë që nga vitet e 60-ta të shekullit të kaluar, arsyet kryesore të emigrimit ndërkombëtar, janë të paraqitura në grafikun e fig. 1 dhe kanë këtë përqindje: Familjare 46%, Punësimi 35%, Lufta 1998-99 8%, Arsimimi & qëllime trajnimi 1%, tjera 4% dhe Arsyet që nuk dihen 6%.

**Fig. 1: Grafiku mbi migrimin ndërkombëtar & arsyet gjatë viteve 1969-2009.** Burimi: ASK 2013.

**Rëndësia e Indikatorit për zhvillimin hapësinor:** Të dhënat për migrimin ndërkombëtar, për hulumtuesit, sidomos për planerët demograf dhe social, paraqesin një burim të rëndësishëm për të vlerësuar trendin e migrimit në aspektin riprodhues, atë gjinor, të moshës dhe strukturave të tjera demografike në relacion me (mos) zhvillimin territorial të vendit. Këto të dhëna janë shumë të rëndësishme për hulumtues të disiplinave e organizatave të ndryshme dhe për hartuesit e politikave e të planeve hapësinore, si në nivel komune ashtu edhe në nivel vendi. Përderisa, emigrimi ndërkombëtar përfshin kryesisht të rinj, në migrimin kombëtar, ishin familje të tëra që u zhvendosën nga viset rurale, kryesisht kodrinore-malore, në viset urbane apo ndër-urbane.


Përveç ndikimit socio-ekonomik, migrimi ndikoi edhe në aspektin riprodhues të popullsisë së Kosovës dhe të zonave të caktuara. Nëse vazhdohet me këtë shkallë të migrimit të të rinjve, Kosova do të humbë një resurs shumë të rëndësishëm, pasojat e të cilit do të vërehen më vonë.

Andaj, Indikatorin e migrimin ndërkombëtar të popullsisë është i një rëndësie të veçantë për planifikimet e zhvillimeve hapësinore, ngase përmes shqyrtimit të komponentëve social, ekonomik dhe të tjerë, mundëson edhe informata bazë mbi të cilat planifikohen zhvillimet e ardhshme dhe politikë-bërjes brenda dhe jashtë shtetit.

**Gjendja e Indikatorit dhe krahasimi:** Sipas të dhënave zyrtare të Agjencisë së Statistikave të Kosovës cilat dalin nga regjistrimi i popullsisë së Kosovës (2011), të grumbulluara përmes FORMULARI S1, numri i personave (të lindurit në Kosovë) që kanë emigruar nga Kosova është 380,826 veta. Në raport me popullsinë rezidente në Kosovë, del se 21.4 % e popullsisë jeton jashtë saj. Bazuar në analizat e mëtejme të ASK-së, kur në llogaritjen e përgjithshme të numrit popullsisë së emigruar dhe asaj me prejardhje kosovare (1969 - 2011) për vlerë reprezentative është marrë vlera mesatare e shtimit natyror prej 153.978 fëmijëve të lindur jashtë Kosovës, ky numër është rritë dhe vlerësohet në rreth 704.000 banorë. Mirëpo, ky numër është akoma më i madh kur i shtohet edhe numri i të emigruarve nga vala e fundit (2014 - 2015).

Bazuar në të dhënat nga regjistrimi i popullsisë 2011, mbi 35% të të gjithë popullsisë kosovare kishte emigruar në Gjermani, në Zvicër me rreth 23% dhe në Itali me mbi 7%. Derisa, në vendet të tjerë si: Kanada, Australi si dhe vendet tjera përbënin mbi 10% të popullsisë emigruese kosovare. Nga raporti gjinor i popullsisë kosovare që kishte emigruar ishte: 56.67% meshkuj dhe 43.33 % femra. Emigrimi më i hershëm karakterizohej me dominim të gjinisë mashkullore (i fuqisë punëtore për të kaluar viteve të fundit në dominim nga femrat për shkak të martesave të shumta). Në emigrim është e përfshirë kryesisht moshë e re e popullsisë, si moshë kryesore riprodhuese në aspektin e fertilitetit dhe të fuqisë punëtore, e përfaqësuar nga Grup-moshë 25-44 vjeç dhe përbën 47.2% të popullsisë emigruese, me dominim Grup-moshe 30-34 vjeç me 12.7% brenda saj (ASK, 2014).

Harta. 2. Harta e migrimeve sipas komunave të Kosovës. Burimi: ASK 2014<sup>12</sup>.



Në raport me popullsinë rezidente, numrin më të madh të popullsisë së emigruar e kanë komuna e Suharekës me rreth 47% dhe komuna e Prishtinës me rreth 15% të popullsisë që jeton jashtë vendit. Ndërsa, me numrin më të madh të popullsisë që ka migruar prijnë komunat Prishtinë, Gjakovë Mitrovicë dhe Suharekë, përderisa me numrin më të vogël të emigrimit (nën 10%) janë komunat e vogla Ranillug, Partesh dhe Mamushë.


**Konkluzione dhe rekomandime:** Bazuar në analizën e të dhënave, del se Kosova është vend emigrantor me mbi 30% të popullsisë së përgjithshme që jeton jashtë vendit.

- Analiza e të dhënave dhe teoritë e migrimeve, tregojnë se, popullsia që emigron është kryesisht nga vendet më pak të zhvilluara në drejtim të atyre të zhvilluara, gjithnjë në kërkim të një jete më të mirë, siç është edhe rasti me Kosovën;
- Migrimi ndërkombëtar në Kosovë, ka atakuar të dy gjinitë dhe më së shumti grup-moshën e re të popullsisë;
- Ndër komunat me numrin më të madh të emigruarave bëjnë pjesë: Suhareka, Mitrovica, Klina dhe Gjakova. Andaj, në këtë kontekst, duhet bërë edhe më shumë analiza hapësinore brenda njësieve territoriale, për të gjetur shkaqet e emigracionit në këto komuna dhe për të ndërmarr veprime konkrete në parandalimin e migrimit të mëtejshëm, që për pasojë do të ketë zbrazjen e vendbanimeve (në veçanti atyre rurale) dhe debalancimin e strukturave demografike në vend.

<sup>12</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK): Migrimi kosovar , Prishtinë 2014

**Përshkrimi i Indikatorit:** Sipas EUROSTAT-it, Agjencisë Evropiane për Statistika, kapacitetet shkollore dhe personeli mësimor nëpër objektet arsimore paraqiten përmes raporteve në mes të numrit të nxënësve dhe numrit të mësimdhënësve, në kuadër të numrit të përgjithshëm të nxënësve të një hapësire të caktuar territoriale (shtet, rajon apo komunë).

**Mënyra e matjes së Indikatorit:** Nga të dhënat e publikuara në vitin 2015/2016 nga ASK, në Kosovë llogaritet të jenë 367.940 nxënës nga niveli parashkollor deri në nivelin e mesëm të lartë dhe 25.020 punëtorë arsimor, prej të cilëve 23.366 janë mësimdhënës, ndërsa 1.654 janë personel administrativ. Nga këto të dhëna është nxjerrë raporti ndërmjet nxënësve dhe mësimdhënësve, që sipas kriterit në udhëzimin administrativ të hartuar nga MASHT, ky raport, nëpër institucionet parashkollore duhet të jetë - 12 fëmijë për 1 edukator (12/1), përderisa nëpër institucionet e arsimit fillor dhe të mesëm të lartë ai duhet të jetë - 21 nxënës për 1 mësimdhënës (21/1). Po ashtu, janë shfrytëzuar edhe të dhëna tjera, për të njohur gjendjen në objektet shkollore dhe sa ato përmbushin kushtin për sipërfaqe - hapësirë optimale për një nxënës.



**Fig. 1. Grafiku me numrin e nxënësve dhe mësimdhënësve në arsimin fillor e të mesëm gjatë viteve të fundit.** Burimi: IPH me të dhëna nga ASK, "Statistikat e Arsimit 2010 - 2016", Prishtinë.

**Burimi informatës/ave:** Burim kryesor i informatave për këtë tregues është Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), me Raportet e statistikave të arsimit të publikuara në vitin 2015/2016 dhe në vitet paraprahe që nga 2010/2011. Gjithashtu, janë shfrytëzuar edhe informata tjera shtesë nga: Statistikat e Arsimit në Kosovë (2010-2016) të Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë si dhe planet zhvillimore komunale (PZHK-të e aprovuara viteve të fundit nga Asamblëtë e komunave gjegjëse).

**Kufizimet për matjen e Indikatorit:** Nga mungesë e të dhënave në disa nga PZHK-të, për gjendjen e objekteve shkollore dhe të hapësirës nevojshme për nxënës, është llogaritur një mesatare e përbashkët duke shfrytëzuar të dhënat nga shumica e komunave që e posedojnë këtë informatë. Në disa komuna, meqë në planet zhvillimore të tyre ofrohen të dhënat të njëjta (në përputhje me njëra tjetrën), nuk është shumë e sigurt se ato pasqyrojnë gjendje të saktë të shtrirjes së shërbimeve edukative - arsimore. Nga të dhënat statistikore në ASK dhe MASHT ka informata për numrin e objekteve shkollore, numrin e nxënësve, mësimdhënësve, personelit, me ndarjet sipas gjinisë e përkatësisë etnike, mirëpo nuk ka të dhëna për shtrirjen dhe gjendjen fizike të këtyre objekteve si dhe




të sipërfaqeve të përgjithshme përbrenda dhe jashtë duke përfshirë mesataret e sipërfaqeve të tyre për një nxënës.

**Rëndësia e Indikatorit për zhvillimin hapësinor:** Njohja me gjendjen, kapacitetin dhe shtrirjen e objekteve shkollore në territorin e Kosovës, është e një rëndësie të veçantë, për menaxhim të mirëfilltë të sistemit arsimor dhe për ndërmarrjen e hapave të tjerë që përfshijnë planifikimin e zhvillimeve të ardhshme në sektorin e arsimit. Të dhënat në dispozicion, jo vetëm që na tregojnë për nivelin e zhvillimit të shërbimeve edukative – arsimore, por edhe na orientojnë në përcaktimin e prioriteteve sektoriale dhe në fokusimin e investimeve të ardhshme, drejt plotësimit nevojave dhe kërkesave të nxënësve dhe të personelit të përfshirë në procesin e mësim-dhënies e të mësim-nxënies. Bazuar në rezultate të këtyre treguesve, planerët dhe politikë-bërësit i drejtojnë / adresojnë kërkesat e tyre për: ndërtim të objekteve të reja shkollore, rikonstruktiv, rehabilitim dhe rregullimin të kthinave e të hapësirave në objektet ekzistuese për laboratorë, kabinete dhe për avancimin e stafit mësimor përmes trajnimeve, si dhe rregullim të hapësirave rekreative e sportive, me qëllim të plotësimit të nevojat në përmirësimin e gjithmbarshëm të nivelit të shërbimeve edukative e arsimore.

**Gjendja e Indikatorit dhe krahasimi:** Në Kosovë, nga të dhënat e vitit 2015/2016 në nivelin parashkollor kemi një numër prej 3.915 fëmijësh dhe 528 edukatorësh, ku raporti del të jetë 7 fëmijë/1 edukator. Në arsimin fillor janë 258.464 nxënës dhe 17.563 mësimsdhënës, me raport 15/1. Në arsimin e mesëm vijnë 83.906 nxënës me 5.275 mësimsdhënës, ku raporti nxënës mësimsdhënës qëndron 17/1.

Kosova, në krahasimin e brendshëm (në mes të komunave) dhe të jashtëm (me disa vende evropiane), nuk ka dallime të madha në aspektin e raportit në mes nxënësve dhe mësimsdhënësve. Në nivelin parashkollor / para-fillor, raporti nxënës/mësimsdhënës në Kosovë është 18/1, kurse në Shqipëri 18/1, në Kroaci 13/1, në Itali 13/1, në Gjermani 8/1, në Austri 11/1, në Francë 20/1 dhe mesatare 12/1 në Evropë.

Në Kosovë, raporti nxënës/mësimsdhënës në nivelin fillor, është 15/1, në Shqipëri 19/1, në Kroaci 14/1, në Itali 12/1, në Gjermani 12/1, në Austri 11/1, në Francë 18/1, dhe mesatare 14/1 në Evropë. Kurse në nivelin e mesëm të lartë, ky raport në Kosovë është 17/1, në Shqipëri 16/1, në Kroaci 8/1, në Itali 13/1, në Gjermani 15/1, në Austri 12/1, në Francë 12/1 dhe me mesataren 12/1 në Evropë.



**Fig. 3. Grafiku me numrin e nxënësve/mësimsdhënës në: Rajon e Evropë (majtas) si dhe kontinente tjera (djathtas).** Burimi: IPH me të dhëna nga ASK 2016 dhe <http://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained-index.php-Education-statistics>.

Kurse, sipas standardeve të përcaktuara nga MASHT, hapësirat e nevojshme nëpër objekte shkollore për një nxënës janë: në institucionet parashkollore - 1.8-2.2 m<sup>2</sup>/nx. dhe 1.6-1.9 m<sup>2</sup>/nx. - në shkollat fillore e të mesme. Ndërsa, sipërfaqja mesatare për një fëmijë nëpër hapësirat e objekteve shkollore në Kosovë (e nxjerrë nga të dhënat në dispozicion për disa komuna), del të jetë: në institucionet parashkollore - 5.71 m<sup>2</sup>, për arsimin fillor - 4.28 m<sup>2</sup>/nx. dhe për arsimin e mesëm - 2.94 m<sup>2</sup>/nx. Mirëpo, kjo sipërfaqe ndryshon nga komuna në komunë, ku disa prej tyre hapësirën shkollore e kanë nën standardet e lejuara dhe disa të tjera e kanë numrin shumë të vogël të nxënësve, me çka edhe rritet hapësira për një nxënës (deri në 14.68 m<sup>2</sup>/nx në Vushtrri). Në komunat, si Ranillug, Graçanicë dhe Podujevë shihet se ka mungesë të institucioneve parashkollore sepse hapësirat për 1 fëmijë janë më


të vogla për dallim nga Vitija, Kllokoti, Vushtria të cilët kanë më shumë hapësirë për 1 fëmijë. Përderisa, komunat Dragash, Junik, Graçanicë, Shtërpçë dhe Mitrovicë, kanë mesatare të lartë të hapësirës shkollore për 1 nxënës (deri 9.23 m<sup>2</sup>/nx. - Junik) në shkollat fillore, Podujeva ka hapësirë të pamjaftueshme dhe nën standardet e lejuara (me 1.31 m<sup>2</sup>/nx.). Ndër komunat të cilat kanë hapësirë të madhe arsimin e mesëm të lartë janë: Graçanica (me 10.0 m<sup>2</sup>/nx.), Shtërpçë (me 5.51 m<sup>2</sup>/nx.), Hani i Elezit (me 4.30 m<sup>2</sup>/nx.). Ndërsa, komunat me hapësirë të pamjaftueshme për 1 nxënës janë: Vushtrria (me 1.47 m<sup>2</sup>/nx.), Suhareka (me 1.04 m<sup>2</sup>/nx.), Shtimja (me 1.45 m<sup>2</sup>/nx.) dhe Ranillugu (1.2 m<sup>2</sup>/nx.).

### **Konkluzione dhe rekomandime:**

- Në Kosovë, shtrirja e objekteve shkollore jo gjithmonë përkon edhe me shpërndarjen dhe dendësinë e popullsisë. Kemi qytete të mëdha me numër të pamjaftueshëm të objekteve shkollore dhe fshatra me pak banorë dhe objekte shkollore të pashfrytëzueshme;
- Në disa komuna ende është duke u aplikuar mësimi në tri ndërrime, përderisa në komuna të tjera ky sistem është ndryshuar me ndërtimin e shkollave të reja;
- Në disa komuna të Kosovës, në planet e tyre zhvillimore paraqitet mungesë hapësire dhe gjendje jo e mirë e objekteve shkollore (edukative – arsimore), ku edhe parashihen ndërtime të objekteve të reja për çerdhe, shkolla fillore dhe të mesme. Rëndësi e madhe në planifikimin e çerdheve i jepet komunave Mamushë, Novobërdë, Shtime, Junik, të cilat nuk kanë fare;
- Për shkak të mos përmbushjes së kushteve për arsimim më cilësor dhe për hapësira të nevojshme përcjellëse, si biblioteka, laboratorë e hapësira sportive, kemi raste kur nxënësit regjistrohen në shkolla private prej nivelit parashkollor në nivelin fillor dhe në atë të mesëm;
- Vlera e raportit nxënës/mësimdhënës, nuk ka dallim të madh me vendet tjera të Evropës, kjo rezulton se Kosova nuk është në gjendje të keqe sa i përket kapacitetit të kuadrove mësimdhënëse;
- Prandaj, rekomandohet që: me një menaxhim më të mirë të sigurohen hapësira përkatëse për mësim cilësor, dhe të ofrohet shërbim i transportit efikas për të gjithë nxënësit, në mënyrë që të zvogëlohet nevoja e ndërtimit të shkollave të reja, sidomos në rastet kur numri i nxënësve nuk është i mjaftueshëm.

**Përshkrimi i Indikatorit:** Sipas EUROSTAT-it, Agjencisë Evropiane për Statistika, kapacitetet teknike dhe njerëzore nëpër objektet e shërbimeve shëndetësore paraqiten përmes raporteve në mes të numrit të shtretërve dhe numrit të mjekëve për 100.000 banorë, në kuadër të numrit të përgjithshëm të popullsisë, të një hapësire të caktuar territoriale.

**Mënyra e matjes së Indikatorit:** Në Kosovë, nga statistikat e fundit, të publikuara në 2014 nga ASK<sup>13</sup>, llogaritet të jenë 13.680 persona të angazhuar për shërbime shëndetësore në sektorë të ndryshëm, prej të cilëve 5.420 janë mjekë, ndërsa 8.760 janë personel ndihmës profesional e jo profesional. Numri i shtretërve në të gjitha objektet shëndetësore është 3.767, të shpërndarë në shtatë spitale rajonale, si dhe në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK). Për të mundësuar krahasimin e vlerave të tanishme të rezultuara, për Indikatorin më specifik: raporti shtretër / banorë dhe raporti mjekë / banorë, të bazuar në numrin e përgjithshëm të popullsisë së Kosovës (1.739.825 b. - Regj. 2011), janë marrë edhe të dhënat nga vitet paraprake për të nxjerrë trendin e zhvillimit tyre.



**Fig. 1. Grafiku me numrin e shtretërve dhe të mjekëve gjatë viteve 2010-2014.** Burimi: IPH mbi të dhënat të ASK-së për vitet 2011, 2012, 2013 dhe 2014.

**Burimi informatës/ave:** Burimi kryesor i informatave për këtë tregues është Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), me Raportet e statistikave të shëndetësisë të publikuara në


vitin 2014 dhe në vitet paraprake. Po ashtu, janë përdorë edhe të dhëna tjera nga komunat e ndryshme, përkatësisht nga Raportet vjetore për nivelet shëndetësore që udhëhiqen prej drejtorive të shëndetësisë si dhe informata shtesë nga planet zhvillimore komunale (PZHK) të tyre. Një përqindje shumë e vogël e të dhënave buron edhe nga Instituti për Shëndetin Publik të Kosovës, për spitale rajonale dhe klinika të veçanta të QKUK-së.

**Kufizimet për matjen e Indikatorit:** Në mungesë të bashkëpunimit të rregullt e të bashkërendimit të mirë mes niveleve të ndryshme (qendror e lokal), kemi edhe mospërputhje në vlerat e fituara nga matjet e realizuara për numrin e personelit shëndetësor dhe të shtretërve. Kurse, në raportet e cekura më lartë, të ofruara nga sektori publik i shëndetësisë, mungojnë ose nuk përmenden fare (përveç në 3 raste) të dhënat mbi sipërfaqen e objekteve shëndetësore. Përderisa, të dhënat tjera për potencialin, kapacitetin dhe shërbimet e ofruara nga sektori privat i shëndetësisë nuk janë përfshirë fare dhe mungojnë plotësisht. Prandaj, bazuar në të gjitha këto kufizime, rrjedh se siguria për informacionin është e zbehur dhe nuk mundëson vlerësim të saktë mbi potencialin shëndetësor me kapacitetet teknike (të sipërfaqes, shtretërve dhe pajisjeve) dhe njerëzore (të stafit të angazhuar profesional e ndihmës) në raport me pacientët si dhe për cilësinë e shërbimeve të ofruara mjekësore nëpër objektet shëndetësore.

<sup>13</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)

**Rëndësia e Indikatorit për zhvillimin hapësinor:** Njohja me kapacitetin e potencialeve njerëzore e teknike dhe të shtrirjes së objekteve shëndetësore, është i një rëndësie të veçantë, për menaxhim të mirëfilltë të sistemit shëndetësor, duke përfshirë edhe planifikimin e zhvillimeve të ardhshme hapësinore për territorin e caktuar. Të dhënat në dispozicion, për shtrirjen dhe gjendjen e objekteve shëndetësore me numrin e shtretërve e të mjekëve, në raportin me numrin e pacientëve dhe


dendësinë e popullsisë, na tregojnë për nivelin e zhvillimit të shëndetësisë si dhe na orientojnë në përcaktimin e prioriteteve sektoriale dhe në fokusimin e investimeve të ardhshme, për të plotësuar nevojat e popullsisë të bazuara në këto dëshmi (fakte). Më saktësisht, na drejojnë për adresimit të kërkesave, për ndërtimin e objekteve të reja shëndetësore, për rikonstruktimin dhe rehabilitimin e objekteve ekzistuese, për rregullimin dhe adaptimin e kthinave për mjekime të veçanta dhe për avancimin e stafit profesional e të pajisjeve mjekësore, me të cilat do të ndikohet në përmirësimin e shërbimeve shëndetësore në përgjithësi.



**Fig. 2. Harta e shtrirjes së objekteve për shërbime shëndetësore në Kosovë.** Burimi: IPH

**Gjendja e Indikatorit dhe krahasimi:** Në Kosovë në sektorin dytësor të shëndetësisë kemi një kapacitet prej 2.020 shtretër të shpërndarë në shtatë spitalet rajonale, si dhe 1.747 në sektorin e shëndetësisë terciare, përkatësisht në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës.

Kosova, me vlerën mesatare prej 216.5 shtretërve për 100.000 banorë, ka vlerën me të vogël nga të gjitha vendet e Evropës, përfshirë edhe vendet që nuk janë anëtare të Bashkimit Evropian (BE). Në BE, vlera mesatare për numrin e shtretërve është 538.2 / 100.000 banorë, ku vlerën me të lartë e ka Gjermania me 824.8, ndërsa vlerën me të ulët e ka Suedia me 272.6, kurse në nivelin rajonal, jemi pas Kroacisë me 561.9, Maqedonisë me 459.1 dhe Turqisë me 251.6 shtretër për 100 000 banorë.



**Fig. 3. Grafiku për numrin e shtretërve dhe të mjekëve në Kosovë në raport me disa vende në rajon dhe Evropë.** Burimi: ASK 2014 dhe [http://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php/Healthcare\\_statistics](http://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php/Healthcare_statistics)

Ndërsa, sa i përket numrit të mjekëve në 100.000 banorë, në BE prinë Greqia me 612.6, që ndiqet nga Austria me 478.0 dhe me numrin më të vogël është Polonia me 217.9 mjekë, përderisa Kosova me 325.3 mjekë, në nivel rajoni qëndron me mirë dhe lë pas Kroacinë me 278.4, Maqedoninë me 269.6 dhe Turqinë me 168.8 mjekë / 100 000 banorë.

### **Konkluzione dhe rekomandime:**

- Shtrirja e objekteve për shërbime shëndetësore, në Kosovë, përkon me shpërndarjen dhe dendësinë e popullsisë - kujdesi më i madh ofrohet aty ku ajo është më shumë e koncentruar.
- Në Kosovë, potenciali i kapaciteteve njerëzore dhe teknike, nëpër objektet shëndetësore që ofrojnë shërbime: parësore (primare), dytësore (sekondare) dhe tretësore (terciare), ka pësuar ndryshime gjatë viteve të fundit, ku në vlerat e fituara dallohet një ulje e numrit të shtretërve dhe një rritje e numrit të mjekëve / 100 000 banorë (grafiku në fig. 1).
- Sikurse në Evropë ashtu edhe në Kosovë, për arsye të mos përmbushjes së kapaciteteve dhe të shkaqeve ekonomike, kemi edhe zvogëlim të numrit të shtretërve apo mungesë të tyre në raport me numrin e kërkesave për stacionim, gjë e cila sjellë mbingarkesë të objekteve shëndetësore.
- Zvogëlimi i numrit të shtretërve nëpër objektet shëndetësore është bërë për shkak të mungesës së hapësirave të nevojshme, të kthinave të veçanta për mjekime specifike dhe për vendosje të aparaturës / pajisjeve mjekësore të teknologjisë bashkëkohore.
- Vlera e raportit mjekë/banorë, edhe pse rezulton se është në rritje, është më se e nevojshme të rritet akoma më shumë për të përballuar kërkesat evidente për shërbime të ndryshme nga mjekë me specializime të ndryshme.
- Me një menaxhim më të mirë, do të sigurohej një shërbim 24 orësh për 7 ditë (24/7), sidomos në punktet e sektorit të shëndetësisë parësore dhe me theks të veçantë nëpër zonat rurale, do të ndikonte në zvogëlimin e rrezikut për jetë, me gjithë vështirësitë për udhëtime të gjata për tek qendrat e mëdha / objektet e shëndetësisë dytësore e terciare dhe gjendjen sociale të popullsisë dërmuese në Kosovë.

**Indikatori:** SHKALLA E VARFËRISË SIPAS KONSUMIT TË EKONOMIVE FAMILJARE  
**Synimi:** BALANCIMI I ZHVILLIMIT SOCIAL DHE PËRMIRËSIMI I STANDARDIT  
 JETËSOR  
**Objektivi:** RRRITJA EKONOMIKE PËR ULJEN E VARFËRISË


**Përshkrimi i Indikatorit:** Shkalla e varfërisë sipas konsumit të ekonomisë familjare paraqet përqindjen e popullsisë, ku konsumi i ekuivalentit për të rritur, është më i ulët se sa kufiri i caktuar i varfërisë.<sup>14</sup> Shkalla e varfërisë paraqet numrin e popullsisë së varfër, por nuk e tregon intensitetin e varfërisë. Sipas linjës (kufirit) varfëria klasifikohet si varfëri e përgjithshme dhe varfëri e skajshme (ekstreme). Në varfëri të përgjithshme, popullsia nuk arrin ti përmbush nevojat themelore për ushqim, higjienë, veshje, strehimin, kujdes shëndetësor dhe arsimim, ndërsa në varfëri ekstreme popullsia nuk arrin të plotësoj kërkesat themelore as për ushqim.

**Mënyra e matjes së Indikatorit:** Shkalla e varfërisë sipas konsumit është matës më real dhe më i saktë, e cila paraqet numrin e popullsisë së varfër që bie nën nivelin (linjën) e varfërisë në raport me numrin e përgjithshëm të popullsisë.

**Burimi informatës/ave:** Burim i informatave për këtë indikator është Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), Sektori i Standardit Jetësor përkatësisht Departamenti i Statistikave Sociale (DSS), i bazuar në Anketën e Buxhetit të Ekonomive Familjare (ABEF), për të ofruar të dhëna statistikore lidhur me konsumin, të ardhurat, si dhe për çështjet tjera të ngjashme që kanë të bëjnë me standardin jetësor të ekonomive familjare në Kosovë.

**Kufizimet për matjen e Indikatorit:** Vlerësimet e varfërisë në Kosovë përgjatë viteve 2003 – 2008 sipas të dhënave të përgatitura nga rezultatet e ABEF, nuk janë drejtpërsëdrejti të krahasueshme për shkak të dallimeve të instrumentit matës dhe kornizës së mostrës, përveç të dhënave të përgatitura sipas mostrës së njëjtë të vitit 2008, për vitet 2009, 2010 dhe 2011 të cilat janë të krahasueshme. Kufizimet për matjen e Indikatorit qëndrojnë në qasjen dhe vjetërsinë e të dhënave (2011).

**Rëndësia e Indikatorit për zhvillimin hapësinor:** Shkalla e varfërisë është tregues i rëndësishëm që shërben për të identifikuar rajonet të cilat kanë përqindjen më të madhe të popullsisë së varfër si dhe për ta krahasuar atë sipas standardit të jetesës, në mënyrë që në të ardhmen të planifikohet një zhvillim më i balancuar socio- ekonomik në të gjithë territorin. Në vendbanimet përreth qendrave rajonale, si në Prishtinë, Mitrovicë, Prizren, Pejë, Gjakovë, Gjilan dhe Ferizaj, për uljen e varfërisë duhet planifikuar



rritje ekonomike për zhvillim social më të balancuar për përmirësim të standardit jetësor.

**Fig.1. Varfëria dhe varfëria e skajshme sipas vendbanimit (%) 2009-2011.** Burimi: ABEF 2009-2011<sup>15</sup>

### Gjendja e Indikatorit dhe

**krahasimi:** Problemi i varfërisë në aspektin socio-ekonomik është shumë i madh. Shkalla e varfërisë në Kosovë, në PHK 2010-2020+, sipas të dhënave të realizuara gjatë vitit 2004 (të bazuara në hulumtimet e Bankës Botërore) ka qenë: 50.3% e popullatës ka jetuar në varfëri të përgjithshme, kurse 16% e popullatës ka jetuar në varfëri ekstreme. Ndërsa, sipas të dhënave të bazuara në ABEF-in e vitit 2011 të përgatitura nga BB dhe ASK, është vlerësuar se 29.7% e popullsisë së Kosovës jetojnë nën linjën e kufirit të varfërisë, ndërsa 10.2% e popullsisë jetojnë nën linjën e kufirit të varfërisë së

<sup>14</sup> Varfëria në konsum në Republikën e Kosovës në vitin 2011, mars 2013

<sup>15</sup> BB, ASK, Varfëria në Konsum në Republikën e Kosovës në vitin 2011, Prishtinë, mars 2013


skajshme. Sipas (fig.1) shkalla e varfërisë është më e lartë në vendbanimet rurale, përveç shkallës së varfërisë së skajshme të vitit 2009 që është me e lartë në vendbanimet urbane. Shkalla e varfërisë prej vitit 2009 - 2010 është zvogëluar për 5%, ndërsa prej vitit 2010 – 2011 është rritur në masë të vogël për 0.5%.

Standardi jetësor i një ekonomie familjare varet nga madhësia dhe struktura demografike e ekonomisë familjare. Sipas të dhënave të përgatitura në vitin 2011, nga ASK dhe BB, në Kosovë, linja e kufirit të varfërisë së përgjithshme është 1.72€ në ditë, ndërsa, linja e kufirit të varfërisë ekstreme është 1.20€ në ditë, për ekuivalentin për të rritur (fig.2).

Viti	Kufiri i varfërisë së përgjithshme (me ekuivalentin për të rritur në ditë)	Kufiri i varfërisë së skajshme (për ekuivalentin për të rritur në ditë)
2011	1.72€	1.20€
2010	1.61€	1.07€
2009	1.55€	1.02€

**Fig.2. Linjat e kufirit të varfërisë së përgjithshme dhe varfërisë së skajshme.** Burimi: Varfëria në Konsum në Republikën e Kosovës në vitin 2011


Sipas raportit të BB “Varfëria në konsum në Republikën e Kosovës në vitin 2009”, shkalla e varfërisë sipas shpërndarjes gjeografike të popullatës në rajonet e Kosovës, në: Ferizaj, Gjakovë, Gjilan, Mitrovicë, Prishtinë dhe Prizren është 16% -17% të të varfërve, ndërsa në Pejë është 11.0 % dhe Gjilan 5.8%, të të varfërve të Kosovës. Varfëria e skajshme është më e shprehur në rajonet e Gjakovës dhe



Mitrovicës që përbën më shumë se 20%, Prishtina me 18.7% dhe Gjilani, Peja dhe Prizreni së bashku përbëjnë 23.4 %, të popullatës në varfëri të skajshme (fig3).

**Fig 3: Shpërndarja e të varfërve, 2009<sup>16</sup>.** Burimi: IPH sipas të dhënave nga vlerësimet e stafit të Bankës Botërore bazuar në ABEF 2009

Sipas të dhënave zyrtare të vendeve të rajonit të publikuara, të vitit 2011, Kosova është vendi më i varfër në Evropën Juglindore, me shkallën më të lartë të varfërisë (29.7%), pastaj radhiten: Maqedonia (27.1 %), Bosnja dhe Hercegovina (17.9 %), Shqipëria me të dhënat e vitit 2012 (14.3 %), Mali i Zi (9.3 %) dhe e fundit është Serbia (6.8 %) me shkallën më të ulët të varfërisë (fig.4).



**Fig.4. Shkalla e Varfërisë në vendete Evropës Juglindore.** Burimi: IPH me të dhëna zyrtare të rajonit.

<sup>16</sup> BB, ASK, Varfëria në Konsum në Republikën e Kosovës në vitin 2009, Prishtinë, maj 2011

### **Konkluzione dhe rekomandime:**

- Si rezultat i shkallës së ultë të rritjes ekonomike (3-4)%, Kosova nuk arrin të krijoj një zhvillim të balancuar socio-ekonomik, si dhe të përmirësojë standardin jetësor, gjendjen sociale në Kosovë si dhe të ndikojë në uljen e varfërisë;
- Sipas vlerësimit të Bankës Botërore të vitit 2012, Kosova radhitet në grupin e shteteve me “të ardhura të ulëta të mesme”<sup>17</sup> kështu që popullata akoma lufton të përmbushë nevojat themelore të konsumit.

Prandaj, rekomandohet:

- Nga hartuesit e politikës, të hartohet një strategji me qëllim të redukimit të varfërisë, e cila do të jetë prioritet i programit politik dhe do të përshpejtojë zhvillimin në shkallë të gjerë;
- Të hartohet një strategji e zhvillimit të përgjithshëm ekonomik për uljen e shkallës së varfërisë, sipas politikave efikase ekonomike për rritje ekonomike, në mënyrë që të nxitë ngritjen e: sektorit public e privat prodhues (industrisë), eksportit, remitencave, përkrahjes së ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, etj., të cilat do të ndikonin në gjenerimin e vendeve të punës, ngritjen e nivelit të të ardhurave, ndihmave sociale dhe ekonomike dhe cilësisë së kushteve të banimit, dhe në përgjithësi në përmirësimin e standardit jetësor;
- Zhdukja e varfërisë së skajshme të jetë prioritet i hartuesëve të politikave të qeverisë me qëllim të rritjes së mirëqënies sociale në vend;
- Të përgatiten informata (vlerësime) statistikore për çështjet e varfërisë, të bazuara në regjistrimin e përgjithshëm të popullsisë, me qëllim të krahasueshmërisë dhe qasjes së të dhënave;
- Sipas të dhënave për zbutjen e varfërisë, për një periudhë më afatgjate Kosovës i duhet rritje ekonomike mbi 8 për qind;
- Në këtë drejtim përparësi për zhvillim duhet të kenë sektorët shëndetësisë dhe arsimit që kanë ndikim të drjtëpërdrejtë rritjen e standardit jetësor në përgjithësi.

---

<sup>17</sup> Ministria e Tregtisë dhe Industrisë: Strategjia për Zhvillimin e Sektorit Privat 2013-2017, Prishtinë, Mars 2013.




Iphk  
010/1.10

Indikatori: SHKALLA E PAPUNËSISË

Synimi: ZHVILLIM I KOHEZIONIT SOCIO-EKONOMIK NË KOSOVË

Objektivi: NGRITJA E NIVELIT TË PUNËSIMIT DHE RITJIA E ZHVILLIMIT TË BALANCUAR

**Përshkrimi i Indikatorit:** Shkalla e papunësisë paraqet raportin e të papunësuarve (në numër ose përqindje) në kuadër të kapacitetit të përgjithshëm të fuqisë punëtore aktive në nivel vendi ose të një territori të caktuar brenda një vendi apo në tërë. Pra, ky indikator socio-ekonomik tregon nivelin e fuqisë punëtore të pashfrytëzuar në proceset ekonomike në tërë territorin e Kosovës.



**Mënyra e matjes së Indikatorit:** Për të llogaritur përqindjen (%) e popullsisë së papunësuar, së pari duhet të nxirret numri e me të edhe raporti i popullsisë së aftë dhe të gatshme për punë, në kuadër të popullsisë aktive për punë. Më pas, nga ai numër i përgjithshëm i kësaj kategorie të popullsisë zbritet numri i popullsisë së punësuar dhe në këtë mënyrë gjendet edhe shkalla e papunësisë, si raport i ndryshimit të atyre vlerave, në këtë rast sipas komunave në Kosovë.


Fig 1. – Harta e papunësisë nëpër komunat e Kosovës. Burimi: ASK 2013<sup>18</sup>.

**Burimi informatës/ave:** Burimi i të dhënave më të sigurta dhe zyrtare, për popullsinë dhe strukturën e përgjithshme ekonomike të saj në Kosovë, sipas zonave përkatëse të parapërcaktuara për moshën aktive dhe jo aktive, është Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK).

**Kufizimet për matjen e Indikatorit:** janë standardet ndërkombëtare sipas të cilave identifikohen dy ndarje të popullsisë “ekonomikisht aktive”: popullsia aktive “e zakonshme”, e matur në lidhje me një periudhë të gjatë reference si ajo vjetore, dhe popullsia aktive “aktuale” që matet në lidhje me një periudhë më të shkurtër reference si javore apo ditore, në bazë të të cilave kufizohemi në gjetjen e shkallës së papunësisë, duke e zbritur me numrin e përgjithshëm të të punësuarve<sup>19</sup>. Këto vlera të papunësisë së Republikës së Kosovës, këto matje nuk mund të jenë edhe aq reale, meqë nuk ka koncepte të qarta për regjistrimin e përgjithshëm të shkallës së papunësisë dhe se këto rezultate janë të bazuara në të dhënat e mbledhura nga anketat.

<sup>18</sup>Agjencia e Statistikave e Kosoves (ASK), Atlasi i Regjistrimit të Popullsisë 2011, Prishtinë 2013.

<sup>19</sup> INSTAT, “Njerëzit dhe Puna në Shqipëri” faqe 28, Tiranë 2004.



Indikatorët kryesorë të tregut të punës (%)	Meshkuj	Femra	Totali
Shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore	61.8	21.4	41.6
Shkalla e joaktivitetit	38.2	78.6	58.4
Raporti punësim ndaj popullsisë (shkalla e punësimit)	41.3	12.5	26.9
<b>Shkalla e papunësisë</b>	<b>33.1</b>	<b>41.6</b>	<b>35.3</b>
Shkalla e papunësisë tek të rinjtë (15-24 vjeç)	56.2	71.7	61.0
Përqindja e të rinjve NEET në popullsinë e të rinjve (15-24 vjeç)	26.6	34.0	30.2
Përqindja e punësimit të paqëndrueshëm ndaj punësimit të përgjithshëm	26.7	18.9	24.9

Fig. 2. Skema e klasifikimit tregut të punës për popullsinë e Kosovës. Burimi: Rezultati AFP-së më 2014<sup>20</sup>.

**Rëndësia e Indikatorit për zhvillimin hapësinor:** Indikatorit i raportit të papunësisë ndaj popullsi së përgjithshme është shumë i rëndësishëm dhe se duhet të analizohet me kujdes gjatë hartimit të planeve zhvillimore-ekonomike të një rajoni. Analiza e mirëfilltë e këtij Indikatorit na parapërgatitë për një shfrytëzim sa më racional të popullsisë aktive. Pra, duhet gjetur zgjidhje që ofrojnë hapjen e vendeve të reja të punës dhe njëkohësisht zbritjen e shkallës së papunësisë dhe rritjen e zhvillimit rajonal (ekonomik, administrativ, tregtar, etj) dhe të infrastrukturës e shërbimeve adekuate për investitorët.




Fig. 3. Paraqitja grafike e nivelit të papunësisë së Kosovë me vendet e rajonit. Burimi: Anketimet e Fuqisë Punëtore (AFP apo LFS) të Zyrave Kombëtare të Statistikave.

**Gjendja e Indikatorit dhe krahasimi:** Sipas anketimit të fuqisë punëtore më 2014, nga numri i përgjithshëm i popullsisë aktive del se shkallën e papunësisë në Kosovë, e përbëjnë rreth 35,5 % të papunësuar. Ndërsa Kosova në krahasim me vendet e rajonit të Evropës Juglindore por edhe më tej ka nivelin papunësinë më të lartë ndër vite (figura 2).

<sup>20</sup> ASK, "Rezultatet e Anketës së Fuqisë Punëtore në Kosovë 2014" faqe 10, Prishtinë, Qershor 2014 (Shënim: Të dhënat për Kosovën për vitin 2010 nuk janë në dispozicion).

### **Konkluzione dhe rekomandime:**

- Të dhënat e fundit nga regjistrimi i popullsisë tregojnë se nga 1.252.248 banorë të Kosovës që janë mbi 15 vjeç, 508.100 e tyre përbëjnë fuqinë punëtore në Kosovë. Nga ta, 280.454 persona janë të punësuar kurse 227.464 persona të tjerë konsiderohen të pa punë.
- Shkalla e papunësisë assesi nuk mund të kufizohet vetëm me rritjen e numrit të popullsisë së përgjithshme, sepse ky është një tregues shumë kompleks, i cili, përveç rritjes demografike të popullsisë, nënkupton edhe transformimin e përbërjes sociale-ekonomike të popullsisë dhe të mënyrës së jetesës në përgjithësi;
- Është e nevojshme që të gjitha qendrat komunale të paraqesin të dhënat e përgjithshme të popullsisë, para së gjithash numrin e të papunëve;
- Për shkak të territorit të vogël të vendit dhe me qëllim të zhvillimit ekonomik, ku kemi një numri të vogël të popullsisë, është e domosdoshme të krijohen vende pune, të cilat do të arrinin vetëm me anë të zhvillimit të hapësirës dhe rritjes së prodhimit ekonomik vendor.


**Përshkrimi i Indikatorit:** Bruto Produkti Vendor (BPV) për kokë banori është tregues më i rëndësishëm makroekonomik në Sistemin e Llogarive Kombëtare, i cili paraqet performancën e ekonomisë së një shteti për një periudhë të caktuar kohore duke e krahasuar me periudhën paraprake (me vitin paraprak) dhe vendet tjera kurse në aspektin social përdoret për të vlerësuar gjendjen e standardit jetësor të banorëve.

**Mënyra e matjes së Indikatorit:** BPV për kokë banori (€/b) llogaritet në bazë të vlerës reale të bruto produktit të një vendi (BPV) duke e pjesëtuar me numrin e banorëve të atij vendi. BPV llogaritet në bazë të parimeve metodologjike të Sistemit Evropian të Llogarive “European System of Accounts” - ESA 2010 dhe “System of National Accounts” - SNA 2008.<sup>21</sup>

**Burimi informatës/ave:** Burim i informatave për këtë indikatorë është Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) në bashkëpunim me Institucionet financiare (BQK) dhe Institucionet Qeveritare.

**Kufizimet për matjen e Indikatorit:** BPV / kokë banori në të shumtën e rasteve klasifikohet si indikator indirekt për të vlerësuar standardin e jetës, pasi që BPV reale në kalkulim nuk i merr parasysh shpenzimet (sociale) private të shoqërisë dhe shpenzimet që shkaktohen në mjedis si pasojë e aktiviteteve ekonomike. Për shkak të hulumtimeve dhe analizave nga institucione të ndryshme për këtë tregues jepen edhe vlera të ndryshme.

**Rëndësia e Indikatorit për zhvillimin hapësinor:** Bruto Produkti Vendor (BPV) për kokë banori, është



tregues i rëndësishëm që ndihmon procesin e zhvillimit hapësinor. Vendet me BPV shumë më të lartë kanë potencial më të madh për të planifikuar zhvillimet e ardhshme dhe për të krijuar ekonomi më funksionale. Planifikimi ekonomik bëhet në bazë të rezultateve dhe trendit zhvillimor të llogarive kombëtare.

Sipas vlerësimit të Bankës Botërore të vitit 2012, Kosova synon të radhitet në grupin e shteteve me “të ardhura të sipërme të mesme” deri në vitin 2020, ndërsa deri më 2030 – ajo synon grupin e shteteve me “të ardhura të larta”.<sup>22</sup>

**Fig.1. Grafikoni i rangimit të Kosovës në indeksin e zhvillimit të BB.** Burimi: MTI, Strategjia e Zhvillimit Sektorit Privat 2013-2017.

<sup>21</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), Bruto produkti vendor në qasjen e shpenzimeve (2008-2013), Prishtinë, Shtator 2014.

<sup>22</sup> Ministria e Tregëtisë dhe Industrisë: Strategjia për Zhvillimin e Sektorit Privat 2013-2017, Prishtinë Mars 2013.





Fig.2. Vlerat e BPV-së për kokë banori në vendet e rajonit në vitin 2013. Burimi: IPH me të dhënat zyrtare statistikore për BPV për kokë banori nga vendet e rajonit

**Gjendja e Indikatorit dhe krahasimi:** Sipas Bankës Botërore, vlerësim i vitit 2012 (fig. 1), Kosova bën pjesë në grupin e shteteve me të ardhura të ulëta të mesme të selektuara në rajonin “Evropë dhe Azi Qendrore”<sup>23</sup>. Kurse, sipas të dhënave zyrtare statistikore të vendeve të rajonit të publikuara, gjendja e Bruto Produktit Vendor (BPV) për kokë banori

me vlerë më e lartë në vitin 2013 është regjistruar në Malin e Zi (5,412€), e ndjekur nga Serbia (4,731€), Maqedonia (3,930 €), Bosnja dhe Hercegovina (3,509€), Shqipëria (3,358€)<sup>24</sup> dhe e fundit me BPV-në për kokë banori më të ulët në rajon është Kosova (2,935 €) si në (fig.2).



Sipas ASK 2014, BPV në Kosovë është rritur në vlerën prej 3,882.8 milion euro në 5,326.6 milion euro ndërsa BPV për kokë banori (fig.3) është rritur prej 2,258 euro (në vitin 2008) deri në 2,935 euro (në vitin 2013). Rritja reale e BPV për vitin 2013 vlerësohet të jetë rritur me një normë prej 3.4 %.<sup>25</sup>

Fig.3. Grafiku i paraqitjes së BPV/kokë banori në Kosovë 2008-2013. Burimi: ASK, BPV në qasjen e shpenzimeve (2008- 2013).

### Konkluzione dhe rekomandime:

- Performanca ekonomike e Kosovës nuk është në nivel të kënaqshëm dhe në krahasim me vendet tjera, ajo radhitet e fundit me BPV-në për kokë banori prej 2.935 € - është më e ultë në rajon dhe Evropë;
- Sipas ASK-së vlera e BPV-së dhe BPV-së për kokë banori është në rritje (ngritja e BPV është mesatarisht 250 mijë euro gjatë një viti), por nuk është e mjaftueshme që të ndryshojë gjendjen sociale në Kosovë dhe të ndikojë në uljen e papunësisë dhe varfërisë;
- Procesi i zhvillimit ekonomik në Kosovë është shumë i ngadalshëm si pasojë e moszbatimit të ligjit, evazionit fiskal, kontrabandës ekonomike, të mungesës së: një strategjie të zhvillimit të përgjithshëm ekonomik, politikave efikase ekonomike, sektorit prodhues, përkrahjes shtetërore të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme si dhe të rënies së investimeve të reja nga investitorët e vendit dhe të huaj;
- Si rezultat i shkallës së ultë të rritjes ekonomike, Kosova nuk arrin të krijojë një zhvillim të balancuar socio-ekonomik, si dhe të përmirësojë standardin jetësor, për të krijuar të ardhura më të larta dhe për të ofruar qasje në konsumin e mallrave dhe të shërbimeve cilësore arsimore e shëndetësore.

<sup>23</sup> Ministria e Tregtisë dhe Industrisë: Strategjia për Zhvillimin e Sektorit Privat 2013-2017, Prishtinë Mars 2013.

<sup>24</sup> Të dhënat zyrtare statistikore për BPV për kokë banori nga web. faqet zyrtare të rajonit ([www.stat.rs](http://www.stat.rs); [www.monstat.org](http://www.monstat.org); [www.instat.gov.al](http://www.instat.gov.al); [www.bhas.ba](http://www.bhas.ba); [www.stat.gov.mk](http://www.stat.gov.mk)).

<sup>25</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), Bruto produkti vendor në qasjen e shpenzimeve (2008-2013), Prishtinë ,Shtator, 2014

**Përshkrimi i Indikatorit:** Ky indikator paraqet hisen e pjesëmarrjes së sektorëve të bujqësisë, industrisë dhe të shërbimeve si përfaqësuesit (komponentë) kryesor në krijimin e të ardhurave në kuadër të Bruto Produkti Vendor (BPV), i cili është Indikatorin më i rëndësishëm ekonomik në Sistemin e Llogarive Kombëtare për paraqitjen ekonomisë së një shteti në një periudhë të caktuar.

**Mënyra e matjes së Indikatorit:** Ky indikator shprehet në përqindje të pjesëmarrjes të tri komponentëve kryesor në BPV për periudha të caktuara kohore dhe të krahasueshme me shtete tjera në botë.

**Burimi i informatës/ave:** Burimi referues për këtë tregues është Agjencia për Statistika e Kosovës (ASK 2015), me ndihmën e Zhvillimit të Indikatorëve Botëror (World Development Indicators, 2011) dhe të parimeve metodologjike të Sistemit Evropian dhe Sistemit Kombëtar të Llogarive ("European System of Accounts" - ESA 2010 & "System of National Accounts" - SNA 2008)<sup>26</sup>.

**Kufizimet për matjen e Indikatorit:** Kufizimet që konsistojnë për këtë tregues janë:

- Ka shumë pak të dhëna të veçanta për sektorët e turizmit dhe tregtisë, ato zakonisht nëkuptohen si të përfshira në grupin e shërbimeve (tabela në fig. 1);
- Ndarja dhe paraqitja e vlerave të përqindjes sipas sektorëve pjesëmarrës me 20/20/60 % në BPV (fig. 1), kur e njëjta % vazhdon të jetë ndër vite, nënkuptohet si vlerë e përafërt e prezantuar;
- Niveli i përgjithshëm i kapaciteteve për të dhënat statistikore, që sipas Bankës Botërore, është shumë i ulët në Kosovë, (fig. 2).




Fig.1. Grafiku për nivelin e statistikave në Kosovë.

Burimi: <http://data.worldbank.org/country/kosovo>

**Rëndësia e Indikatorit për zhvillimin hapësinor:** Indikatorin për BPV-së, BPV / kokë banori si dhe i % së pjesëmarrjes së sektorëve shfrytëzohen për të siguruar matjen, vlerësimin dhe krahasimin e pasurisë së prodhuar të një shteti sipas sektorëve kryesor ekonomik si dhe për të bërë analiza të shumta gjatë krahasimit të zhvillimeve në periudha të ndryshme kohore përbrenda vendit si dhe mes shtetesh të Rajonit, Evropës dhe Botës

**Gjendja e Indikatorit dhe krahasimi:** Paraqitja e nivelit të gjendjes aktuale të zhvillimit dhe e trendit për brenda Kosovës, vazhdon të jetë e njëjta për shumë vite. Kurse, sipas të dhënave të Bankës Botërore, në vitin 2011 BPV ishte rreth 4.2 miliard \$, përderisa në vitin 2014 ishte ngritur në rreth 7.2

26 Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), Bruto Produkti Vendor në Qasjen e Shpenzimeve (2008-2013), Prishtinë 2014.

mld \$. Kurse BPV / për kokë banori që në vitin 2010 ishte 1.847 \$ në vitin 2014 kishte ngritje në 3.815 USD.

VENDI	BUJQËSIA	INDUSTRIA	SHËRBIMET
Shqipëria	18.50%	24.70%	56.6%
Kosova	20.00%	20.00%	60.00%
Mali I Zi	0.80%	11.30%	87.90%
Maqedonia	10.20%	27.50%	62.3%
Serbia	7.90%	31.80%	60.30%
Bota	5.90%	30.50%	63.60%
SHBA	1.12%	19.10%	79.70%
Kina	9.10%	42.60%	48.30%
Japonia	1.20%	27.50%	71.40%
Gjermania	0.80%	28.10%	71.10%
Franca	1.90%	18.30%	79.80%

**Fig.2. Pjesëmarrja e sektorëve ekonomik në BPV – Bujqësi, Industri dhe Shërbime në shtetet e rajonit.**  
Burimi:ESK 2015

#### **Konkluzione dhe rekomandime:**

- Me këtë indikator do të duhej të paraqiteshin të ardhurat për kokë banori në vend, dhe se cili nga sektorët ekonomik dhe me çfarë përqindje merr pjesë në ato të ardhura;
- Nuk mjafton që me këtë indikator të përcaktohet niveli zhvillimor komunal, apo në bazë të vlerës së tij të krahasohet se cila komunë ose cili rajon është më i zhvilluar se tjetri, por as të mirëqenies ekonomike e të amvisërive.
- BPV/kb apo edhe BPV e ndarë në sektorë, nuk paraqesin me automatizëm mirëqenien e amvisërive lokale, me zhvillimin (ngritjen apo rënien) e saj, por pasqyrojnë vetëm transkacione shtetërore (të paraqitura dhe të arkivuara) si në rastin tonë të përafërta dhe me vlera të njëjta ndër vite (Bujqësi / Industri / Shërbime: 20 / 20 / 60 %).
- Prandaj, është e domosdoshme që me ndihmën e indikatorëve tjerë të prezantohet gjendja reale e zhvillimit shoqëror dhe ekonomik e vendit;

**Indikatori: VLERA E EKSPORT - IMPORTIT DHE E BILANCI TREGTAR****Synimi:** ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM DHE I BALANCUAR EKONOMIK**Objektivi:** ZHVILLIM I BALANCUAR EKONOMIK PËR PËRMIRËSIMIN E KUALITETIT TË JETËS

**Përshkrimi i Indiktorit:** Këta indikatorë mbulojnë Eksport – Importin sipas viteve dhe paraqesin tregtinë e mallrave e të shërbime dhe parashikimet tregtare në varësi të madhësisë së biznesit. Këto të dhëna tregojnë shkëmbimin ndërmjet rezidentëve dhe jo-rezidentëve në një ekonomi, vlerën e tyre të shtuar në proces të prodhimit.

**Mënyra e matjes së Indiktorit:** Me indeksin e çmimeve të Export - Importit paraqiten ndryshimet në transaksionet e çmimeve të mallrave dhe shërbimeve ndërmjet banorëve të një shteti dhe botës për rreth. Përderisa, çmimet ndryshojnë me hapa të ndryshëm, merret mesatarja e tyre, e cila paraqet “Indeksin e çmimit”. Të dhënat, për importet dhe eksportet, janë treguar në drejtim të rritjes vjetore

Vitet	Eksport		Importi		Bilanci tregtar	Mbulimi i imp. me eks në %
	Vlera	Rritja e eksportit në %	Vlera	Rritja e importit në %		
2002	27,599	0.0	854,758	0.0	-827,159	3.2
2003	35,621	29.1	973,265	13.9	-937,644	3.7
2004	56,567	58.8	1,063,347	9.3	-1,006,780	5.3
2005	56,283	-0.5	1,157,492	8.9	-1,101,209	4.9
2006	110,774	96.8	1,305,879	12.8	-1,195,105	8.5
2007	165,112	49.1	1,576,186	20.7	-1,411,074	10.5
2008	198,463	20.2	1,928,236	22.3	-1,729,773	10.3
2009	165,328	-16.7	1,935,541	0.4	-1,770,213	8.5
2010	295,957	79.0	2,157,725	11.5	-1,861,768	13.7
2011	319,165	7.8	2,492,348	15.5	-2,173,183	12.8
2012	276,100	-13.5	2,507,609	0.6	-2,231,509	11.0
2013	293,842	6.4	2,449,064	-2.3	-2,155,222	12.0
Ritja mesatare	26.4	Ritja mesatare	9.5			

dhe të përqindjes së pjesëmarrjes në BPV, të paraqitur në rritje vjetore dhe % të BPV-së, madhësisë së biznesit si dhe rritjen e tregut të eksportit në USD (\$).

**Burimi i informatës/ave:** për këta tregues janë Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK 2015) dhe Ministria e Tregtisë dhe Industrisë / Departamenti Industrisë (MTI / DI: *Raporti Vjetor i Zhvillimit Industrial në Kosovë për vitin 2013*).

**Fig. 1. Tabela me vlerat e Eksport-Importit përgjithshëm, rritja, bilanci tregtar dhe mbulimi importit nga eksporti për vitet 2002 - 2013.** Burimi: ASK 2014.

**Kufizimet për matjen e Indiktorit:** Atëherë, këtu limitimet konsistojnë në konceptin e pranuar dhe të krahasueshëm në botë, në atë të indeksit të çmimeve si një tregues (indikator) i përgjithshëm makro-ekonomik, e jo të Indiktorit të veçantë për gjendjen reale të mirëqenies ekonomike të qytetarëve apo edhe të mundësive për investime.

**Rëndësia e Indiktorit për zhvillimin hapësinor:** Oda Ekonomike e Kosovës thekson se: “Bilanci tregtar, përkatësisht raporti në mes të importit dhe eksportit, janë Indiktorit më realë të situatës aktuale të ekonomisë së vendit” (OEK, 2015). Kjo në mënyrë të drejtpërdrejtë shfaq edhe mundësinë ekonomike për investime dhe zhvillime hapësinore, pra mundësinë për investime të limituara ose të varura tërësisht nga ekonomia e vendit.

**Gjendja e Indiktorit dhe krahasimi:** Nga analiza e të dhënave për periudhë 2009-2013, vërehet se bilanci negativ tregtar i Kosovës, ka shënuar rritje prej 2,231.509 milion Euro në vitin 2012, përderisa gjate vitit 2013, ka pësuar rënie prej 76.287 milion Euro. Po ashtu, referuar vlerave të rritjes mesatare, e shënuar prej disa viteve, tregon se përqindja e rritjes së eksportit është më e lartë përkundër rritjes së importeve, kurse mbulimi i vlerës së importeve me vlerën e eksporteve në % (përqindje), vazhdon ende të jetë shumë i vogël, duke arritur vlerën më të madhe të mbulimit në vitin 2010 prej 13.7%.






Fig. 2: Grafiku për vlerat e Eksport- Importit të përgjithshëm, rritjes dhe mbulimit të importit me eksport (në %) për vitet 2002-2013. Burimi MTI 2014<sup>27</sup>.




Fig 3: Grafiku i paraqitjes së imporneve nga vendet e CEFTA-s, sipas produkteve industriale në %. Burimi: MTI 2014.

### Konkluzione dhe rekomandime:

- Ekziston ndërlihdje e fuqishme e Kosovës me shtetet e rajonit, e cila në kontekst të importit të artikujve të prodhimeve industriale më së shumti vjen në pah me Serbinë dhe Maqedoninë, gati në të gjithë artikujt metalike, kimike, plastike dhe të gomës, letrës dhe tekstit, përveç importit të prodhimeve të industrisë së drurit që vjen nga Mali i Zi;
- Kosova vazhdon të ketë deficit të lartë në bilancin tregtar, ku dallimi në mes të shkallës së importit dhe eksportit vazhdon të jetë i thellë, meqë në masë të madhe importon prodhime industriale nga jashtë se sa që eksporton prodhime industriale vendore;
- Të dhënat e fundit nga Agjencia e Statistikave të Kosovës tregojnë për një situatë alarmante, ku eksporti mbulon importin me vetëm 10 %, shifër që mbetet shqetësuese për vendin dhe me trendë përkeqësimi, sipas njohësve të çështjeve ekonomike (OEK, 2015).

<sup>27</sup> MTI / DI, Raporti Vjetor i Zhvillimit Industrial në Kosovë për vitin 2013, Prishtinë 2014.

**Përshkrimi i Indikatorit:** Numri dhe përqindja (%) e vizitorëve vendor dhe të jashtëm është tregues statistikor i cili paraqet nivelin e zhvillimit të sektorit të turizmit në vend. Termi “vizitor” përfaqëson një “person” që udhëton dhe qëndron në një vend tjetër nga ai i vendbanimit të përhershëm, për një periudhë më pak se 12 muaj. Vizitorë vendor konsiderohen personat me vendbanim të përhershëm në Kosovë që udhëtojnë dhe qëndrojnë së paku një natë në një vend tjetër përbrenda saj. Kurse vizitorë të jashtëm janë personat me vendbanim të përhershëm jashtë Kosovës që vijnë dhe qëndrojnë për kohësisht ose së paku një natë në Kosovë.

**Mënyra e matjes së Indikatorit:** Matja e numrit të vizitorëve bazohet në llogaritjen e numrit të përgjithshëm të vizitorëve që janë regjistruar në: pikat hyrëse kufitare, aeroporte, zyrat e informimit turistik në komuna, apo edhe në bazë të statistikave dhe hulumtimeve më të hollësishme të kryera nga ekspertët e fushës. Aktualisht, të dhënat në dispozicion janë të bazuara në praktikën e deritanishme dhe programin statistikor të ASK-së dhe kryesisht merren me numrin e hoteleve, numrin e të punësuarve, kapacitetet e akomodimit (dhoma, shtretër), numrin e vizitorëve vendor dhe të jashtëm, me ndarjet e klasifikuara sipas muajve, vendit të prejardhjes dhe netëve të qëndrimit tyre në Kosovë.




Fig. 1. Numri i vizitorëve dhe bujtjeve sipas qendrave regjionale krahasuar më 2008 dhe 2014. Burimi: ASK 2015.

**Burimi i informatës/ave:** Në mungesë të mbledhjes dhe grumbullimit të dhënave për Indikatorin nga MTI/Divizioni i Turizmit, përmes zyrave të informacionit turistik, etj, janë shfrytëzuar të dhënat nga Agjencia e Statistikave të Kosovës të përgatitura nga anketa e realizuar përmes pyetësorëve për statistika të turizmit në 105 objektet me kapacitete më të mëdha, që ushtrojnë veprimtari hoteliere, në territorin e Kosovës<sup>28</sup>.

**Kufizimet për matjen e Indikatorit:** Këto kufizime konsistojnë në: Mungesën e të dhënave me vlera të sakta për Indikatorin, nga sektori i turizmit (DT në MTI), që kushtëzon shfrytëzimin e rezultateve të dala prej anketës së realizuar nga 7 (shtatë) zyrat rajonale statistikore (Prishtinë, Prizren, Pejë, Gjakovë, Gjilan, Mitrovicë dhe Ferizaj).që tregojnë vlera të përafërt për numrin e përgjithshëm të turistëve vendor dhe të huaj në Kosovë (fig.1) pa ndonjë klasifikim dhe pasqyrim tjetër të nevojshëm për zhvillim të turizmit.

Pra, nuk mund të mburremi me të dhëna të sakta e të besueshme, për numrin e përgjithshëm të vizitorëve, pikat më të vizituara dhe potencialet më atraktive turistike, marketingun dhe promovimin

<sup>28</sup> ASK: Statistikat e hotelierisë TM1, Prishtinë 2015.

e vendeve dhe të llojeve të preferuara për turizëm, kapacitetet njerëzore të gatshme për hartim, monitorim, zbatim dhe vlerësim të strategjisë për zhvillimin e turizmit në Kosovë, etj.

**Rëndësia e Indikatorit për zhvillimin hapësinor:** Numri i vizitorëve vendor dhe të huaj ka rëndësi për planifikimin e infrastrukturës së nevojshme për zhvillimin e turizmit në bazë të potencialeve dhe lokaliteteve turistike të Kosovës. Planifikimi hapësinor i rajoneve me vlera turistike, resurse të shumëta natyrore, kulturore dhe historike ka për qëllim rritjen e numrit të vizitorëve për të nxitur zhvillimin e sektorit të turizmit për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik.

**Gjendja e Indikatorit dhe krahasimi:** Numri i vizitorëve vendor, në vitin 2014 është rritur në raport me vitin 2013 për 2.42 %, ndërsa numri i bujtjeve (netë-qëndrimet) të tyre për 0.74%. Kurse, numri i vizitorëve të jashtëm, në vitin 2014 është rritur për 22.44%, përderisa numri i bujtjeve të tyre për 21.68 % në raport me vitin 2013 (fig. 2).

Ndërsa, numri më i madhi vizitorëve të jashtëm është nga Shqipëria, Gjermania, SHBA-ja, etj<sup>29</sup>. Regjionet më të vizituara gjatë vitit 2014 janë: regjioni i Prishtinës me 77.167 vizitor, Peja me 11.534 vizitor dhe Prizreni me 8.615 vizitor radhitet i treti<sup>30</sup>.




Fig. 2. Numri i vizitorëve (vendorë dhe të jashtëm) dhe i bujtjeve prej 2008 – 2014. Burimi: IPH sipas ASK 2015.

### **Konkluzione dhe rekomandime:**

- Sipas informatave që disponojmë, numri i vizitorëve vendor dhe të jashtëm në Kosovë, krahasuar me vendet fqinje, nuk është në nivel të kënaqshëm karrshi resurseve ekzistuese për zhvillim të turizmit;
- Politikat qendrore dhe lokale të institucioneve relevante në Kosovë ende nuk e konsiderojnë turizmin si sektor me prioritet për zhvillim të qëndrueshëm të vendit;
- Mungesa e të dhënave nga MTI/DT, për gjendjen e turizmit në përgjithësi, përfshirë numrin e turistëve, llojin e turizmit si dhe destinacionet e preferuara të turistëve, e vështirësojnë procesin e planifikimit për zhvillimin e turizmit;
- Mungesa e strategjisë për zhvillim të turizmit në Kosovë rezulton me ngecje të shumta dhe sfiduese në identifikim të destinacioneve specifike turistike, menaxhim efikas të resurseve turistike, marketing dhe promovim të turizmit, pjesëmarrje të sektorit të turizmit në BPV, si dhe në vendosje të parimeve për zhvillim të turizmit në tërë territorin Kosovës si pjesë e zhvillimit të qëndrueshëm të vendit.

<sup>29</sup> ASK: Statistikat e hotelerisë TM1, Prishtinë 2015.

<sup>30</sup> ASK: Statistikat e hotelerisë TM1, Prishtinë 2015.

**Përshkrimi i Indikatorit** – Indikatorit ka për qëllim të paraqes nivelin e përfshirjës së sektorit të bujqësisë në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të Kosovës. Përmes aktivitetit të ndërmarrjeve bujqësore<sup>31</sup> sipas komunave ku ato veprojnë do të definohen zonat me resurse dhe potenciale për zhvillimin e bujqësisë.

**Mënyra e matjes së Indikatorit** – bëhet në bazë të numrit të ndërmarrjeve bujqësore që janë regjistruar në Agjencionin për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK), sipas Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike (NVE) të përshtatur sipas Nomenklaturës së Aktiviteteve Ekonomike të Komunitetit Evropian (ang. NACE).

**Burimi i informatës/ave** – Agjencioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK) pranë Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë si dhe Agjencia e Statistikave të Kosovës.


**Kufizimet për matjen e Indikatorit** – Formatit i publikimit të ndërmarrjeve bujqësore në vjetarin e ASK krijon kufizimin e informatave lidhur me nënsektorët e bujqësisë, për këtë arsye nuk mund të bëhen analiza më të hollësishme. Gjithashtu për kufizim mund të konsideroim edhe ndërmarrje të cilat kryejn veprimtari bujqësore në mënyrë ilegale.

**Rëndësia e Indikatorit për zhvillimin hapësinor** – Indikatorit për ndërmarrjet bujqësore dhe shtiren e tyre hapësinore na ndihmon në orjentimin e planifikimit të sektorit të bujqësisë në zonat me potencial të rezurseve për zhvillimin e kesaj veprimtarie ekonomike. Në këtë mënyrë planifikohet ofrimi i kushteve të infrastrukturës teknike për krijimin e një ambienti të favorshëm për këtë biznes.

**Gjendja e Indikatorit dhe krahasimi** – Raporti i ndërmarrjeve bujqësore të regjistruara si aktivitet ekonomik në nivel vendi me ndërmarrjet e regjistruara sipas veprimtarive tjera ekonomike gjatë vitit 2012 (fig.x) është: 7% ndërmarrje me veprimtari bujqësore dhe 93% ndërmarrje me veprimtari të tjera ekonomike; kurse në vitin 2015 (fig.x) është: 9% ndërmarrje me veprimtari bujqësore dhe 91% ndërmarrje me veprimtari tjera ekonomike, që rezulton me 2% rritje të ndërmarrjeve që merren me veprimtari bujqësore në krahasim me të dhënat e vitit 2012.



**Fig.x. Përqindja ndërmarrjeve të regjistruara 2012**  
Burimi: IPH/ Vjetari Statistikor i Republikës së Kosovës 2016



**Fig.X.Përqindja e ndërmarrjeve të regjistruara 2015**  
Burimi: IPH/ Vjetari Statistikor i Republikës së Kosovës

<sup>31</sup> Ndërmarrjet bujqësore janë veprimtari ekonomike që merren me eksploatimin e burimeve bimore, shtazore dhe natyrore, duke përfshirë veprimtaritë e kultivimit të të korrave, rritjes dhe shumimin e kafshëve, korrjen e bimëve me trung dhe bimëve të tjera, të kafshëve, produkteve të kafshëve nga ferma ose nga mjediset e tyre natyrore

Shpërndarja e numrit të ndërmarrjeve që ushtrojnë veprimtari bujqësore në komuna për vitin 2015, është si në vijim: prinë Leposaviqi me 113, e dyta Suhareka me 58, e treta Prishtina me 56, Zveçani me Zubin Potokun me nga 48 ndërmarrje, Peja me 46, Podujeva me 40, ndërsa komunat tjera kanë nën 40 ndërmarrje të regjistruara<sup>32</sup>.




Fig.4.Numri i ndërmarrjeve të regjistruara bujqësore në komuna për vitin 2014 dhe 2015. Burimi: IPH/ Vjetari Statistikor i Republikës së Kosovës 2016

Numri i përgjithshëm i ndërmarrjeve të regjistruara në Komunat e Kosovës, në raport me numrin e ndërmarrjeve që ushtrojnë veprimtari bujqësore në komuna për vitet 2014 dhe 2015.




Fig .X. Nr.i ndërmarrjeve të regjistruara në vitin 2015, në raport me ndërmarrjet bujqësore 2014 dhe 2015 në komuna. Burimi: IPH/ Vjetari Statistikor i Republikës së Kosovës 2016 dhe Vjetari Statistikor i Republikës së Kosovës 2015

<sup>32</sup> ASK, Vjetari Statistikor i Republikës së Kosovës, Prishtinë 2015

### **Konkluzionet dhe rekomandime:**

Numri i ndërmarrjeve bujqësore është në rritje në krahasim me vitet paraprake, si dhe në krahasim me disa ndërmarrje me veprimtari të tjera ekonomike, që do të thotë se trendi i zhvillimit të bujqësisë është pozitiv por jo i mjaftueshëm për nevat e vendit. Duke u bazuar në këtë konstatim, rekomandohet:

- Përmirsimi i infrastrukturës teknike për nevoja të bujqësisë si: kanalizim, ujësjellës, rrugë, sistemi i ujitjes, e të tjeta, të cilat do të ndikojnë në stimulimin e fermerëve dhe orientimin e bizneseve në prodhime bujqësore;
- Lehtësira financiare në vitet e para të zhvillimit për ndërmarrjet e reja bujqësore;
- Lehtësira për pjesmarrje në panaire për të prezentuar prodhimet e tyre;
- Ofrimi i lokacioneve më të favorshme me kosto të ulëta për ushtrimin e veprimtarive të ndërmarrjeve bujqësore;
- Ngritja e sasisë së prodhimeve bujqësore për të zvoluar nevojat e importit dhe ngritjen e exportit.

**Përshkrimi i Indikatorit:** Zonë ekonomike është territori që ka një status të veçantë ekonomik. “Ligji për zonat ekonomike” në Kosovë parasheh katër lloje të zonave ekonomike: zonat e lira ekonomike, zonat ekonomike apo parqet industriale, parqet teknologjike si dhe qendrat inovative. Indikatorin në këtë rast paraqet shpërndarjen hapësinore të zonave ekonomike në tërë territorin e Kosovës.

**Mënyra e matjes së Indikatorit:** Bëhet në bazë të numrit të Zonave Ekonomike (ZE) që janë regjistruar tek Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë - KIESA pranë MTI-së.

**Burimi i informatës/ave:** Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë – KIESA.

**Kufizimet për matjen e informatave:** Sa i përket informatave lidhur me numrin e ZE-ve ato janë transparente dhe lehtë mund të gjinden në Web faqen e MTI ose Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë. Kufizim mund të konsiderohet, funksionalizimi i tyre, që do të thotë se sa janë funksionale bizneset të cilat veprojnë në ZE.

**Rëndësia e Indikatorit për zhvillimin hapësinor:** Indikatorin për numrin e Zonave Ekonomike në Kosovë si dhe shtrirja e tyre hapësinore, ndihmon procesin e planifikimit të ngritjes së zonave të reja ekonomike në nivel vendi. Planifikimi i ZE do të bëhet në mënyrë që të arrihet një zhvillim i balancuar në tërë territorin e Kosovës.

**Gjendja e Indikatorit dhe krahasimi:** Sipas informatave zyrtare nga MTI, disa zona ekonomike janë të shpallura me vendim të Qeverisë, disa janë në fazën e krijimit dhe për disa ekziston iniciativa për krijimin dhe legalizimin e tyre.

Zonat e shpallura konform legjislacionit<sup>33</sup>:

- Parku i Biznesit në Drenas (PBD)- përfshinë një sipërfaqe prej 24 ha të ndarë në 56 njësi të madhësive të ndryshme, gjendet në fshatin Korreticë e Epërme të Drenasit dhe shtrihet në km e 18-të përgjatë magjistrale Prishtinë – Pejë ;
- Park i Biznesit në Mitrovicë - përfshinë një sipërfaqe prej 3.5 ha, është i paraparë për 22 objekte biznesi. Shtrihet në pjesën veri-lindore të qytetit të Mitrovicës, 500 m’ larg stacionit hekurudhor dhe 1km’ nga magjistralla që lidh Kosovën me Serbinë;
- Parku teknologjik Skenderaj – përfshinë një sipërfaqe rreth 19.63 ha, e cila është e ndarë në 33 parcela dhe gjendet në zonën kadastrale Klinë e poshtme;
- Parku industrial në Shtime - përfshinë një sipërfaqe prej 10.70 ha, gjendet në km’ e 2-të në rrugën magjistrale Shtime-Ferizaj (M - 5.3), ku planifikohet të vendosen 15 biznese të vogla dhe të mesme të karakterit prodhues.

Iniciativat për krijimin e ZE, të cilat nuk kanë marrë vendimin nga Qeveria:

- Zona Industriale në Suharekë- Shirokë, me një sipërfaqe rreth 162.25 ha’, ku janë të parapara 77 parcela, me mundësi të zgjerimit. Kjo zonë gjendet në lindje, është e kufizuar me rrugën ekzistuese Suharekë – Prizren në jug me rrugën ekzistuese të zonës së vjetër industriale dhe në perëndim me vreshtat ekzistuese;
- Zona ekonomike Gjilan - Novobërd, me një sipërfaqe rreth 693,409 m<sup>2</sup>, që është krijuar sipas marrëveshjes mes dy komunave , për një zonë të përbashkët ekonomike e cila gjendet në territorin e komunës së Novobërdës, në Llabjanë, në vendin e quajtur Koznica , që ka dalje në rrugën regjionale Prishtinë – Gjilan dhe rrugën rajonale Prishtinë – Novobërd – Kamenicë – Ranillug - Dheu i Bardhë.

<sup>33</sup> MTI, Raport informativ për MMPH, 18/01/2015

- Zona Ekonomike - Parku Industrial “ZINKUNIE” - Prizren, ka një sipërfaqe prej rreth 18 ha, e ndarë në 30 parcela. Parku gjendet në rrugën e Transitit të Prizrenit.
- Zonë e Lirë Ekonomike/ MITROVICË – gjendet në vendin e ashtuquajtur Frashër i Vogël-Zhigovinë”, me sipërfaqe rreth 48.26 ha.




Fig. - Numri i ZE në Kosovë Burimi: IPH/ Raport informativ nga MTI /18/01/2015

Sipas Koncept Planit Kombëtar për Zhvillimin e Zonave Ekonomike në Kosovë 2014- 2018<sup>34</sup>, Qeveria e Republikës së Kosovës, në muajin mars 2014, ka vendosur t'i shpallë zona të lira ekonomike sipas tri vendimeve: 02/178 - Zona e Lirë Ekonomike në Zonën Kadastrale të Gjakovës, 03/178 - Zona e Lirë Ekonomike në Zonën Kadastrale të Mitrovicës dhe 01/180 - Zona e Lirë Ekonomike në Zonën Kadastrale të Prizrenit.

Mirëpo funksionalizimi dhe zhvillimi i këtyre zonave është në ngecje për shkak të procedurave të ndryshme.

#### Konkluzionet dhe rekomandimet;

- Në bazë të Raportit informativ nga MTI për Zonat Ekonomike si dhe vendodhjen e tyre në tërë territorin e Kosovës, mundë të konkludojmë se për momentin nuk ka nevojë për themelimin e ZE-ve të reja, duke marr parasysh shpërndarjen e këtyre zonave pothuaj në të gjitha qendrat e Kosovës.
- Për të gjitha ZE-të e themeluara duhet të gjendet mënyra për funksionalizimin sa më efikas të tyre, përmes organeve këshilldhënëse, duke u bazuar edhe në përvojat e vendeve tjera.

34 MTI, Koncept Plani Kombëtar Për Zhvillimin E Zonave Ekonomike Në Kosovë 2014-2018, Prishtinë 2013.




- Gjatë përzgjedhjes së lokacioneve për zhvillimin e zonave të lira ekonomike duhet marrë parasysh disa faktorë të cilët ndikojnë direkt në krijimin e përparësisë për zgjedhjen e lokacionit: pozita gjeografike me lokacion strategjik, e kaluara e zhvillimit industrial të lokacionit (zonës) në krahasim me lokacionet tjera si dhe infrastruktura e favorshme për zhvillim e këtyre zonave, që do të ndikonin për zhvillimin e ekonomisë, përmirësimin e stabilitetit ekonomik dhe politik.

Prandaj, rekomandohet që:

- Përzgjedhja e lokacionit për vendosja e ZE-ve të bëhet në koordinim mes MTI-në, MZHE-në dhe MMPH/IPH-në duke u bazuar në PH të Kosovës si dhe në PZHK të komunës përkatëse;
- Të themelohet organi këshilldhënës për funksionimin sa më efikas të zonave;
- Të bëhet raportimi për funksionalizimin e ZE-ve në baza vjetore;
- Të aplikohet bashkëpunimi ndërkufitar rajonal dhe ndërkombëtar;
- Të bashkëpunohet me Universitetet dhe qendrat inovative;
- Të bëhet promovimi i zonave ekonomike përmes marrëdhënieve dhe kontakteve të drejtëpërdrejta me publikun;
- ZE e Gjakovës duhet të shpejtojë procedurat pronësore për funksionalizimin e zonës, duke marrë parasysh rëndësinë e saj si dhe intersin e bizneseve të cilat kanë shfaqur interesim për të kryer veprimtaritë e tyre; dhe
- Të aplikohet në fondet e BE-së, për zhvillimin e ZE-ve sipas planifikimit, parakushteve dhe kushteve për shfrytëzim sa më racional të zonës ekonomike.

**Përshkrimi i Indikatorit:** Remitancat klasifikohen në dy kategori: të brendshme dhe të jashtme. Remitancat e brendshme janë dërgesat kur ka migrim nga zonat rurale në ato urbane brenda një shteti ndërsa ato të jashtme janë kur ka migrim nga shteti amë në një shtet tjetër. Remitancat e jashtme (dërgesat e emigrantëve) nga diaspora në Kosovë vijnë në forma të ndryshme: a) remitancat e dërguara nga emigrantët në formën e parave të gatshme dhe b) remitancat e dërguara në formën e mallrave dhe shërbimeve. Për çështjen e remitancave, informacione të shumta japin agjensitë e statistikave, raportet nga BQK dhe Banka Botërore, hulumtimet nga anketat në institute dhe OJQ, etj. Indikatori paraqet nivelin e ndihmës dhe sipas mundësive edhe shtrirjen hapësinore të saj (burimi i ndihmës dhe destinacioni në Kosovë).

**Mënyra e matjes së Indikatorit:** Grumbullimi i mjeteve të pranuar nga të gjitha kanalet e njohura shërbyese jep shumën totale të remitancave në Kosovë. Të dhënat nga Banka Qendrore e Kosovës, Agjencia e Statistikave si dhe të dhënat nga iniciativat që japin të dhëna statistikore kanë siguruar informata për numrin total të dërgesave, mënyrat e dërgimit si dhe shtetet prej të cilave vijnë kontributet nga emigrantët. Të dhënat nga ASK 2013 tregojnë se 43% e qytetarëve të Kosovës kanë anëtarë të familjes që jetojnë jashtë vendit. Ndërkohë që, 22.4% e familjeve kosovare kanë pranuar remitanca prej familjarëve të tyre, gjatë vitit 2012.



**Fig.1.Grafiku me dërgesat e emigrantëve sipas shteteve.** Burimi: IPH me të dhëna nga BQK (Banka Qendrore e Kosovës, "Remittances by contry" 2016), Prishtinë.

**Burimi informatës/ave:** Burim kryesor i informatave për këtë tregues është Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), me Raportet e statistikave për remitancat ne vitin 2013 dhe statistikat nga BQK (Banka Qendrore e Kosovës). Gjithashtu, janë shfrytëzuar edhe informata tjera shtesë nga hulumtime të cilat merren me çështje të ekonomisë, si 'theGlobalEconomy.com' dhe 'open.data.al'.

**Kufizimet për matjen e Indikatorit:** Nga mungesa e të dhënave për vitet e fundit, janë shfrytëzuar raporte të ASK të vitit 2013. Kufizim tjetër në informacionet për remitancat, janë mospërputhjet e të dhënave statistikore nëpër raporte të ndryshme të prodhuara në Kosovë, sidomos të paqartësisë në shifrat totale të dërgesave. Po ashtu, këto informata, mbi vlerën e përgjithshme vjetore, nuk mund të jenë me saktësi të madhe, për shkak se një numër i konsiderueshëm i tyre vjen nëpërmjet kanaleve joformale.

**Rëndësia e Indikatorit:** Përnjohja me kapacitetin, shumën dhe mënyrën e dërgimit të remitancave (të mjeteve financiare të ardhura nga diaspora), si me dhe kanalet e, është e një rëndësie të veçantë, për rolin e diasporës në zhvillimin ekonomik dhe social të vendit. Informatat e siguruar nga të dhënat statistikore sigurojnë një transparencë të të ardhurave dhe tregojnë qe remitancat janë ndër shtyllat kryesore të zhvillimit ekonomik, duke pasur parasysh që një shumë e konsiderueshme nuk

evidentohet në rrugë formale. Të dhënat në dispozicion, na tregojnë për rolin e investimeve të emigrantëve përgjatë viteve në zbutjen e varfërisë në shumë familje të Kosovës, sidomos në zonat rurale, meqë edhe emigrimi nga këto zona është më i dukshëm në nga zonat urbane. Bazuar në rezultate të këtyre treguesve, planerët dhe politikë-bërësit i drejtojnë / adresojnë kërkesat e tyre për: sigurimin e një terreni të sigurtë që remitencat të kthehen në investime direkte dhe formave lehtësuese nga institucionet përkatëse në mënyrë që diaspora t'i shfrytëzojë sa më shumë transaksionet përmes bankave sesa rrugën e dhënies së parave kesh.




Fig.2.Grafiku me dërgesat e emigrantëve sipas kanaleve shërbyese. Burimi: IPH me të dhëna nga BQK 2016.

**Gjendja e Indikatorit dhe krahasimi:** Në vitin 2015 Kosova ka pranuar remitanca në vlerë prej 665.5 milionë euro. Krahasuar me vendet e rajonit, rezulton se Serbia ka vlerën më të madhe të sasisë së pranuar prej 2.974 miliardë euro në vit ndërsa Sllovenia është me vlerën më të vogël të remitancave me 50.75 milionë euro në vit dhe. Vlerat për vendet tjera të Ballkanit janë: Maqedonia (217.13 milionë euro në vit), Mali i Zi (118.61 milionë euro në vit), Greqia (242.36 milionë euro në vit), Shqipëria (594 milionë euro në vit) dhe Kroacia (999.61 milionë euro në vit).





Fig.3.Grafiku me remitancat në shtetet e rajonit. Burimi IPH me të dhëna nga BQK 2016 dhe [www.theglobaleconomy.com](http://www.theglobaleconomy.com)

Në Kosovë, nga të dhënat e vitit 2016 nga Banka Qëndrore e Kosovës, vërehet një rritje e dërgesave nga viti 2011 me 492.5 milionë euro deri në vitin 2016 me 691 milionë euro. Vlerësohet se të hyrat vjetore nga diaspora janë: (a) remitanca në para të gatshme, (b) kontributet në mallra dhe gjësende që sjellin, (c) kontributi i vizitorëve - "Turizmi i diasporës". Shumica e remitancave janë përdorur për konsum, për ndërtim të shtëpive dhe riparime, për qëllime shëndetësore, për arsim dhe vetëm një pjesë modeste përdoren për investime në afarizëm. Dërgesat më të mëdha, në Kosovë, vijnë nga shteti i Gjermanisë për dallim nga Shqipëria ku burimi kryesor i remitancave është Greqia me 44.3 % dhe Italia 36.4 %.



**Fig. 4. Grafiku me dërgesat e emigrantëve sipas viteve.** . Burimi: IPH me të dhëna nga BQK (Banka Qendrore e Kosovës, "Remittances by channels" 2016), Prishtinë.

Përqindjet më të larta të familjeve pranuese të remitancave janë në rajonet e Gjakovës (35%), Pejë (30%), Gjiçanit (29%) dhe Prizrenit (23%). Studimi tregon se pjesa më e madhe e remitancave në Kosovë, vijnë nga Gjermania (38%), Zvicra (23.5%), Italia (4.3%), Austria (3.6%), SHBA-të (6.9%) etj. Varësisht nga mënyrat e dërgimit të mjeteve, emigrantët shfrytëzojnë shërbimet bankare, agjencitë për transferim dhe mënyra të tjera joformale (Fig.2).

#### **Konkluzione dhe rekomandime:**

- Statistikat në dispozicion tregojnë se diaspora është një ndër resurset ekonomike më të mëdha në Kosovë, përfshirë edhe faktin se një numër i konsiderueshëm i të hyrave nuk kalojnë në rrugë zyrtare;
- Mbi pesëqind (>500) milion euro në vit llogaritet shuma e të hyrave nga diaspora, ku shumica shfrytëzohet për konsum ditor e një pjesë e vogël për investime;
- Të hyrat nga remitancat tregojnë edhe nivelin e varfërisë së një vendi, duke pasur parasysh krahasimin mes Kosovës me 665.5 milionë euro në vit dhe Sllovenisë me 50.75 milionë euro në vit remitanca;
- Dërgesat nga remitancat krijojnë një pabarazi ekonomike në mes shtresave sociale. Ato ndikojnë në rritjen e konsumit ditor por jo edhe në investime të qëndrueshme;
- Me një menaxhim më të mirë të këtyre të hyrave, do të krijohej një strategji për kthimin e remitancave në investime direkte, që do të rezultonte me përmirësimin e gjendjes ekonomik dhe krijimin e vendeve të reja të punës.

**Përshkrimi i Indikatorit:** Buxheti i Republikës së Kosovës paraqet shumën e lejuar me ligj, e cila vihet në dispozicion për shpenzim nga Fondi i Kosovës<sup>35</sup> për Organizatat Buxhetore<sup>36</sup> për periudhën nga 1 Janari deri 31 Dhjetor të vitit të njëjtë. Organizatat Buxhetore janë të gjitha Ministritë, Komunat, Agjencitë dhe Institucionet të cilat pranojnë ndarje buxhetore nga Fondi i Kosovës.

Indikatorit ka për qëllim të përshkruaj ndarjen e buxhetit nëpër sektorët e rëndësishëm të Qeverisë dhe në Komunat e Kosovës. Përmes krahasimeve do të definohen sektorët dhe komunat me më shumë buxhet dhe në këtë mënyrë do të bëhen të qarta kahjet e zhvillimit aktual në Kosovë. Nëse është e mundur do të bëhet krahasimi i vijave buxhetore të Kosovës me shtetet e rajonit për të nxjerrë në pahë pozitën e vendit me shtetet tjera në rajon. E njëjta do të bëhet edhe për nivelin komunal, përmes krahasimit do të kuptohet niveli i ndarjes buxhetore nëpër komuna

**Mënyra e matjes së Indikatorit:** Buxheti i Kosovës përgatitet për një periudhë njëvjeçare, llogaritet në mënyrë analitike ndërsa njësia matëse është Million Euro. Buxheti i Kosovës përgatitet nga Ministria e Financave (MF) në koordinim me organizatat buxhetore dhe miratohet në fund të vitit në Kuvendin e Kosovës. Buxheti për vitin e ardhshëm përgatitet në vitin aktual përmes një zinxhiri veprimesh i njohur si proces buxhetor.

Për nevoja të matjes së Indikatorit është shfrytëzuar e njëjta metodë. Informatat për ndarjen e buxhetit për digasteret e rëndësishëm të Qeverisë janë marrë të gatshëm nga Ministria e Financave, është bërë krahasimi i shpenzimeve kapitale dhe janë nxjerrë ndryshimet në mes sektorëve dhe komunave të Kosovës.

**Burimi i informatës/ave:** Burimi i informatës për Indikatorin është Ligji për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin fiskal, i cili hartohet nga Departamenti i Buxhetit në kuadër të MF, e cila e procedon draft Ligjin për buxhet në Kuvendin e Republikës së Kosovës, që hyn në fuqi pas miratimit.


**Kufizimet për matjen e Indikatorit:** Formatit i publikimit të Buxhetit të Kosovës krijon kufizime në qasjen e informatave, për këtë arsye nuk mund të përgatiten analiza të shpejta, statistika të sakta apo ilustrime të qarta grafike për të dhënat. Problemi kyç shfaqet gjatë analizës së “Ligjit për Buxhetin”, ku ka raste kur investimet kapitale nuk janë të precizuara drejtë, p.sh. nuk përshkruhet natyra e investimit (qoftë ajo ndërtim i një shkolle apo diçka tjetër) apo kush është përfituesi (cila komunë), e gjithashtu edhe kur shpenzimet kapitale me vlerë prej disa milion € janë emërtuar si: “Programi i bashkëfinancimit me Kuvendet Komunale”, ose “Bashkëfinancim me IPA”, “Pyllëzimi i sipërfaqeve të zhveshura”, “Mirëmbajtja e rrugëve”, “Pajisje të tjera”, etj, etj, që e kufizon marrjen e informatave të sakta se për cilin projekt konkret apo hapësirë territoriale bëhet fjalë.

Kufizimet në llogaritjen e informatave për investime të nivelit lokal nga Ligji për Buxhetin e Kosovës, paraqiten tek mënyra e ndarjeve të buxhetit në komuna pasi që struktura organizative e drejtorive në kuadër të komunave nuk është e njëjtë. Në disa komuna kemi Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik, kurse te disa të tjera nuk ekziston, pastaj te disa komuna Drejtoria e Infrastrukturës është e ndarë, ndërsa


<sup>35</sup> Fondi i Kosovës – fond i krijuar në Bankën Qendrore të Kosovës dhe llogaritë tjera bankare komerciale të cilat mund të krijohen nga Thesari dhe ku të gjitha paratë publike, duke përfshirë edhe interesin e mbledhur nga këto, janë të depozituara dhe nga të cilat bëhen të gjitha Shpenzimet në pajtim me Ligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës.

<sup>36</sup> Organizatat Buxhetore Qendrore janë të gjitha Organizatat Buxhetore duke përjashtuar Komunat. Kategoritë e shpenzimeve të cilat gjenden në Ligj për Buxhetin e Republikës së Kosovës janë: Pagat dhe Mëditjet, Mallrat dhe Shërbimet, Shërbimet Komunale, Subvencionet dhe Transferet, Shpenzimet Kapitale dhe Rezervat.

te disa komuna perfshihet në kuadër të shërbimeve publike: mbrojtja civile, emergjenca dhe infrastruktura publike e rrugore.




**Fig. 1. Buxheti i përgjithshëm i Qeverisë së Kosovës për 2016 – ndarja në nivelin lokal dhe nivelin qendrorë. Burimi: IPH/ Ligji për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016.**



**Fig.2.Ndarja e buxhetit të Kosovës për organizatat buxhetore dhe shpenzimet kapitale në %. Burimi: IPH/ Ligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016**

**Rëndësia e Indikatorit për zhvillimin hapësinor:**

Buxheti i Kosovës me shpenzimet kapitale janë të rëndësishme pasi që pasqyrojnë gjendjen, shtrirjen e investimeve dhe kahjen e zhvillimeve afat-shkurta, afatmesme dhe afatgjata. Afati kohor për realizimin e projekteve kapitale e lehtëson punën në monitorimin dhe realizimit të këtyre projekteve. Të gjitha këto që u përmenden: buxheti, shpenzimet kapitale si dhe afatet kohore e kanë rëndësinë në orjentimin e zhvillimeve të ardhëshme në hartimin e planeve hapësinore të nivelit qendror apo lokal.



**Gjendja e Indikatorit dhe krahasimi:**


Buxheti i përgjithshëm i Kosovës ndahet për: Nivelin qendror dhe atë lokal, në kuadër të të cilit parashihen edhe shpenzimet kapitale (shpenzimet për projektet kapitale), për vitin fiskal si dhe parashikimet për dy vitet në vijim. Buxheti i përgjithshëm për vitin 2016 është afërsisht 1,7 mld. €, prej të cilit afërsisht 400 mil.€ ndahet për buxhetin e nivelit lokal, ndërsa 1,3 mld. € për nivelin qendror.

Nga shuma e Buxhetit të përgjithshëm Qeveritar, 78% u janë ndarë organizatave buxhetore kurse, 22% janë shpenzimet kapitale. Nga 22% i shpenzimeve kapitale, 75% janë ndarë për nivelin qendror dhe 25% për nivelin lokal.

**Fig.3. Ndarja e shpenzimet kapitale në % për nivelin lokal dhe qendrorë për 2016. Burimi: IPH/ Ligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016**

Nëse e bëjmë analizen e buxheteve të ndara në digasteret qeverisë (Fig.3.) shofim dallimet mes buxhetit të përgjithshem dhe të shpenzimeve kapitale, ku buxheti në MPMS arrinë vlerën rreth 360 mil €, që është më i larti në krahasim me ministritë tjera, ndërsa shpenzimet kapitale arrijnë në 1 milion


€. Ndërsa MI ka maksimumin e buxhetit të shpenzimeve kapitale në krahasim me ministritë tjera, me 170 mil €.



**Fig. 4. Buxheti në digasteret e qeverisë së Kosovës dhe projektet kapitale 2016.** Burimi: IPH/ Ligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016


Sa i përket shpenzimeve kapitale MI është e para me 53% ndërsa e dyta me rradhë është MMPH me 11%. Një numër më i madh i ministrive ka shpenzimeve kapitale deri në 5%, në mesin e tyre MBPZHR ka vetëm 1%, që është e pamjaftueshme për të kontribuar në ngritjen e zhvillimit ekonomik të vendit. Në bazë të këtyre analizave apo krahasimeve vijmë në përfundim se të gjitha projektet kapitale të Qeverisë janë të orientuara në infrastrukturën rrugore.

Në bazë të Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016, kufiri i buxhetit, shpenzimet kapitale dhe vlerësimet e tyre për vitet 2017-2018 kanë një ngritje minimale e cila arrin në 2%. Për vitin 2016 përqindja e shpenzimeve kapitale është 27.8 % e Buxhetit të përgjithshëm, ndërsa sipas parashikimeve: për vitin 2017 shpenzimet kapitale do të jenë 28.2% e buxhetit të përgjithshëm dhe për vitin 2018 shpenzimet kapitale parashihen të jenë 29.8% e buxhetit të përgjithshëm.




**Fig. 5. Buxheti i përgjithshëm dhe shpenzimet kapitale për vitin 2016 dhe vlerësimet për 2017 e 2018.** Burimi: IPH/ Ligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016

Gjendja e buxhetit të përgjithshëm dhe shpenzimet kapitale në komunat e Kosovës, tregojnë se në 7 qendrat e mëdha buxheti dallon nga ato më të vogla, e sidomos komuna e Prishtinës e cila dallon dukshëm nga të gjitha komunat e tjera. (Fig.5.) Ky dallim ndodhë duke marrë parasysh se kriteret bazë për fitimin e granteve të përgjithshme për buxhetin e një komune janë: numri i popullsisë (80%), sipërfaqja e komunës (6%), numri i popullsisë pakicë në komunë (3%) dhe për komunat ku shumica e popullsisë përbëhet nga pakicat kombëtare (2%). Prandaj, komuna e Prishtinës, si qendër më e madhe me sipërfaqe, popullsi si dhe nga të hyrat vetanake arrinë të jetë komuna me më shumë buxhet.



**Fig. 6. Buxheti dhe shpenzimet kapitake nëkomunat e Kosovë për 2016.** Burimi: IPH/ Ligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës per vitin 2016

Duke e krahasuar buxhetin e 7 qendrave më të mëdha, Prishtina ka përqindjen më të madhe të buxhetit të përgjithshëm me 31%, pastaj radhiten qendrat tjera: Prizreni me 19%, Ferizaji me 12%, Gjilani, Peja dhe Gjakova me 10% dhe e fundit është Mitrovica me 8% ( fig.6).



Prishtina ka 22% buxhet më shumë se Mitrovica, 21% buxhet më shumë se Gjakova, Peja dhe Gjilani; ndersa dallimi me Prizrenin është për 12%. Krahasuar me Ranillukun si komuna me buxhetin më të vogël, Prishina ka 98% buxhetin më të lartë.

Nga kjo analizë vërehet se Prishtina dhe Prizreni janë dy qendrat me më shumë buxhet.

**Fig. 7. Përqindja e buxhetit sipas qendrave më të mëdha komunale.** Burimi: IPH/ Ligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016




### **Konkluzione dhe rekomandime:**

- Me rastin e dërgimit të Ligjit për buxhetin dhe ndarjet buxhetore në Kuvendin e Kosovës për shqyrtim dhe aprovim, duhet të përgatitë një dokument i cili spjegon ndërlidhjen në mes të buxhetit për vitin e caktuar fiskal dhe politikat qeveritare. Në këtë dokument duhet të jepen detaje se si zbatimi i buxhetit do të ndikojë në zhvillimin e gjithëmbarshtëm ekonomik dhe në arritjen e objektivave qeveritare;
- Në koordinim me organizatat buxhetore, duhet të shmangin ndarjet e paqarta buxhetore, siç janë: “bashkëfinancim me donatorë”, “rregullim i infrastrukturës”, “investime nëpër fshatra”, “bashkëfinancim me Kuvende Komunale”, etj, ngase në këtë mënyrë nuk është e qartë se për çfarë projektsh janë ndarë mjetet e caktuara buxhetore;
- MF duhet të publikojë me rregull të gjitha raportet buxhetore vjetore, si dhe të publikojë ndarjet buxhetore dhe shpenzimet buxhetore në formë “Excel”, me qëllim që të mundësohet analiza dhe shqyrtimi i buxhetit;
- Shpenzimet për projektet kapitale përpos infrastruktures rrugore, duhet të orientohen edhe në sektorët tjerë, të cilët kanë ndikim në rritjen ekonomike të vendit si: bujqësi, industri e të tjera, pasi që gjendja e përgjithshme e infrastrukturës rrugore është realizuar me rreth 85% në tërë teritorin e Kosovës;
- Të precizohet përshkrimi i projekteve se për çfarë ndarje ndërsektoriale bëhet fjalë tek ndarja e buxhetit të shpenzimeve kapitale në komuna p.sh. të precizohet lloji infrastrukturës si: kanalizim, ujësjellës, rrugë apo tjetër dhe lokacioni i saktë;
- Struktura organizative e drejtorive në kuadër të komunave duhet unifikohet në nivel vendi;
- Buxhetit i vitit 2016 dhe vlersimi i rritjes së buxhetit deri në 2018 për shpenzimet kapitale parashihen të jenë 29.8% e buxhetit të përgjishëm, që do të thotë se rritja ekonomike është shumë e vogël afërsisht 2%, me shumë paka gjasa për ndryshimin e gjendjes ekonomike të vendit.

**Përshkrimi i Indikatorit:** Ky indikator e jep sasinë e energjisë elektrike të prodhuar gjatë një viti të caktuar dhe sasinë e konsumuar të kësaj energjie gjatë të njëjtit vit në Republikën e Kosovës.

**Mënyra e matjes së Indikatorit:** Njësia matëse e Indikatorit është gigavatorë (GWh). Në këtë rast krahasohet sasia e prodhuar e energjisë elektrike me sasinë e konsumuar dhe gjendet diferenca.

**Burimi i informatës/ave:** Për paraqitjen e këtij Indikator janë përdorë informata nga Zyra e Rregullatorit për Energji, *Deklaratë mbi Sigurinë e Furnizimit në Kosovë, Prishtinë 2015*<sup>37</sup>, kurse për krahasimet me të dhënat nga shtete të rajonit janë shfrytëzuar edhe Raporti për energji nga CEE Bankwatch Network (Weishaar, S.E., & Madani, S., 2015)<sup>38</sup> dhe Publikimi Kroat për Potenciale and Projekte të Energjisë, Zagreb 2015<sup>39</sup>.



#### Kufizimet për matjen e Indikatorit:

Konsiderohet se nuk ka ndonjë kufizim të matjes së prodhimit dhe konsumit të energjisë elektrike meqë ato jepen në raportet vjetore nga ZRrE.

Fig. 1. Diagrami mbi raportin e prodhimit dhe konsumit të energjisë elektrike në Kosovë gjatë viteve 2010-2014. Burimi: ZRrE 2015.


**Rëndësia e Indikatorit për zhvillimin hapësinor:** Viteve të fundit, me përjashtim të vitit 2013, në Republikën e Kosovës, kërkesa për konsum të energjisë elektrike nuk ka mundur të mbulohet me prodhimin e saj. Atëherë shihet qartë rëndësia e këtij Indikator që flet për nevojën e shtimit të prodhimit të kësaj energjie, kur dihet se blerja është më e kushtueshme dhe se Kosova disponon me resurse për prodhim të saj. Shtimi i prodhimit të energjisë elektrike mund të arrihet me shfrytëzimin e mirë të kapaciteteve prodhuese ekzistuese të rehabilituara si dhe ndërtimin e kapaciteteve të reja, për çka edhe duhet të caktohen lokacioni i përshtatshëm për ndërtim, lloji dhe teknologjia më efikase e tyre. Energjia elektrike kushtëzon zhvillime të rëndësishme në hapësirë të cilat nuk mund të ndodhin në mungesë të saj, prandaj edhe prodhimi i balancuar i saj është i domosdoshëm për zhvillimin ekonomik.

**Gjendja e Indikatorit dhe krahasimi:** Në fig. 1 është dhënë balanca e prodhimit dhe konsumit të energjisë elektrike gjatë viteve 2010-2014 në Republikën e Kosovës. Aty shihet se, prodhimi është rritur për çdo vit (nga viti 2010 - 2013), kurse vetëm në vitin 2013 ai ka arritur të plotësojë nevojën e konsumit për energji elektrike. Në vitet tjera konsumi është mbuluar duke e shtuar sasinë e energjisë elektrike të importuar, përderisa në vitin 2014, prodhimi saj, jo vetëm që nuk ka mbuluar konsumin, por ka rënë madje nën nivelin e vitit 2010.

<sup>37</sup> Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRrE), Deklaratë mbi Sigurinë e Furnizimit në Kosovë (energji elektrike, gaz natyror dhe naftë), Prishtinë 2015.

<sup>38</sup> Weishaar, S.E., & Madani, S., Report on the long-term economic viability of constructing new electricity capacities for electricity exports in the Western Balkan countries: CEE Bank-watch Network 2015.

<sup>39</sup> Busurelo, B., Zgrabljic, I., Lenardic, M., Klanjic, S., THE REPUBLIC OF CROATIA: ENERGY POTENTIAL AND PROJECTS. Zagreb 2015.



Ndërsa, në diagramin e fig.2 shihet prodhimi energjisë elektrike në raport me konsumin e vitit 2012 në Republikën e Kosovës si dhe në shtetet e rajonit. Prej shteteve të prezantuara, atë vit, Serbia dhe Bosna e Hercegovina e kanë mbuluar plotësisht konsumin me prodhim, kurse diferencën më të madhe në mes të prodhimit dhe konsumit e kanë pasur Kroacia dhe Maqedonia.


Fig. 2. Diagrami për balancën mes prodhimit dhe konsumit të EE në Kosovë dhe Rajon (2012). Burimi: IPH<sup>40</sup>.

### Konkluzione dhe rekomandime:

- Republika e Kosovës, sipas të dhënave të mësipërme, ka nevojë për rritje të prodhimit të energjisë elektrike me qëllim të mbulimit të kërkesës së konsumit. Aktualisht, me përjashtim të Serbisë dhe Bosnjës e Hercegovinës, asnjë shtet në rajon nuk e mbulon plotësisht konsumin me prodhim të energjisë elektrike;
- Në Kosovë, nga viti 2010 deri në vitin 2013, prodhimi i energjisë elektrike është rritur për çdo vit, përkundër faktit që nuk ka pasur shtim të kapaciteteve të reja prodhuese.
- Rënia e prodhimit të energjisë elektrike në vitin 2014, madje deri në nivelin e vitit 2010, akoma nuk është stabilizuar, meqë kërkesat për konsum kanë qenë më të mëdha se sa prodhimi, nëse përjashtohet prodhimi i vitit 2013 i cili kishte mbuluar plotësisht konsumin e energjisë elektrike;
- Duke i pasur parasysh informatat e mësipërme rekomandohet:
  - Shtimi i kapaciteteve të reja enegjetike, pa të cilat nuk mund të paramendohet zhvillim i qëndrueshëm i vendi dhe nuk mund të mbulohen kërkesat në rritje për konsum të energjisë;
  - Shfrytëzimi maksimal dhe efikas i kapaciteteve ekzistuese;
  - Zvoglimi i humbjeve teknike;
  - Ngritja e nivelit teknik të rrjetit të distribucionit;
  - Etj.

<sup>40</sup> Informatat janë marrë nga: Raporte e publikime të cituara në rajon dhe Deklarata e ZRrE-së në Kosovë (2015).

**Përshkrimi i Indikatorit:** Ky indikator paraqet sasinë e prodhuara të energjisë elektrike që fitohen me djegieje të burimeve fosile (thëngjillit/linjtit) dhe nga burime tjera ripërtëritëse (rinovuese) si dhe jep raportin e tyre ndaj sasisë totale.



Linjiti (qymyri) është resursi më i rëndësishëm energjetik i Kosovës, i cili furnizon 97% të prodhimit total të energjisë elektrike në termocentralet “Kosova A” dhe “Kosova B”. Basenet më të rëndësishme të linjtit në Kosovë (fig. 1) janë: 1) Baseni i Kosovës; 2) Baseni i Dukagjinit dhe 3) Baseni i Drenicës.

**Fig. 1.** Harta me basenet e thëngjillit në Kosovë. Burimi: Korporata Energjetike e Kosovës.

Energjia e prodhuar nga burime ripërtëritëse është energjia që fitohet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga burimet rinovuese natyrore siç janë: rrezet e diellit, era, shiu, rrjedhat ujore dhe nxehtësia nëntokësore (gjeo-termale). Tri hidrocentralet që operojnë në Kosovë janë: HC Dikanci, HC Radavci dhe HC Burimi. Ndërsa HC Lumbardhi është i kyçur në rrjetin e transmisionit.

**Mënyra e matjes së Indikatorit:** Nga sasia totale e energjisë së prodhuar elektrike, nxirret raporti i sasisë së fituar të energjisë elektrike, nga gjeneratorët (me kapacitete të caktuara), të vendosur për këtë qëllim, që përdorin burime të ndryshme natyrore ripërtëritëse dhe jo-ripërtëritëse. Njësia matëse e Indikatorit për energjinë e prodhuar elektrike është GWh (Gigavatorë) dhe MWh (Megavatorë).


**Burimi i informatës/ave:** Për paraqitjen e këtij Indikatorit janë përdorë informata nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZHE) dhe INSTAT (Shqipëri).

**Kufizimet për matjen e Indikatorit:** Konsiderohet se nuk ka ndonjë kufizim të matjes të sasisë së prodhuar të energjisë elektrike nga thëngjilli dhe nga burimet ripërtëritëse, meqë informatat që jepen në raportet vjetore nga ASK-ja janë të dhëna të drejtpërdrejta për sasinë e fituara në gjeneratorët e centraleve elektrik nga prodhuesit e ndryshëm.

**Rëndësia e Indikatorit për zhvillimin hapësinor:** Furnizimi i sigurt dhe i rregullt me energji elektrike është shumë i rëndësishëm për zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të një vendi dhe të përmirësimit të standardit të jetesës në të. Ai, duhet të jenë i besueshëm, i qëndrueshëm dhe i përbalueshëm për popullsinë dhe bizneset, ashtu që të luajë një rol mbështetës për rritjen ekonomike dhe cilësinë e jetës. Sot, prodhimi i energjisë elektrike nga resurset ripërtëritëse natyrore, jo vetëm që është më i pastër dhe më pak i dëmshëm për mjedisin jetësor por shihet edhe si "shpëtim" për të ardhmen e resurseve jo-ripërtëritëse të planetit.

Vendet e Evropës Juglindore kanë për detyrë t'i identifikojnë prioritetet e veta në sektorin energjetik nëse synojnë të sigurojnë rritjen e vet ekonomike si dhe, në të njëjtën kohë, nëse dëshirojnë të sigurojnë zhvillim ekonomik efikase me shfrytëzim racional të energjisë dhe emetim të ultë të karbonit në atmosferë. Këto shtete kanë për obligim që deri në vitin 2020 të përcaktojnë dhe zbatojnë masat për zhvillimin e burimeve të energjisë ripërtëritëse dhe rritjen e shkallës së përdorimit të kësaj energjie në kuadrin e konsumit të përgjithshëm nacional të energjisë.

Vitet	Prodhimi i thëngjillit (në mijëra ton)	Prodhimi energjisë elektrike në TC (GWh)	Prodhimi i EE në hidrocentrale (GWh)	Konsumi i EE (GWh, përfshirë 220 & 110kV)	Importi i energjisë elektrike (GWh)	Eksporti i energjisë elektrike (GWh)
2002	5,528	3,152		1,950	816	648
2003	6,466	3,221		2,041	637	278
2004	5,658	3,481		2,139	651	195
2005	6,391	3,999		2,109	491	226
2006	6,532	3,970		2,155	538	253
2007	6,715	4,309	93	2,392	623	360
2008	7,842	4,506	76	2,941	648	235
2009	7,871	5,260	89	3,201	767	114
2010	7,958	5,481	115	3,480	817	351
2011	8,212	5,696	75	3,685	816	371
2012	8,028	5,847	65	3,612	625	473
2013	8,219	6,248	137	3,706	522	857
2014	7,204	5,324	151	3,772	875	475
2015	8,241	5,979	142	3,972	684	552
2016	8,801	6,249	235	3,595	459	1,064




**Fig. 2. Tabela me grafikun për: Prodhim të thëngjillit, gjenerim nëpër TC-ja dhe HC-ja, konsum, import dhe eksport të energjisë elektrike, nga viti 2002- 2016.** Burimi: ASK 2016.

**Gjendja e Indikatorit dhe krahasimi:** Furnizimi me energji elektrike në Kosovë është realizuar kryesisht nga prodhimi i Termocentraleve 'Kosova A' e 'Kosova B', hidrocentraleve në Ujman, Lumëbardh, Radavc, Dikanc, Burim dhe Centrali me erë AEC Kosova në Golesh. Linjiti është produkti dominues, me pjesëmarrje prej 99.62%, në totalin e thëngjillit si burim primar në dispozicion, i pasuar nga thëngjilli

bituminoz me 0.38%. Kosova posedon vetëm rezerva të linjitet e jo edhe lloje tjera të thëngjillit. Nevojat për lloje tjera të thëngjillit plotësohen nga importi.

Prodhimi i energjisë elektrike në Kosovë (tabela në fig. 2), është rritur fuqishëm nga viti 2002 deri në vitin 2013, ndërsa në vitin 2014 kemi një rënie të prodhimit për shkak të një avarie në sistem. Burimi kryesor i furnizimit të brendshëm - vendor janë termocentralet Kosova A dhe Kosova B (me 97%) nga djegia e linjitet dhe një kontribut i vogël (me 3%) nga hidrocentralet. Bilanci midis kërkesës dhe furnizimit plotësohet nga importi i energjisë elektrike (me rreth 10 % në vit).

Fig. 3. Grafiku me % e sasisë së importuar të energjisë elektrike në disa vende të rajonit dhe të BE-së.




Të gjitha vendet e EJL janë të varura nga importi i energjisë elektrike. Kosova në krahasim me vendet tjera nuk është shumë e varur nga importi, mirëpo kjo duhet parë me rezervë sa i përket qëndrueshmërisë, sepse kapacitetet e vjetruara gjeneruese nuk garantojnë siguri afatgjate.

Përderisa në Kosovë pjesa më e madhe e energjisë sigurohet nga termocentralet, në Shqipëri deri më më sot, e gjithë energjia e prodhuar është siguruar nga hidrocentralet. Ndërtimi i TEC-i në qytetin e Vlorës erdhi si rezultat i nevojës që kishte vendi për rritjen e prodhimit të energjisë elektrike nga impiantet termike për të balancuar sadopak prodhimin nga impiantet ujore. TEC-i, i cili punon me naftë, pësoi një avari të rëndë dhe sot nuk është në funksion. Specialistë të energjetikës mendojnë se interesimi për vënien në punë të këtij impianti, i pari i ndërtuar në 30 vjetët e fundit në Shqipëri, ka lidhje edhe me situatën energjetike në vend e cila nuk favorizon shumë prodhimin e energjisë nga hidrocentralet në stinën e verës. Sipas tyre energjia elektrike e prodhuar prej këtij objekti në periudhën gusht, shtator, tetor, rezulton me mjaft leverdi.

Pasi Kosova mbështetet kryesisht në prodhimin e energjisë nga termocentralet, ndërsa Shqipëria nga hidrocentralet, bashkëpunimi mes dy shteteve për shkëmbimin e energjisë do iu mundësonte palëve leverdinë e dëshiruar dhe shfrytëzimin maksimal të kapaciteteve të natyrore.

Fig. 4. Raporti i energjisë elektrike në Kosovë dhe Shqipëri. Burim: ASK dhe INSTAT-Shqipëri.



### **Konkluzione dhe rekomandime:**


- Energjetika e Republikës së Kosovës mbështetet kryesisht në shfrytëzimin e linjtit (thëngjillit / qymyrit), që është resursi më i rëndësishëm vendor për prodhim të energjisë elektrike, me pjesëmarrje furnizuese prej rreth 97% në prodhimin total të saj.
- Termocentralet kanë ndikim në ndotje të ajrit në nivel lokal, rajonal dhe nivel global. Pra, ndikimi i ndotjes në shkallë lokale përfshinë disa dhjetëra kilometra prej burimit dhe njihet si ndikim lokal në cilësinë e ajrit, me rritjen e përqendrimeve të SO<sub>2</sub>, NO<sub>x</sub>, CO, gazrave organike, grimcave, metaleve të rënda, përbërjeve organike helmuese, etj.
- Burimet ripërtëritëse të energjisë, si energjia e erës, hidro-energjia dhe ajo e diellit, ripërtërihen vazhdimisht, nuk ndotin mjedisin dhe mund të shërbejnë për ngrohje dhe për prodhim të energjisë elektrike.

Prandaj, duke i pasur parasysh të dhënat e mësipërme rekomandohet që të merren vendime të qëndrueshme dhe të fokusuara në mbrojtje të njeriut dhe natyrës, sipas të cilave kërkohet:

- Të arrihet marrëveshje bilaterale me Shqipërinë për shkëmbimin e energjisë elektrike të prodhuar sipas burimeve dhe sezoneve favorizuese;
- Të bëhet rehabilitimi i termocentraleve, duke i sjellë ato brenda kritereve të lejuara mjedisore dhe eficientë të energjisë;
- Të rritet përdorimi i këtyre burimeve ripërtëritëse për përfitim të energjisë elektrike në mënyrë që të zvogëlohet raporti me sasinë e fituar nga thëngjilli;
- Të synohet kah arritja e objektivit të BE-së: 20 / 20 / 20.

**Indikatori: FURNIZIMI I POPULLSISË ME UJË TË PIJSHËM****Synimi:** INFRASTRUKTURA TEKNIKE & KOMUNIKIMI I INTEGRUAR NË MJEDIS TË RESPEKTUAR**Objektivi:** SIGURIMI I QASJES NË INFRASTRUKTURË PËR TË GJITHË

**Përshkrimi i Indikatorit:** Ky indikator paraqet vlerën e raportit (në përqindje) të popullatës së përfshirë në sistem të ujësjellësit, që furnizohen me ujë të pijshëm nga kompanitë regjionale të ujit (KRU), në kuadër të numrit të përgjithshëm të popullsisë në Republikën e Kosovës.




**Mënyra e matjes së Indikatorit:** Përqindja në nivel republike paraqet mesataren e përqindjeve të popullatave të 7 zonave të Kosovës që furnizohen me ujë nga 7 kompani të ndryshme rajonale të ujësjellësit.

**Fig. 1. Grafiku i % së popullsisë së përfshirë në furnizim me ujë të pijshëm nga KRU-të në Kosovë (2009 – 2013).** Burimi: ZRrE 2014.

**Burimi i informatës/ave:** Informata për gjendjen e Indikatorit në vitin 2013 është në “Raporti vjetor i performancës për ofruesit e shërbimeve të ujit në Kosovë në 2013” të përgatitur në shtator të vitit 2014 nga Zyra Rregullatorë për Ujësjellës dhe Kanalizim.

**Rëndësia e Indikatorit për zhvillimin hapësinor:** Kur të krahasohet e dhëna e vitit 2013 për përqindjen e popullsisë së furnizuar me ujë të pijshëm nga sistemi i ujësjellësit publik në nivel republike me të dhënat që i referohen furnizimit në 4-5 vitet paraprake, do të shihet se a ka pasur përparim në Kosovë sa i përket furnizimit të popullsisë gjatë kësaj periudhe kohore.

Të dhënat për përqindjet e banorëve të furnizuar, sipas zonave të shërbimit me ujë të pijshëm nga KRU gjegjëse, tregojnë se, në cilat rajone më shumë e në cilat më pak janë të përfshirë banorët e Republikës së Kosovës nga shërbimi i KRU-ve. Ky fakt tregon për domosdoshmërinë e planifikimit dhe të zgjerimit të rrjetit të ujësjellësit publik në rajonet me më pak banorë të përfshirë.



**Fig. 1. Grafiku i % së popullsisë së përfshirë në furnizim me ujë të pijshëm nga KRU-të në Kosovë (2009 – 2013).** Burimi: ZRrE 2014, me shkurtesat: GJA – KRU “Radoniqi” (Gjakovë); PE – KRU “Hidrodrini” (Pejë); PR – KRU “Prishtina” (Prishtinë); FE – KRU “Bifurkacioni” (Ferizaj); MIT – KRU “Mitrovica” (Mitrovicë); PZ – KRU “Hidroregjioni Jugor” (Prizren); GJI – KRU “Hidromorava” (Gjilan) MES – % Mesatare e popullsisë përfshirë nga 7 KRU-të;

**Gjendja e Indikatorit dhe krahasimi:** Në vitin 2013, 82 % e popullsisë në Republikën e Kosovës është furnizuar me ujë të pijshëm, prej sistemit publik të ujësjellësit nën menaxhim të KRU-ve. Nga grafiku në fig. 1, kuptohet se, përfshirja e popullsisë në shërbimin e ujësjellësve publik në Republikën e



Kosovës, vazhdimisht është rritur nga viti 2009 deri në vitin 2013. Ndërsa, nga grafiku në fig. 2, kuptohet se në vitin 2013 zona me përqindjen më të madhe të përfshirjes së banorëve nga ky shërbim është regjioni i Gjakovës që furnizon 99.7 % të popullsisë me ujë të pijshëm nga KRU “Radoniqi”, kurse zona me përqindjen më të vogël prej 62.7 % të përfshirjes së banorëve të saj në këtë shërbim është regjioni i Gjilanit që furnizohet nga KRU “Hidromorava”.

**Konkluzione dhe rekomandime:**

- Në Republikën e Kosovës, gjendja sa i përket furnizimit të popullsisë me ujë të pijshëm nga ujësjellësit publik, nga viti 2009 deri në vitin 2013 ka shkuar duke u përmirësuar.
- Rreth 20% e popullsisë së Kosovës, që janë popullsi e viseve rurale, ende nuk furnizohet me ujë të pijshëm nga ujësjellësit publik.
- Zonat që kanë nevojë dhe kërkesa më të mëdha për investime në zgjerimin e rrjetit të ujësjellësit publik në Republikën e Kosovës janë Mitrovica, Prizreni dhe Gjilani.

<b>Indikator:</b>	<b>VENDBANIMET DHE POPULLSIA E PËRFSHIRË NË SHËRBIMIN E LARGIMIT TË MBETURINAVE</b>
<b>Synimi:</b>	INFRASTRUKTURA DHE KOMUNIKIMI I INTEGRUAR DUKE RESPEKTUAR STANDARDET E MBROJTJES SË MJEDISIT
<b>Objektivi:</b>	SHËRBIME PUBLIKE CILËSORE


**Përshkrimi i Indikatorit.** Ky indikator e jep përqindjen e vendbanimeve dhe atë të ekonomive familjare që janë të përfshira nga shërbimi i largimit të mbeturinave si në nivelin shtetëror ashtu edhe në atë komunal në Republikën e Kosovës.

**Mënyra e matjes së Indikatorit.** Posedimi i informacionit për numrin e ekonomive familjare të një komune dhe numrin e këtyre ekonomive që kanë qasje në shërbimin e largimit të mbeturinave e mundëson gjetjen e përqindjes së ekonomive familjare të përfshira nga shërbimi i grumbullimit të mbeturinave në territorin e komunës. Në mënyrë të njëjtë matet edhe Indikatorin në nivel shteti.

#### Burimet e informatave.

1. Republika e Kosovës, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal;
2. Divizioni i Statistikave i Kombeve të Bashkuara;
3. Eurostat;
4. Komisioni European – Europa.eu;
5. OECD;
6. Komisioni i Komunitetit Evropian, për dhe në emër të Qeverisë së Shqipërisë

**Kufizimet në matjen e Indikatorit.** Vlerat numerike të indikatorit për shtete të ndryshme, të paraqitura në figurën 2, vlejën për vite të ndryshme. Ka që janë për vitin 2015, por ka edhe për vitin 2009. Kjo është për shkak të pamundësisë që të sigurohen të gjitha të dhënat për të njëjtin vit. Për këtë arsye, krahasimi i shteteve i paraqitur në figurën 2 nuk e pasqyron gjendjen e sotme të vitit 2017, por atë që është shumë e përafërt me këtë gjendje.



**Rëndësia e Indikatorit për zhvillimin hapësinor.** Ky tregues është i rëndësishëm sepse flet për përkushtimin e shoqërisë kosovare për mbrojtjen e mjedisit nga ndotja me mbeturina. Është e rëndësishme që një përqindje sa më e lartë e popullësisë të ketë qasje në shërbimin e grumbullimit të mbeturinave sepse kështu do të kishte kontrollë mbi mbeturinat dhe ato do të hudheshin vetëm në vende të caktuara për to duke e ruajtur kështu mjedisin nga hudhja e tyre atje ku nuk e kanë vendin. Përqindja eventuale e ultë e përfshirjes nga ky shërbim është tregues i qartë për një gjendje të padëshiruar në ruajtjen e mjedisit dhe se rritja e kësaj përqindje duhet të jetë prioritet i lartë për qeverinë dhe shoqërinë në tërësi sa i përket mjedisit. Duke qenë prioritet i lartë, ai është orientues i qartë për planerët se zhvillimi i ardhshëm hapësinor duhet të jetë shtrirja e shërbimit të largimit të mbeturinave edhe atje ku tani nuk ekziston dhe mbulimi një ditë i tërë popullësisë me këtë shërbim.

Fig. 1 – Republika e Kosovës në raport me disa shtete.

Figura 1<sup>41</sup> tregon se si qëndron Kosova në raport me disa shtete. Siq shihet Kosova zë vendin e parafundit në mesin e këtyre shteteve ku vetëm në Shqipëri përqindja e përfshirjes është më e vogël.

**Gjendja e Indikatorit dhe krahasimi.** Në Republikën e Kosovës, 55.32% të vendbanimeve dhe 56.33%<sup>42</sup> të ekonomive familjare janë të përfshira nga shërbimi i largimit të mbeturinave. Në figurën 1 tregohet si qëndron gjendja në komunat e Kosovës sa i përket përfshirjes së ekonomive familjare. Shihet se në komunat Viti dhe Lipjan përqindja e përfshirjes është shumë e vogël, ndërkaq në komunat Mitrovicë-Veri, Novobërdë dhe Leposaviq shërbimi nuk ekziston fare.




Fig. 2 – Gjendja e përfshirjes në komunat e Republikës së Kosovës<sup>43</sup>

### Konkluzionet dhe rekomandimet

• Figura 2 tregon se Kosova nuk qëndron mirë sa i përket përfshirjes së popullësisë nga shërbimi i largimit të mbeturinave. Objektivi i përcaktuar me Planin Hapësinor të Kosovës është që të ketë shërbime publike cilësore. Një komponentë e rëndësishme e shërbimeve publike është edhe shërbimi i largimit të mbeturinave dhe në këtë komponentë, objektivi është ende larg që të arrihet.

• Mungesa e shërbimit të largimit të mbeturinave rezulton me ndotjen e mjedisit në ato vende prej të cilave mbeturinat nuk largohen. Ndotja e mjedisit ka pasoja të dëmshme për shëndetin e popullatës. Kjo është arsyeja që përmirësimi i menaxhimit të mbeturinave të jetë një prej objektivave me prioritet të pushtetit lokal, sidomos në komunat ku ka më shumë mangësi sa i përket shërbimit të lartpërmendur. Atje ku ka nevojë dhe kërkesë, pushteti qendror duhet ta mbështesë pushtetin lokal në arritjen e këtij objekti. Për këtë

mbështetje, prioritet kanë komunat ku gjendja është më e keqe sa i përket largimit të mbeturinave dhe që mundësitë financuese i kanë më të vogla.

<sup>41</sup> Të dhënat për Kosovën, Serbinë, Malin e Zi dhe Bosnën e Hercegovinën janë të vitit 2015, për Turqinë të vitit 2014, për Kroacinë dhe Maqedoninë të vitit 2013, për Shqipërinë dhe Slloveninë të vitit 2010, për Gjermaninë dhe Francën të vitit 2009 dhe për Danimarkën të dhënat janë të vitit 2008.

<sup>42</sup> Republika e Kosovës, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal. (2016). Raporti i performancës së komunave 2015. Prishtinë

<sup>43</sup> Burimi: Republika e Kosovës, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal. (2016). Raporti i performancës së komunave 2015. Prishtinë

<sup>4</sup> Burimi: United Nations Statistics Division. (2011). Total Population Served by Municipal Waste Collection. (shqyrtuar online në <http://unstats.un.org/unsd/environment/municipalwaste.htm>).

<sup>5</sup> Burimi: Eurostat. (2016). Enlargement countries - environment statistics. (shqyrtuar online në [http://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php/Enlargement\\_countries\\_-\\_environment\\_statistics](http://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php/Enlargement_countries_-_environment_statistics)).

<sup>6</sup> Burimi: European Commission – Europa.eu. (2016). Factsheet – Croatia; Basic waste management data for Croatia. (shqyrtuar online në

[http://ec.europa.eu/environment/waste/framework/pdf/facsheets%20and%20roadmaps/Factsheet\\_Croatia.pdf](http://ec.europa.eu/environment/waste/framework/pdf/facsheets%20and%20roadmaps/Factsheet_Croatia.pdf)).

<sup>7</sup> Burimi: OECD. (2012). OECD Environmental Performance Reviews: Slovenia 2012. (shqyrtuar online në [https://books.google.com/books?id=FORUeREpU5IC&pg=PA155&lpg=PA155&dq=coverage+of+the+population+with+solid+waste+collection+service+in+Slovenia&source=bl&ots=nN6wSiVEiA&sig=OgRRhfWYmof9zn1SrfcU37Dtjvo&hl=en&sa=X&ved=0ahUKewjT3t\\_7pPiQAhVEWRoKkHakWBrGQ6AEIITAB#v=onepage&q=coverage%20of%20the%20population%20with%20solid%20waste%20collection%20service%20in%20Slovenia&f=false](https://books.google.com/books?id=FORUeREpU5IC&pg=PA155&lpg=PA155&dq=coverage+of+the+population+with+solid+waste+collection+service+in+Slovenia&source=bl&ots=nN6wSiVEiA&sig=OgRRhfWYmof9zn1SrfcU37Dtjvo&hl=en&sa=X&ved=0ahUKewjT3t_7pPiQAhVEWRoKkHakWBrGQ6AEIITAB#v=onepage&q=coverage%20of%20the%20population%20with%20solid%20waste%20collection%20service%20in%20Slovenia&f=false)).

<sup>8</sup> Burimi: Komisioni i Komunitetit Evropian, për dhe në emër të Qeverisë së Shqipërisë. (2010). Zbatimi i Planit Kombëtar për Përafrimin e Legjislacionit Mjedisor në Shqipëri; Plani Kombëtar për Menaxhimin e Mbetjeve. (shqyrtuar online në [http://www.miedisi.gov.al/files/userfiles/Mbetje/PKMMb\\_final.pdf](http://www.miedisi.gov.al/files/userfiles/Mbetje/PKMMb_final.pdf)).

<b>Indikator:</b>	<b>VENDBANIMET DHE POPULLSIA E PËRFSHIRË NË SISTEMIN PUBLIK TË NGROHJES QENDRORE</b>
<b>Synimi:</b>	INFRASTRUKTURA DHE KOMUNIKIMI I INTEGRUAR DUKE RESPEKTUAR STANDARDET E MBROJTJES SË MJEDISIT
<b>Objektivi:</b>	SIGURIMI I QASJES NË INFRASTRUKTURË PËR TË GJITHË

**Përshkrimi i Indikatorit:** Ky tregues tregon cilat vendbanime të Republikës së Kosovës kanë sistem publik të ngrohjes qendrore dhe e jep përqindjen e popullsisë, si në nivelin komunal ashtu edhe në atë shtetëror, që është e lidhur në këtë sistem.

**Mënyra e matjes së Indikatorit:** Posedimi i informacionit, në njërën anë për numrin e banorëve të një komune, numrin e familjeve të kësaj komune të cilat janë të lidhura në sistemin publik të ngrohjes qendrore dhe numrin mesatar të anëtarëve të këtyre familjeve dhe në anën tjetër për numrin e banorëve të Kosovës, numrin e familjeve të Kosovës të lidhura në sistem dhe numrin mesatar të anëtarëve të familjeve, e mundëson respektivisht gjetjen e përqindjes në nivel komune dhe të asaj në nivel shteti.

#### **Burimet e informatave:**

1. Ministria e Zhvillimit Ekonomik;
2. Ndërmarrja publike "Termokos" Sh. A.
3. Euroheat & Power;
4. Agjencia e Statistikave të Kosovës;
5. Konferenca e parë vjetore, 3 tetor, 2012, Utzon Center, Slotspladsen 4, Aalborg;
6. Instituti i Statistikave i Republikës së Shqipërisë;
7. Enti për Statistikë i Malit të Zi;
8. Agjencia për Statistikë e Bosnës e Hercegovinës;
9. Eurostat;
10. European Environment Agency.

**Kufizimet në matjen e Indikatorit:** Meqenëse për disa shtete si Kosova, Maqedonia, Bosnja e Hercegovina dhe Mali i Zi nuk është gjetur në Internet e dhëna e gatshme për indikatorin, ajo është dashur të gjendet duke u bazuar në numrin e banorëve të këtyre shteteve, numrin e familjeve të lidhura në sistemin publik të ngrohjes qendrore dhe numrin mesatar të anëtarëve të këtyre familjeve. Gjatë kësaj pune ka pasur kufizime të cilat janë rezultat i nivelit të saktësisë së të dhënave dhe kohës për të cilën ato vlejné. Për shembull për Kosovën dhe Maqedoninë, të dhënat për numrin e popullsisë nuk janë 100% të sakta sepse janë vlerësime. Megjithatë vlerësimet janë mjaft të afërta me shifrat e sakta, prandaj mund të mbështetemi në to. Në anën tjetër, përveç të dhënave për Kosovën të cilat janë të këtij viti (2016), të dhënat për Maqedoninë, Bosnjën e Hercegovinën dhe Malin e Zi janë të viteve 2011, 2012 dhe 2013, pra pak më të vjetra.

**Rëndësia e Indikatorit për zhvillimin hapësinor:** Indikatorit e jep informatën për shpërndarjen hapësinore të sistemit publik të ngrohjes qendrore në Republikën e Kosovës, përqindjen e banorëve të saj dhe përqindjen e banorëve të komunave në të cilat ka sisteme të tilla, të cilët shërbejnë me ngrohje qendrore. Kjo informatë është e rëndësishme sepse tregon sa është arritur objektivi nga Plani Hapësinor i Kosovës për sigurimin e qasjes në infrastrukturë për të gjithë. Meqenëse ky objektivi ka të bëjë edhe me sigurimin e ngrohjes qendrore për të gjithë, faktet në terren e orientojnë planifikimin e zhvillimit të ardhshëm hapësinor në drejtim të planifikimit të shtrirjes së sistemit publik të ngrohjes qendrore atje ku tani ai nuk ekziston në mënyrë që një ditë, tërë popullata e republikës të furnizohet me ngrohje qendrore dhe kështu në këtë segment objektivi të arrihet.

**Gjendja e Indikatorit dhe krahasimi:** Në Republikën e Kosovës, vetëm në Prishtinë dhe në Gjakovë, një pjesë e banorëve furnizohen me ngrohje qendrore nga ngrohoret e këtyre qyteteve. Edhe qyteti i Mitrovicës e ka një ngrohore me kapacitet të vogël, por ajo është jashtë funksionit. Numri i përgjithshëm, i vlerësuar i banorëve të Republikës që furnizohet me ngrohje qendrore nga ngrohoret është rreth 76300 apo 4.3% e popullësisë. Ngrohitorja e qytetit “Termokos” i furnizon rreth 70000 banorë të Prishtinës me ngrohje qendrore që është rreth 34% të popullësisë së komunës së Prishtinës, kurse ngrohitorja e Gjakovës i furnizon rreth 6300 banorë të qytetit ose rreth 7% të popullësisë së komunës së Gjakovës.

Figura 1 tregon se si qëndron Kosova në raport me disa shtete sa i përket përqindjes së popullësisë që furnizohet me ngrohje nga sistemi publik i ngrohjes qendrore. Siq shihet Kosova zë njërin nga vendet e fundit në mesin e këtyre shteteve ku vetëm Shqipëria dhe Mali i Zi e kanë këtë përqindje më të vogël, respektivisht 1% dhe 0.24%. Përqindja e popullësisë që furnizohet me ngrohje nga sistemi publik i ngrohjes qendrore në Danimarkë arrin në 63%, kurse në Islandë madje deri në 92%.




Fig. 1 – Republika e Kosovës në raport me disa shtete<sup>44</sup>.

<sup>44</sup> Të dhënat për Shqipërinë, Maqedoninë, Bosnën e Hercegovinën dhe Malin e Zi janë të vitit 2012, për Kosovën të vitit 2016, kurse për shtetet tjera, të vitit 2013.

<sup>2</sup> Neven Duić., Goran Krajačić., Zoran Pranjić., Gennadii Khavin. (2012). The case of Eastern Europe, 4th Generation District Heating - First Annual Conference 3rd October 2012 Utzon Center, Slotspladsen 4, Aalborg (shqyrtuar online në [file:///C:/Users/PC/Desktop/Presentation%2010\\_Neven%20Duić.pdf](file:///C:/Users/PC/Desktop/Presentation%2010_Neven%20Duić.pdf)).

<sup>3</sup> Enti për Statistikë i Malit të Zi. (2013). Popis stanovništva, domaćinstava i stanova u Crnoj Gori 2011 godine. Podgoricë. (shqyrtuar online në <http://www.monstat.org/userfiles/file/popis2011/saopstenje/domac%20i%20porodice,%20cg-za%20sajt.pdf>).

<sup>4</sup> Agjencia për Statistikë e Bosnës e Hercegovinës. (2016). Popis stanovništva, domaćinstava i stanova u Bosni i Hercegovini, 2013. Rezultati popisa. Sarajevë. (shqyrtuar online në <http://www.popis2013.ba/5180DC86-1791-40C5-8E79-E686E8B30758/FinalDownload/DownloadId-F0D4DFB1E107A2CC732F008EE9A2581E/5180DC86-1791-40C5-8E79-E686E8B30758/popis2013/doc/Popis2013prvolzdanje.pdf>).

<sup>5</sup> Eurostat. (2015). File:Average household size, 2014 (average number of persons in private households).png. (shqyrtuar online në [http://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php/File:Average\\_household\\_size,\\_2014\\_\(average\\_number\\_of\\_persons\\_in\\_private\\_households\).png](http://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php/File:Average_household_size,_2014_(average_number_of_persons_in_private_households).png) dhe në [https://www.google.com/?gws\\_rd=ssl#q=population+of+macedonia](https://www.google.com/?gws_rd=ssl#q=population+of+macedonia)).

<sup>6</sup> European Environment Agency. (2012). Percentage of households connected to district heating. (shqyrtuar online në <http://www.eea.europa.eu/data-and-maps/figures/percentage-of-households-connected-to-district-heating>).

<sup>7</sup> Instituti i Statistikave i Republikës së Shqipërisë. (2016). Popullsia e Shqipërisë. (shqyrtuar online në <http://www.instat.gov.al/al/themes/popullsia.aspx>).

\* Euroheat & Power. (2015). Country by country/2015 Survey, TOP District Heating and Cooling Indicators 2013 (shqyrtuar online në <http://www.euroheat.org/wp-content/uploads/2016/03/2015-Country-by-country-Statistics-Overview.pdf>).

<sup>8</sup> Republika e Kosovës, Qeveria, Ministria e Zhvillimit Ekonomik. (2011). Strategjia e Ngrhjes e Republikës së Kosovës 2011 – 2018. Prishtinë.

### **Konkluzione dhe rekomandime:**

- Republika e Kosovës nuk qëndron mirë në raport me vendet e rajonit dhe të Europës sa i përket zhvillimit të sistemeve të ngrohjes kolektive e cila gjenerohet në qendra të caktuara. Vetëm rreth 4% e popullësisë ka qasje dhe shërbehet nga këto sisteme e kjo është jashtëzakonisht pak.
- Duke qenë ky fakt mund të konstatohet se sa i përket objektivit të Planit Hapësinor të Kosovës për sigurimin e qasjes në infrastrukturë për të gjithë, për një komponentë të infrastrukturës, për infrastrukturën e energjisë termike, objektivi nuk është arritur dhe madje është larg të arriturit.
- Fakti që vetëm një numër shumë i vogël i qytetarëve të Republikës së Kosovës ka qasje në sistemin publik të ngrohjes qendrore dhe duke e ditur se në Kosovë dimri është relativisht i ashpër dhe në çdo shtëpi ka nevojë për ngrohje, logjikisht imponojnë krijimin e një politike të zhvillimit ekonomik e cila njërin prej prioriteve e ka shtrirjen në tërë territorin e republikës, të sistemit të ngrohjes që vjen nga qendrat e caktuara – nga ngrohtoret.
- Fillimisht shtrirja e sistemit do të duhej të vazhdojë në qytetet në të cilët tani më ai ekziston e pastaj sistemi të shtrihej, së pari në qytetet me numër më të madh të banorëve e më vonë edhe në vendbanimet tjera. Në këtë rast vendimmarrësit dhe investitorët do të duhej të përcaktoheshin dhe t'i realizojnë format ekologjike dhe më bashkëkohore të prodhimit të energjisë termike në mënyrë që mjedisi të ruhet sa më shumë që është e mundur.

---

<sup>9</sup> Ndërmarrja publike "Termokos" Sh. A. (2016). Raport i hulumtimit të kënaqshmërisë së konsumatorëve me shërbimet e NP "Termokos" Sh. A. Prishtinë.

<sup>10</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës. (2016). Vlerësim Popullsia e Kosovës 2015. Prishtinë.

<b>Indikator:</b>	<b>TERRITORI DHE POPULLËSIA QË MBULOHEN NGA SHËRBIMET E TELEKOMUNIKACIONIT</b>
<b>Synimi:</b>	INFRASTRUKTURA DHE KOMUNIKIMI I INTEGRUAR DUKE RESPEKTUAR STANDARDET E MBROJTJES SË MJEDISIT
<b>Objektivi:</b>	PËRMIRËSIMI I RRJETIT DHE OBJEKTEVE TË INFRASTRUKTURËS SË BRENSHME

**Përshkrimi i Indikatorit:** Ky është një tregues që flet për nivelin e zhvillimit të telekomunikacionit në Republikën e Kosovës. Indikatorit ngërthen në vete disa komponenta të ndryshme të telekomunikacionit. Për këtë arsye ai është zberthyer në tregues më specifik apo në tregues për këto komponenta. Këta tregues janë:

1. Numrin e përdoruesve (abonuesve) të telefonisë fikse në 100 banorë në Republikën e Kosovës dhe nëpër komuna;
2. Numrin e përdoruesve (abonuesve) të telefonisë mobile në 100 banorë në Republikën e Kosovës
3. Mbulueshmëria e territorit dhe popullsisë nga rrjeti 3G mobil

Momentalisht, mbulimi bëhet nga dy operatorë të telefonisë mobile, Vala që është pjesë e shoqërisë aksionare Posta dhe Telekomit i Kosovës (PTK Sh.A.) dhe Kompania e Telekomunikimit Ipko, të cilët mbulojnë hapësirë dhe përqindje të ndryshme të popullsisë. Mbulueshmëria e hapësirës ka të bëjë me hapësirat apo vendet e Kosovës në të cilat njerëzit mund të hyjnë në Internet përmes telefonave të mençur të tyre apo të flasin me njëri tjetrin duke i shfrytëzuar aplikacionet e Internetit Viber dhe WhatsApp të instaluar në këta telefona. Përqindja e popullsisë së mbuluar nga rrjeti 3G mobil tregon se sa është përqindja e banorëve të republikës të cilët jetojnë në vendbanimet ku ka rrjet 3G.

**Mënyra e matjes së Indikatorit/ve:** Indikatorit 1 dhe 2 në nivel të republikës gjenden kur fillimisht pjestohet numri i banorëve të Kosovës me 100 dhe pastaj me numrin që del pjestohen respektivisht numrat e të gjithë abonuesve të telefonisë fikse dhe asaj mobile në Kosovë. Natyrisht, mënyra e njëjtë e matjes vlen për komunat. Sa i përket Indikatorit 3, posedimi i informacionit për numrin e banorëve në vendbanimet e Kosovës ku ka rrjet 3G dhe numrin e përgjithshëm të popullsisë së Kosovës e mundëson gjetjen e përqindjes së popullsisë së mbuluar nga ky rrjet.

**Burimi i informatës/ave:**

1. Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARrKEP);
2. Banka Botërore (BB);
3. PTK Sh.A.
4. Kompania e Telekomunikimit Ipko;
5. Ofcom

**Kufizimet në matjen e Indikatorit:** Këto kufizime shkaktohen nga fakti se numri i banorëve të Kosovës dhe i atyre në komuna në vitet 2014 dhe 2016 është vetëm një vlerësim prandaj nuk është 100% i saktë. Në anën tjetër mungojnë të dhënat për pjesën veriore të Mitrovicës dhe për disa vendbanime me banorë të kombësisë serbe. Megjithatë vlerësimi është shumë i afërt me shifrën e saktë, prandaj mund të mbështetemi në të.

**Rëndësia e treguesve për zhvillimin hapësinor:** Rëndësia e treguesve për përqindjet e abonuesve të telefonive fikse dhe mobile qëndron në atë se, varësisht nga rritja apo zvogëlimi i interesimit të qytetarëve ndër vite për këto telefoni, bëhet planifikimi për këto telefoni. Rritja e interesimit apo e përqindjes së abonuesve bën që të planifikohet një zgjerim i shtrirjes në hapësirë të telefonisë fikse ose mobile, ndërkaq zvogëlimi i numrit të abonuesve në 100 banorë bën që telefonia fikse ose mobile të mos konsiderohet si dicka me prioritet dhe rrjedhimisht të rezultojë me një zgjerim apo zhvillim më të ngadalshëm të telefonisë.

Indikatorit për komunat e bën të njohur se cilat komuna kanë më pak përdorues në 100 banorë të tyre apo më pak linja telefonike duke treguar kështu se cilat komuna duhet të kenë përparësi për investime në shtimin e numrit të linjave të telefonisë fikse.

KOMUNA	Nr. Abonuesve	Nr. Popullsisë	Nr. Abonuesve në 100 banorë
Deçan	2123	40549	5.24
Dragash	736	34364	2.14
Ferizaj	5071	111842	4.53
Fushë Kosovë	2903	37843	7.67
Gjakovë	5336	96162	5.55
Gjilan	4720	91489	5.16
Glllogoc	1245	59990	2.10
Graçanicë	589	11359	5.18
Hani i Elezit	177	9613	1.84
Istog	1589	40126	3.96
Junik	0	6226	0
Kaçanik	568	33875	1.68
Kamenicë	1226	35261	3.48
Klinë	808	39555	2.04
Klllokot	0	2651	0
Leposaviq	0	13485	0
Lipjan	1851	59196	3.13
Malishevë	298	56482	0.53
Mamushë	138	5688	2.43
Mitrovicë	5048	76000	6.64
Mitrovicë V*	-	73362	-
Novobërdë	70	6923	1.01
Obiliq	1091	22105	4.93
Partesh	438	1731	25.30
Pejë	4869	97706	4.98
Podujevë	1451	89051	1.63
Prishtinë	22822	207477	11.00
Prizren	6515	182449	3.57
Rahovec	1347	57645	2.34
Ranillug	0	3791	0
Shtërpçë	8	6873	0.12
Shtime	1151	28096	4.10
Skenderaj	651	51361	1.27
Suharekë	842	61352	1.37
Viti	920	47775	1.92
Vushtrri	2038	71212	2.86
Zubin Potok	0	6508	0
Zveçan	0	7319	0
GJITHSEJ	64288	1884492	3.62

Viti	2011	2012	2013	2014
Individual	68629	64632	62877	47683
Bizneset	17385	16971	15762	16614
Totali	86014	81603	78639	64297

**Fig.1 – Numri i përdoruesve të telefonisë fikse në Republikën e Kosovës (për vitet 2011-2014).**

Burimi: ARrKEP 2014<sup>45</sup>

Indikatori për mbulueshmërinë e rrjetit 3G mobil e bën të ditur se cilat hapësira apo vendbanime të Kosovës janë ende të pambluara nga ky rrjet. Në këtë mënyrë ai e orienton planifikimin e zhvillimit të ardhshëm hapësinor, zhvillim ky që konsiston në ngritjen e mëtejshme të infrastrukturës së telekomunikacionit.

**Fig.2 – Numri i abonuesve të telefonisë fikse në 100 banorë, sipas komunave të Kosovës në vitin 2014.** Burimi: ARrKEP 2014.

#### **Gjendja e treguesve dhe krahasimi:**

Krahasimi i numrit të përdoruesve të telefonisë fikse në vitin 2014 me numrat në tre vitet paraprake tregon se në periudhën kohore 2011-2014 nuk ka patur zhvillim të telefonisë fikse në Republikën e Kosovës por rënje të saj në çdo vit pasues të kësaj periudhe. Ky fakt i mungesës së investimeve në telefoninë fikse duhet të jetë pasojë e interesimit të vogël të qytetarëve të Kosovës për telefona fiks në kohën kur telefonat mobil, si rezultat i avancimit të telefonisë, janë më praktik, me shumë më shumë mundësi se ata fiks dhe kështu kanë gjetur përdorim të gjërë, si kudo në botë edhe tek ne. Është vlerësuar se në Republikën e Kosovës, mesatarja e numrit të përdoruesve apo abonuesve të telefonisë fikse në 100 banorë është 3.62.

<sup>45</sup> Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare. (2014). Raporti vjetor për vitin 2014. Prishtinë.



Shtetet e rajonit	Nr. Abonuesve në 100 banorë
Kosova	95
Shqipëria	105
Bosna dhe Hercegovina	91
Bullgaria	138
Kroacia	104
Maqedonia	106
Mali i Zi	163
Serbia	122
Slovenia	112
Shtetet e BE	
Austria	152
Britania e Madhe	124
Belgjika	114
Danimarka	126
Franca	101
Gjermania	120
Italia	154
Holanda	116
Spanja	108
Suedia	128
Shtetet me ekonomi më të mëdha	
SHBA	110
Kina	92
Japonia	120
Federata Ruse	155
India	74
Brazili	139

Nga tabela (fig. 2) shihet se më së shumti abonues të telefonisë fikse në 100 banorë ka në komunat Partesh, Prishtinë dhe Fushë Kosovë me respektivisht 25, 11 dhe 8 përdorues në 100 banorë, kurse më së paku ka në komunat Novobërdë, Malishevë dhe Junik me respektivisht 1,1 dhe 0 përdorues në 100 banorë. Diagrami (fig.3) tregon se sa prapa shteteve të rajonit është Republika e Kosovës sa i përket këtij Indikatori. Slovenia, Kroacia dhe Serbia me nga 37 abonues në 100 banorë kanë 9.25 herë më shumë se Kosova me 4 abonues, kurse Mali i Zi me 26 abonues ka 6.5 herë më shumë.

Fig.3 – Kosova në raport me shtetet në rajon në vitin 2014.




Fig.4 – Numri i përdoruesve të telefonisë mobile në Republikën e Kosovës (2010-2014). Burimi: ARrKEP 2014.

Viti	2010	2011	2012	2013	2014
Numri i Abonuesve	1451747	1478944	1663844	1643429	1731291

Fig.5 – Numri i abonimeve në telefoninë mobile në 100 banorë nëpër shtete të ndryshme, viti 2014<sup>46</sup>. Burimi: Banka botërore 2014

Sic shihet në tabelë (fig.4), rritja e vazhdueshme e numrit të përdoruesve të telefonisë mobile flet për një interesim në rritje të qytetarëve të Kosovës për telefona mobil. Interesim në rritje për këtë telefoni ka në tërë botën sepse ajo e ka avansuar shumë mundësinë e komunikimit në mes të njerëzve. Trendi i rritjes së numrit të abonuesve do të vazhdojë sepse njerëzit duan ta përmbushin nevojën që kanë për komunikim. Është vlerësuar se në Republikën e Kosovës, në vitin 2014 kanë qenë 95 abonues të telefonisë mobile në 100 banorë. Tabela (fig.5) tregon se krahasuar me shtetet e rajonit, në vitin 2014, vetëm Bosna e Hercegovina kanë patur më pak abonime në 100 banorë se sa Kosova, kurse Mali i Zi më së shumti. Në tabelë poashtu shihet se në këtë vit Kosova ka patur më pak abonime se sa shtetet e BE dhe shtetet me ekonomitë më të mëdha, me përjashtim të Kinës dhe Indisë që kanë patur më pak.

<sup>46</sup> Banka Botërore (2014). Abonimet në telefoninë mobile për 100 banorë (shqyrtuar online në <http://data.worldbank.org/indicator/IT.CEL.SETS.P2>).

Duke filluar prej datës 1 dhjetor 2013, për të parën herë në Republikën e Kosovës, IPKO e ka sjellur rrjetin më të shpejtë të internetit në mobil, gjeneratën e re të rrjetit 3G. Në vitin 2014, këtë rrjet në Kosovë e ka sjellë edhe Vala. Në fund të vitit 2014 Vala e ka mbuluar 30% të hapësirës së Kosovës me rrjetin e shpejtë të internetit në mobil 3G. Imazhi (fig.6) e tregon këtë mbulueshmëri. Në vitin 2016 IPKO e ka mbuluar 44% të hapësirës së Kosovës dhe 80% të popullsisë së saj me rrjetin në fjalë (fig.7). Tabelat (fig.8 dhe 9) tregojnë se Kosova sa i përket mbulimit të popullsisë me rrjetin 3G mobil qëndron prapa, jo vetëm shteteve të BE, por edhe shteteve të rajonit në të cilin ndodhet.




Fig.6 – Mbulueshmëria e Vala-s me 3G në vitin 2014<sup>47</sup>.




Fig.7 – Mbulueshmëria e Ipko-s me 3G në vitin 2016<sup>48</sup>

Fig.8 – Përqindja e popullsisë së mbuluar nga rrjeti 3G mobil në disa shtete të BE<sup>49</sup>.

Shteti	Përqindja e popullsisë së mbuluar nga rrjeti 3G
Kosova	80 (viti 2016)
Shqipëria	95 (viti 2013)
Bullgaria	95-100 (viti 2015)
Kroacia	95-100 (viti 2015)
Maqedonia	98 (viti 2015)
Mali i Zi	97 (viti 2016)
Sllovenia	95-100 (viti 2015)

Shteti	Përqindja e popullsisë së mbuluar nga rrjeti 3G
Austria	95-100 (viti 2015)
Britania e Madhe	95-100 (viti 2015)
Belgjika	95-100 (viti 2015)
Danimarka	95-100 (viti 2015)
Franca	95-100 (viti 2015)
Gjermania	90-95 (viti 2015)
Italia	95-100 (viti 2015)
Holanda	95-100 (viti 2015)
Spanja	95-100 (viti 2015)
Suedia	95-100 (viti 2015)

Fig.9 – Përqindja e popullsisë së mbuluar nga rrjeti 3G mobil në disa shtete të Ballkanit<sup>50</sup>.

<sup>47</sup> PTK Sh.A. (2014). Vjetari 2014. Prishtinë.

<sup>48</sup> Kompania e Telekomunikimit Ipko (2016). Hartat e mbulueshmërisë (shqyrtuar online në <https://www.ipko.com/residential/harta-e-mbulueshmerise/>).

<sup>49</sup> Ofcom (2015). The European Broadband Scorecard.


<sup>50</sup> Ofcom (2015). The European Broadband Scorecard.

### **Konkluzione dhe rekomandime:**

- Të dhënat për numrin e përdoruesve të telefonisë fikse në Republikën e Kosovës tregojnë se e kemi një trend të rënjes së vazhdueshme të këtij numri. Nga rreth 86000 abonues që ishin në vitin 2011, në vitin 2014 kanë mbetur rreth 64000, pra për vetëm tre vjet numri i abonuesve ka rënë për rreth 22000 apo për 25%. Nëse ky trend do të vazhdonte, Kosova do të ngecte edhe më shumë sa i përket zhvillimit të telefonisë fikse, madje do të mund të mbeste krejtësisht pa të dhe pa përdoruesit e saj;
- Ky fakt do të ndikojë tek planifikimi i zhvillimit të ardhshëm të telekomunikacionit që ai mos ta ketë si prioritet zhvillimin e telefonisë fikse por të fokusohet më shumë në zhvillimin e komponentave tjera të telekomunikacionit;
- Republika e Kosovës nuk qëndron keq sa i përket telefonisë mobile. Numri i abonuesve është rritur vit pas viti dhe në vitin 2014 ka qenë i përafërt me numrin e banorëve apo sa 95% i këtij numri. Kjo tregon se në Republikën e Kosovës ka patur investime dhe zhvillim të pandërprerë të telefonisë mobile gjatë viteve. Kosova ka ecur në hap me shtetet tjera më të pasura dhe nuk qëndron larg tyre në këtë drejtim;
- Interesimi i qytetarëve të Kosovës për telefona mobil që është rritur vit pas viti dhe rëndësia e madhe që e ka rritja e mundësive të komunikimit në mes të njerëzve rezultojnë me konkludimin se duhet të planifikohet dhe realizohet një zhvillim i mëtejshëm i telekomunikacionit në Kosovë, gjë e cila do ta mundësonte një jetë më të mirë për të gjithë qytetarët;
- Deri në muajin dhjetor të vitit 2013, në Republikën e Kosovës nuk ka ekzistuar rrjeti i Internetit të shpejtë 3G mobil. Në mesin e vitit 2016 ky rrjet e ka mbuluar mëse gjysmën e territorit të republikës dhe rreth 80% të popullësisë së saj. Kjo do të thotë se për një periudhë kohore rreth dy vjet e gjysëm, në Kosovë është bërë një hap i madh në zhvillimin e mëtejshëm të telekomunikacionit apo në rritjen e mundësive të komunikimit midis njerëzve;
- Përkundër arritjes së lartpërmendur, në Kosovë ende rreth gjysma e hapësirës nuk mbulohet nga rrjeti 3G dhe në këtë aspekt ajo është prapa vendeve fqinje dhe vendeve të BE. Për këtë arsye është e nevojshme që institucionet dhe kompanitë që kanë të bëjnë me telekomunikacionin t'i vazhdojnë përpjekjet e tyre që e tërë hapësira dhe popullësia të mbulohen nga rrjeti 3G mobil i Internetit. Krijimi i mundësisë që përmes një telefoni të mençur të kesh qasje në Internet nga çdo cep i republikës, do të ishte një arritje e rëndësishme, e dëshirueshme nga çdokush.

**Indikatori:** MBULIMI I TERRITORIT TË KOSOVËS NGA SHËRBIMET E TRANSPORTIT PUBLIK  
**Synimi:** ZHVILLIMI QËNDRUESHËM I TRANSPORTIT PUBLIK (URBAN E NDËR-URBAN)  
**Objektivi:** SHTRIRJA E TRANSPORTIT PUBLIK NË TË GJITHË TERRITORIN E KOSOVËS

**Përshkrimi i Indikatorit:** Ky indikator paraqet shtrirjen e shërbimeve të transportit publik dhe madhësinë e territorin që mbulojnë në Republikën e Kosovës, me vendbanimet e përfshira dhe pjesëmarrjen e popullsisë që gëzojnë qasje në këto shërbime. Në përgjithësi, përmes kësaj, do të fitoheshin edhe njohuri tjera mbi gjendjen aktuale të tërë sistemit të transportit publik në Kosovë.



**Fig. 1. Harta e rrjetit të rrugëve në Kosovë.** Burimi: MI

**Mënyra e matjes së Indikatorit:**

Ky tregues matet duke analizuar të dhënat e mbledhura për shërbimet e transportit publik, siç janë:

- Linjat e transportit publik në Kosovë;
- Qasja apo përfshirja e vendbanimeve të Kosovës në shërbimet e transportit publik;
- Stacionet e autobusëve dhe të trenit si dhe vend-ndaljet me distanca të arritjeve.

Këto të dhëna, të cilat janë në formë të raporteve të publikimit të statistikave, strategjive të ndryshme apo çfarëdo formati tjetër, do të analizohen në dimension të shtrirjes dhe të përfshirjes së tyre gjeografike dhe kohore për territorin e Kosovës.

Në Kosovë, bazuar në Ligjin nr. 03/L-120 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Rrugë nr. 2003/11, rrugët për nga shfrytëzimi ndahen në: *rrugë publike* dhe *rrugë të pa kategorizuara*.

Përderisa, *rruga publike* nënkupton sipërfaqen me rëndësi të përgjithshme për komunikacion, e cila mund të shfrytëzohet nga pjesëmarrësit në komunikacion sipas kushteve të shpallura nga organi kompetent, *rruga e pa kategorizuar* nënkupton rrugën e cila nuk është përcaktuar si rrugë publike, por që shfrytëzohet për komunikacion rrugor nëpër zonat bujqësore, pyjore, për tek liqenet akumulues, e të tjera të ngjashme. Kjo kategori e rrugëve nuk ka ndarje apo nëndarje të tjera. Përndryshe, *rrugët publike* ndahen dhe klasifikohen në gjashtë kategori, si në vazhdim:

1. Auto-udhë - nënkupton rrugën publike të ndërtuar dhe destinuar posaçërisht vetëm për lëvizjen e mjeteve motorike, e cila shënohet me shenjë të veçantë komunikacioni dhe është me sipërfaqe qarkulluese të ndara fizikisht për lëvizje nga drejtime të kundërta, me gjerësi të shiritave së paku 3,5 metra (varësisht nga konfiguracioni i terrenit) dhe me nga një shirit për ndalje emergjente në të dy anët, me gjerësi së paku 2,5 metra;
2. Rrugë nacionale - nënkupton rrugën publike zyrtarisht të kategorizuar si rrugë nacionale, e cila lidh dy e më tepër qytete dhe mund të shërbej për lidhjen e Kosovës me rajonet përreth;
3. Rrugë rajonale - nënkupton rrugën publike e cila lidh qendrat me rëndësi ekonomike të dy apo më tepër regjioneve;
4. Rrugë lokale - nënkupton rrugën publike zyrtarisht të kategorizuar si një rrugë lokale, që lidh hapësirat e banueshme të vendbanimeve brenda një komune;
5. Rrugë urbane – nënkupton rrugën publike që lidh hapësirat e banueshme brenda vendbanimeve të një komune;
6. Rrugë lidhëse - nënkupton rrugën publike e cila lidh vendbanimet me aeroporte, stacione hekurudhore, banja shëruese, qendra rekreative -sportive, parqe nacionale, etj.

**Burimi i informatës/ave:** Burimet kryesore për të dhënat e përdorura janë siguruar nga Ministria e Infrastrukturës (MI), Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), Ministria e Punëve të Brendshme (MPB), INFRAKOS Sh. A. - TRAINKOS Sh. A. dhe Komunat.

**Kufizimet për matjen e Indikatorit:** Mungesa e informatave të sakta e të besueshme që ndërlidhën me mbulimin territorial e të përfshirjes gjeografike dhe kohore të shërbimeve të transportit publik në Kosovë janë pengesë kryesore për matje dhe pasqyrim real të gjendjes së indikatorit.

**Rëndësia e Indikatorit për zhvillim hapësinor:** Me të dhënat e rezultuara të këtij Indikator, mundësohet që të kuptohet më lehtë për gjendjen, shtrirjen hapësinore dhe nivelin e zhvillimit të sistemit të transportit publik me shërbimet që ofrohen në territorin e Kosovës. Rëndësia e tij Indikator është për shkak që mundëson të kuptojmë se a ofrohen shërbimet e transportit publik në të gjithë territorin e Kosovës, nëse po, çfarë është gjendja e tyre dhe se çka duhet të përmirësohet, dhe nëse nuk ofrohen shërbimet e transportit në të gjithë territorin e Kosovës, atëherë duhet të kuptohet pse këto shërbime nuk janë të ofruara dhe se çka duhet të bëhet që këto shërbime të ofrohen edhe në ato vendbanime apo zona që deri tani janë privuar nga ky shërbim. Po ashtu, nga trajtimi i këtij indikator do të paraqesim për herë të parë edhe gjendjen e plotë të sistemit të transportit tokësorë në Kosovë, analizë e cila do të integrohet edhe në planin e ardhshëm hapësinorë të Kosovës dhe Hartën Zonale të Kosovës, dhe dokumentet dhe strategjitë e tjera sektoriale.

**Gjendja e Indikatorit dhe krahasimi:** Kosova ka sipërfaqen 10,906 km<sup>2</sup> në të cilën jetojnë 1.771.604 banorë (ASK, 31 dhjetor 2015) me dendësinë banimi 162.5 b/km<sup>2</sup>. Kosova ka 38 komuna me qendrat e tyre komunale ku jetojnë 655,007 b (ASK, 2011) apo 37 % e popullsisë së Kosovës, ndërsa pjesa tjetër e popullsisë jetojnë në 1,431 vendbanime tjera, që kryesisht janë fshatra.

Çdo qendër komunale (duke përfshirë komunat veriore, për të cilat mungojnë informatat) ka shërbime të transportit publik apo linja të rregullta ditore në drejtim të kryeqendrës, Prishtinës dhe anasjelltas. Pjesëmarrja e popullsisë së vendbanimeve, nëpër të cilat (direkt të kyçura) dhe/apo në afërsi të të cilave (qasje e mundësuar) kalojnë këto linja të rregullta të shërbimeve të transportit publik kombëtar, përbën rreth 40 % të popullsisë së Kosovës.

Shumica e komunave, për qytetarët e vet, këto shërbime i kanë të rregulluara përmes shërbimeve të transportit publik regjional apo lokal, që për fokus kanë lëvizjen drejt qendrës regjionale e qendrave ndërlidhëse komunale, si dhe vendbanimeve tjera rurale. Momentalisht, asnjë nga institucionet që sigurojnë informacione të kësaj natyre nuk posedon informatën bazike për këtë indikator: *Sa dhe cilat vendbanime janë të përfshira në rrjetin e shërbimeve të transportit publik?!*

Sipas “Strategjisë Sektoriale dhe Transportit Multi-modal 2015-2025 dhe Planit të Veprimit 5 Vjeçar” qarkullimi më i madh i automjeteve, dhe sidomos i autobusëve në Kosovë ndodhë në rrugët nacionale

dhe regionale që lidhin disa qendra të mëdha urbane me Prishtinën, si dhe disa qendra komunale me disa qendra tjera regionale, siç janë Ferizaj, Prizreni, Mitrovica, Peja, Gjlani dhe Gjakova. Në Kosovë, për sa i përket numrit të autobusëve , kombi-busëve dhe veturave të regjistruara gjatë viteve 2011 – 2015, vërehet një trend që është në rritje të vazhdueshme, shih tabelën në fig. 2.

Fig. 2. Tabela me numrin e automjeteve të regjistruara në qendrat e regjistrimit sipas viteve. Burimi: MPB

Tipi / Vitet	2011	2012	2013	2014	2015
Autobusët	1,117	1,298	1,570	1,697	2,124
Kombibuset	2,698	2,520	3,225	3,161	3,212
Vetura	170,321	176,398	222,537	236,145	281,847




Fig.3. – Qarkullimi ditor i veturave private – automjeteve (majtas) dhe autobusëve (djathtas). Burimi: MI




Fig. 4. – Model studimi - vlerësimi. Burimi: MMPH / IPH

Në mungesë të informatës së saktë, se cilat vendbanime janë të përfshira në shërbime të transportit publik (qoftë edhe një herë në ditë në çfarëdo lloj forme), është përgatitur një model studimi, me anë të së cilit është vlerësuar qasshmëria e vendbanimeve në shërbimet e transportit publik. Ky model bazohet në disa të dhëna, siç janë rrugët sipas kategorisë, vendbanimet sipas

madhësisë demografike, dhe roli administrativ e funksional i tyre. Informatat e prodhuara nga ky model, shih fig. 4, tregojnë se, nga 1468 vendbanime sa janë në Kosovë (ASK 2011) 1166 vendbanime apo 79.42% prej tyre janë mbuluar nga shërbimet e transportit publik, duke përfshirë 98 % të popullsisë së Kosovës apo 1,744,396 banorë.

Fig. 5. – Grafiku i pjesëmarrjes së popullsisë së Kosovës në shërbime të TP. Burimi: MMPH/IPH




Fig. 6. Harta për mbulimin e territorit të Kosovës nga shërbimet e transportit publik. Burimi: MMPH/IPH

### **Konkluzione dhe rekomandime:**


Mungesa e të dhënave zyrtare për pasqyrimin e gjendjes së Indikatorit, apo më saktë mungesa e informacioneve për shtrirjen, itineraret, numrin dhe cilësinë e shërbimeve të transportit publik në nivel të vendbanimeve në Kosovës është një handikap i madh për trajtimin e këtij indikator. Sidoqoftë, dizajni i një modeli fillestar për të prodhuar informacionet e parë, se ku mund të ketë dhe ku jo shërbime të transportit publik është një hapë i rëndësishëm për zhvillimin e këtij indikator si dhe të nën-indikatorëve tjerë apo atyre ndërlidhës. Prodhimi i kësaj informatë është me shumë rëndësi edhe në nivel të bashkëpunimit me nivelin lokal, gjë që do mundësonte edhe marrjen e informatave tjera të rëndësishme, përveç atyre që saktësojnë të dhënat mbi:

- Numrin e linjave të transportit nga qendrat komunale apo regjionale,
- Itinerarin e linjave të transportit,
- Gjendjen e mjeteve të transportit publik,
- Nivelin e shërbimeve, etj.

Iphk  
026/3.06

**Indikator:** PËRQINDJA E RRUGËVE TË ASFALTUARA NGA RRJETI I RRUGËVE  
**Synimi:** INFRASTRUKTURA DHE KOMUNIKIMI I INTEGRUAR  
**Objektivi:** PËRMIRËSIMI I RRJETIT DHE OBJEKTEVE TË INFRASTRUKTURËS SË BRENDSHME

**Përshkrimi i Indikatorit:** Ky indikator paraqet përqindjen e rrugëve të asfaltuara nga rrjeti i rrugëve të Republikës së Kosovës ku janë të përfshira të gjitha kategoritë e rrugëve, pra edhe rrugët lokale.



**Fig. 1.** Harta e rrjetit kryesor të rrugëve në Republikën e Kosovës. Burimi: Ministria e Infrastrukturës.

**Mënyra e matjes së Indikatorit:** Vlera numerike e cila tregon përqindjen e rrugëve të asfaltuara mund të gjendet nëse dihet sa është gjatësia e të gjitha rrugëve të Republikës së Kosovës dhe sa kilometra nga këto rrugë janë të asfaltuara.

**Burimi i informatës:** Ministria e Infrastrukturës; shtëpia konsulente ndërkombëtare "A.T. Kerni"


**Kufizimet në matjen e Indikatorit:** Ende nuk ekziston e dhëna e saktë se sa është gjatësia e rrugëve lokale në Republikën e Kosovës dhe sa kilometra prej tyre janë të asfaltuara. Ministria e Infrastrukturës (MI) e ka vlerësuar se gjatësia e tyre është 4761 kilometra. Përqindja e asfaltimit të rrugëve

lokale është vlerësuar që është bërë duke marrë për bazë prononcimin për media të ish ministrit Fatmir Limaj nga i cili është dhënë shifra rreth 80% të asfaltuara më 23.11.2010, me rastin e përfundimit të rrugës së asfaltuar në fshatin Smirë të komunës së Vitisë. Kjo tregon se e dhëna për Indikatorin mbështetet në vlerësime dhe nuk është 100% e saktë, por megjithatë është shumë e përafërt me vlerën e saktë, prandaj edhe mund të mbështetemi në të. Të dhënat në diagramin 1 janë gjithashtu vlerësime. Vlerësimin e ka bërë shtëpia konsulente ndërkombëtare "A.T. Kerni" më 30.05.2015 në Lubjanë të Republikës së Sllovenisë.



**Rëndësia e Indikatorit për zhvillimin hapësinor:** E dhëna e këtij Indikatorit flet për gjendjen aktuale të rrugëve në vendin tonë. Ajo tregon se a është kjo gjendje e keqe apo e mirë dhe kjo i orienton qeveritë qendrore dhe lokale që ta caktojnë asfaltimin e rrugëve si prioritet të lartë ose jo. Harta këtu tregon se çfarë shpërndarje kanë patur rrugët e paasfaltuara regjionale në vitin 2013 dhe për cilat treva të republikës duhet të planifikohet asfaltimi i këtyre rrugëve nga MI. Sa i përket rrugëve lokale, komunitatet kanë të dhënat që tregojnë se për cilat zona të territoreve të tyre duhet të planifikohet asfaltimi i këtyre rrugëve.

**Fig. 2. Grafiku për % e rrugëve të asfaltuara në Kosovë dhe raporti saj me të vendeve në rajon.** Burimi: MI dhe ShKN "A.T. Kerni".



**Gjendja e Indikatorit dhe krahasimi:** Është vlerësuar se rreth 85% të rrugëve nga rrjeti i rrugëve të Republikës së Kosovës ku hyjnë të gjitha kategoritë e rrugëve, janë të asfaltuara. Në hartën më lart tregohet shtrirja e auto-udhës, rrugëve nacionale dhe atyre regjionale në territorin e republikës, si dhe tregohet gjendja e tyre, për sa i përket asfaltimit. Në grafikun e fig. 2, vërehet se Sllovenia i ka 100% të rrugëve (këtu hyjnë të gjitha kategoritë e rrugëve) të asfaltuara, kurse Bosnja e Hercegovina 92%, Kroacia 91%, Kosova 85%, Maqedonia 75%, Mali i Zi 65%, Serbia 63% dhe Shqipëria 40% të tyre.

### **Konkluzione dhe rekomandime:**

- Analiza e të dhënave të vitit 2004 për rrugët rezultoi me një vlerësim se në atë kohë, në Kosovë kanë qenë të asfaltuara 30-35% të të gjitha kategorive të rrugëve. Sot në vitin 2015 është vlerësuar se kjo përqindje ka arritur në rreth 85%, pra gati sa është trefishuar. Kjo tregon se në 10 vitet e fundit, Republika e Kosovës ka përparuar dukshëm në zhvillimin e infrastrukturës së transportit dhe se objektivi për përmirësimin e rrjetit dhe objekteve të infrastrukturës së brendshme, i caktuar me Planin Hapësinor të Kosovës, është arritur.
- Tani ka mbetur që niveli i përmirësimit të rrjetit të ngrihet edhe më lart deri sa përqindja e rrugëve të asfaltuara të arrijë në 100%. Pra duhet të planifikohet dhe përpjekjet të orientohen në asfaltimin e rrugëve, të cilat ende janë të paasfaltuara. Prioritet duhet t'u jepet atyre komunave dhe zonave ku ka më shumë rrugë të paasfaltuara.
- Republika e Kosovës momentalisht qëndron mirë në raport me shtetet në rajon sa i përket asfaltimit të rrugëve. Me 85% të rrugëve të asfaltuara, momentalisht mund të mos jetë akoma prioritet shumë i lartë i Qeverisë, por kjo nuk do të thotë se investimet në rrjetin rrugor nuk janë me prioritet. Edhe pse në vendin tonë janë ndërtuar dhjetë kilometra auto-udhë, ende ka nevojë për investime në ndërtimin e auto-udhëve sepse këto do të ngrisin nivelin e sigurisë në trafik, e lehtësojnë lëvizjen dhe ndihmojnë në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të vendit.

**Indikatori:** DENDËSIA E RRJETIT RRUGOR TË ASFALTUAR NË KOSOVË  
**Synimi:** INFRASTRUKTURA DHE KOMUNIKIMI I INTEGRUAR  
**Objektivi:** PËRMIRËSIMI I RRJETIT DHE OBJEKTEVE TË INFRASTRUKTURËS SË BRENDSHME

**Përshkrimi i Indikatorit:** Ky indikator paraqet gjatësinë në kilometra të rrugëve të asfaltuara, të të gjitha kategorive në 1 km<sup>2</sup> të sipërfaqes së Republikës së Kosovës.

**Mënyra e matjes së Indikatorit:** Njësia matëse e rezultatin e Indikatorit është km/km<sup>2</sup>. Ai gjendet kur numri i cili e tregon gjatësinë në kilometra të rrugëve të asfaltuara, të të gjitha kategorive në Republikën e Kosovës, pjesëtohet me numrin, i cili e tregon sipërfaqen në km<sup>2</sup> të Republikës së Kosovës.



**Fig. 1. Harta e rrjetit kryesor të rrugëve në Republikën e Kosovës.** Burimi: Ministria e Infrastrukturës.

**Burime të informatës/ave:** Ministria e Infrastrukturës e Republikës së Kosovës; Zyra e Statistikave e Republikës së Sllovenisë; Ministria e Infrastrukturës e Republikës së Sllovenisë; Auto-moto Klubi i Bosnjës dhe Hercegovinës; Ministria e Detarisë, Qarkullimit dhe Infrastrukturës e Republikës së Kroacisë; Ministria e Trafikut, Detarisë dhe Telekomunikacionit e Republikës së Malit të Zi; Ndërmarrja Publike për Rrugët Shtetërore e Republikës së Maqedonisë

**Kufizimet në matjen e Indikatorit:** Këto kufizime shkaktohen nga mungesa e të dhënave 100% të sakta për gjatësinë e rrugëve lokale në Republikën e Kosovës dhe për gjatësinë e asfaltimit të tyre. Ministria e Infrastrukturës (MI) e ka vlerësuar se gjatësia e tyre është 4761 kilometra, kurse sa kilometra prej tyre janë të asfaltuara është vlerësim që është bërë duke e marrë për bazë prononcimin për media të ish ministrit Fatmir Limaj nga i cili

është dhënë shifra rreth 80% të asfaltuara më 23.11.2010, me rastin e përirimit të rrugës së asfaltuar në fshatin Smirë të komunës së Vitisë. Duke i patur këto dy vlerësime është gjetur pastaj gjatësia e rrugëve të asfaltuara, të të gjitha kategorive. Pra edhe kjo gjatësi është një vlerësim që megjithatë është shumë e përafërt me vlerën e saktë, prandaj edhe mund të mbështetemi në të.

**Rëndësia e Indikatorit për zhvillimin hapësinor:** Krahasimi i vlerës numerike të këtij Indikatorit me vlerën numerike të po të njëjtit tregues që i referohet gjendjes para 11 vjetëve, tregon se a ka pasur zhvillim sa i përket infrastrukturës rrugore në Kosovë. Krahasimi i vlerës numerike të këtij Indikatorit me vlerat numerike të treguesve të njëjtë që u referohen shteteve tjera, tregon si qëndron Kosova në

raport me ato shtete dhe po ashtu u jep një orientim qeverive qendrore dhe lokale që ta caktojnë rritjen e dendësisë së rrugëve të asfaltuara si prioritet të lartë ose jo. Harta më lart tregon se çfarë shpërndarje kanë pasur rrugët e paasfaltuara regjionale në vitin 2013 dhe për cilat treva të republikës duhet të planifikohet asfaltimi i tyre nga MI që njëherësh do ta rriste edhe dendësinë e rrjetit rrugor të asfaltuar. Sa i përket rrugëve lokale, komunat i kanë të dhënat që tregojnë se për cilat zona të territoreve të tyre duhet të planifikohet asfaltimi i tyre.

**Gjendja e Indikatorit dhe krahasimi:** Është vlerësuar se dendësia e rrjetit rrugor të asfaltuar në Republikën e Kosovës është 0.53 km/km<sup>2</sup>. Në hartën më lart tregohet shtrirja e auto-udhës, rrugëve nacionale dhe atyre regjionale në territorin e republikës, si dhe gjendja në vitin 2013 sa i përket asfaltimit të tyre.





Fig. 2. Grafiku për dendësinë e rrjetit rrugor të asfaltuar në Republikën e Kosovës për vitet 2004 dhe 2015. Burimi: Mi.

Dendësia prej 0.195 km/km<sup>2</sup> sa është vlerësuar të ketë qenë në vitin 2004 ka arritur në 0.53 km/km<sup>2</sup> në vitin 2015 duke e rritë kështu vlerën gati për 3 herë më shumë për këto 11 vite. Kjo flet për një përparim të dukshëm të Kosovës në zhvillimin e infrastrukturës së transportit në këtë periudhë kohore. Për më tepër, në mesin e vendeve të rajonit, vetëm Republika e Sllovenisë e ka dendësinë më të madhe të rrjetit të rrugëve të asfaltuara

me 1.00 km/km<sup>2</sup> të sipërfaqes së saj. Kurse, Republika e Kosovës radhitet e dyta me 0.53 km/km<sup>2</sup> të sipërfaqes së saj, ndërsa pas saj vijnë Kroacia me 0.43 km/km<sup>2</sup>, Bosnja e Hercegovina dhe Maqedonia me nga 0.41 km/km<sup>2</sup> si dhe Shqipëria me dendësi të njëjtë me të Serbisë 0.28 km/km<sup>2</sup>.

Fig. 3. Grafiku për vlerën e dendësisë dhe renditjen e Kosovës në raport me shtetet rajon. Burimi: Ministrinë dhe zyrat statistikore të vendeve në rajon.



### Konkluzione dhe rekomandime:

- Analiza e të dhënave të vitit 2004 për rrugët rezulton me një vlerësim se në atë kohë, dendësia e rrjetit rrugor të asfaltuar në Kosovë ka qenë 0.195 km/km<sup>2</sup>. Sot në vitin 2015 është vlerësuar se kjo dendësi ka arritur në 0.53 km/km<sup>2</sup>, pra gati sa është trefishuar. Kjo tregon se në 10 vitet e fundit, Republika e Kosovës ka përparuar dukshëm në zhvillimin e infrastrukturës së transportit dhe se objektivi për përmirësimin e rrjetit dhe objekteve të infrastrukturës së brendshme, i caktuar me Planin Hapësinor të Kosovës, është arritur.
- Në Republikën e Kosovës ende janë rreth 15% të rrugëve të paasfaltuara. Kjo do të thotë se duhet të planifikohet dhe përpjekjet të orientohen në asfaltimin e këtyre rrugëve. Kështu do të rritej akoma dendësia e rrjetit të rrugëve të asfaltuara. Prioritet duhet t'u jepet atyre komunave dhe zonave ku ka më shumë rrugë të paasfaltuara.
- Republika e Kosovës momentalisht qëndron mirë në raport me shtetet në rajon sa i përket dendësisë së rrjetit të rrugëve të asfaltuara. Me 0.53 km rrugë të asfaltuara në 1 km<sup>2</sup> të sipërfaqes së shtetit, Kosova radhitet e dyta pas Sllovenisë. Për shkak të kësaj pozite, relativisht të mirë dhe përmirësimit të dukshëm të rrugëve në Kosovë, momentalisht rritja e mëtejshme e dendësisë së rrugëve të asfaltuara mund të mos jetë prioritet shumë i lartë i Qeverisë, por kjo nuk do të thotë se investimet në rrjetin rrugor nuk janë prioritet. Edhe pse në vendin tonë janë ndërtuar dhjetëra kilometra auto-udhë, ende ka nevojë për investime në ndërtimin e auto-udhëve sepse këto do e ngritin nivelin e sigurisë në trafik, e lehtësojnë lëvizjen dhe e rrisin shpejtësinë e saj.

**Indikatori:** DENDËSIA E RRJETIT HEKURUDHOR NË REPUBLIKËN E KOSOVËS  
**Synimi:** INFRASTRUKTURA DHE KOMUNIKIMI I INTEGRUAR  
**Objektivi:** PËRMIRËSIMI I RRJETIT DHE OBJEKTEVE TË INFRASTRUKTURËS SË BRENDSHME




**Përshkrimi i Indikatorit:** Ky indikator paraqet numrin e kilometrave të hekurudhave të Republikës së Kosovës në 1 km<sup>2</sup> të sipërfaqes së Republikës.

**Mënyra e matjes së Indikatorit:** Njësia matëse e Indikatorit është km/km<sup>2</sup>. Ai gjendet kur numri i cili e tregon gjatësinë në kilometra të të gjitha hekurudhave të Kosovës pjesëtohet me numrin, i cili e tregon sipërfaqen në km<sup>2</sup> të Republikës së Kosovës.

**Burimi i informatës/ave:** Ministria e Infrastrukturës (MI); Trainkos; Infrakos

Fig.1 . Harta e rrjetit hekurudhor në Republikën e Kosovës. Burimi: MI.

Fig. 2. Grafiku për vlerën e Indikatorit ndër vite në Kosovë. Burimi: MI.




**Kufizimet në matjen e Indikatorit:** Sipas shifrës që e jep ky tregues, del se Republika e Kosovës, krahasuar me vendet e rajonit nuk qëndron keq sa i përket dendësisë së rrjetit hekurudhor e madje ajo qëndron edhe më mirë se sa SHBA në këtë aspekt. Problemi është se një pjesë e këtij rrjeti është jashtë funksionit dhe edhe hekurudha që është në funksion nuk është në gjendje të mirë. Ky fakt e zbeh shifrën që e jep Indikatori dhe ia zvogëlon dukshëm rëndësinë dhe relevanten.

**Rëndësia e Indikatorit për zhvillimin hapësinor:** Krahasimi i vlerës numerike të këtij Indikatori me vlerën numerike të po të njëjtit tregues që i referohet gjendjes para 5 vjetëve, tregon a ka pasur zhvillim sa i përket hekurudhave në Kosovë. Krahasimi i vlerës numerike të këtij Indikatori me vlerat numerike të treguesve të njëjtë që u referohen shteteve tjera, tregon si qëndron Kosova në raport me ato vende.

Gjendja e këtij Indikatori i cili ka mbetur i njëjtë për shumë vjet me radhë, tregon qartë për nevojën e planifikimit të përmirësimit dhe zhvillimit të rrjetit hekurudhor, i cili ka stagnuar për shumë vjet. Harta e shtrirjes së rrjetit hekurudhor në Kosovë tregon se dy nga 7 qytetet më të mëdha të vendit tonë, Gjilani dhe Gjakova, nuk janë të përfshirë në këtë rrjet, prandaj duhet të planifikohet ndërtimi i linjave hekurudhore që i lidhin edhe këto dy qytete dhe kështu e rrisin edhe dendësinë e rrjetit.

**Gjendja e Indikatorit dhe krahasimi:** Dendësia e rrjetit hekurudhor në Republikën e Kosovës është 0.04 km/km<sup>2</sup>. Në grafikun e fig. 3, vërehet se në 5 vitet e fundit, por jo vetëm në këtë periudhë, dendësia e rrjetit hekurudhor në Republikën e Kosovës ka qenë e njëjtë, pra nuk është ndërtuar as edhe një kilometër hekurudhë që do të thotë se në këtë drejtim nuk ka pasur zhvillim. Nga diagrami 2



shihet se prej shteteve të prezantuara, Gjermania e ka rrjetin më të dendur hekurudhor me 0.12 km hekurudhë për 1 km<sup>2</sup> të sipërfaqes së saj, kurse Kosova me 0.04 qëndron diku në mes.

Fig. 3. – Kosova në raport me disa shtete. Burimi: MI

### **Konkluzione dhe rekomandime:**

- Indikatorit i dendësisë së rrjetit hekurudhor në Kosovë që me shifër është: i njëjtë me atë në Maqedoni, pak më i ulët se në Francë e Serbi dhe madje më i lartë se në SHBA, nuk e jep pasqyrën reale të zhvillimit të rrjetit hekurudhor në Kosovë;
- Dendësia e rrjetit ka qenë e njëjtë jo vetëm në 5 vitet e fundit sic tregon diagrami 1, por ajo është e njëjtë që nga viti 1963 kur është ndërtuar linja e fundit hekurudhore në Republikën e Kosovës;
- Fakti që në 52 vitet e fundit nuk është ndërtuar as edhe një kilometër hekurudhë flet për zhvillimin e infrastrukturës hekurudhore në këtë periudhë kohore;
- Linjat hekurudhore në relacionet Klinë-Prizren dhe Fushë Kosovë-Podujevë janë jashtë funksionit, kurse ato që janë në funksion nuk janë në gjendje të mirë;
- Transporti hekurudhor i mallrave dhe udhëtarëve vlerësohet si më i përshtatshëm, me mundësi të transportimit të më shumë mallrave dhe udhëtarëve për një herë, më komfort, më i sigurt dhe më pak i kushtueshëm se sa transporti rrugor, prandaj niveli i tanishëm, jo i kënaqshëm i hekurudhave të Kosovës shtron nevojën e ngutshme për planifikimin e zhvillimit dhe më pas zhvillimin e infrastrukturës dhe transportit hekurudhor;
- Dy nga 7 qytetet më të mëdha të vendit tonë, Gjilani dhe Gjakova, nuk janë të përfshirë në rrjetin hekurudhor të Republikës së Kosovës, prandaj duhet të planifikohet ndërtimi i linjave hekurudhore që i lidhin edhe këto dy qytete.

**Përshkrimi i Indikatorit:** Toka, si element kryesor mjedisor dhe resurs natyror, është bazë për shumicën e aktiviteteve biologjike dhe njerëzore në planetin tonë. Përdorimi Tokës, sipas Eurostat - Agjenci Evropiane e Statistikave për vendet e BE-së (*ang. land use*), nënkupton kategorizimin e shfrytëzimit të sipërfaqes së tokës për funksione socio-ekonomike (p.sh për bujqësi, komerciale, banim, etj.). Ky tregues paraqet sasinë e sipërfaqeve (*në ha*) dhe raportet e tyre të pjesëmarrjes (*në %*), sipas klasifikimit të përvetësuar për nga mbulesa e tokës dhe përdorimi saj nga aktivitete sektoriale bujqësore, pyjore, ujore dhe të ndërtimeve njerëzore (përfshirë objektet për banim, industri, tregti, turizëm, rekreacion, infrastrukturë dhe shërbime) në kuadër të sipërfaqes së caktuar territoriale.

**Mënyra e matjes së Indikatorit:** Për pasqyrimin e pjesëmarrjes së përdorimeve të tokës, së pari duhet të identifikohen, regjistrohen dhe maten sasinë e sipërfaqeve (*në km<sup>2</sup> ose ha*) sipas klasave dhe nënklasave kryesor të përdorimeve të përvetësuar, nga të cilat më pas rrjedhin edhe raportet e pjesëmarrjes tyre (*në %*) karshi sipërfaqes së përgjithshme të territorit të Kosovës, Komunës, Zonës Veçantë, etj.

**Burimi informatës/ave:** Të dhënat për klasifikimin dhe sasinë e përdorimeve të tokës janë përdorë nga Raporti "Inventarizimi Nacional i Pyjeve të Kosovës 2012", i MBPZHR / APK-së 2013 (fig. 1) dhe Raporti nr.17 "Udhëzues për Planifikim Hapësinor Rural" që është pjesë e *Sistemit Kombëtar për Vlerësim dhe planifikim të Menaxhimit të Tokës* i projektit EULUP 2012 (fig.2).

Përdorimi (shfrytëzimi) i sipërfaqes së tokës		2002			2012		
Klasat	Nënklasat	ha	%	%	ha	%	%
Sip. e Tokës Pyjore	Tokë me Pyje	460,800	42.1	44.7	481,000	44.7	47.4
	Tokë tjetër pyjore	28,200	2.6		29,200	2.7	
Sip. e Tokës Bujqësore	Tokë e punueshme	342,400	31.3	45.3	309,000	28.7	43.7
	Livadhe / Kullosa	153,200	14.0		161,400	15.0	
Sip. e Tokës Ndërtimore	Vendbanime urb./rur	40,000	3.7	9.8	48,000	4.5	8.4
	Tokë tjetër ndërtimi	65,000	5.9		42,400	3.9	
Sipërfaqe Ujore	Liqene e lumenj	4,600	0.4	0.4	5,200	0.5	0.6
	Ligatina & moçale				800	0.1	
<b>Sipërfaqja totale e tokës</b>		<b>1,094,200</b>	<b>100</b>	<b>100</b>	<b>1,077,000</b>	<b>100</b>	<b>100</b>


Fig. 1. Tabela me grafikun e pjesëmarrjes së përdorimeve të tokës në Kosovë. Burimi: IPH dhe MBPZhr / APK 2013.

#### Kufizimet e matjes së Indikatorit:

Të dhënat për përdorim të tokës, janë shumë të rëndësishme për të kuptuar funksioni-min e sistemeve mjedisore por edhe shumë të


larmishme nëpër raporte e studime të ndryshme për të bërë vlerësime të sakta periodike për ndryshimet e shkaktuara nga ndikime të mundshme njerëzore në resurset natyrore, larminë biologjike dhe në ekosisteme. Ngjashëm, edhe të dhënat në grafikun dhe tabelën e përdorimeve të sipërfaqes së tokës nga APK/MBPZhr, të llogaritura në bazë të 3.453 sipërfaqeve provë, nuk sigurojnë ndonjë saktësi reale por janë në shërbim të krahasimeve të vlerave për sektorë të ndryshëm. Mirëpo, së shpejti, Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), pritet të publikoj rezultatet të proceduara zyrtare nga Regjistrimi Bujqësor i vitit 2014 për përdorimin e sipërfaqes së tokës, që do të jenë më të sigurta dhe në linjë me ato që jepen nga EUROSTAT-i (Agjencia Evropiane e Statistikave) për vendet e BE-së.

Fig. 2. Tabela me grafikun e përdorimeve të tokës në Kosovë. Burimi: ZNKE, Projekti EULUP 2012.



Kategoria I-rë MT CORINE	Area (km <sup>2</sup> )	Area (%)
Urbane	273.40	2.52%
Bujqësi	4,371.19	40.25%
Pyje	6,193.24	57.02%
Ujëra	23.23	0.21%
<b>Totali</b>	<b>10,861.06</b>	<b>100.00%</b>

qëllim të zhvillimit qëndrueshëm të vendit. Informatat për shfrytëzimin e sipërfaqes së tokës (posedimin-kush?, mbulesën-çka? dhe përdorimin-si?), formojnë bazën e të dhënave për analiza të ndryshme hapësinore, territoriale dhe të trendit të zhvillimit socio – ekonomik e mjedisor, të cilat gjithnjë e më shumë ndikojnë në arritjen e zhvillimit të dëshiruar strategjik me qëllim të ruajtjes së vlerave natyrore dhe shfrytëzimit sa më racional të tyre në favor të përmirësimit të jetesës në përgjithësi.



(\*) EU average excluding Bulgaria, Croatia, Cyprus, Malta and Romania.  
Source: Eurostat (online data code: lan\_1u)

**Fig. 3. Grafiku me raportet e llojeve kryesor të përdorimit të sip. tokës për 23 shtetet anëtare të BE-së.** Burimi: Eurostat 2009.

infrastrukturë e shërbimeve dhe nevojës për ruajtje të larmisë biologjike, ekosistemeve, resurseve natyrore e kulturore, të hapësirave të përbashkëta rekreative, etj. Aktualisht, ndër vlerat më të rëndësishme të ndryshuara të përdorimit të tokës në vend, gjatë dhjetë viteve të fundit (shih tabelën e APK/MBPZHR), veçojmë:

**Gjendja e Indikatorit dhe krahasimi:** Ndryshimi i vlerave sasiore të përdorimit të tokës (në ha dhe %), është shkak i proceseve të vazhdueshme që ndodhin në mjedisin tonë jetësor dhe nuk vërehen në baza ditore. Ato janë pasojë e tensioneve që dalin nga konflikti mes kërkesës së popullsisë për më shumë banim/strehim, vende pune,

1. Rritjen graduale prej 2.7 % të sipërfaqes së përgjithshme të tokës pyjore dhe ngritje të sipërfaqes me pyje nga 0.27 në 0.28 ha/b
2. Rënien prej 1.6 % të sipërfaqes përgjithshme të tokës për përdorim bujqësor dhe ulje të sipërfaqes së punueshme nga 0.20 në 0.18 ha/b;
3. Rënien prej 1.4 % të sipërfaqes përgjithshme ndërtimore dhe rritjen prej 0.8 % të sipërfaqes së tokës me ndërtime nga vendbanimet, dhe
4. Rritjen prej 0.2 % e sipërfaqes përgjithshme ujore me kontribut të barabartë nga nënklasat e saj.

### **Konkluzione dhe rekomandime:**

- Është e nevojshme që edhe në Kosovë të bëhet klasifikimi dhe unifikimi me kategorizimin e përdorimeve të tokës sipas Eurostat-it me qëllim të krahasimit të jashtëm të vlerave të rezultuara;
- Krahasimi i jashtëm (ndër-shtetëror) i rezultateve të drejtpërdrejta (vlerave sasiore), për klasat ose nënklasat e përdorimit të sipërfaqes së tokës, nuk pritet të japin rezultate reale e të krahasueshme, meqë varen nga gjeografia, reliefi dhe lloji i zënies së sipërfaqes së tokës në territorin e vendit caktuar;
- Krahasimi i jashtëm i rezultateve të drejtpërdrejta bëhet vetëm për rezultatet që paraqesin ndryshimet sasiore përbrenda një klase (ose nënklase), përmes një Indikatorit tjetër ndihmës, si: sipërfaqja e tokës së punueshme bujqësore për kokë banori, në Kosovë është në limitin kritik prej 0.18 ha/b përderisa në vendet e BE-së është 0.52 ha/b;

- Krahasimi i rezultateve të brendshme (vendore) bëhet përbrenda të njëjtës klasë (ose nënklasë) por në periudha të ndryshme kohore, si p. sh.:
  - Rënia e vlerës së % së përdorimit bujqësor (prej 1.6 %), është pasojë e konvertimit të tokës bujqësore në tokë pyjore, tokë ndërtimore dhe në sipërfaqe ujore, janë ndikuar nga ndryshimet klimatike, ndërtimet legale e ilegale dhe zgjerimit të shtretërve të lumenjve nga gërryerjet dhe vërshimet;
  - Rritja e vlerës së % së tokës ndërtimore (prej 0.8 %), është shkaktuar nga kërkesat e pakontrolluara të lëvizjeve të popullsisë dhe ndryshimeve në ekonomi;
  - Rritja e vlerës së % së sipërfaqes pyjore (prej 2.7 %), është shkaktuar dhe stimuluar nga ndikimi i ndryshimeve klimatike – mjedisore, përmes zgjerimit të habitatit vegjetativ dhe shndërrimit të kullosave në sipërfaqe pyjore; dhe
  - Rritja e vlerës së % së sipërfaqes ujore është rezultat i baraspeshuar i shtimit të pjesëmarrjes së moçaleve dhe ligatinave në këtë klasë dhe i zgjerimit të shtretërve të lumenjve nga gërryerja e bankinave gjatë vërshimeve dhe nxjerrja e pakontrolluar e inerteve.



**Përshkrimi i Indikatorit:** Ky indikator paraqet degradimin e pyjeve nga prerjet ilegale si dhe shpyllëzimet pa kriter që kanë dhënë rezultate negative në mbrojtjen e pyjeve si dhe rritjen e shkallës së erozionit.

**Mënyra e matjes së indikatorit:** Matja e rritjes vjetore natyrale, e shprehur në *Ha ose %* për sipërfaqe të pyllëzuara dhe të ripyllëzuara të tokës pyjore dhe *në m<sup>3</sup>* për vëllimin e masës drunore në pyje, bëhet nga APK (Agjencia e Pyjeve të Kosovës) në kuadër të MBPZHR, që është edhe burimi më i sigurt për këto informata.

**Burimi i informatave:** Në Kosovë janë dy institucione të burimit të informatave : Agjencioni i Pyjeve të Kosovës dhe Agjencioni Mbrojtjes së Mjedisit të Kosovës. APK-ja është përgjegjëse për çështjet e ndërlidhura me rregullimin e pyjeve dhe tokave pyjore, administrimin dhe menaxhimin e tokave pyjore publike ndërsa AMMK për parqet Kombëtare.

**Kufizimet për matjen e Indikatorit:** Informatat për Indikatorin bazohen nga statistikat që janë marr drejtpërsëdrejti nga tereni. Në bazë të studimeve të bëra nga Agjencia Pyjore e Kosovës përveç studimeve shkencore janë theksuar edhe problemet sa i përket mungesës së monitorimit si pasojë e numrit të vogël të monitoruesve si dhe problemet që janë paraqit si rezultat i fatkeqësive natyrore dhe atyre të shkaktuara nga vet njeriu.



Fig.1. Harta e shtrirjes pyjeve në Kosovë. Burimi: MBPZHR.

**Rëndësia e Indikatorit për zhvillim hapësinor:** Është ndër Indikatorit kryesor për mbrojtjen e ekosistemit dhe të zhvillimit mjedisor, si një nga 3 shtyllat përbërëse të zhvillimit të qëndrueshëm, i cili na ofron të dhëna, si për burimet dhe shtrirjen e këtij resursi të nevojshëm natyror në Kosovë ashtu edhe për specifika të ndryshme të Sfidave Zhvillimore, duke marrë parasysh të gjitha interesat tjera publike. Për më shumë, e drejta për ripërtëritje dhe ripyllëzim të sipërfaqeve pyjore, parashihet: si masë për mbrojtje të natyrës, në Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës (Nr. 03/L-233 me nenet 8 dhe 48) dhe si masë kundër erozionit, në Ligjin për Ujërat e Kosovës (Nr. 04/L-147 me nenet 51 – 54).

**Gjendja e Indikatorit dhe krahasimi:** Kushtet e mira fiziko-geografike janë shumë të përshtatshme për rritjen e pyjeve ku mesatarja vjetore e shtimit natyrale është 0.5% ose 2020 ha/vit. Pyllëzim ose farim artificial për periudhë 2002-2012 janë 2800 ha si dhe specie druri te futura (akacie)3200 ha ku mbulushmëria e sip. pyjore zvogëlon aktivitetin eroziv. Pyje te mbrojtura (Malet e Sharrit dhe Bjeshkët e Nemuna) janë 59600ha. apo 12.3% e sipërfaqes pyjore. Sipërfaqet e dëmtuara të pyjeve nga sëmundjet e ndryshme, moti i keq, rrëshqitjet, zjarri, prerje ilegale etj. Me rreth 58200 ha apo 12 % e sipërfaqes së përgjithshme të pyjeve ku zjarret janë dukuri që përfshin sipërfaqen me te madhe degraduese 12200ha ose 2.5% e sipërfaqes së përgjithshme të pyjeve që ndikojnë në rritjen e shkallës erozive. Rritja vjetore bruto specieve drunore është 1960000m<sup>3</sup> ndërsa ikja vjetore (prerje dhe ikje natyrale ) është 1862000m<sup>3</sup> kurse rritja natyrore është 98000m<sup>3</sup> ose 5% në shkallë vjetore. Prerjet vjetore në Kosovë janë më të larta në Evropë qe përafërsisht balancohen me rritjen vjetore. Krahasuar me Sllovenin qe ka prerje vjetore 37% kurse Evropa JL 50%.

Sipërfaqet e dëmtuara e të degraduara të pyjeve, që ndikojnë në rritjen e shkallës erozive në ato zona, sillen rreth 12 % (ose 58.200 ha) të sipërfaqes së përgjithshme, shkaktohen nga zjarret (me 2.5 % ose 12.200 ha), sëmundjet e ndryshme, moti i keq, rrëshqitjet, prerjet ilegale, etj. Mirëpo, referuar “Strategjisë për zhvillimin e Pylltarisë 2010-2020”, në Kosovë, rreth 70% të territorit pyjor mbulohet me plane menaxhimi, që këtë tregues e bënë mjaft perspektivë në kuadër të përafërimit me Bashkimin Evropian. Ngaqë, BE-ja (më 2006), kishte miratuar Planin e Veprimit për Pyjet 2007 – 2013, duke ofruar një kornizë aktivitetesh të ndërlidhura me komunitetin, në nivel të shteteve anëtare, me objektivin e përgjithshëm: Mbështetja e zgjerimit për menaxhim të qëndrueshëm pyjor dhe sigurimi i rolit shumë funksional të pyjeve.

Përndryshe, pyjet e mbrojtura (në kuadër të Parqeve Kombëtare: Mali Sharr dhe Bjeshkët e Nemuna), që përbëjnë rreth 12.3 % (me 59.600 ha) të sipërfaqes tërësishme pyjore në Kosovë, janë përgjegjësi e MMPH-së.

<b>Pyjet në Kosovë</b>	<b>2003-2004</b>	<b>2012-2013</b>	<b>Rritje vjetore (në Ha &amp; m<sup>3</sup>)</b>
Spektori privat (ha)	185.920	180.800	
Spektori publik (ha)	278.800	295.200	
E pa njohur (ha)	0	5000	
Sipërfaqe totale pyjore (në ha)	464.720	481.000	<b>2.020 (0.5%)</b>
Vëllimi total (në m <sup>3</sup> )	33,9 milion	40,5 milion	<b>0.8 mil.(2 %)</b>

Fig. 2. Tabela e rritjes vjetore të pyjeve. Burimi: MBPZhR.

### **Konkluzione dhe rekomandime:**

- Sipas analizave të mësipërme monitorimi është njëri nga aspektet e rëndësishme që nuk është duke u realizuar aq sa ka nevojë;
- Është duke vazhduar humbja e masës drusore nga prerjet ilegale;
- Nuk është duke u realizuar meliorimi i nevojshëm e pyjeve dhe kullosave;
- Po mungon intervenimi bio-kimik ne zonat qe dëmtohen nga sëmundjet e ndryshme;
- Mirëmbajtja e pyjeve është e nivelit jo të knaqshëm;
- Erozioni po vazhdon të jetë njëri nga shkaktarët kryesor për evitimin e të cilit ka nevojë për ndërtimi i pritave, gardianeve, gardheve dhe pandave në funksion të zbutjes së tij;
- Mbrojtja, ruajtja dhe menaxhimi i qendrueshëm i mjedisit të gjelbër do të ketë ndikim të drjtëpërdrejtë në zbutjen e shkallës së erozionit.


**Indikator:** POTENCIALI I TOKËS SË KLASIFIKUAR BUJQËSORE (PTB)  
**Synimi:** MBROJTJA, RUAJTJA DHE SHFRYTËZIMI RACIONAL I RESURSEVE NATYRORE  
**Objektivi:** MENAXHIMI EFIKAS I TOKËS SË PËRSHTATSHME BUJQËSORE

**Përshkrimi i Indikatorit:** Ky indikator paraqet tërë potencialin e tokës bujqësore në Kosovë, të klasifikuara në tetë (8) klasa, për nga përshtatshmëria, cilësia fizike, klima, terreni dhe mënyra e përdorimit të saj për kultivimin e kulturave bujqësore, sikur në planin model për *Përshtatshmërinë e Tokës Bujqësore (PTB)* nga Raporti nr. 17 - “Udhëzues për Planifikim Hapësinor Rural”, që është pjesë e *Sistemit Kombëtar për Vlerësim dhe Planifikim të Menaxhimit të Tokës*, të realizuar nga ekspertët e projektit të BE-së: EULUP 2012<sup>51</sup>.

**Fig. 1. Tabela me 8 klasat e tokës bujqësore.** Burimi: ZNKE, EULUP 2012.

Përshtatshmëria	Cilësia e tokës	Kodi	Grupet e shfrytëzimit të tokës
0	E Papërshtatshme	8	Tokë pyjore që pamundëson kultivimin e kulturave bujqësore
1-35	Shumë e dobët	7	Tokë e dobët, me pengesa të mëdha kultivuese, kryesisht kullosa & livadhe;
36-45	E dobët	6	
46-55	Nën mesatare	5	Tokë bujqësore me disa kufizime për kultivim e kulturave bujqësore
56-65	Mesatare	4	
66-75	Mbi mesatare	3	
76-85	E mirë	2	Tokë e mirë lavërtarie për kultivimin e kulturave bujqësore
86-100	Shumë e mirë	1	

**Fig. 2. Harta e shtrirjes së Tokës Bujqësore sipas klasave të Përshtatshmërisë në Kosovë.** Burimi: ZNKE, EULUP 2012.



**Mënyra e matjes së Indikatorit:**

Matja e këtij Indikatorit bëhet përmes identifikimit, shtrirjes hapësinore dhe më pas matjes së sipërfaqeve për të 8 klasat e tokës bujqësore, në tërë territorin e Kosovës / komunës, sipas modelit të projektit BE-së “EULUP” (fig. 1 dhe 2). Ky klasifikim i tokës bujqësore bazohet në të dhëna relevante të rëndësisë së përgjithshme (të 100 %), duke përfshirë: vetitë fizike (me 65 %), veçoritë e tokës (relievi, ndryshimet hapësinore me rregullim peizazhi - 25 %) dhe kushtet klimatike (10 %). Rezultatet e fituara për 8 klasat e dhëna si në modelin e PTB-së janë vlera të caktuara numerike me njësi të sipërfaqes në km<sup>2</sup> (ose ha) kurse raporti i pjesëmarrjes tyre në % jepet në kuadër të sipërfaqes përgjithshme të tokës bujqësore, komunës apo edhe të Kosovës.


**Burimi i informatës/ave:** Ekzistojnë shumë burime të dhënash për

<sup>51</sup> Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian (ZNKE) e BE-së, Projekti Nr. 2010/230-489 EULUP - Mbështetje e Mëtutjeshme e Shfrytëzimit Tokës: Sistemi Kombëtar për Vlerësim dhe Planifikim të Menaxhimit të Tokës, Raporti Nr. 17 “Udhëzues për Planifikim Hapësinor”, Prishtinë 2012.

Indikatorin, nga institucionet shkencore, publike dhe qeveritare të nivelit qendror dhe lokal, por modeli gjenerues gjendet në Bazën e të Dhënave në IPH, gjegjësisht në Raportin Teknik Nr.17: “Udhëzues për Planifikim Hapësinor” që është në kuadër të “Sistemit Kombëtar për Vlerësim dhe Planifikim të Menaxhimit të Tokës”.

**Kufizimet për matjen e Indikatorit:** Kategorizimi i mëparshëm dhe cilësia e tokës sipas “klasave të kadastrave”, nuk i plotësonte nevojat moderne të planifikimit hapësinor e urban në Kosovë. Për fat të mirë, tani është zhvilluar një Sistem Kombëtar për Përshtatshmërinë e Tokës Bujqësore (PTB), në kuadër të projektit “EULUP” 2012, i mbështetur nga grupi i ekspertëve të vendeve anëtare të BE-së, të cilët analizuar të dhënat aktuale të tokës, klimës dhe terrenit në Kosovë, duke i ekzaminuar ato edhe me të dhëna tjera të klasifikimit të përshtatshmërisë së tokës në vendet e rajonit dhe gjetkë. Përfundimisht, u krijua një model, i klasifikimit më specifik, që i plotëson më së miri nevojat e vendit dhe ato ndërkombëtare, me të dhëna që janë në përputhje me metodat e FAO-s (Food and Agriculture Organization of the United Nations) dhe sipas MTC-së (Mbulesa e Tokës CORINE 2006).

**Rëndësia e Indikatorit për zhvillimin hapësinor:** Ka të bëjë me rëndësinë e gjetjes së potencialit të tokës bujqësore, sipas klasave më të përshtatshme (të bazuara në faktorët ndikues mjedisor), për planifikimin dhe menaxhimin e politikave kombëtare për zhvillimin ekonomik dhe për sigurimin e ushqimit për popullsinë e vendit. Është shumë me rëndësi, që hartat në Sistemin Kombëtar të përgatitura nga EULUP-i të shërbejnë për kornizë bazë dhe të integrohen me prioritetet strategjike



komunale dhe të reflektojnë zgjidhje në nivel vendi. Përderisa, të dhënat e reja të mbledhura, më të hollësishme e të përditësuara, nga zonat urbane dhe rurale komunale, do të integrohen dhe reflektojnë në zgjidhjet me prioritet dhe interesa, kombëtare e lokale, duke siguruar hapësirat për veprimtari të përcaktuara.

Fig. 3. Grafiku me raporte e sipërfaqeve nën shfrytëzim të sektorëve urban, bujqësor dhe pyjor nëpër 8 klasat kryesore. Burimi: ZNKE, Projekti EULUP 2012.

Klasat e Tokës	Sipërfaqet e klasave (në km <sup>2</sup> )	TB (Toka Bujqësore) (në km <sup>2</sup> )	TB (Toka Bujqësore) (në %)	Grupimi Cilësor i TB (në %)
1	1054.51	907.01	20.77	1 – 4 / 81.32 %
2	1279.84	1014.84	23.24	
3	1354.42	956.36	21.90	
4	1445.45	672.35	15.40	
5	1323.13	374.00	8.57	5 – 8 / 18.68 %
6	989.06	186.25	4.27	
7	490.37	71.20	1.63	
8	2871.32	184.20	4.22	
<b>Total</b>	<b>10808.1</b>	<b>4366.21</b>	<b>100.00 %</b>	<b>100.00 %</b>

Fig. 4. Tabela me kapacitetin e tokës bujqësore nëpër 8 klasat kryesore. Burimi: ZNKE, Projekti EULUP 2012.

**Gjendja e Indikatorit dhe krahasimi:**

Nga të dhënat për potencialin e tokës bujqësore sipas modelit të ndërtuar për PTB në territorin e Kosovës (në fig. 1, 2, 3 dhe 4), vërehet se Kosova ka potencial të mjaftueshëm të tokës bujqësore për sigurimin e ushqimit të nevojshëm për popullsinë e vet. Kosova, me mesataren e përgjithshme

prej 0.10 ha për kokë banori të tokës së punueshme – arave dhe me 0.20 ha/b të tokës kualitative bujqësore si dhe me 0.25 ha/b të sipërfaqes së përgjithshme të TB, qëndron afër mesatares së kufirit kritik prej 0.17 ha/b) dhe larg mesatares së BE-së prej 0.52 ha/b.

Për më tepër, sipërfaqet e tokës kualitative bujqësore, me përshtatshmëri dhe cilësi të lartë kultivimi, shtrihen kryesisht në pjesët më të rrafshëta dhe përkaj lugjinave lumore dhe janë vazhdimisht të

kërcënuara dhe nën presion të kërkesave të shumta për ndërtime të reja duke ndikuar në zgjerime të mëtejme të vendbanimeve të mëdha të Kosovës. Prandaj, me fanatizëm duhet fuqizuar ligjin për mbrojtjen dhe ruajtjen e këtij resursi natyror të nevojshëm për zhvillim të qëndrueshëm të vendit.

### **Konkluzione dhe rekomandime:**

Me zhvillimin e një plani për *Përshatshmërinë e Tokës Bujqësore (PTB)* në Raporti nr. 17 - “*Udhëzues për Planifikim Hapësinor Rural*”, që është pjesë e *Sistemit Kombëtar për Vlerësim dhe Planifikim të Menaxhimit të Tokës*, në kuadër të projektit “EULUP 2012”, u krijua një model i sofistikuar, i klasifikimit më specifik, që i plotëson më së miri nevojat e vendit dhe ato ndërkombëtare, me të dhëna që janë në përputhje me metodat e FAO-s (Food and Agriculture Organization of the United Nations) dhe sipas MTC-së (Mbulesa e Tokës CORINE 2006)

Andaj rekomandohet që:


- Të gjitha komunat e Kosovës përmes Insitutit për Planifikim Hapësinor të pajisen me planet e hartuara në Sistemin Kombëtar për Vlerësim dhe Planifikim të Menaxhimit të Tokës nga Projekti i BE-së - EULUP 2012 dhe të vazhdojnë punën në zbatimin tyre për nevoja lokale.
- Komunat, përmes institucioneve përgjegjëse, duhet të bëjnë përditësimin e këtyre hartave – planeve me të dhëna më të hollësishme në të mirë të qartësisimit (identifikimit dhe pasqyrimin) të pjesëmarrjes apo të përkatësisë së çdo prone (parcele të kadastrave) në klasat e përvetësuar të tokës bujqësore.

**Përshkrimi i Indikatorit:** Ky indikator paraqet sasinë e sipërfaqes së shfrytëzuar apo jo të tokës bujqësore (resursit natyror dhe bazë elementare për shumicën e aktiviteteve biologjike e njerëzore), si dhe jep vlera numerike e raporte të ndryshme për shfrytëzuesit, funksionin dhe llojin e përdorimit të saj. Përmes vlerave të rezultuara për Indikatorin kryesor si për numrin e ekonomive aktive në bujqësi – kush?, sasinë e sipërfaqeve të shfrytëzuara – sa?, mënyrën e përdorimit tyre nga aktivitete nën-sektoriale – si? dhe pjesëmarrjen e kultivimeve kryesore – çfarë?, do të kuptohet edhe gjendja aktuale zhvillimore e këtij sektori në Kosovë.

**Fig 1. Tabela me tregues kryesor në bujqësi.** Burimi: ASK 2015<sup>52</sup>

Regjistrimi i Bujqësisë 2013/14	Gjithsejtë	Statusi Ekonomike Bujqësore	
		Biznese Familjare	Subjekte juridike
<i>Ekonomitë Bujqësore (EB)</i>	130.775	130.436	339 (0.2 %)
<i>TB e Shfrytëzuar e (ha)</i>	413.635	405.429	8.206 (2.0 %)
<i>Njësitë Blegtorale (NjB)</i>	281.747	270.668	11.078 (4.0 %)
<i>Njësi të Punës Vjetore (NJPV)</i>	86.620	84.221	2.399 (2.8 %)

**Fig. 2. Grafiku për shfrytëzimin e tokës bujqësore në Kosovë.** Burimi: ASK 2015.



**Fig. 2. Grafiku për shfrytëzimin e tokës bujqësore në Kosovë.** Burimi: ASK 2015.

**Mënyra e matjes së Indikatorit:** Përveç numrit për ekonomitë aktive bujqësore, të njëjve blegtorale dhe të mjeteve të punës duhet pasqyruar edhe sasinë e sipërfaqeve të kultivuara të tokës bujqësore, të klasifikuara për nga lloji dhe mënyra e përdorimeve dhe kultivimeve të përvetësuara. Nga vlerat e rezultuara për sipërfaqe të identifikuar, të matura e të regjistruara (në km<sup>2</sup> ose ha) sipas klasifikimit, rrjedhin edhe llogaritë sasiore (në ha) dhe raportet e pjesëmarrjes tyre (në %) në kuadër të sipërfaqes së përgjithshme të tokës bujqësore dhe të mbarë territorit të Kosovës (Zonës Veçantë, Regjionit apo Komunës).

**Burimi informatës/ave:** Burimi kryesor i të dhënave të shfrytëzuara për sasinë e përdorimit të tokës bujqësore janë përdorë rezultatet nga Raporti “Regjistrimi i Bujqësisë”, të publikuar nga ASK-ja më 2015.

**Kufizimet e matjes së Indikatorit:** Informatat për përdorimin e tokës bujqësore kanë qenë jo shumë të sakta nëpër raporte të ndryshme të deritanishme. Mirëpo, Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), në vitin 2015 ka publikuar rezultatet zyrtare të Regjistrimit Bujqësor të vitit 2014, për përdorimet dhe shfrytëzimin e tokës bujqësore (në ha dhe %), të cilat janë më të sigurtat dhe në linjë me formatin që jepet edhe nga EUROSTAT (Agjencia Evropiane e Statistikave për BE-në).

**Rëndësia e Indikatorit për zhvillimin hapësinor:** Të dhënat për përdorimin ose humbjen e tokës bujqësore shërbejnë për të kuptuar funksionimin e sistemeve bujqësore-mjedisore dhe vlerësimin e ndryshimeve të mundshme që tregojnë për efektet ose pasojat e arritura nga ndikimet natyrore e njerëzore në këtë resurs jetik. Për zhvillimin hapësinor të territorit caktuar, përveç rëndësisë së

<sup>52</sup> ASK, Regjistrimi Bujqësisë në Republikën e Kosovës 2014 – Rezultatet Përfundimtare, Prishtinë 2015.

posedimit (zotërimin) të pronës është shumë me rëndësi të dihet edhe nxënia (mbulesa) e sipërfaqes së tokës bujqësore si resurs natyror dhe burim potencial për shfrytëzim ose përdorime funksionale socio-ekonomike e mjedisore, me qëllim të zhvillimit qëndrueshëm ekonomik të vendit. Informatat për shfrytëzimin e tokës (si për posedimin, mbulesën dhe përdorimin e saj), formojnë bazën e të dhënave hapësinore për analiza të ndryshme territoriale dhe të trendit të zhvillimit, të cilat gjithnjë e më shumë ndikojnë në arritjen e zhvillimit të dëshiruar strategjik me qëllim të ruajtjes dhe të shfrytëzimit sa më racional të vlerave natyrore në favor të përmirësimit të jetesës së qytetarëve në përgjithësi.

Sipërfaqe e TB në Kosovë-47 % ose 512,000 ha (100 %)	E shfrytëzuar Kosovë 41 % 413,635 ha (80.8 %)	Ekonomitë Bujqësore 130,775	Me Sistem të Ujitjes 10.5% ose 43,491 ha	Kulturat kryesore
<b>Ara të Punueshme</b> (Kom. Prishtinës: 0.10 ha/b; 27.7 %)	<b>180,381 ha</b> (43.6 %)	113,231	Ujiten vetëm <b>22,888 ha</b> ose <b>52.6 %</b>	Drithra: Gruri - 50.3 %; Misri - 19.4 %; Perime - 3.7 % (6.689 ha specia, qepë, shalqi)
<b>Pemishte</b> (me 3,520 ha plantacione)	<b>4,399 ha</b> (1.06 %)	11,677		Molla - 56.1%; Kumbulla - 19.9%
<b>Vreshta</b>	<b>3,215 ha</b> (0.8 %)	6,242		Rr. vene - 58.6 % Rr. tryeze – 41.4 %
<b>Livadhe 29 % &amp; Kullota 71 %</b> (281.747 Nj.Blegt.)	<b>224,604 ha</b> (54.3 %)	91,227	-	Gjedhet 71 %; Shpezët 17%; Delet 7 %, dhe Kafshë tjera 5%.


**Fig. 3. Tabela me raporte të përdorimit, ujitje, EB & kulturat kryesore të tokës bujqësore.** Burimi: IPH me të dhëna nga ASK-ja 2015.

**Gjendja e Indikatorit dhe krahasimi:** Në Kosovë, në vitin 2014, ishin gjithsej 512,000 ha tokë bujqësore ose 47 % të sipërfaqes tërësishme të saj. Nga kjo sipërfaqe, 413,635

ha (ose 41 % e sip. Kosovës) që i bie se 80.8 % e sipërfaqes së tokës bujqësore shfrytëzohet për kultura e prodhime bujqësore nga 130,775 Ekonomi Bujqësore (me mesataren e shfrytëzimit prej 3.2 ha).

**Fig. 4. Grafiku me krahasimin e pjesëmarrjen e tokës punueshme - arave, kullotave e livadheve dhe kulturave shumëvjeçare në BE, Mal të Zi, Serbi e Kosovë.** Burimi: ASK 2015.

Pjesa më e madhe, e sipërfaqes së shfrytëzuar të tokës bujqësore, i takon livadheve dhe kullotave (54.3%), përdërisa pjesëmarrja e tokës së punueshme-arave është 43.6% (180,381 ha). Kultura që zë pjesën më të madhe të tokës së punueshme-arave është gruri (50.3%) dhe misri (19.4%). Kurse, me perimet, si: specia (38%), qepë dhe shalqinj janë mbjellë 3.7% të tokës së punueshme -



arave (ose 6,689 ha). Sipërfaqja e tokës së punueshme – arave për kokë banori (prej 0.10 ha/person) është mjaft e ulët, kurse sipërfaqja mesatare për Ekonomi Bujqësore është 1.6 ha.

Me përmirësimet janë gjithsej 4,399 ha (nga të cilat 3,520 ha - plantacione), të kultivuara kryesisht me mollë (56.1%) dhe kumbull (19.9%) prej 11,677 Ekonomive Bujqësore. Në Kosovë, sipërfaqja e vreshtave është 3,215 ha, nga e cila 58.6% është e kultivuar me rrush për prodhimin e verës, të cilat kultivohen 6,242 Ekonomi Bujqësore me mesatarisht 0.52 ha.

Nga gjithsej sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore, 10.5% (43,491 ha) mund të ujitet. Në vitin 2014, që në përgjithësi ka qenë vit me të reshura të mjaftueshme, rreth gjysma e kësaj sipërfaqe ishte ujitur (22,888 ha).

### **Konkluzione dhe rekomandime:**

- Rezultatet më të besueshme të regjistrimit të bujqësisë 2014, tregojnë se rreth 20 % (19.2 %) e fondit të tokës bujqësore nuk është e shfrytëzueshme;
- Në Kosovë, sipërfaqja e tokës së punueshme bujqësore –arave për kokë banori, është prej 0.10 ha/b, nën limitin kritik (0.17 ha/b), përderisa në vendet e BE-së është 0.52 ha/b.
- Pas luftës së fundit në Kosovë, nga shkak i lëvizjeve të shumta të popullsisë dhe nevojës së tyre për strehim/banim dhe zhvillim ekonomik (ndërtime në industri, tregti e komerciale, shërbime publike, sociale, kulturore, infrastrukturë, transport, rekreacion, etj.), janë bërë shumë zhvillime me ndërhyrje të pakoordinuara dhe të pakontrolluara në mjedisin jetësor, të cilat atakuan tokën më cilësore për zhvillime bujqësore, që për pasojë sollën dhe konvertimin e saj në tokë ndërtimore;
- Në MBPZHR nuk ka informata të sakta për fondin dhe sasinë e humbur të tokës bujqësore, nga shndërrimi saj në tokë urbane / ndërtimore, erozioni, vërshimet, gërryerja dhe nxjerrja e inerteve në shtretërit e lumenjve, etj.

Prandaj rekomandohet që:


- Me çdo kusht të fuqizohet ligji për mbrojtjen dhe ruajtjen e tokës kualitative bujqësore, si resurs natyror, me qëllim të përdorimit të saj vetëm për prodhime bujqësore, përmes së cilës sigurohen dhe përmirësohen ushqimi i mjaftueshëm për plotësimin e nevojave të popullsisë, përfitimet në ekonomitë familjare si dhe përmirësim të bilancit tregtar të vendit;
- Instrumentet përkatës të planifikimit hapësinor të shfrytëzohen me qëllim të ruajtjes, rehabilitimit dhe të përdorimit efikas të tokës kualitative bujqësore;
- Të bëhet rehabilitimi dhe zgjerimi i rrjetit të sistemit të ujitjes, me qëllim të rritjes së sipërfaqeve të tokës së punueshme bujqësore – arave dhe plantacioneve nën ujitje;
- Të stimulohen fermerët dhe NVM-të që merren me përpunimin e prodhimeve bujqësore;
- Të sigurohen mekanizmat për një përkujdesje dhe menaxhim më efikas në mbrojtje, ruajtje, trajtim, planifikim dhe shfrytëzim racional të tokës kualitative bujqësore që përkon edhe me një përkushtim më serioz të të gjithë hisedarëve me qëllim të:
  - Realizimit të politikave qeverisëse për zhvillim të vendit;
  - Arritjes së synimeve dhe të objektivave kryesore të sektorit bujqësor; dhe
  - Përfitimit ekonomik ose të sigurimit të ekzistencës për më shumë se gjysmën e popullsisë së Kosovës, e cila merret vetëm me aktivitete bujqësore.



**Përshkrimi i Indikatorit:** Ky tregues paraqet potencialin e tokës ndërtimore në Kosovë të mbështetur në modelin e projektit të EULUP-it të njohur si “Plani i Zonave Ndërtimore (PZN). PZN përbëhet nga shumë shtresa të të dhënave hapësinore të cilat reflektojnë kufizime të zhvillimeve hapësinore duke u mbështetur në legjislacionin Kosovar në fuqi. PZN-ja është informatë rasterike në GIS, të cilën e posedon MMPH-ja. Në bazë të PZN-së mund të llogariten se cilat sipërfaqe janë të përshtatshme për ndërtim sipas kriterëve të dhëna në këtë model. PZN jep restriksionet për 16 veçori hapësinore.

**Mënyra e matjes së Indikatorit:** Mënyra e matjes së këtij Indikatorit është përmes kufizimeve të dhëna në ndërtimin e këtij modeli. Kufizimet janë faktorë që tregojnë se cilat sipërfaqe nuk kanë kufizime fare (0) dhe atyre që kanë kufizime (1 – 16), siç shihen në fig. 1 dhe janë renditur në vijim:

**PLANI I ZONAVE TË NDËRTIMIT NË KOSOVË**



0. Pa kufizime,
1. Përshtatshmëria e tokave bujqësore - klasa 1-4;
2. Ndjeshmëria e tokës ndaj erozionit >75;
3. Hapësirat me biodiversitet të vlerësuar >75;
4. Shkalla hipsometrike >1200 m;
5. Ndjeshmëria e ujërave nëntokësor >75;
6. Zonë e rezervuar për miniera;
7. Hapësirat nën ujitje;
8. Zonat e ruajtura natyrore;
9. Rrjeti i largpërçuesve 100 m buffer;
10. Zonat e rrezikuara nga vërshimet;
11. Zona e ujërave të mbrojtura;
12. Guroret;
13. Lokacionet e trashëgimisë kult.;
14. Zonat e minuara;
15. Aeroportet dhe kufizimit rreth tyre;
16. Monumentet e natyrës.

**Fig. 1. – Plani i Zonave të Ndërtimit (PZN) sipas kufizimeve në Kosovë.**  
Burimi: EULUP.

**Burimi i informatës/ave:** Për këtë tregues ka disa burime të informatave që përfshijnë shumë institucione qeveritare dhe publike në Kosovë, ndërsa modeli gjenerues është në IPH.

**Kufizimet për matjen e Indikatorit:** Ky tregues në përgjithësi tregon dy zona në Kosovë që kanë të bëjnë me zona që ka kufizime dhe zona që nuk ka kufizime të zhvillimeve hapësinore. Dobësia e këtij Indikatorit janë mos azhurnimi me ndryshimet aktuale që kanë ndodhë në hapësirë dhe fakti që nuk tregojnë zonat me kufizime ose jo jashtë zonës aktuale të ndërtimit. Kjo dobësi mund të eliminohet atëherë kur sigurohen të dhënat në GIS (Geographic Information System) për kufijtë e zonave aktuale ndërtimore.

**Rëndësia e Indikatorit për zhvillim hapësinor:** Ky tregues është i rëndësishëm për shkak që mundëson gjetjen e zonave që nuk kanë kufizime të zhvillimeve hapësinore dhe zonave që kanë shkallë të caktuar të kufizimeve për zhvillime hapësinore. Ky tregues është i rëndësishëm sepse mundëson krahasimin e potencialit të tokës ndërtimore sipas regjioneve dhe komunave në Kosovë, i cili do të shërbejë për lokalizimin dhe shtrirjen e zonave të ardhshme të ndërtimit në Kosovë dhe sipas komunave.

**Gjendja e Indikatorit dhe krahasimi:** Ky tregues paraqet potencialin e zonave ndërtimore në Kosovë sipas kufizimeve ose jo kufizimeve, duke mos përfshirë zonat aktuale ndërtimore si dhe ndryshimet e bëra deri më tani në territorin e Kosovës. Sipas PZN-së, sipërfaqja totale e territorit të Kosovës sipas 16 faktorëve me kufizime dhe sipërfaqeve pa kufizime është si në grafikun në vijim:




Fig. 2. Grafiku i Pjesëmarrjes së Zonave Kufizuese në Kosovë (në km<sup>2</sup>). Burimi: Projekti i BE/EULUP.

Bazuar në PZN, Kosova ka 18.11% ose 1972.74 km<sup>2</sup> të territorit të sajë si tokë të përshtatshme për ndërtim, ndërsa pjesa tjetër e mbetur shtrihet në njërën ose në disa nga 16 faktorët kufizues të modelit, e që paraqesin kufizime për zhvillim (ose ndërtim) të ardhshëm.

Ndërsa gjendja sipas komunave është si në vijim:

**Fig. 3. Tabela me sipërfaqe sipas faktorit kufizues nëpër komuna të Kosovës (në km<sup>2</sup>). Burimi: Projekti i BE/EULUP.**

Komuna/Faktori	0	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16
Ferizaj	36.205	180.19	20.28	28.0525	19.8725	26.81	3.7275	0	0	21.945	6.015	0.1275	1.205	0.075	0	0	0.125
Drenas	51.89	130.78	4.365	3.3375	0	2.47	15.625	47.7475	0	11.795	2.5425	0.5975	2.005	0	2.1275	0	0.38
Istog	14.85	158.215	32.2675	17.01	122.9675	27.1075	7.945	56.1125	0	13.5475	0.8825	0.835	1.1875	1.4375	0	0	0
Klinë	45.095	194.3275	1.8375	0	0	35.115	13.8725	0	1.7825	3.795	6.0325	2.3725	3.075	0.685	0.51	0.0225	0.495
Leposaviq	192.61	46.0375	122.8775	62.6825	54.805	0	42.96	0	0	5.5525	0.74	2.17	1.58	0.41	1.68	0	0
Malishevë	57.765	198.6225	14.47	3.835	0	5.9625	16.53	0	1.605	5.365	0.62	0.13	0.85	0.075	0.465	0	0.2575
Obiliq	3.4675	33.16	1.1325	0.0275	0	9.535	21.3075	15.105	0	17.4625	2.98	0	0.4225	0.24	0	0	0
Pejë	29.72	94.0075	27.185	19.265	240.5475	77.8825	3.7375	49.15	42.105	9.22	2.24	0.3875	4.5025	2.305	0	0	0.2575
Podujevë	156.835	215.5075	42.4725	59.2675	36.965	42.8675	35.355	0	0	21.255	10.6825	6.43	2.8275	0	0.46	0	0.7575
Rahovec	41.3775	146.9375	9.535	1.8525	0	12.0775	18.69	28.25	0.0525	7.3775	4.64	0.365	1.815	2.155	0.78	0	0
Shtime	28.485	52.325	20.265	9.3225	0.0025	7.89	7.885	0	0	3.64	2.405	0	2.105	0	0	0	0.125
Skenderaj	61.9525	268.305	8.685	9.01	0	8.0625	4.45	0	0	10.4475	0	1.2375	1.3425	0.845	0	0	0
Suharekë	86.42	113.3325	59.7675	25.12	17.65	17.3775	4.92	0	24.82	8.325	0.8275	0.1775	1.55	0.6975	0	0	0
Zubin Potok	69.855	31.27	92.2725	62.3525	37.535	2.47	14.31	0	0	3.8175	0.5175	14.3125	0.895	0.905	0	0	0
Zveçan	44.8075	17.0175	25.8175	14.15	2.1825	2.6825	4.455	0	0	6.7925	0.7825	0.7075	0.6275	1.5125	1.2625	0	0
Gjakovë	47.0100	143.0925	13.255	18.56	3.92	7.8875	15.9375	76.455	0	12.7875	2.35	0.9125	1.7525	0.015	0.185	0	0
Vushtri	47.0825	143.725	13.255	18.56	3.92	7.8875	15.9375	76.455	0	12.7875	2.35	0.9125	1.7525	0.015	0.185	0	0
Fushë Kosovë	5.6575	25.53	0.195	0.0025	0	8.44	35.0425	0	0	7.175	0.605	0.1675	0.7975	0.5	0	0	0
Mamushë	0.3175	5.295	0.0975	0	0	4.5275	0	0	0	0.7075	0	0	0	0	0	0	0
Partesh	8.5125	8.8575	0.5075	0.025	0	5.6075	0.5875	0	0	2.18	2.18	0.09	0.1275	0	0	0	0
Deçan	5.3975	26.245	9.675	15.92	131.3225	7.2475	0.1475	83.821	0	5.165	0.0625	0.46	0.85	7.915	0	0	0.375
Junik	2.68	22.075	3.855	6.2575	39.09	1.7825	0.9075	0.3725	0	0	0	0	0.7425	0	0	0	0
Novobrdë	85.1125	69.6375	11.2875	9.28	0	0.3375	17.4	0	0	8.3	0	0.1075	1.5125	0.75	0.23	0	0
Lipjan	49.7875	150.375	33.865	6.7275	0	10.635	54.2875	2.9025	0.34	10.875	5.97	0.345	1.955	0.4	5.085	4.5925	0.27

Hani I Elezit	34.2 425	6.14	30.6 55	4.21 25	0.02 25	0	2.34	0	0	4.05 25	0	0.4 875	0.3 9	0	0	0	0	
Kaçanik	37.7 3	44.5 3	67.3 475	13.6 7	0.00 75	4.2 7	2.1	0	22.0 375	16.5 925	0.4 725	0.1 25	2.4 65	0	0	0	0	
Gjilan	138. 722 5	132. 562 5	37.9 175	12.1 375	0	11. 315	44.4 95	0	0	7.97 25	0.7 575	2.5 4	2.0 9	0.1 25	0	0	0.2 55	
Prizren	105. 717 5	104. 537 5	91.6 45	38.7	50.2 675	26. 185	23.7 55	46. 105	110. 582 5	19.2 95	0.5 275	4.6 975	2.6 725	1.7 85	0	0	0.3 75	
Dragas h	22.4 175	29.2 125	12.5 3	25.0 875	310. 257 5	1.1	13.1 075	0	14.5 5	3.43 25	0	0.2 925	0.6 225	0.0 75	0	0	0	
Shterpc ë	25.4 925	12.3 45	20.5 925	26.8 1	30.3 75	0	0.67 25	0	128. 637 5	1.77	0	0	0.7 025	0.1 05	0.1 8	0	0	
Graçani cë	1.44 25	22.0 65	1.26 25	0.04 25	0	3.5 75	72.1 3	0	0	15.2 25	0.9 3	2.1 8	0.7 05	1.7 1.7	1.1 675	0	0	
Prishtin ë	108. 595	129. 782 5	147. 325	44.2 925	0.13 25	11. 48	26.6 125	7.8 05	8.96 25	29.1 8	0.9 45	5.2 95	1.7 35	0.3 97 5	0.5 825	0	0	
Ranillug	24.5 95	30.5 6	2.53 5	1.75 75	0	4.8 65	7.14 25	0	0	4.35 25	0.8 425	0.1 2	0.8 3	0	0	0	0	
Kameni cë	126. 335	121. 867 5	41.2 8	30.1 625	0.15 75	15. 047 5	74.5 35	0	0	3.64 25	0.3 4	0.2 65	2.4 75	0	0	0	0	
Viti	54.9 5	104. 907 5	49.6 875	12.9 625	3.51 75	19. 615	12.0 1	0	0	3.97 5	5.5 075	1.2 55	1.1 425	0.0 92 5	0	0	0	
Kllokot	2.54 75	6.89 75	1.78	0.05	0	9.2 325	0.41	0	0	1.49 25	0	0.6 175	0.3 85	0	0	0	0	
Mitrovi cë Veriore	1.09 25	2.09 25	0.06 25	0	0	0.2 3	0.07 75	0	0	1.48 5	0.0 05	0.0 225	0.0 275	0.3 67 5	0	0	0	
Mitrovi cë	62.9 775	64.7 475	35.7 9	51.1 225	73.2 125	5.9 5	13.1 425	4.9 025	0	11.8 025	1.1 475	1.0 925	2.0 4	2.7 85	0	0	0	
Totali	197 2.74	340 9.10 8	113 4.36 5	641. 412 5	119 3.06 5	521 .99 5	647. 387 5	438 .05	355. 475	342. 672 5	68. 372 5	60. 692 5	53. 787 5	26. 31 5	17. 772 5	5.1 5	3.6 72 5	
%	18.1 1	31.3 0	10.4 1	5.89	5	10.9 9	4.7 5.94	4.0 2	3.26	3.15	3	0.6 6	0.5 9	0.4 4	0.2 6	0.1 5	0.0 5	0.0 3

### **Konkluzione dhe rekomandime:**


- Aplikimi i kufizimeve të vazhdueshme kryesisht të karakterit mjedisorë dhe bujqësorë e kufizon edhe potencialin e tokës ndërtimore;
- Mos azhurnimi i gjeo-informacioneve mbi të cilat është ndërtuara modeli i potencialit të tokës ndërtimore ose PZN-ja krijon rezultatet jo reale dhe vështirë të përdorshme për analiza hapësimore lokale;
- Pavarësisht disa kufizimeve ky tregues mundëson përcjelljen e trendit të shfrytëzimit të potencialit të tokës ndërtimore dhe lokalizimin e kësaj kategorie të tokës;
- Ndër Objektivat më të rëndësishme për monitorimin e këtij Indikatori do të jenë:
  1. Rishikimi i faktorëve dhe parametrave të modelit apo rishikimi i pjesshëm i përmbajtjes së modelit;
  2. Azhurnimi i informacioneve gjeografike në bazë të së cilave është ndërtuar ky model;
  3. Krijimi i informacioneve gjeografike me rezolucion më të detajuar hapësior;
  4. Sforcimi ligjor i këtij modeli dhe detyrimi i komunave që zgjerimin e zonave ndërtimore ta bëjnë sipas PZN-së.

<b>Indikator:</b>	<b>NUMRI DHE SHTRIRJA E VENDBANIMEVE JOFORMALE</b>
<b>Synimi:</b>	PËRMIRËSIMI I KUSHTEVE TË JETESËS
<b>Objektivi:</b>	PARANDALIMI DHE ZVOGËLIMI I NUMRIT TË VBjF-ve (FORMALIZMI TYRE)

**Përshkrimi i Indikatorit:** Ky indikator paraqet numrin e vendbanimeve joformale në nivel vendi dhe të ndara (regjistruara) edhe sipas njësive lokale administrative në fuqi.

**Mënyra e matjes së Indikatorit:** Procesi i identifikimit të vendbanimeve joformale është bërë dhe përfunduar nga MMPH-ja, ku në vitin 2010 është punuar edhe raporti mbi gjendjen e vendbanimeve joformale në Kosovë, në bazë të cilit janë të identifikuar 174 VBjF. Mënyra e matjes së këtij Indikatorit është përmes raporteve që nxjerr MMPH-ja kohë pas kohe. Ky tregues do të matet përmes këtyre nën tregueseve:

- Numri i vendbanimeve joformale;
- Numri i banorëve në vendbanimet joformale;
- Struktura etnike dhe socio-ekonomike e popullsisë në vendbanimet joformale; dhe
- Shkalla e investimeve zhvillimore (kapitale) dhe urbanizimi i tyre.



**Fig. 1. Vendbanimet joformale në komunën e Mitrovicës (2010).**  
Burimi: MMPH/DPH "Raporti i gjendjes së VBjF" 2010.

#### **Burimi i informatës/ave:**

Burimi kryesor i sigurimit të informatave për këtë tregues janë MMPH-ja dhe drejtoritë përkatëse komunale.

#### **Kufizimet për matjen e**

**Indikatorit:** Ky tregues momentalisht nuk mund të trajtohet për shkak se nuk ka informata krahasuese. Raporti i vetëm zyrtarë për vendbanimet joformale është "Raporti i Gjendjes së Vendbanimeve Joformale në Kosovë" i botuar në vitin 2010.

Mënyra e vlerësimit të vendbanimeve joformale lë hapësirë për diskutim serioz dhe në mënyrë objektive. Mënyra se si një vendbanim joformal largohet nga lista e vendbanimeve joformale (... kur bëhet formal) është jo shumë e qartë. Sipas praktikave të deritashme, një vendbanim joformal largohet nga lista e vendbanimeve joformale në momentin kur ai vendbanim përfshihet dhe trajtohet nga dokumentet e planifikimit në nivel lokal (PZHK, HZK, (PZHU), ose edhe PRrHU (PRrU)). Duke marr në konsideratë shkallën e implementimit të dokumenteve të planifikimit në Kosovë, konsiderohet se ky vlerësim është jo i drejtë dhe si rrjedhojë edhe i dëmshëm për banorët e këtyre vendbanimeve.

Përveç raportit të gjendjes së vendbanimeve joformale të vitit 2010 nuk kemi ndonjë raport tjetër që tregon gjendjen e vendbanimeve joformale pas vitit 2010.

**Rëndësia e Indikatorit për zhvillim hapësinor:** Ky tregues është i rëndësishëm për shkak që do të mundësojë identifikimin e vendbanimeve joformale në nivel vendi dhe komune, si dhe do të mundësojë trendin e rritjes ose zvogëlimit të numrit të vendbanimeve joformale duke u fokusuar edhe në analizimin kushteve të jetës në këto vendbanime përmes shkallës së investimeve në projektet kapitale dhe zhvillimor. Rregullimi i vendbanimeve joformale është detyrë dhe obligim i planeve përkatëse hapësinore që përfshijnë territorin e këtyre vendbanimeve.

**Gjendja e Indikatorit dhe krahasimi:** Në bazë të raportit mbi gjendjen e vendbanimeve joformale të vitit 2010, numri i përgjithshëm i vendbanimeve joformale në Kosovë është 174. Sipas këtij raporti, numrin më të madh të vendbanimeve joformale e kanë komunat si: Klina 20, Gjilani 17, Graçanica 15, Skenderaj 10, Peja 10, Lipjani 9, Vushtrri 9, Deçani 9, Rahoveci 8, Gjakovë 8, Prishtinë 7, Obiliqi 7, Ferizaj 6, Prizreni 5, Kaçaniku 5, Kamenicë 5, Shtëmë 4, Viti 4, Drenasi 3, Mitrovicë 3, Ranillug 3, Shtërpci 3, Dragash 3, Fushë Kosovë 2, Novobërd 2, Killokot 1, Malishevë 1, Mamushi 1, Hani i Elezit 1, Podujevë 1, Suharekë 0, Zveçani 0, Zubim Potok 0, Leposaviqi 0, Istog 0, Junik 0.




Fig. 2. Grafiku me numrin e Vendbanimeve joformale sipas komunave në Kosovë (2010)

### **Konkluzione dhe rekomandime:**

Trajtimi sipërfaqësorë i kësaj çështje krijon mundësi reale për rritjen e kësaj kategorie të vendbanimeve dhe mund të shkaktojë probleme të shumta (sociale, pronësore, ekonomike dhe shëndetësore) për banorët e këtyre vendbanimeve.

Objektivat më me rëndësi për monitorimin e këtij Indikatorit do të mund të ishin si në vazhdim:

1. Identifikimi i hapësinor i VJF me kufijtë e tyre të saktë në GIS;
2. Rishikimi i kriterëve për identifikimin e vendbanimeve joformale;
3. Vendosja e kriterëve objektive kur një VJF mund të dal nga lista e VJF;
4. Zhvillimi i studimeve socio-ekonomike dhe pronëso- juridike për secilin VJF;
5. Zhvillimi i projekteve dhe programeve të veçanta që mund të trajtojnë një problem të vetëm ose disa probleme bashkërisht në VJF.

**Përshkrimi i Indikatorit:** Ky indikator paraqet numrin e ndërtimeve pa leje në nivel vendi dhe të ndara edhe sipas njësive lokale administrative në fuqi ose në ndarje tjetër specifike për nevoja statistikore.

**Mënyra e matjes së Indikatorit:** Në Kosovë, procesi i trajtimit të ndërtimeve pa leje është në vazhdim e sipër si pjesë e punës së MMPH-së për implementimin e Ligjit për Trajtimin e Ndërtimeve Pa Leje me Nr. 04/L-188. Në Ligjin për Ndërtim me Nr. 04/L-110, neni 15 tregon ndarjen e kategorive të objekteve për lëshimin e lejes ndërtimore sipas nivelit të rrezikshmërisë, si:

1. *Kategoria I* - ndërtimet me rrezikshmëri të ulët,
2. *Kategoria II* - ndërtimet me rrezikshmëri të mesme, dhe
3. *Kategoria III* - ndërtimet me rrezikshmëri të lartë dhe me interes nacional.

Ndërsa, neni 19 tregon për kompetencat e subjekteve për lëshimin e lejes ndërtimore, ku MMPH-ja është përgjegjëse për objektet e kategorisë së III-të dhe komunat janë përgjegjëse për objektet e kategorisë së I-rë dhe të II-të. Po ashtu, edhe përgjegjësia për legalizim të objekteve të ndërtuara pa leje, i takon MMPH-së për kategorinë e III-të dhe komunave për kategorinë e I-rë dhe të II-të.



Matja e këtij Indikatorit bëhet përmes Regjistrisë Shtetërore të Ndërtimeve Pa Leje (RShNPL), që zhvillohet në MMPH, në bazë të informatave dhe raportimeve që vijnë nga komunat, të mbështetura me të dhëna për nën Indikatorit si: në vijim:

- ✓ Numri i ndërtimeve pa leje;
- ✓ Numri i lejeve ndërtimore të lëshuara nga drejtoritë përkatëse brenda vitit;
- ✓ Numri i refuzimeve të lejes ndërtimore të lëshuara nga drejtoritë përkatëse brenda vitit;
- ✓ Periudha kohore e pritjes për leje ndërtimore;
- ✓ Numri i ankesave në organet kompetente;
- ✓ Numri i rrënimëve.

**Fig. 1. – Harta e ndërtimeve pa leje në Kosovë.** Burimi: RShNPL<sup>53</sup> 2015.

<sup>53</sup> MMPH / DPHBN, Regjistri Shtetëror i Ndërtimeve Pa Leje, Prishtinë 09.09.2015.

**Burimi i informatës/ave:** Burimet kryesore dhe të vetme për marrjen e informatave për këtë indikator janë MMPH / DPHBN dhe Komunat e Kosovës / Drejtoritë e Urbanizmit dhe të Inspektoratit.

Nr.	Kategoria	Komuna	Nr. objekteve
1	I - II	Deçan	11893
2		Dragash	12314
3		Ferizaj	32721
4		Fushë Kosovë	7453
5		Gjakovë	8501
6		Gjilan	32128
7		Glllogoc	14152
8		Gracaninë	2617
9		Hani i Elezit	2000
10		Istog	3874
11		Junik	917
12		Kaçanik	8691
13		Kamenicë	915
14		Klinë	12016
15		Klllokot	33
16		Leposaviq	6
17		Lipjan	15783
18		Malishevë	19780
19		Mamushë	1
20		Mitrovicë e Jugut	8134
21		Novobërdë	6
22		Obiliq	3550
23		Partesh	0
24		Pejë	13568
25		Podujevë	4796
26		Prishtinë	46528
27		Prizren	27900
28		Rahovec	14822
29		Ranillug	1766
30		Shtërpçe	530
31		Shtime	9766
32		Skënderaj	5967
33		Suharekë	15333
34		Viti	3190
35		Vushtrri	9738
36		Zubin Potok	1
37		Zveçan	5
38		Mitrovicë e Veriut	1441
	III	<b>MMPH</b>	849
<b>TOTAL</b>			<b>353685</b>

**Kufizimet për matjen e Indikatorit:**

Kufizimet për matjen e këtij Indikator ndërlidhen me disa komuna të cilat nuk e kanë filluar procesin e regjistrimit të ndërtimeve pa leje në territorin e tyre si pjesë e projektit shtetëror për përpilimin e RShNPL-së. Këto, kryesisht janë komuna që menaxhohen nga minoritetet në Kosovë, të cilat procesin e regjistrimit të ndërtimeve pa leje në territorin e tyre e ndërlidhin me çështje politike. Ndërsa, vështirësitë tjetër do të jetë edhe natyra e mekanizmit raportues nga niveli lokal në atë qendror, për ndërtimet pa leje të cilat kanë ndodh pas datës 30 gusht 2013 e të cilat i nënshtrohen ligjit për Ndërtim.

**Rëndësia e Indikatorit për zhvillim hapësinor:**

Ky tregues është i rëndësishëm për shkak që do të mundësojë identifikimin e çdo objekti të ndërtuar pa leje dhe do të mundësojë krijimin e hartës së përgjithshme të ndërtimeve pa leje të cilat do të shqyrtohen dhe prezantohen edhe në Hartën Zonale të Kosovës dhe Komunës.

Me anë të këtij Indikator do të bëhet edhe përcaktimi i zonave me numër të objekteve të kësaj kategorie, të cilat në procesin e planifikimit do të kenë efekte në orientimin e zhvillimeve dhe investimeve kapitale në hapësirë për integrimin e tyre drejt zonave formale urbane.

**Fig. 2. Tabela me numrin e ndërtimeve pa leje sipas komunave dhe MMPH-së.** Burimi: RShNPL (09.09.2015).


**Gjendja e Indikatorit dhe krahasimi:**

MMPH-ja, në kuadër të zbatimit të Ligjit për Trajtimin e Ndërtimeve Pa Leje, deri më 09.09.2015 ka përfunduar procesin e përpilimit të Regjistrimit

Shtetëror të Ndërtimeve pa Leje (RShNPL). Gjendja sipas këtij Regjistri është paraqitur në tabelën e fig. 2, ku numri i ndërtimeve pa leje në gjithë territorin e Republikës së Kosovës është 353.685 objekte, prej nga 849 objekte ose 0.24 % e totalit janë të kategorisë së III-të dhe 352,836 objekte ose 99.76 % i përkasin kategorisë së I-rë dhe të II-të.



Fig. 3. Grafiku sipas numrit të ndërtimeve pa leje të regjistruara nëpër komuna. Burimi: IPH (sipas RShNPL 2015)



### **Konkluzione dhe rekomandime:**

Sipas analizës së mësipërme në nivelin e lartë të ndërtimeve pa leje ka ndikuar:

- Mungesa e planeve urbanistike për të përcjellë kërkesat në rritje për ndërtim që për pasojë është shfaqë dukuria e zgjerimit urban të pakoordinuar;
- Mos zbatimi i instrumenteve ligjore dhe efikasiteti i ulet organizativ dhe monitorues nga të dy nivelet e qeverisjes;

Për menaxhim të kësaj situate duhet të zbatohen objektivat e qarta të radhitura si në vazhdim:

- Të vazhdohet me inventarizimin e objekteve pa leje të ndërtuara pas datës 30 gusht 2013;
- Monitorimi dhe zbatimi i Hartës Zonale të Kosovës dhe Hartave Zonale të Komunave, si dhe Planeve Rregulluese të Hollësishme;
- Ndërtimi i bazës së të dhënave në GIS që përmbledh të gjitha objektet e ndërtuara (kategoria I, II – III) duke përfshirë edhe statusin legal të ndërtimit.

**Indikatori: NUMRI I NJËSIVE TË BANIMIT NË KOSOVË****Synimi:** ZHVILLIM SOCIAL TË BALANCUAR PËR PËRMIRËSIMIN E STANDARDIT JETËSOR**Objektivi:** DENDËSIMI I NJËSIVE TË BANIMIT PËR SHFRYTËZIM RACIONAL TË TERRITORIT

**Përshkrimi i Indikatorit:** Ky indikator paraqet numrin e njësive të banimit në territorin e Kosovës. Përderisa, një njësi e banimit (banesë<sup>54</sup>) është një: shtëpi, apartament, shtëpi e lëvizshme, grup i dhomave ose një dhomë e vetme, të cilat së bashku me hapësirat ndihmëse shërbejnë për strehim të një ekonomie familjare<sup>55</sup>, që kanë hyrje të veçantë, qasje të drejtpërdrejtë nga jashtë apo nëpërmjet një koridori të përbashkët të ndërtesës.

**Mënyra e matjes së Indikatorit:** Numri i njësive të banimit në Kosovë është llogaritur sipas metodologjisë klasike të intervistimit, duke e mbledhur numrin e njësive të banimit, të regjistruara në secilën komunë. Të dhënat kryesore të përgatitura nga ASK janë rezultat i Regjistrimit të Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave në Kosovë 2011.

**Burimi informatës/ave:** Burim i sigurtë i informatave për këtë indikator është Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) si dhe institucionet përgjegjëse për rregullimin e sektorit të banimit në nivelin qendror (MMPH/DPHNB-Divizioni i Banimit) dhe në nivelin lokal (Drejtoritë e Urbanizmit në komuna dhe Ndërmarrja Publike Banesore SH.A., që është pronë e Komunës së Prishtinës).

**Kufizimet për matjen e Indikatorit:** Këtu mund të theksohen kufizimet në të dhëna jo të plota nga regjistrimi i i fundit i popullsisë më 2011, sidomos në komunat veriore të Kosovës. Për shkak të mungesës së: legjislacionit adekuat për banim, politikave dhe strategjisë së banimit, sektorit të banimit nëpër komuna, analizave krahasuese dhe burimeve të ndryshme të informatave, janë bërë vetëm vlerësime të ndryshme për njësitë dhe gjendjen e banimit.

**Rëndësia e Indikatorit për zhvillimin hapësinor:** Numri njësive të banimit është tregues i rëndësishëm për orientimin dhe planifikimin e zhvillimeve të ardhshme hapësinore në zonat e evidentuara, në të cilat kërkesat për zhvillime të reja duhet bazuar në gjendjen ekzistuese dhe në projeksionet e popullsisë, për të siguruar banim të përshtatshëm, me qëllim të përmirësimit të kushteve për ngritjen e standardit jetësor, përfshirë edhe infrastrukturën me shërbimet përcjellëse teknike, sociale, publike, kulturore dhe hapësirat e lira të përbashkëta.

**Gjendja e Indikatorit dhe krahasimi:** Për gjendjen e banimit të një vendi më së miri e tregojnë indikatorët më specifik që shprehin: 1) Numri i njësive të banimit; 2) Njësitë e banimit sipas statusit të shfrytëzimit; 3) Njësitë e banimit sipas tipologjisë së vendbanimit; dhe 4) Dendësia e banesave.


Sipas regjistrimit të popullsisë në vitin 2011, numri i njësive të banimit në territorin e Kosovës është 412.884 në të cilat jetojnë 297.090 ekonomi familjare me 1.739.825 banorë dhe 4.2 b/nj, prej tyre rreth 28.7% janë të pabanuara<sup>56</sup>. Numri i njësive të banimit në Kosovë është rritur për 46.7% në krahasim me të dhënat e Regjistrimit të vitit 1981 (me rreth 220.000), në të cilat kanë jetuar rreth 223.000 ekonomi familjare me 1.584.440 banorë (8.9 % më pak se regjistrimi i vitit 2011).

<sup>54</sup> ASK: Banesat dhe Ndërtesat Sipas Komunave, Prishtinë, Dhjetor 2013 "Banesë është konsideruar tërësia e lidhur ndërtimore e destinuar për banim, e cila përbëhet prej një apo më tepër dhomave me kthina përkatëse ndihmëse (kuzhinë, paradhomë, korridor, baxho, wc etj.) ose pa kthina ndihmëse, e cila ka një apo më tepër hyrje dhe është dedikuar për banim".

<sup>55</sup> Ligji Nr. 03/L-237 Për Regjistrimin e Popullsisë, të Ekonomive Familjare dhe të Banesave, Tetor, 2010. "Ekonomi familjare - secila familje apo bashkësi tjetër e personave, të cilët deklarojnë se ata jetojnë së bashku dhe së bashku i shpërndajnë të ardhurat e veta për plotësimin e nevojave themelore jetësore".

<sup>56</sup> ASK, Vjetari statistikave të Kosovës, Prishtinë, Maj 2014

Numri më i madh i njësive të banimit është ndërtuar dhe rindërtuar pas konfliktit të vitit 1999, përfshirë edhe fondin prej 27% të njësive të dëmtuara<sup>57</sup>, të cilat janë realizuar nga investime të ndryshme, si: vet-financim të ekonomive familjare, të sektorit privat ndërtimor, të donatorëve të ndryshëm për strehim emergjent dhe një numër shumë shumë i vogël i tyre nga Qeveria e Kosovë (përmes 2 Ministrive të linjës, për: Komunitete e Kthim dhe Punë e Mirëqenies Sociale).



**Fig 1. Grafiku me tabelë për numrin e banorëve, njësive të banimit dhe ekonomive familjare në Kosovë (2011) dhe vende të rajonit. Burimi:** IPH me të dhënat nga statistikat zyrtare të shteteve të rajonit nga regjistrimet e viteve të fundit.

Nga krahasimi i gjendjes së banimit nëpër vendet e rajonit (fig. 1), del se prinë Serbia me numrin më të madh prej 3.231.931 njësive të banimit dhe me mesatare prej 2.2 banorë/njësi; pastaj radhitet Kroacia me 2.257.515 nj. b. & mes. prej 1.9 b/nj; Shqipëria me 1.012.400 nj. b. & 2.8 b/nj; Maqedonia<sup>58</sup> me 698.143 nj. b. & 2.9 b/nj; përderisa Kosova klasifikohet e parafundit me 412.884 nj. - 4.2 b/nj; dhe Mali i Zi i fundit me 247.354 dhe mes. 2.5 b/nj.

Për të vlerësuar gjendjen e shfytëzimit të njësive të banimit duhet të llogaritet raporti në mes të numrit të njësive të banimit dhe numrit të ekonomive familjare që rezulton me numrin/sasinë e njësive të pabanuara<sup>59</sup>. Sipas të dhënave në fig. 1, del se me numrin më të madh të njësive të pabanuara ndër vendet e rajonit<sup>60</sup> prinë Kroacia me 32.0%; për të vazhduar Kosova me 28.7%; pastaj Shqipëria me 28.6%; Serbia me 23.0%; Mali i Zi me 21.2% dhe në fund me numrin më të vogël prej 19.2% është Maqedonia.


Në Kosovë, njësitë e banimit sipas statusit të shfrytëzimit të njësive banesore (shih fig. 2), klasifikohen në: banesa të banuara, të pabanuara dhe lloj tjetër i banesave. Komunitat me numër më të madh të banesave të banuara janë: Prishtina (43943), Prizreni (30502), Ferizaji (18456), Gjilani (18314), Peja (17936), Gjakova (17283), Podujeva (14194), Mitrovica (13618), ndërsa komunitat me numër më të vogël të banesave të banuara janë: Parteshi (433), Klllokoti (506), Mamusha (518), Juniku (765) dhe Ranillugu (941).

<sup>57</sup> MMPH, IPH: Raport i Zhvillimit Hapësinor për Sektorin e Banimit, Prishtinë, Shkurt 2004.

<sup>58</sup> Regjistrimi i fundit i popullsisë në Maqedoni 2002

<sup>59</sup> ASK, Regjistrimi i Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave në Kosovë 2011, Prishtinë, Dhjetor 2013. "Nga të dhënat kryesore: Një banesë konsiderohet «e pabanuar» ose «e pashfrytëzuar» kur askush nuk jeton në të tërë kohën. Mund të ketë persona që përkohësisht janë aty, por që zakonisht jetojnë diku tjetër (mund të jetë banesë e rezervuar për shfrytëzim sezonal apo dytësor) ose nga personat që nuk përfshihen në regjistrimin e popullsisë (siç janë personeli diplomatik) ose mund të jetë banesë e zbrazët (siç janë banesat për tu lëshuar me qira ose për shitje)".

<sup>60</sup> Përqindjet e vendeve të rajonit janë kalkuluar sipas të dhënave zyrtare statistikore (Numri i njësive të banimit, Numri të ekonomive familjare dhe Numri i banorëve), të cilat janë marrë nga web. faqet zyrtare (<http://popis2011.stat.rs>; [www.monstat.org](http://www.monstat.org); [www.instat.gov.al](http://www.instat.gov.al); [www.dzs.hr](http://www.dzs.hr); [www.stat.gov.mk](http://www.stat.gov.mk)).




**Fig. 2. Grafiku me numrin dhe llojin e shfrytëzimit të banesave sipas komunave në Kosovë. Burimi: IPH me të dhëna nga ASK, Vjetari Statistikor i Republikës së Kosovës, Prishtinë Maj 2014.**

Në qendrat e mëdha urbane ka numër më të madh të banesave të pabanuara. Komunitat me numër më të madh të banesave të pabanuara janë: Prishtina (15402), Prizreni (9123), Peja (7554), Ferizaji (7094), Gjiłani (4987), Gjakova (4520), Podujeva (3809,) ndërsa komunitat me numër më të vogël të njërive të pabanuara të banimit janë: Juniku (17), Mamusha (149), Parteshi (203), Kllokoti (224) dhe Ranillugu (447).

<b>Numri i ndërtesave për banim</b>	<b>340,945</b>
<b>Numri i ndërtesave me të paktën 1 banesë të zakonshme të shfrytëzuara</b>	<b>247,949</b>
<b>Numri mesatar i banesave për ndërtesë</b>	<b>1.3</b>
<b>Numri i banesave</b>	<b>412,884</b>
<b>Numri i banesave të zakonshme (të shfrytëzuara)</b>	<b>412,519</b>
<i>E shfrytëzuar nga një ose më shumë banorë të zakonshëm</i>	<i>293,078</i>
<i>E shfrytëzuar nga banorë që nuk përfshihen në regjistrim (Personeli diplomatik)</i>	<i>1,083</i>
<i>E rezervuar për qëndrim sezonal/shfrytëzim të rastit (pushime, punë sezonale)</i>	<i>18,550</i>
<b>Numri i banesave të zbrazëta</b>	<b>99,808</b>
<b>Numri i njërive tjera të banimit</b>	<b>365</b>
<b>Numri mesatar i ekonomive familjare për banesë</b>	<b>1.0</b>
<b>Numri mesatar i banueshem për banesa</b>	<b>5.9</b>
<b>Numri mesatar i dhomave për banesë</b>	<b>4.0</b>
<b>Mesatarja e hapësirës së shfrytëzueshme për banorë</b>	<b>13.3</b>

**Fig. 3. Tabela me numrat për ndërtesat dhe banesat (me llojin e shfrytëzimit të njërive banimore). Burimi: ASK: Regjistrimi i Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave në Kosovë 2011**

Në Kosovë, gjatë regjistrimit të popullsisë më 2011, janë të evidentuara edhe 365 Njësi Tjera Banesore<sup>61</sup> (lloje tjera objektesh që përdoren për banim të zakonshëm). Komunitat me më shumë kësi njësi (objekte) tjera të banimit janë: Prishtina (75), Skenderaji (29), Ferizaji (27), Shtërpca (24), Mitrovica (23) si dhe ato me numër më të vogël, sikur Istogu (3), Shtimja (2) dhe Malisheva, Novobërda, Ranillugu, Parteshi dhe Klllokoti (me nga 1)



**Fig. 4. Grafikoni i banesave sipas tipologjisë së vendbanimit. Burimi:** IPH me të dhëna nga ASK, Vjetari Statistikor i Republikës së Kosovës, Prishtinë Maj 2014.

Njësitë e Banimit (ose banesat) ndahen edhe sipas tipologjisë së vendbanimit, të territoreve apo të zonave urbane dhe rurale. Sipas ASK 2013, Territori Urban - është një zonë e urbanizuar gjeografike e definuar në nivel të vendbanimit që karakterizohet me densitet më të madh të popullsisë dhe tipare të mëdha të veprimitarisë njerëzore krahasuar me zonat përreth dhe që përcaktohet me vendim administrativ të komunës. Kurse, Territori Rural - është zonë gjeografike jo e urbanizuar e përkufizuar në nivel vendbanimi që karakterizohet me densitet më të ulët të popullsisë dhe zakonisht shumica e tokës shfrytëzohet për bujqësi e që është përcaktuar me vendim administrativ të komunës<sup>62</sup>.

Nga Regjistrimi i vitit 2011, del se komunitat me numër më të madh të njësjive të banimit në territorin urban janë: Prishtina (49.420), Prizreni (22.202), Gjilani (14,533), Peja (13.236), Mitrovica (11.453), Ferizaji (11.017), Gjakova (10.934) ndërsa komunitat me numër më të vogël të njësjive të banimit në territorin urban janë: Dragashi (457), Zveqani (534), Shtërpca (570), Malisheva (653), etj. Përderisa, Komunitat që sipas sistemit administrativ kanë vetëm territor rural janë: Graçanica (3.393), Novobërda (2.498), Hani i Elezit (1.716), Ranillugu (1.389), Juniku (782), Klllokoti (731), Mamusha (667), Parteshi (637), etj.

STATUSI I BANIMIT	TIPI I VENDBANIMIT		
	Urbane	Rurale	Gjithsej
Banesë me një apo më shumë banues të zakonshëm	126,056	167,022	293,078
Banesë me banues që nuk janë përfshirë në regjistrim	811	272	1,083
Banesë e rezervuar për qëndrim sezonal/ të herë pas herëshëm apo shfrytëzim dytësor	6,584	11,966	18,550
Banesë e zbrazët	42,340	57,468	99,808
<b>Gjithsej</b>	<b>175,791</b>	<b>236,728</b>	<b>412,519</b>

**Fig. 5. Banesat e zakonshme sipas tipit të vendbanimit (urbane/rurale) dhe statusit të banimit. Burimi:** ASK 2013.


<sup>61</sup> ASK, Vjetari statistikor i Republikës së Kosovës, 2014 Prishtinë. “Njësitë e tjera banesore janë ato njësi të banimit të cilat janë mobile (p.sh. tenda ose dhoma rimorkio), gjysmë të përhershme (p.sh. kabina ose kasollja), e improvizuar (streha ose baraka), ose që nuk është e dizajnuar për të banuar njerëzit (garazhi, shitorja, streha natyrore), por të cilat në kohën e regjistrimit përdoren si banim i zakonshëm nga një ose më shumë persona”.

<sup>62</sup> ASK, Regjistrimi i Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave në Kosovë 2011, Të Dhënat Kryesore, Prishtinë Dhjetor 2013.

Komunat me numër më të madh të njësive të banimit në territorin rural janë: Prizreni (17.438), Ferizaji (14.560), Podujeva (13.182), Peja (12.267), Lipjani (11.684), ndërsa komunat që kanë numër më të vogël të njësive të banimit në territorin rural janë: Deçani (887) dhe Zveçani (3.004), etj.

Në bazë të rezultateve të kalkuluara nga IPH me të dhënat e vitit 2011 të publikuara nga ASK, 43,5% e numrit të përgjithshëm të njësive të banimit janë të përqëndruara në territorin urban në krahasim me 56,5% të njësive të banimit që janë të përqëndruara në territorin rural. Kjo ka rezultuar se një përqindje më e madhe e popullsisë në Kosovë jeton në territorin rural.

Dendësia e banesave paraqet numrin njësive të banimit për km<sup>2</sup> sipas grid-it, në bazë të regjistrimit të vitit 2011. Shtrirja e dendësisë së banimit me mbi 500 njësi në një km<sup>2</sup> është më e shprehur në qendrat më të mëdha urbane: Prishtina, Mitrovica, Peja, Gjakova, Prizreni, Ferizaj dhe Gjlani. Dendësia e banimit me numër më të vogël (2 njësi të banimit në një km<sup>2</sup>) është e shprehur në komunat me vendbanime malore dhe rreth brezit kufitar të Kosovës.



**Fig. 6. Harta me shtrirje të dendësisë së banesave. Burimi:** ASK, Atlasi i Regjistrimit të Popullsisë në Kosovë 2011, Prishtinë 2013,

### **Konkluzionet dhe rekomandimet:**

- Sektori i banimit duhet të jetë prioritet i politikave të Qeverisë së Kosovës, sipas të cilave duhet të hartohet Ligji për Banim si dhe programe dhe strategji përkatëse që do të ndikojnë në përmirësimin e gjendjes së banimit dhe standardin jetësor në përgjithësi;
- Organet kompetente përgjegjëse për sektorin e banimit duhet të përgatisin analiza dhe hulumtime të nevojshme për të dhëna më të sakta (database) për sektorin e banimit, në mënyrë që të mbulohen paqartësitë e krijuara nga mungesa e tyre për një periudhë të gjatë kohore mes regjistrimit të popullsisë (1981-2011);

- Të dhënat për banim janë të domosdoshme për të krijuar bazë të qëndrueshme për planifikimin dhe identifikimin e nevojave për banim duke ju referuar projeksioneve të zhvillimit të popullsisë;
- Sipas disa analizave të të dhënave, vlerësohet se në Kosovë ka mungesë të njësive për banim, ndërsa sipas regjistrimit të popullsisë 2011, numri i njësive të banimit është më i madh se sa numri i ekonomive familjare, që do të thotë se në Kosovë ka numër të madh të banesave të pabanuara (28.7%). Për këtë arsye duhet të bëhet koordinimi dhe bashkëpunimi i të gjitha institucioneve për të harmonizuar nevojat për banim (kërkesat) në raport me numrin e njësive të zbrazëta të banimit sipas UANr.19/2010 për Përmbajtjen e Bonusit të Banimit;
- Sektori i planifikimit hapësinor duhet të synojë menaxhim efektiv për organizimin territorial hapësinor, për dendësim të njësive të banimit (banim kolektiv) në të gjitha rajonet e Kosovës të përshtashme për banim (jo vetëm në qendrat më të mëdha urbane: Prishtinë, Mitrovicë, Pejë, Gjakovë, Prizren, Ferizaj dhe Gjilan). Në këtë mënyrë do të ndikohet në shfrytëzim sa më racional të tokës dhe të resurseve natyrore, dhe sigurimin e zhvillimit të balancuar socio –ekonomik;
- Në të gjitha komunat duhet të krijohet sektori i banimit i cili sipas Ligji nr. 03/l-164 që do të jetë përgjegjës për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit dhe sipas Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale do të jetë përgjegjës për të përmirësuar gjendjen e banimit;
- Për shkak të kapaciteteve të pamjaftueshme buxhetore të sektorit public, duhet të krijohen mundësitë për investime nga sektori privat. Rekomandohet që investimet në sektorin e banimit të realizohen përmes Partneritetit Publik-Privat, si njëra nga metodat më të qëndrueshme në këtë aspekt.



<b>Indikator:</b>	<b>NUMRI I KËRKESAVE PËR BANIM</b>
<b>Synimi:</b>	ZHVILLIM SOCIAL TË BALANCUAR PËR PËRMIRËSIMIN E STANDARDIT JETËSOR
<b>Objektivi:</b>	KRIJIMI I KUSHTEVE PËR BANIM TË PËRBALLUESHËM

**Përshkrimi i Indikatorit:** Ky indikator paraqet kërkesat për banim në territorin e Kosovës, nga kategori të ndryshme, të cilat kërkojnë zgjidhjen e çështjes së banimit: ekonomitë familjare, personat me asistencë sociale, personat e kthyer nga vendet e rajonit, personat me të ardhura të ulëta, komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, familjet e individëve dhe veteranëve të UÇK-së dhe familjet e dëshmorëve, ish të burgosurëve politik si dhe personat e riatdhesuar<sup>63</sup>.

**Mënyra e matjes së Indikatorit:** Numri i kërkesave për banim në Kosovë llogaritet sipas metodologjisë standarde, procesit të mbledhjes, verifikimit dhe raportimit të të dhënave nga institucionet komunale dhe qendrore. Sipas Ligjit nr. 03/L-164 për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit, komunat janë të obliguara që të hartojnë “Programin trevjeçar të banimit” në të cilin përshkruhen të dhënat lidhur me sektorin e banimit (numri i kërkesave për zgjidhjen e çështjes së banimit). Ndërsa, sipas Rregullores së Sistemit për Menaxhimin e Performancës së Shërbimeve Komunale-MAPL-së, komunat raportojnë të dhënat për performancën vjetore sipas fushave përkatëse, në këtë rast të mirëqenies sociale nëpërmjet “Numrit të kërkesave për banim/strehim të rasteve sociale dhe njerëzve në nevojë”.

**Burimi informatës/ave:** Burim i sigurtë i informatave për këtë indikator në nivelin qendror dhe lokal janë: MMPH/DPHNB-Divizioni i Banimit, Komunat, Këshilli Qendror për Banim si dhe OJQ-të që merren me çështje të banimit. Institucionet tjera qendrore që janë të involvuara indirekt me projekte të banimit janë: MKK, MPMS, MAPL/Departamenti për Performancë dhe Transparencë Komunale/Divizioni për Performancë Komunale, MPB/Departamenti për Riintegrim e Personave të Riatdhesuar, donatorët dhe organizatat ndërkombëtare.

**Kufizimet për matjen e Indikatorit:** Për shkak të: mungesës së hartimit të “Programeve trevjeçare të banimit” nga të gjitha komunat e Republikës së Kosovës, mënyrës së raportimit (disa komuna raportojnë për periudhën njëvjeçare dhe disa paraqesin numrin e përgjithshëm ndër vite), ngecjes së zbatueshmërisë së legjislacionit adekuat dhe mungesës së: vijës buxhetore për banim në komuna, bazës së të dhënave për banim si dhe standardeve për ofrimin e shërbimeve apo mjeteve përkatëse profesionale për performancë më objektive, paraqiten kufizime në të dhëna të sakta dhe të sigurta për numrin kërkesave për banim.

**Rëndësia e Indikatorit për zhvillimin hapësinor:** Numri kërkesave për banim është tregues i rëndësishëm që shërben për të planifikuar zhvillimet e ardhshme për sektorin e banimit, për të krijuar kushte për banim të qëndrueshëm dhe ngritje të standardit jetësor. Raporti ndërmjet numrit të kërkesave për banim dhe numrit të banesave të pabanuara<sup>64</sup> (28.7%) është tregues që vlerëson nivelin e zhvillimeve të reja për sektorin e banimit në procesin e planifikimit hapësinor.

**Gjendja e Indikatorit:** Kërkesat për banim janë shtuar si rezultat i: shkatërrimit të një numri të madh të shtëpive gjatë luftës, rasteve të shumëta sociale, migrimit të familjeve drejt qyteteve të mesme dhe të mëdha si dhe ndryshimit të strukturës familjare. Sipas ligjit në fuqi Nr. 03/L-164 për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit, kërkesat për zgjidhjen e çështjes së banimit kryesisht janë trajtuar për kategoritë, për familjet ose individët të cilët nuk janë në gjendje ekonomike t’i përballojnë ofertat e tregut të lirë të banesave dhe të sigurojnë mjete financiare për banim. Sipas regjistrimit të popullsisë në vitin 2011, në Kosovë numri i banesave të pabanuara është 99.808 (28.7%), prej tyre 42.340 njësi në territorin urban dhe 57.468 njësi në territorin rural, përderisa në të njëjtën kohë kemi numër të madh të kërkesave për banim.

<sup>63</sup>MMPH, Koncept dokumenti për Banim Social, Prishtinë, Prill 2015

<sup>64</sup>ASK, Vjetari statistikave të Kosovës, Prishtinë, Maj 2014

Kërkesat për zgjidhjen e çështjes së banimit në Kosovë ndryshojnë nga viti në vit, disa komuna kanë ofruar përkrahje përdërisa, në disa komuna ka rritje të kërkesave të reja. Sipas “Programeve trevjeçare të banimit” të cilat i kanë përgatitur 18 komuna (Gjakovë, Istog, Klinë, Fushë Kosovë, Kamenicë, Mitrovicë, Lipjan, Obiliq, Rahovec, Pejë, Podujevë, Prizren, Shtime, Shtërpce, Ferizaj, Vushtrri, Hani i Elezit, Graçanicë), numrin më madh të kërkesave për banim e kanë: Graçanica(577) dhe Peja (400) ndërsa numrin më të vogël të kërkesave për banim e kanë: Shtimja (36) dhe Podujeva (49).

Numri i kërkesave për banim/strehim<sup>65</sup> të rasteve sociale dhe njerëzve në nevojë është trajtuar në raportet e përgatitura për performacë të komunave. Sipas Raportit të Performances së Komunave gjatë vitit 2014, janë parashtruar 2374 kërkesa për banim/strehim, prej të cilave janë strehuar 997 familje sipas kapaciteteve të komunave. Komunitat me numër më të madh të kërkesave janë: Gjilani dhe Ferizaji (396 - 360 kërkesa), ndërsa komunitat që kanë numër më të vogël të kërkesave janë: Novobërda dhe Vitia (6 – 8 kërkesa) dhe komunitat që nuk kanë pasë asnjë kërkesë janë: Obiliqi, Shtërpca, Mitrovica e Veriut, Hani i Elezit, Mamusha, Juniku, Kllokoti, Ranillugu, Parteshi dhe Zveçani). Mesatarja e përgjithshme e numrit të familjeve të strehuara është 40 familje. Numri më i madh i komunave ka strehuar më pak familje se mesatarja e vendit.<sup>66</sup>




Fig. 1. Numri i kërkesave për banim/strehim të rasteve sociale dhe njerëzve në nevojë. Burimi: IPH me të dhëna nga “Raporti i Performances së Komunave 2014”




Fig. 2. Numri i kërkesave për banim sipas viteve. Burimi: IPH me të dhëna nga MAPL

<sup>65</sup> STREHIMI sipas Divizionit të Banimit/ MMPH është zgjidhje e shpejtë për banim të përkohshëm (për shtatë ditë)

<sup>66</sup> MAPL, Raporti i Performances së Komunave 2014, Prishtinë, Janar 2015


Numri i kërkesave për banim sipas raporteve të preformancës së komunave sipas viteve (2012-2015) është në rënie, përveq se në vitin 2013 (2456) ka pasur më shumë kërkesa për banim në krahasim me vitin 2014 (2374), numri i kërkesave në vitin 2015 (2031) është më i vogël për 343 kërkesa të banimit.

Gjendja e banimit social në Kosovë është e njëjtë me vendet e rajonit: Shqipëria, Mali i Zi, Serbia dhe disa Kantone të Bosnjës çështjet e kërkesave për banim i kanë zgjidhur nëpërmjet ligjeve për banim social, Sllovenia dhe Maqedonia nëpërmjet ligjeve për banim ndërsa Kroacia nëpërmjet ligjit për përkujdesje sociale.

#### **Konkluzionet dhe rekomandimet:**

- Duhet të bëhet koordinimi dhe bashkëpunimi i të gjitha institucioneve për të harmonizuar nevojat për banim (kërkesat) në raport me numrin e njësive të zbrazëta të banimit;
- Duhet të punohet në krijimin e kushteve për banim të përballueshëm për familjet ose individët të cilët nuk janë në gjendje ekonomike t'i përballojnë ofertat e tregut të lirë të banesave;
- Në të dy nivelet e qeverisjes duhet të krijohen linja buxhetore për të trajtuar qështjen e banimit duke përfshirë edhe kërkesat gjithnjë në rritje për zgjidhjen e problemit të banimit;
- Duhet të krijohet baza e të dhënave për sektorin e banimit, e nevojshme për të përgatitur analiza dhe hulumtime për prezantimin e gjendjes reale të sektorit;
- Të bëhet koordinimi në mes të ministrive të cilat aktualisht merren me zgjidhjen e çështjes së banimit për kategoritë e ndryshme të shoqërisë të bazuara në ligjin në fuqi;
- Të insistohet në raportime të rregullta vjetore nga komunat e Kosovës, për kërkesat dhe zhvillimet në sektorin e banimit.

**Përshkrimi i Indikatorit:** Ky tregues paraqet sasinë e resurseve ujore sipërfaqësore, në rrjedhat lumore dhe në akumulimet artificiale.



#### **Mënyra e matjes së Indikatorit:**

Mënyra dhe metoda më e mirë e analizimit dhe vlerësimit të gjendjes sasiore të resurseve ujore është që të veprohet sipas studimeve dhe modeleve krahasuese, duke u bazuar në gjendjen e rrjedhave lumore dhe të akumulimeve ujore.

Në raportet vjetore të përpunuara nga IHMK / AMMK dhe Departamenti i Ujërave në MMPH jepen vlera krahasuese dhe ato monitoruese për resurset ujore në rang pellgu, dege dhe nëndege lumore si dhe për akumulimet ujore të shprehura me m<sup>3</sup>/s, Ha, km<sup>2</sup>, për njësi kohe (ditë, muaj, vit) etj.

**Harta 1. Shtrirja e rrjetit hidrografik në Kosovë.** Burimi: ASK, Vjetari Statistikor i R. së Kosovës 2016.

**Burimi i informatës/ave:** Informatat për indikatorin si tërësi janë marrë nga MMPH-ja ( Departamenti i Ujërave dhe AMMK / IHMK), nga raportet e monitorimit të rrjetit hidrografik përmes 22 stacioneve hidrometrike, që nga viti 2003 si dhe të dhënat historike nga dhjetarët hidrologjik që janë në IHMK

**Kufizimet për matjen e Indikatorit:** Matja dhe raportimi i të dhënave për këtë tregues është i zbatuar mjaftueshëm, nga se, në Kosovë janë paraparë edhe ndërtime dhe ri-funksionalizime të pikave monitoruese hidrologjike për potencialet e rrjedhave lumore. Ndërsa, kufizimet evidente ekzistojnë në monitorimin e rregullt e të vazhdueshëm të potencialeve ujore në liqenet akumuluese dhe në basene nëntokësore (akuifere).

**Rëndësia e Indikatorit për zhvillimin hapësinor:** Ndërhyrjet e pakontrolluara humane në sipërfaqet ujore, sidomos pas viteve 1999, që kanë ndikuar negativisht në hapësirën tonë me një sërë pasojash prezentë në trupat ujqor. Ndotja e ujit, degradimi i shtretërve lumor, shkarkimi i mbeturinave të ngurta në trupat ujqor, shfrytëzimi pa kriter i ujit për nevoja të bujqësisë dhe industrisë, uzurpimi i pronave të shtetit të lumit, investimet shumë të ulëta në parandalimin e vërshimeve, etj, japin pasqyrë të padëshirueshme të gjendjes aktuale.

Mbrojtja, shfrytëzimi dhe shtrirja hapësinore e resurseve ujore ka rëndësi jetike për botën bimore, shtazore, njeriun dhe veprimtaritë ekonomike. Rëndësia e monitorimit vazhdueshëm është e madhe, si në aspektin e shfrytëzimit resurseve ujore për përfitim ekonomik ashtu edhe në ruajtjen e tyre nga keqpërdorimi dhe rreziku i fatkeqësive, nga se pasojat mund të jenë shumë të mëdha për jetën e njeriut. Shpërndarja natyrore e ujit nuk është e njëjtë në gjithë territorin e Kosovës, andaj planifikimi

i qëndrueshëm për shfrytëzim të këtij resursi jetik për nevojat e popullsisë, industrisë dhe bujqësisë, duhet të jetë i baraspeshuar në aspektin hapësinor dhe mjedisor.

**Gjendja e Indikatorit dhe krahasimi:** Gjendja e Indikatorit dhe krahasimi i vlerave sasiore në rrjedhat sipërfaqësore dhe ato akumuluese sipas të dhënave nga IHMK<sup>67</sup>. është me sa vijon:

Nr	Pellgu	Stacioni	Lumi	Qmin	Qmes	Qmax
1	Drini i Bardhë	Berkovë	Istogu	0.48	3.75	186.00
2		Drelaj	Bistrica e Pejës	0.32	4.20	83.50
3		Grykë	Bistrica e Pejës	0.46	5.95	194.01
4		Klinë	Klina	0.00	1.49	49.20
5		Mirushë	Mirusha	0.02	1.21	23.30
6		Deçan	Bistrica e Deçanit	0.60	4.28	58.00
7		Rakovinë	Drini i Bardhë	0.80	24.64	358.00
8		Gjakovë	Ereniku	0.06	12.33	542.00
9		Piranë	Toplluha	0.04	3.47	55.40
10		Gjonaj	Drini i bardhë	0.10	48.80	1118.01
11		Prizren	Bistrica e Prizerenit	0.03	4.47	424.03
12	Ibri	Drenas	Drenica	0.02	1.52	32.80
13		Lluzhan	Llapi	0.90	5.01	63.80
14		Nedakovc	Sitnica	0.50	13.62	328.00
15		Milloshëvë	Llapi	0.00	4.48	82.70
16		Prelez	Ibri	0.80	13.39	452.80
17		Leposaviq	Ibri	0.50	30.85	667.01
18	Morava e Binçës	Konqul	Morava e Binçës	0.03	9.21	1012.00
19		Domarovc	Kriva Reka	0.02	2.60	30.08
20		Viti	Morava e Binçës	0.05	1.06	18.70
21	Lepe nci	Kaçanik	Nerodime	0.15	4.17	17.50
22		Hani i Elezit	Lepenci	0.10	10.49	184.00

Fig. 2. Tabela me sasitë ujore në stacionet (pikat) matëse. Burimi: MMPH/AMMK/IHMK.

Bazuar në të dhënat hidro-meteorologjike, Pellgjet e Drinit Bardhë (në zonat gjeografike të Istogut, Pejës dhe Gjakovës - ana e djathtë e lumit, përveç zonës së Hasit), të Ibri, Lepencit, Lumëbardhit Prizrenit dhe Plavë janë me sasi të ujit sipërfaqësor prej 10-53 l/s/km<sup>2</sup>. Ndërsa, gjendja më e keqe (e thatë), me sasi prej 2-8 l/s/km<sup>2</sup>, na paraqitet në zonën qendrore dhe lindore të Kosovës, në basenet e Drenicës, Mirushes, Toplluhes, dhe Moravës së Binçës, që konsiderohen si basene me sasi shumë të limituara uji.

N.R.	Emri i lokacionit	Ujërrjedha	Sipërfaqja e pellgut (km <sup>2</sup> )	Rrjedha mesatare (m <sup>3</sup> /s)	Vëllimi në milion m <sup>3</sup>	
					Në shfrytëzim	Gjithsej
1	Gazivoda	Ibër	1060	13.50	350.0	390.0
2	Batllava	Batllavë	226	1.06	25.1	30.0
3	Badovci	Gračankë	103	1.05	20.0	26.4
4	Radoniqi	L. Deçanit	130	0.16	102.0	113.0
5	Perlepnica	Perlepticë	71	0.50	3.6	15.6
6	Livoq	Livoq	53.6	-	-	-
<b>Gjithsej</b>			<b>1643.4</b>	<b>16.3</b>	<b>500.7</b>	<b>574.0</b>

Fig. 3. Tabela me kapacitetet e liqeneve akumuluese ekzistuese nëpër rrjedhat lumore. Burimi: MMPH/AMMK dhe DU.

Liqenet artificiale formohen me qëllim të prodhimit të energjisë elektrike (hidrocentrale), furnizimit të qyteteve me ujë, furnizimit të kapaciteteve industriale, për ujitjen e sipërfaqeve bujqësore dhe për mbrojtjen e tyre nga vërshimet, për rekreacion, etj. Liqenet artificiale ekzistuese në Kosovë janë: Liqeni i Gazivodës (në kufi me Serbinë), Batllaves, Badovcit, Radoniqit, Livoqit dhe Perlepnices.

<sup>67</sup> MMPH-AKMM, Raport: Gjendja e Ujrave në Kosovë, 2010 Prishtinë

Deri më tani, në akumulacione ujore (Gazivodë, Radoniq, Batllavë, Badovc dhe Përlepnice), shfrytëzohen 1.518 km<sup>2</sup> ose 13.23 % të sipërfaqeve të pellgjeve lumore të Kosovës, me vëllim të dobishëm ujqor prej 574 milion m<sup>3</sup>/vit. Kurse, nga analizat e më hershme, me qëllim të zbutjes së mungesave për ujë në amvisni, industri dhe bujqësi, janë paraparë edhe ndërtime të akumulacioneve të reja ujore në territorin e Kosovës, si në Master Planin e vitit 1981. Me ndërtimin e kapaciteteve tjera akumuluese planifikohet që të shfrytëzohen 3.440 km<sup>2</sup> pellgje lumore në 20 pika akumuluese ose 31.5 % të sipërfaqes së përgjithshme të pellgjeve lumore të Kosovës. Vëllimi i dobishëm ujqorë do të jetë 724.5 milion m<sup>3</sup>/vit (shih fig. 3), do të mbulohe në tërësi nevojat dhe kërkesat e popullsisë për ujë.

N.R.	Akumulacioni	Rrjedha	Sipërfaqja e pellgut (km <sup>2</sup> )	Rrjedha mesat. (m <sup>3</sup> /s)	Rrjedha vjet. (mil/m <sup>3</sup> /vit)	Vëllimi dobishëm (mil/m <sup>3</sup> )
1	Drelaj	L. Pejës	173	4.65	146.60	84.5
2	Kërstovci	Binç	118	3.20	100.96	40.0
3	Movë	Klinë	239	1.20	37.80	34.0
4	Ponoshec	Labenicë	26	2.25	70.78	38.0
5	Ripaj	Travë	59	2.38	74.88	36.0
6	Reqan	L. Prizrenit	155	4.55	143.32	68.0
7	Dragaçinë	Dragaçinë	36	0.25	7.94	6.8
8	Kremenatë	Kremenatë	56	-	15.90	7.9
9	Binaq	Lumi madh	72	0.63	19.46	1.0
10	Konçul	Moravë	1.632	6.86	216.03	120
11	Firajë	Lepenc	229	5.34	168.30	16.5
12	Shtime	Topilë	102	0.66	20.91	113.0
13	Ceceli	Lumëkuqi	47	0.41	12.92	21.0
14	Makovc	Prishtevkë	26	0.19	6.01	10.0
15	Majac	Kaçandoll	88	0.68	21.35	30.0
16	Vaganicë	Lushtë	46	0.23	7.24	8.0
17	Miroq	Tersten	31	0.20	6.30	6.0
18	Dobroshevc	Drenicë	35	1.38	43.40	23.2
19	Pollat	Llap	111	1.23	36.68	37.5
20	Bistricë	Bistricë	159	1.40	44.26	26.0
<b>Gjithsej</b>			<b>3.440</b>	<b>37.72</b>	<b>1.201.04</b>	<b>724.4</b>

Fig. 4. Tabela me kapacitetet e liqeneve akumuluese të parapara nëpër rrjedhat lumore. Burimi: MMPH/AMMK dhe DU.

Bazuar në krahasimin e të dhënave, nga Raporti i AKMM-së “Gjendja e Ujërave në Kosovë” me të dhënat e burimeve tjera në dispozicion (si nga SGDJ R. Pllana fig. 5 dhe ASK-ja fig. 6) kemi dallime dhe ndryshime të mëdha si në sasi ujqor, në sipërfaqe pellgu dhe në numrin e popullsisë së përgjithshme të Republikës së Kosovës nga të cilat duhet të nxirret edhe sasia e ujqit për kokë banori.

Pellgu	Sipërfaqe (km <sup>2</sup> )	Prurje (m <sup>3</sup> /s)	Prurje vjetore (mil.m <sup>3</sup> )	Banorë në vitin 1971	Sasia e ujqit (m <sup>3</sup> /b)	Banorë në vitin 1981	Sasia e ujqit (m <sup>3</sup> /b)	Banorë në v. 2000 / parashikim	Sasia e ujqit (m <sup>3</sup> /b)
Drini Bardhë	4289	62.53	1.970	494280	3986	746647	2638	1039388	1895
Pllava	360	7.30	230	26850	8566	41985	5478	59451	3869
Ibri	4009	24.49	771	478076	1613	745220	1035	1031193	748
Morava Binçes	1564	10.47	330	169998	1941	255553	1291	356057	927
Lepenci	685	9.74	307	74489	4121	109962	2792	153819	1996
<b>Gjithsej</b>	<b>10907</b>	<b>111.54</b>	<b>3.608</b>	<b>1243693</b>	<b>2901</b>	<b>1899367</b>	<b>1899</b>	<b>2639908</b>	<b>1397</b>

Fig. 5. Tabela me analizë të dhënash për vitet 1971, 1981 dhe parashikimit për 2000. Burimi: SGDJ, Dr. Ruzhdi Pllana 1984<sup>68</sup>.

<sup>68</sup> Savez Geografskih Društva Jugoslavie, Dr Ruzhdi Pllana: Voda kao Faktor Privrednog Razvoja SAP Kosova, 1984 Prishtinë

VITI	Nr. Banorëve	Koment	Sasia e ujit në m <sup>3</sup> sipas IHMK/2010	Sasia e ujit në m <sup>3</sup> /k.banori/vit
1948	727820	Regjistrim	<b>3.716.070.696 m<sup>3</sup>/Vit</b>	<b>5105.7</b>
1961	963988	Regjistrim		<b>3854.6</b>
1971	1243693	Regjistrimi		<b>2988.1</b>
1981	1584440	Regjistrimi		<b>2345.5</b>
1991	1956196	Vlerësim		<b>1899.7</b>
2002	1985000	Vlerësim I ASK		<b>1872.1</b>
2006	2100000	Vlerësim I ASK		<b>1769.5</b>
2011	1780021	Regjistrimi nga ASK		<b>2087.5</b>
2016	1854297	Parashikimi nga ASK		<b>2004.1</b>
2026	2014081	Parashikimi nga ASK		<b>1845.2</b>

**Fig. 6. Tabela me numër të popullsisë gjatë viteve 1948-2026 dhe sasinë e ujit në m<sup>3</sup>/b.** Burimi: ASK burimet statistikore 1948-2026.

Kosova, hyn në grupin e shteteve me resurse ujore sipërfaqësore të limituara, me mesataren prej 1000 - 3000 m<sup>3</sup> ujë për kokë banori në vit, ku bëjnë pjesë edhe disa nga shtetet e BE-së, si Bullgaria, Greqia, Çekia, Spanja, Portugalia, Rumania, etj.

### **Konkluzione dhe rekomandime:**

Kosova konsiderohet ndër shtetet me sasi uji të limituara.

Popullsia për nevojat e veta shfrytëzon burime të ndryshme uji: ujësjellësi, pusët, burime ujore, lumenj, liqene, etj.

Sipas analizave të mësipërme në Kosovë shfrytëzohen 477,804 m<sup>3</sup>/ditë.

Kjo sasi e shfrytëzuar e ujit për kok banori është 256 l/ditë që konsiderohet më e ulta në rajon, ndërsa në bujqësi 1-35.4 m<sup>3</sup>/s varësisht nga nevojat, ku ujiten vetëm rreth 66,700 ha.


Shpërndarja jo e njëjtë e sasisë së ujërave, në rrjedhat lumore dhe gjatë reshjeve atmosferike, tregon për domosdoshmërinë e planifikimit dhe ndërtimit të kapaciteteve të reja për shfrytëzim të këtij resursi jetik.

Prandaj, rekomandohet që:

- Të bëhen matje të sakta të sipërfaqeve të pellgut për shkak të dallimeve në mes burimeve të ndryshme të informatave;
- Të ngritet niveli i monitorimit të ujerave në Kosovë;
- Të eliminohen të gjitha problemet e shfaqura teknike gjatë matjeve rreth aparaturave, pajisjeve monitoruese dhe mirëmbajtjes së tyre;
- Të krijohet baza e të dhënave në nivel pellgësh lumore;
- Të monitorohen me rregull dhe vazhdimisht liqenet akumuluese për shkak të vlerave strategjike;
- Të rishikohet Master-plani i Hidro-ekonomisë së Kosovës lidhur me ndërtimin e kapaciteteve të reja akumuluese;
- Të shtohen përpjekjet për sigurimin e kapaciteteve të mjaftueshme në të gjitha zonat ku problem i ujit është i theksuar.

**Përshkrimi i Indikatorit:** Ky indikator paraqet kualitetin e ujërave sipërfaqësor të Kosovës të ndarë sipas klasifikimit I, II, III dhe IV të shkallës së ndotjes, të bazuar në pjesëmarrje të parametrave ndotës dhe të vlerës ndikuese.

**Mënyra e matjes së Indikatorit:** Kualiteti i ujërave sipërfaqësore në Kosovë bazohet në metodat ndërkombëtare të llogaritjes së prezencës dhe pjesëmarrjes së këtyre parametrave: SHBO<sub>5</sub>, PE, pH, NO<sub>2</sub>, NH<sub>4</sub><sup>+</sup>, SO<sub>4</sub>, PO<sub>4</sub>, Fosfori total, FP si dhe të metaleve të rënda : Pb<sup>2+</sup>, Cd<sup>2+</sup>, Cu<sup>2+</sup>, Cr<sup>6+</sup>, Ni<sup>2+</sup>, Fe<sup>2+</sup>,



Zn<sup>2+</sup>, Mn<sup>2+</sup>, Cr<sup>3+</sup>. Në Kosovë këta parametra kanë filluar të monitorohen dhe maten prej vitit 2008, nga Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës (IHMK) dhe në bazë të Vlerës së Lejuar Mesatare (VLM) të tyre përcaktohen edhe klasat përkatëse të kualitetit të ujërave sipërfaqësor.

**Burimi i informatës/ave:** Në Kosovë janë dy burime të besueshme të informatave: Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës- Instituti Hidro-Meteorologjik (IHM) dhe Instituti i Shëndetit Publik (ISHP), që bëjnë analiza laboratorike për prezencën e parametrave të përmendur.

**Fig.1. Harta me shkallët e ndotjes së lumenjve.** Burimi: MMPH/IPH

**Kufizimet për matjen e Indikatorit:** Informatat për Indikatorin bazohen në vlerat e dala nga analizat e mostrave që janë marrë drejtpërdrejtë në rrjedhat lumore. Mirëpo, stacionet hidrometeorologjike, të ngritura në rrjedhat lumore, si dhe pikat ku merren mostrat e ujit nuk

janë të mjaftueshme. Në aspektin hapësinor këto vend matje duhen të zhvillohen edhe më tej dhe se duhet të monitorohet çdo rrjedhë lumore nga burimi deri në grykëderdhje. Pikat monitoruese, duhet të jenë aktive, sidomos në monitorimin e vendbanimeve urbane ku shkarkohen ujërat e zeza dhe industriale.

**Rëndësia e Indikatorit për zhvillimin hapësinor:** Në aspektin e menaxhimit të ujërave të ndotura, Kosovën e presin obligime të mëdha, sidomos në relacion me përmbushjen e direktivave të BE (Direktiva 91/271/EEC mbi Trajtimin e Ujërave të Ndotura Urbane) si dhe të përmbushjes së detyrimeve të tjera ndërkombëtare. Prandaj, në aspektin e zhvillimeve hapësinore, është shumë me rëndësi të identifikohen pikat më të rrezikuara nga ndotja në mënyrë që shkaktarët të trajtohen para derdhjes tyre në ujërat sipërfaqësor, sidomos në rrjedhat lumore që dalin jashtë vendit.

**Gjendja e Indikatorit dhe krahasimi:** Gjendja aktuale në Kosovë është e njëjtë sikur edhe në vendet e rajonit. Në Kosovë praktikisht nuk ekzistojnë impiante për trajtimin e ujërave të zeza dhe industriale, me përjashtim të disa gropa septike për zonat e kufizuara shtëpiake apo laguna natyrore të cilat janë formuar në pikat shkarkuese të sistemeve grumbulluese të ujërave të ndotura. Në disa kampe të



Forcave të Armatosura të KFOR-it dhe në Kompleksin e QKUK-së në Prishtinë ka impiante për trajtim biologjik të ndotjes.

Shkarkimet e ujërave të ndotura urbane, përbëjnë burimin kryesorë të ndotjes së ujërave sipërfaqësore, sepse ato përmbajnë shumë lëndë që shpenzojnë oksigjenin e tretur, kompozime të tretshme të fosforit dhe azotit (eutrofikimin), baktere dhe viruse patogjene, si dhe lëndë tjera që ndikojnë në cilësinë e ujërave. Ekziston vetëm impianti për trajtimin e ujërave të zeza në Skenderaj i cili nuk është në funksion.

Shkarkimet e ujërave të ndotura industriale, janë një ndër ndotësit kryesorë të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore. Ndër ndotësit më të mëdhenj janë: KEK-u, Ferronikel-i, Sharrcem-i, Minierat e Trepçës, të Kishnicës, Artanës dhe minierat tjera.

Aktualisht, shtrirja e rrjetit të stacioneve monitoruese, për cilësitë fiziko - kimike të ujit, është me sa vijon: në pellgun e Drinit të Bardhë - 24 stacione, në pellgun e Ibrit - 17 stacione, në pellgun e Moravës së Binçës - 6 stacione dhe në Pellgun e Lepencit - 6 stacione.

**Fig.1. Tabela e gjendjes së ujit sipas parametrave ndotës në pellgjet lumore.** Burimi: IHMK / AMMK / MMPH.

Pellgjet	O <sub>2</sub> I tretur	SHBO5	PE	pH	NO <sub>2</sub>	NH <sub>4</sub>	SO <sub>4</sub>	PO <sub>4</sub>	Fosfor	FP	Metale të rënda në VLM
P. D. Bardhë	+	+	+	+	-	0-	+	-	+-	+0	Cr
P.Iber Sitnicë	+-	0	0	0 -	0-	0-	0-	0	+-	+	Cr, Cd, Zn
Morava e Binçës	0+	0	0	0+	0	0	0-	0	0	0+	Cr
Lepenci	+ 0	0	0	0	0	0	0-	0	0	0	Cr

Sqarim: (+) në vlera të lejuara, (0) Vlera e lejuar mesatare, (-) tejkalimi i vlerave të lejuara

Situata e tanishme e ndotjes së trupave uhor është rënduar edhe më shumë nga hedhja e mbetjeve të amvisërisë prej vendbanimeve të afërta dhe nga dukuria tjetër negative e shfrytëzimit të inerteve në shtretërit e lumenjve (më shumë Drini i Bardh, Moravë e Birçës e më pak në Pellgun e Ibrit dhe Lepencit.

### **Konkluzione dhe rekomandime:**

- Duke pasur parasysh gjendjen aktuale të të dhënave rekomandohet të shtohet numri i stacioneve monitoruese dhe numri i pikave për marrjen e mostrave;
- Sipas të dhënave Lumi Sitnica është lumi më i ndoturi nga të gjithë lumenjtë në Kosovë, prandaj rekomandohet të bëhet trajtimi dhe menagjimi i duhur i pellgut të lumit;
- Në të gjithë territorin e Kosovës duke i përfshirë të gjitha komunat, duhet të shtohen përpjekjet për trajtimin e ujërave të ndotura para shkarkimit tyre në ujërat sipërfaqësor;
- Të krijohen mundësitë financiare për ndërtimin e impianteve për trajtim të ujërave industriale dhe urbane;
- Të ndërpritet dukuria e nxjerrjes së pakotrolluar të inerteve, që ka ndikim direkt në degradimin dhe shkatërrimin e shtretërve të lumenjve.

**Indikatori: DEGRADIMI I SHTRËTËRVE TË LUMENJVE DHE RREZIKU NGA VËRSHIMET****Synimi:** MBROJTJA E TRUPAVE UJOR NGA DEGRADIMI DHE NGA VËRSHIMET PARANDALIMI NGA DEGRADIMI DHE VËRSHIMET E UJËRAVE**Objektivi:** SIPËRFAQËSOR

**Përshkrimi i Indikatorit:** Ky indikator paraqet sipërfaqet e degraduara për brenda trupave ujore dhe për rreth tyre e që janë nën rrezik permanent prej vërshimeve. Mbrojtja e shtretërve të lumenjve nga degradimi është jetike për botën bimore, shtazore dhe vet faktorin njeri si dhe mbron cilësinë dhe sasinë e tokave bujqësore të kualitetit të lartë, infrastrukturën, vendbanimet dhe kualitetin e ujit.



**Mënyra e matjes së Indikatorit:** Mënyra dhe metoda më e mirë e analizës dhe vlerësimit të gjendjes mjedisore të lumenjve është veprimi i bazuar në gjendjen ekzistuese në terren dhe në studimet e modeleve krahasuese sipas imazheve satelitore të orto-fotove 2009 / 2012. Raportet vjetore, të përpunuara nga Departamenti i Ujërave në MMPH, japin vlerat krahasuese të ha/vit. Ky raport i vlerave është në rritje sidomos për shkak të degradimit të sipërfaqeve ujore nga operatorët legal dhe ilegal të zhavorrit. Zbatimi i vendimit të Qeverisë së R. Kosovës nr. 02/46, më datë 2 nëntor 2011, i cili ndalon shfrytëzimin dhe eksploatimin e materialeve inerte nga shtretërit, brigjet dhe hapësirat përreth lumenjve në të gjithë territorin e vendit.

**Fig. 1.** Sipërfaqet e degraduara në Lumin Drini Bardhë (analizat në orto-fotot e v. 2009 / 12). Burimi: MMPH/DU.



**Burimi i informatës/ave:** Burimi i informatave për këtë Indikatorin është MMPH-ja me të dhënat që merren nga Departamenti i Ujërave dhe IHMK/AMMK.

**Kufizimet për matjen e Indikatorit:** Ky tregues është vështirë të implementohet nga se në Kosovë janë paraparë ndërtimi i argjinaturave dhe rregullimi i shtretërve të lumenjve në gjatësi 491km që sipas vlerësimeve janë konstatuar se sjellin përmbytje. Deri me tani janë rregulluar vetëm 140 km.

Shumë toka bujqësore, infrastrukturë fizike e vendbanime janë të ekspozuar rreziqeve nga përmbytja si pasojë e mos mirëmbajtjes së shtretërve të lumenjve, nxjerrja ilegale e zhavorreve, hedhja e mbetjeve të amvisërisë dhe të ngurta pranë shtretërve të lumenjve, bimëve të vet rritura etj, e që ndikojnë drejtpërsëdrejti në hapësirën përgjatë dhe për rreth shtratit të lumit.

**Rëndësia e Indikatorit për zhvillimin hapësinor:** Eksploatimi i inerteve në shtretërit e lumenjve është dukuri negative që është e shprehur sidomos pas vitit 1999 e vazhdon edhe sotë edhe për kundër ndalesave të ndryshme që janë të përcaktuara me ligj. Puna ilegale e këtyre aktiviteteve në shtrirë të lumenjve është në rritje e sipër nga operator ilegal. Pasojat janë të mëdha sidomos në humbjen e sipërfaqeve bujqësore të kualitetit të lartë, shkatërrim i infrastrukturës fizike, vërshimeve në tokat bujqësore dhe vendbanime, prishja e shtretërve të lumenjve etj. Lumenjtë që janë degraduar nga veprimet ilegale - nxjerrja e inerteve janë me rrezik për vërshime dhe rezikojnë mjedisin ekologjik.

**Gjendja e Indikatorit dhe krahasimi:** Gjendja nuk është e nivelit të mirë dhe ende nuk ka përmirësime as për parandalimin e degradimeve e as në parandalimin e vërshimeve. Degradimet sipas llogaritjeve të bëra janë rreth 100 ha/vit. Mirëmbajtja e argjinaturave ekzistuese dhe ndërtimi i të rejave janë vetëm në fazën e para-fizibilitetit, kurse urbanizimi i shtretërve lumor as që ka filluar, etj, janë disa nga mangësitë apo edhe mos realizim i projekteve të parapara me Plan Hapësinor të Kosovës.

Fig. 3. Tabela për gjendjen në shtretërit e lumenjve. Burimi: MMPH.

Gjendja e shtretërve të lumenjëve në Kosovë		
Drini i Bardhë	Burimi me bashkë rrjedhën e lumit Istog Bashkërrjedhja nga Istogu në drejtim të Rakovinës Rakovinë deri në Gjonaj	I pa dëmtuar I dëmtuar I dëmtuar
Ereniku	Nga burimi deri në Junik Nga Juniku deri në Shishman Nga Shishmani deri në Gjakovë Nga Gjakova deri në grykëderdhje të Drinit Bardhë	I pa dëmtuar I dëmtuar Me dëmtime evidente Dëmtime evidente
Lumëbardhi i Pejës	Nga burimi deri në Pejë Nga Peja deri në grykëderdhje të Drinit të bardhë	I pa dëmtuar I dëmtuar dhe vazhdon dëmi
Lumëbardhi i Deçanit	Të gjitha degët	I pa dëmtuar
Istogu	Të gjitha degët	I pa dëmtuar
Klina	Të gjitha degët	I pa dëmtuar
Lumëbardhi i Prizrenit	Të gjitha degët	I pa dëmtuar
Ibër	Drejtim i ujë rrjedhës Kushtovë - Mitrovicë dhe vazhdim	Dëmtime evidente
Drenicë, Llap, Sitnicë	Të gjitha degët	I pa dëmtuar
Morava e Binçes	Doberçan, Domaroc, Krivareka në hyrje Kamenicës në Hajnovc, dega e lumit Desivojc në Lajçiç	Me dëmtime evidente dhe të vazhdueshme
L. Lepenci	Nga burimi deri në Doganaj Nga Doganaj deri në Kaçanik Nga Kaçaniku deri në kufi me Maqedoninë	I pa dëmtuar Dëmtime të lehta Dëmtime të lehta

Pellgu lumor	2009 ha të degraduar	2012 ha të degraduar
Drini i bardhë	970.8	1165.8
Ibër	2.6	4.5
Morava e Binçes	31.5	39.1
Lepenci	0	0
Gjithsejtë	1004.9	1209.4

Fig.4. Tabela për krahasimin e gjendjes së shtretërve të lumenjve. Burimi: MMPH.


**Konkluzione dhe rekomandime:** Faktorët natyror dhe mungesa e kujdesit nga institucionet përkatëse si ne nivelin qendror dhe atë lokal janë faktorët kryesor që ndikojnë në degradim të shtretërve lumor.

Andaj, rekomandohet:

- Ndërprerja e menjëhershme e nxjerrjes ilegale të zhavorrit ne shtretërit e lumenjve;
- Riparimi i dëmeve në argjinaturat e dëmtuara;
- Ndërtimi i argjinaturave të parapara me studime të Hidro-ekonomies së Kosovës;
- Pastrimi nga mbetjet e krijuara nga faktori njeri;
- Pastrimi i shtretërve të lumenjve nga bimët e vetë rritura që pengojnë dhe devijojnë rrjedhën e ujit;
- Zgjerimi i shtretërve te lumenjve;
- Lirimi i tokave i shtretërve të lumenjve nga uzurpimet.

**Përshkrimi i Indikatorit:** Ky indikator paraqet shkallën e rrezikshmërisë nga vërshimet në Kosovë, përkatësisht tregon zonat potenciale të vërshimit nga rrejtja e lumenjve në Kosovë.

Vërshimet, që zakonisht trajtohen si fatkeqësi natyrore, mund të jenë në shkallë të ndryshme të rrezikshmërisë dhe paraqesin gjendjen kur një sipërfaqe tokësore, që në kushte normale është e thatë, papritmas përfshihet nga uji duke u përmytur.




Kur një zonë e banuar përfshihet nga vërshimet, uji me vete mund të përmbajë objekte siç janë shtëpi, ura, automjete, gjësende shtëpiake dhe njerëz, si dhe mund të zhduk ferma, pemë dhe shumë mjete të tjera të rënda duke shkaktuar dëme shumë të mëdha në jetë të njerëzve, bagëti, të korrave dhe në veçanti ekonomisë familjare dhe shtetërore.

**Fig. 1. Harta e rrjetit hidrografik në Kosovë.**

Burimi: MMPH.

**Mënyra e matjes së Indikatorit:** Ky indikator është matur duke u bazuar në modelin hapësinor të rrezikshmërisë nga vërshimet (RrV) në rrjedhat ujore natyrore sipërfaqësore. Rrezikshmëria nga vërshimet, përkatësisht identifikimi i sipërfaqeve me shkallë të lartë të vërshimit nga lumenjtë është matur duke u bazuar në disa parametra gjeografik, siç janë:

Nr.	Faktorët	Zone e identifikuar si RrV
1	Lumenjtë	Po
2	Pjerrtësia	0-1 gradë
3	Klasat e CORINE-së: 231, 243, 311, 321, 324	Poligonet duhet të jenë në prerje tërthore me lumenjtë



**Fig. 2. Kushtet e një terreni vërshues.** Burimi: <https://www.wired.com/2011/05/flooding-creates-floodplains/>

Në përgjithësi, vërshimet në Kosovë rezultojnë për shkaqe të kombinimit të sasisë së madhe të reshjeve që bien për një kohë shumë të shkurtër në hapësirën e një pellgu lumorë, shkrirjes së menjëhershme të sasisë së madhe të borës gjatë sezonës së dimrit dhe pranverës, kushteve të përshtatshme topografike dhe pamundësisë së shtretërve të lumenjve për të përmbajtur apo qarkulluar sasinë e pranuar të ujit, natyrisht duke u ndihmuar edhe nga mosmirëmbajtja e shtretërve të lumenjve dhe hedhja ilegale e mbeturinave solide-inerte. Gjithsesi, një rol tjetër me rëndësi luan edhe gjendja e tokës, si për nga kushtet e shfrytëzimit ashtu edhe nga përbërja e sajë.

Vërshimet mund të kenë pasoja shkatërruese dhe mund të shkaktojnë pasoja në ekonomi, mjedis dhe popullsi<sup>69</sup>:

- Efektet në ekonomi të vërshimeve: gjatë kohës së vërshimeve shkatërrohen shumë rrugë, ura, ferma, shtëpi, instalime publike dhe automjete, duke lënë shumë njerëz pa shtëpi, punëtor pa punë dhe ndërmarrje pa punëtor. Përveç kësaj, qeveria detyrohet që në terren të angazhoj policinë, zjarrfikësit dhe grupet e tjera të emergjencave për të ndihmuar banorët e afektuar. Të gjitha këto angazhime kanë një kosto shumë të madhe për banorët dhe qeverinë duke ju kushtuar për vite të tëra banorëve dhe bizneseve që të kthejnë jetën e tyre në normalitet.
- Gjithashtu, edhe mjedisi vuan nga pasojat e vërshimeve për shkak që vërshimet me vete marrin shumë substanca kimike dhe substanca tjera të rrezikshme, duke kontaminuar trupat e ndryshëm ujorë. Përveç kësaj, vërshimet shkaktojnë edhe mbytjen e kafshëve të ndryshme dhe joshin insekte të reja në zonat e afektuara, si dhe mund të ndryshojnë edhe ekuilibrin natyror të ekosistemit.
- Shumë njerëz dhe kafshë mbyten nga pasojat e vërshimeve, sidomos nga vërshimet e papritura dhe të shpejta. Vërshimet shkaktojnë edhe lëndimin e shumë njerëzve, duke lënë shumë të tjerë pa strehë, ndërkohë që shkaktojnë edhe ndërprerjen e ujit të pijes dhe rrymës. Përveç kësaj, vërshimet sjellin edhe shumë sëmundje dhe infeksione, duke përfshirë edhe ethet ushtarake, murtajën pneumonike, dermatopatike dhe dizenterinë. Ndonjëherë insektet dhe gjarpërinjtë tërhiqen në zonat e vërshuara duke bërë shumë dëme.

Ndërkohë që ana e vetme pozitive e vërshimeve, sidomos tek vërshimet e ngadalshme sezonale është që në zonat e përfshirë nga vërshimet depozitohen shumë nitrare dhe plehra tjera që janë të përshtatshme për kultivimin e disa kulturave bujqësore.

**Burimi i informatës/ave:** MMPH.

**Kufizimet për matjen e Indiktorit:** janë direkt të ndërlidhura me saktësinë e informatave dhe numrin kufizues të faktorëve kombinues në model.

**Rëndësia e Indiktorit për zhvillim hapësinor:** Ky tregues, fillimisht mundëson identifikimin e zonave që afektohen nga rrezikshmëria e vërshimeve, numri i njësive të banimit dhe të gjitha strukturave të tjera ndërtimore në vendbanimet, fondi i tokës bujqësore, si dhe përmbajtje të tjera mjedisore që i nënshtrohen këtij rreziku.

**Gjendja e Indiktorit dhe krahasimi:** Në Kosovë vërshimet ndodhin kryesisht përgjatë rrjedhave ujore dhe shkaktohen nga pesë lloje të faktorëve:

- a) Intensiteti i madh i reshjeve që bien për një kohë të shkurtë në një zonë të caktuar dhe mos aftësia e shtretërve të lumenjve për qarkullimin e sasisë së pranuar të ujit;
- b) Shkrirja e menjëhershme e sasisë së madhe të borës, kryesisht në fund të sezonit dimërorë që për pasojë ka dërgimin e sasisë së madhe të ujit drejt rrjedhave ujore dhe mos aftësia e shtretërve të lumenjve për transportimin e sasisë së pranuar të ujit;

<sup>69</sup> <http://eschooltoday.com/natural-disasters/floods/what-is-a-flood.html>

- c) Mosmirëmbajtja e rrjedhave ujore, përkatësisht mos menaxhimi i mirëfilltë i shtretërve të lumenjve për shkak të bllokimit natyror dhe ndërhyrjeve të pa përgjegjshme njerëzore;



Fig. 3. Harta e zonave me rrezikshmëri nga vërshimet në Kosovë. Burimi: MMPH

- d) Ndërtimeve pa leje në zonat e rrezikuara nga vërshimet. Sipas MMPH-së, në Kosovë numri i ndërtimeve pa leje është >300,000.
- e) Inxhinierisë së dobët të projektimit dhe ndërtimit të infrastrukturës teknike si në zonat urbane ashtu edhe në linjat e infrastrukturën teknike, me theks të veçantë në rrugë. Për shkak të këtij faktori, përkatësisht për shkak të planifikimit jo të mirë të sistemit të drenazhimit urban ndodh shpesh që zona të caktuara urbane të vërshohen dhe kështu të kemi edhe **vërshime urbane**, apo edhe për shkak të projektimit jo të mirë të shtretërve të rrugëve, përkatësisht drenazhës së rrjedhave ujore natyrore që përshkojnë shtratin e rrugës, segmente të caktuara të rrugëve bllokohen nga vërshimet për kohë të caktuar (p.sh. rruga N2, segmenti Llapnasellë - QMI). Ky faktor i vërshimeve është ngushtë i lidhur me planifikimin dhe menaxhimin hapësinor-urban, si dhe më tepër me faktorë tjerë të inxhinierisë së infrastrukturës teknike, si në fazën e projektimit ashtu edhe në fazën e implementimit.

Për shkak të kufizimeve në të dhënat e disponueshme nuk është e mundur trajtimi apo vlerësimi i detajuar i rrezikshmërisë së vërshimeve sipas faktorëve të listuar më lartë, por mund të përfundohet që faktorët e listuar nën pikat a), b), c) dhe d) trajtohen në mënyrë të përgjithësuar në kuadër të këtij indikator.

Sipas faktorëve të elaboruar në sesionin e mënyrës së matjes së indikatorit, në Kosovë kemi gjithësejt 155 zona të rrezikuara nga vërshimet me sipërfaqe 7,112 ha, të cilat gjeografikisht janë të shpërndara në fushëgropën e Kosovës, të Dukagjinit, Llapit dhe të Drenicës. Ndërkohë që komuna më të rrezikuara nga vërshimet janë: Podujeva, Vushtrria, Lipjani, Ferizaj, Obiliqi, Vitia, Gjlani, Shtime, Drenasi, Klina, Gjakova, Peja dhe Mitrovica.

Sipas figurës nr. 3, lumenjtë që më së shumti shkaktojnë vërshime në Kosovë janë: Stitnica, Llapi, Morava e Binçës, Nerodimja, Drini i Bardhë, Lumëbardhi i Pejës, Ereniku, Mirusha, Toplluga, Shtimjanka, Drenica dhe Ibri.

Në bazë të vlerësimeve që i përmban Master Plani për Ujëra i 1983-së për përmbytjet me rastisje një here në 100-vite, mund të jenë me ndikime të konsiderueshme<sup>70</sup>:

- Pellgu i Drinit të Bardhë- 50%
- Pellgu i Lumit Ibër- 24%
- Pellgu i Lepence- 20%
- Pellgu i Moravës së Binçës- 6%.

Ky vlerësim tregon se gjatësia e lumenjve të Kosovës të rrezikuar nga përmbytjet sillet rreth 491 km, ndërsa vetëm rreth 140 km janë të rregulluara (28%).



Fig. 4. Dalja e lumit Gadime nga shtrati i tij në fshatin Gadime, lagjja e ashkalinjëve, 19 prill 2014. Burimi: IPH



Fig. 5. Vërshimet nga lumi Sitinca në në qytetin e Lipjanit, 19-20 prill 2014. Burimi: IPH

### **Konkluzione dhe rekomandime:**

Identifikimi i zonave me rrezikshmëri nga vërshimet mundësonë fillimisht të kuptojmë peshën e këtij problemi të shtrirë në hapësirë, dhe pastaj, me ndihmën e dokumenteve të planifikimit hapësinorë të jepen zgjidhjet adekuate për reduktimin apo edhe eliminimin e kësaj problematike. Lidhur me informatat, shqetësimet janë kryesisht tek saktësia, kompleksiteti dhe azhurnimi i informacioneve gjeohapësinore të përdorura për prodhimin e informatës së rrezikshmërisë së zonave nga vërshimet. Të dhënat që do duhej të azhurnohen dhe të përdorën për përgatitjen më të saktë të kësaj informate janë:

- MDST me saktësi <10m/px;
- CLC Corine <1ha njësi trajtimi;

<sup>70</sup> Raporti për Gjendjen e Ujërave në Republikën e Kosovës 2015, faqe 47, AMMK – Prishtinë.



- Shfrytëzim i Tokës mbi baza sezonale dhe rrotacioneve;
- Rrjet preciz i rrjedhjeve ujore të azhurnuara;
- Sasia, intervali dhe shpërndarja e reshjeve në baza të mesatares mujore shumë vjeçare;
- Rrymat ajrore, me theks të veçantë shpejtësia dhe koha;
- Temperaturat mesatare shumë vjeçare të shpërndara sipas muajve;
- Përbërja pedologjike.


Pavarësisht hendikepit në informacionet e procesuara në modelin hapësinor të gjenerimit të informacioneve për zonat me rrezikshmëri nga vërshimet, kjo informatë është shumë e domosdoshme për fillimin e trajtimit të kësaj problematike në dokumentet e planifikimit hapësinorë nacional dhe lokal, nga ku fillon edhe dhënja e zgjidhjeve preliminare për këtë problem.

Ndërkohë që, vërshimet në zonat urbane apo *vërshimet urbane* janë më specifike dhe nuk ndërlidhën tërësisht me hendikepet për të dhënat e trajtuara më sipër. Prandaj, për keto raste, rekomadohet zhvillimi i një indikatori të veçantë që do të na jap informata më të sakta për gjendjen reale dhe rekomandimet për ndryshim.

**Përshkrimi i Indikatorit:** Ky indikator paraqet cilësinë e ajrit dhe monitorimin e saj që rrjedhë si obligim ligjor (Ligji për mbrojtjen e mjedisit neni 50, Ligji për mbrojtje të ajrit nga ndotja neni 23 dhe Ligji për veprimtarin hidrometeorologjike neni 5). Monitorimi i cilësisë së ajrit duhet të sigurojë të dhëna për nivelin e ndotjes së ajrit, ndryshimet klimatike, ndikimet në shëndetin e popullsisë dhe ndikimet materiale në ekosistem dhe vegjetacion.

**Mënyra e matjes së indikatorit:** Gjendja momentale e monitorimit të cilësisë së ajrit nuk i plotëson kërkesat e nevojshme për monitorim. Të dhënat për emisione i raportojnë vetëm 4 operatorë: KEK, Fabrika e çimentos “Sharr Cem”, New Co Feronikeli dhe Ngrohtorja e qytetit “Termokos” në Prishtinë. Kurse dy institucione, IHMK dhe IKSHP, bëjnë monitorim dhe përpunimin e pavarur të informative.

#### LOKACIONET NË TË CILAT MONITOROHET CILËSIA E AJRIT



**Burimet e informatave:** IHMK, IKSHP, KEK, SHARCEM, FERONIKEL

**Kufizimet për matjen e indikatorit:** Informatat për Indikatorin bazohen në matjet e stacioneve të vendosura në pikat e lartpërmendura. Nuk ka stacione monitoruese të mjaftueshme për të paraqitur gjendjen reale në tërë territorin e Kosovës. Aktualisht kontribuues më të mëdhenj të ndotjes së ajrit në Kosovë janë: KEK-u që përfshin Termocentralet (Kosova A dhe Kosova B) dhe Mihjet sipërfaqësore të linjtit në Obiliq, Kompleksi Industrial në Mitrovicë, Ferro-nikeli në Gillogoc, Fabrika e çimentos Sharr-Cem në Han të Elezit, Fabrika e industrisë kimike dhe e gomës BALLKAN në Suharekë, Sistemet për ngrohje qendrore (Prishtinë, Gjakovë dhe Mitrovicë), Industria e rëndë bazike të cilat aktualisht nuk operojnë (Gjakovë, Pejë, Gjilan), Trafiku, Bujqësia, Deponitë e mbetjeve urbane dhe atyre industriale. Nga të dhënat me të

cilat disponon AMMK, vlerësohet se ajri në Kosovë nuk është i cilësisë së duhur dhe në disa lokalitete është tepër i ndotur nga aktivitete prodhuese (rrethina e KEK-ut, Feronikelit, Sharrcemit, ndotja nga trafiku, deponitë e mbetjeve urbane dhe industriale etj.). Më së shumti ka tejkalime të vlerave të lejuara të pluhurit, dhe grimcave të pluhurit PM 10 dhe PM 2,5.

**Rëndësia e Indikatorit për zhvillimin hapësinor:** Analiza e të dhënave për vlerësimin e cilësisë së ajrit në Kosovë, është bërë duke u bazuar në të dhënat në dispozicion dhe duke marrë si pikë krahasimi standardet e BE-së nga Direktiva 2008/50/EC, mbi cilësinë e ajrit dhe Udhëzimi administrative për

vlerat kufitare - normat e cilësisë së ajrit; Nr. 02/2011 Direktiva 2008/50/EC për Cilësinë e ajrit mjedisor dhe ajrit të pastër për Evropë. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka bërë punë të mire në transpozimin e legjislacionit Evropian përmes aprovimit të Udhëzimit Administrativ për Normat e cilësisë së ajrit. Materiet grimcore (pluhuri) krijohen nga proceset natyrore dhe antropogjene, të cilat shpërndahen në ajër në formë difuzive dhe në tokë bien nën ndikimin e gravitacionit ose së bashku me të reshurat atmosferike. Materiet grimcore kategorizohen në bazë të madhësisë së grimcave (grimcat PM10, PM2,5 dhe PM1 me diametër të caktuar aerodinamik < 10µm, <2,5µm dhe <1µm) dhe grimcat totale të suspenduara GTS.


Prandaj, duke i pasur informatat dhe analizat e mësipërme parasysh, është shumë me rëndësi që përmes indikatorit në fjalë të ofrohet një pasqyrë reale për zonat e ndotura dhe niveli i ndotjes së tyre. Në këtë mënyrë do të bëhet më lehtë marrja e vendimeve të duhura për zhvillim hapësinor për territorin për të cilin hartohet plani përkatës hapësinor.

**Gjendja e Indikatorit dhe krahasimi:** Bazuar në të dhënat e disponueshme për cilësinë e ajrit, të dhënat për emisione dhe të dhënat tjera statistikore, mund të vlerësohet se ajri në Kosovë ka cilësi jo të kënaqshme. Problem parësorë i ndotjes së ajrit në Kosovë është ndotja me grimcat PM10, duke mos i abstrahuar edhe ndotësit tjerë të cilët atakojnë shëndetin e njeriut, vegjetacionin, botën bimore, dhe botën shtazore. Institucionet e Kosovës në periudhën e pasluftës brenda mandatit dhe mundësive kanë bërë përpjekje në ndërmarrjen e masave adekuate për zvogëlimin e ndikimit të burimeve ndotëse në ajër dhe në përmirësimin e cilësisë së ajrit. Megjithatë nevojitet angazhim edhe më i madh në përmirësimin e gjendjes së përgjithshme në sektorin e ajrit.

Në bazë të dhënave aktuale kuptohet se nga kompanitë me të mëdha industriale ka tejkallim të Vlerave të lejuara mesatare të Pluhurit .

	Pluhuri	NOx	SO <sub>2</sub>	CO <sub>2</sub>
Sharrcem	Tejkallim i VLM	VLM	VLM	Në rritje
TCB1	Tejkallim i VLM	Ka tejkallime të VLM	Ka tejkallime të VLM	Në rritje
TCB2	Tejkallim i VLM	Ka tejkallime të VLM	Ka tejkallime të VLM	Në rritje
Feronikeli	Tejkallim i VLM	VLM	Ka tejkallime të VLM	X
Sharrcem	Tejkallim i VLM	VLM	VLM	X

Tabela : Vlerat e lejuara mesatare në bazë të standardeve të Bashkimit Evropian



### **Konkluzione dhe rekomandime:**

Ndër sfidat kryesore mjedisore për Kosovën është edhe plotësimi i standardeve mjedisore evropiane dhe përafrimi i legjislaturës kombëtare mjedisore me atë evropiane. BE ka parashtruar në mënyrë të qartë kriteret, metodologjinë dhe normat e lejuara, të cilat duhet të plotësohen nga shtetet anëtare të BE por edhe shtetet në zhvillim, shtetet candidate për anëtarësim apo edhe shtetet pretenduese për anëtarësim në BE.

Për plotësimin e këtyre kriterëve, metodologjive dhe normativave të lejuara që i ka parashtruar BE duhet të merren parasysh këto direktiva:

- Direktiva 2008/50/EC, për cilësinë e ajrit dhe ajër të pastër në Evropë;
- Direktiva 2004/107/EC, në lidhje me arsenin, kadmiumin, merkurin, nikelin dhe hidrokarburet policiklike në ajrin mjedisorë;
- Direktiva 2001/80/EC, mbi limitimin e emisionëve të ndotësve të caktuar në ajër nga impiantet me djegieje të mëdha;
- Direktiva 2002/3/EC, në lidhje me Ozonin në ajrin mjedisorë;
- Direktiva 2000/69/EC në lidhje me vlerat limite për benzenin dhe monoksid karbonin në ajrin mjedisorë;
- Direktiva 1999/30/EC në lidhje me vlerat limite për dyoksidin e sulfurit, dyoksidin e azotit dhe oksidet e azotit, materiet grimcore (PM10, PM 2.5) dhe plumbi në ajrin mjedisorë;
- Direktiva 96/62/EC, mbi vlerësimin dhe menaxhimin e cilësisë së ajrit mjedisorë.

Përpos plotësimit dhe respektimit të direktivave të mësipërme duhet të merren parasysh edhe rekomandimet e mëposhtme:

- Të ndërmerren masa që sa më parë të zbatohen politikat dhe strategjitë përkatëse për përmirësim e cilësisë së ajrit;
- Ndërmarrja e veprimeve që do të ndikojnë në kufizimin maksimal të qarkullimit të mjeteve të vjetra në komunikacion;
- Obligimin e kompanive për ndërrimin e filtrave në bazë të standardeve në fuqi;
- Përmirësimi dhe plotësimi i stacioneve për monitorim të ajrit në 7 qendra të mëdha të Kosovës;
- Sigurimi i disa stacioneve mobile që do të bëjnë monitorimin e shpejtë për rastet emergjente.

**Përshkrimi i Indikatorit:** Ky indikator paraqet gjendjen e lokacioneve të ndotura mjedisore, të krijuara nga mbetjet industriale dhe mbeturinat tjera të rrezikshme, të deponuara në disa pjesë të vendit tonë. Këto pika ose lokacione, me ndikim të madh negativ në mjedisin jetësor, quhen pika të ndjeshme mjedisore apo “hot-spotte - pika të nxehta”.

**Mënyra e matjes së Indikatorit:** Matja e këtij Indikatorit bëhet duke llogaritur shumën e sipërfaqeve (në km<sup>2</sup>), të mbuluara me mbetje industriale dhe të tjera të rrezikshme, në raport me sipërfaqen e tërësishme të vendit. Matjet kanë rezultuar se sipërfaqja e përgjithshme e pikave të ndjeshme mjedisore / hot-spotteve në vendin tonë është 9.94 km<sup>2</sup> ose rreth 0.1 % e territorit të Kosovës.




Fig. 1. Harta me lokacionet e hotspotteve në Kosovë Burimi: MMPH/AMMK<sup>71</sup>.

**Burimi i informatës/ave:** Burimi kryesor i të dhënave për këtë tregues është Agjencia e Mbrojtjes së Mjedisit të Kosovës, në kuadër të MMPH.

**Kufizimet për matjen e Indikatorit:** Deri në vitin 2006 nuk ka pas progres, në pastrim dhe rehabilitim të pikave dhe lokacioneve të ndjeshme mjedisore, për shkak të mungesës së strategjisë, mjeteve financiare dhe institucioneve përgjegjëse për hulumtimin, monitorimin dhe menaxhimin e tyre. Prandaj, edhe matja e këtij Indikatorit, si në të kaluarën edhe tani, është i kufizuar edhe për kundër

<sup>71</sup> MMPH / AMMK, Raporti për Hotspotet Mjedisore në Kosovë, Prishtinë, 2011.

faktit që pastrimi dhe rehabilitimi është realizuar në disa prej këtyre pikave dhe lokacioneve të cilat shihen në fig. 1, edhe pse shkalla e progresit të arritur nuk është prezantuar në nivelin e duhur.

**Rëndësia e Indikatorit për zhvillimin hapësinor:** Ky tregues është shumë i rëndësishëm, sepse si i tillë, në formën e të dhënave hapësinore, na tregon për vendshtrirjen e pikave / lokacioneve të ndjeshme mjedisore, madhësinë e sipërfaqes, llojin e ndotësit të rrezikshëm ose industrial dhe sasinë ndotëse. Njëherit, kjo bazë e mirë e informacionit, do të shërbejë si në identifikimin e sfidave dhe çështjeve në profil ashtu edhe në pëcaktimin e zgjidhjeve gjatë hartimit të projekteve tek strategjia për rehabilitimin dhe ripërdorimin e këtyre zonave, duke orientuar politika dhe donacione drejt fushës së mbrojtjes së mjedisit.

**Gjendja e Indikatorit dhe krahasimi:** Në tërë territorin e Kosovës janë identifikuar rreth 110 zona të ndjeshme mjedisore. Ndërsa, 27 prej tyre janë evidentuar si zona me potencial dhe me ndikim më të madh në mjedis dhe në shëndetin e popullsisë.


Gjatë krahasimit të të dhënave rezulton se ndotja me e madhe ishte deri në vitin 2006. Mirëpo, gjatë viteve 2007-2009 Minsitria e Mjedisit dhe Planifikimi Hapësinor në bashkëpunim me Komisionin Evropian, ka investuar në mbylljen dhe rehabilitimin e katërmbëdhjetë (14) deponive të mbeturinave komunale. Po ashtu, ajo ka bërë investime edhe në ndërtimin e shtatë qendrave për sterilizimin e mbeturinave infektive spitalore, si dhe në ngritjen e imipanteve për ruajtjen e përkohshme të mbeturinave të rrezikshme.

Përveç kësaj, Ministria e Zhvillimit Ekonomik në përkrahje të organizatave ndërkombëtare dhe të donatorëve, ka realizuar disa projektet, për rehabilitimin e deponive industriale, si: Projekti për Pastrimin dhe Rikultivimin e Tokës nga deponitë e KEK-ut, kryesisht në Obiliq, si dhe trajtimi i deponive në Artanë dhe në Kelmend.

#### **Konkluzione dhe rekomandime:**

- Duke ju referuar analizave dhe të dhënave të mësipërme, është e qartë nevoja e studimeve të thella për ripërdorimin e masës së deponuar në pikat e ndjeshme mjedisore (hot-spote), të cilat janë pasuri shtetërore dhe mund të jenë lëndë e parë për prodhime tjera finale;
- Në mungesë të vlerësimit të gjendjes reale dhe hartimit të strategjisë me kosto përkatëse financiare, për pastrimin dhe rehabilitimin e hot-spoteve, situata vazhdon të jetë në nivel të njëjtë të ndotjes;
- Rekomandohet azhurnimi i të dhënave për të gjitha projektet e realizuara në fushën e hotspoteve;
- Të bëhet hulumtimi dhe pasqyrimi i gjendjes reale për pikat dhe lokacionet e ndjeshme mjedisore;
- Rekomandohet hartimi i politikave që inkurajojnë menaxhimin e qëndrueshëm të mjedisit, duke zhvilluar projekte përmes Partneritetit publik-privat.

**Përshkrimi i Indikatorit:** Llojlojshmëria bimore paraqet numrin e llojeve të ndryshme, që janë të përfaqësuara në një komunitet të caktuar dhe përbëhet prej dy komponenteve: llojet e pasura, që paraqesin numërimin e thjeshtë të llojeve dhe llojet ekujlibër, që vlerësojnë se sa është e barabart abondanca<sup>72</sup> e llojeve.



**Mënyra e matjes së Indikatorit:** Matja e këtij Indikatorit bëhet duke llogaritur numrin e asociacioneve apo fitocenozeve, aleancave, rendeve dhe klasave të vegjetacionit të pyjeve dhe livadheve, në raport me sipërfaqen e përgjithshme në vend.

**Fig. 1. Harta e zonave të rëndësishme të bimëve. Burimi:** Raporti fillestar teknik i identifikimit të zonave Natyra 2000, në Kosovë.

**Burimi i informatës/ave:** Burimi kryesor i të dhënave për këtë tregues është Departamenti i Biologjisë, në Universitetin e Prishtinës.

**Kufizimet për matjen e Indikatorit:** Kufizimet që paraqiten në matjen e këtij Indikatorit janë si rezultat i mungesës së inventarizimit të fitodiversitetit, në Kosovë. Pastaj shkatërimi i diversitetit floristik nga faktori antropogjen po ashtu paraqesin pengesë për matjen e Indikatorit. Një gjë e tillë ndikon në mënyrë të drejtpërdrejt në shkatërimin e habitateve dhe zhdukjen e llojeve bimore, të cilat nuk janë të njohura për shkencën dhe që duhet të hulumtohen.

**Rëndësia për zhvillimin hapësinor:** Ky tregues është i rëndësishëm sepse është mbështetje e ekosistemeve tokësore, në nivel global. Rol tjetër për zhvillimin hapësinor është ofrimi i shërbimeve të ekosistemeve për mbrojtjen e pellgjeve lumore, rregullimin e shtretërve të lumenjëve, duke

<sup>72</sup> Abondanca është vlerësimi relativ i numrit të individëve për çdo lloj të asociacionit

përfshirë edhe ata ndërkufitar, përmirësimin e tokave, stabilizimin e klimës globale dhe sigurimin e habitateve për shumë lloje të faunës së egër.

**Gjendja e Indikatorit dhe krahasimi:** Sipas shënimeve të autorëve të ndryshëm mendohet se në Kosovë janë prezent afro 2800-3000 lloje të florës vaskulare.<sup>73</sup> Vegetacioni i Kosovës është i përfaqësuar më 139 asociacione/fitocenoza, 63 aleanca, 35 rende dhe 20 klasa.<sup>74</sup> Vegetacioni i livadheve të ultësirave klasifikohet në katër asociacione që i përkasin një aleance, një rendi dhe një klase. Vegetacioni i livadheve kodrinore subalpike dhe alpike klasifikohet në 65 asociacione, 33 aleanca, 22 rende dhe 13 klasa. Ndërsa vegetacioni pyjor në 70 asociacione, 29 aleanca, 8 subaleanca, 12 rende dhe 6 klasa.<sup>75</sup>

#### **Konkluzione dhe rekomandime:**

1. Mos evidentimi i zonave të rëndësishme bimore;
2. Mungesa e hulumtimit të të gjitha llojeve bimore në Kosovë;
3. Mungesa e të dhënave për llojet bimore të rrezikuara dhe atyre të rrezikuara me zhdukje;
4. Mungesa e inventarizimit bimor;
5. Mos evidentimi i të gjitha llojeve bimore të cilat janë të rëndësishme për tu përfshirë në Listën e Kuqe të Botës.

---

<sup>73</sup> Millaku F, etj. Libri i Kuq i Florës Vaskulare të Republikës së Kosovës, MMPH, GIZ, UP - Prishtinë, 2013

<sup>74</sup> Strategjia dhe plani i veprimit për Biodiversitetin, MMPH, 2011 – 2020

<sup>75</sup> Raporti i gjendjes së natyrës, MMPH/AMMK,/IKMN, 2006-2007




Iphk  
045/5.07

**Indikator:** ZONAT ME VLERA TË E MBROJTURA NATYRORE

**Synimi:** MBROJTJA DHE SHFRYTËZIMI I QËNDRUESHËM I VLERAVE TË TRASHËGIMISË

**Objektivi:** IDENTIFIKIMI DHE RUAJTJA E HABITATEVE NATYRORE DHE E LARMISË BIOLOGJIKE

**Përshkrimi i Indikatorit:** Zonat e mbrojtura, paraqesin sipërfaqen e gjelbër me vlera të trashëguara natyrore të cilat gëzojnë mbrojtje ligjore, e që janë identifikuar për rrjetin Emerald të Këshillit të Evropës, në të cilin Kosova ende nuk është anëtare.



**Mënyra e matjes së**

**Indikatorit:** Nga të gjitha zonat e mbrojtura, të identifikuar në vend deri në vitin 2014, është llogaritur shuma e përbashkët e sipërfaqeve të tyre. Vlera e dhënë në përqindje, tregon raportin, në kuadër të sipërfaqes së përgjithshme të Kosovës.

**Burimi i**

**informatës/ave:** Burimi kryesor i të dhënave për këtë tregues është Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës (IKMN), në kuadër të Agjencisë së Mbrojtjes së Mjedisit të Kosovës (AMMK), Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH)<sup>76</sup>.

**Fig. 1. Harta me zonat e mbrojtura natyrore në Kosovë.** Burimi: IMNK / AMMK / MMPH.

**Kufizimet për matjen e Indikatorit:** Një ndër kufizimet që paraqiten në matjen e këtij Indikatorit është gjendja aktuale e vendit tonë, pasi që Kosova ende është në fazën e identifikimit të zonave potenciale për të qenë nën mbrojtje.

<sup>76</sup> MMPH / AMMK, Raporti për Gjendjen e Natyrës 2010-2013, Prishtinë 2014.

Kështu që, Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës është duke propozuar zona të reja, të cilat së shpejti do të kenë statusin e mbrojtjes ligjore, në të ardhmen. Prandaj, të gjitha investimet e mundshme që do të realizohen brenda tyre, duhet të shqyrtohen si çështje të veçanta.

**Rëndësia e Indikatorit për zhvillimin hapësinor:** Indikatorit i zonave të mbrojtura natyrore ka rëndësi të madhe, duke pasur parasysh se përmes identifikimit dhe planifikimit të mbrojtjes dhe shfrytëzimit të qëndrueshëm mjedisor, do të arrihet zhvillimi ekonomik i vendit. Në kuadër të këtyre zonave janë krijuar edhe regjime të mbrojtjes dhe të shfrytëzimit të shkallës së parë, dytë dhe tretë, në të cilat ndalohen aktivitetet që kanë ndikim të dëshëm për vlerat e trashëgimisë natyror dhe kulturore, larmisë biologjike dhe peisazhit.

**Gjendja e Indikatorit dhe krahasimi:** Gjatë krahasimit të të dhënave të shprehura në përqindje, për zonat e mbrojtura deri në vitin 2007, shifet se Kosova ishte e renditur e parafundit në rajon, që do të thotë se kishte vetëm 4,2 % sipërfaqe të mbrojtur në kuadër të territorit të vendit (fig. 2). Mirëpo, pas shpalljes së Parkut Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”, si kategori e dytë e mbrojtjes në IUCN, sipërfaqja e zonave të mbrojtura është rritë në rreth 11 %, kështu që, Kosova tani është renditur e treta me radhë në mesin e shteteve të këtij rajoni (fig. 3).




Fig. 2. Grafiku me % e zonave të mbrojtura në vendet e rajonit / 2007. Burimi: Ministrinë përkatëse të rajonit.

Fig. 3. Grafiku i renditjes së vendeve të rajonit / 2014. Burimi: Ministrinë e vendeve të rajonit.

### Konkluzione dhe rekomandime:

- Vendi ynë posedon larmi biologjike me vlera të veçantë natyrore, në bazë të të cilave duhet të planifikohet studimi dhe njohja e tyre në mënyrë që të mundësohet përcaktimi i lokacioneve të tjera, të zonave të mbrojtura.
- Sikur në vendet e rajonit dhe më gjerë, edhe në Kosovë, zonat e mbrojtura janë të ndara sipas kategorisë së IUCN-së dhe janë të destinuara për të qenë pjesë e rrjeteve të ndryshme ndërkombëtare të zonave të mbrojtura.
- Meqenëse, Kosova nuk ka të identifikuar ende rajonet biogjeografike, duhet, që sa më shpejtë që të jetë e mundur, një gjë e tillë të përfundojë. Të gjitha të dhënat e grumbulluara do të jenë argument bazë për përfshirjen e vendit tonë në rrjetin e organizatave të ndryshme ndërkombëtare dhe argument me ndikim në marrjen e vendimeve të duhura për zhvillimin hapësinor të territorit, për të cilin hartohet plani përkatës hapësinor.

<b>Indikatori:</b>	<b>VLERA E BUXHETIT TË NDARË PËR MBROJTJE DHE ZHVILLIM TË TRASHËGIMISË KULTURORE</b>
<b>Synimi:</b>	MBROJTJA, RUAJTJA DHE PROMOVIMI I TRASHËGIMISË KULTURORE
<b>Objektivi:</b>	NGRITJA E VLERËS BUXHETORE PËR TRASHËGIMI KULTURORE DHE NDARJA MË E BARABARTË NË KOMUNAT E KOSOVËS

**Përshkrimi i Indikatorit:** Ky indikator paraqet vlerën e ndarë të buxhetit për një vit kalendarik për trashëgiminë kulturore të Kosovës. Për më tepër, vlera e analizuar e buxhetit për Trashëgimi Kulturore është bërë përmes buxhetit të ndarë nëpër projektet e përcaktuara (definuara) nga MKRS-ja.

**Mënyra e matjes së Indikatorit:** Investimet kapitale për trashëgimi kulturore të buxhetit të MKRS-së, janë të ndara me projekte të veçanta dhe buxhet të caktuar.

Mënyra e matjes së Indikatorit është bërë me krahasimin e vlerës buxhetore të ndarë për projekte të caktuara për trashëgimi kulturore për vitet 2008-2016.

**Burimi informatës/ave:** Burimi i informacionit për Indikatorin në fjalë është Ministria e Financave - Departamenti për thesar i cili harton Ligjin për Buxhet të Republikës së Kosovës.

**Kufizimet për matjen e Indikatorit:** Orientimet e zhvillimeve me projekte të përcaktuara nga MKRS/DTK nuk janë të shpërndara në mënyrë të barabartë.

**Rëndësia e Indikatorit për zhvillimin hapësinor:** Në Planin Hapësinor të Kosovës, për qëllim kryesor në fushën e trashëgimisë kulturore, është theksuar mbrojtja, ruajtja dhe promovimi i Trashëgimisë Kulturore në tërë territorin e Kosovës. Aty, synohet që përmes përmirësimit (ngritjes) së vlerës buxhetore si dhe shpërndarjes së fondit të investimeve në mënyrë më të barabartë nëpër komunat e Kosovës të arrihet ky qëllim. Prandaj, edhe investimet në projektet kapitale, sipas prioriteteve të përcaktuara, varësisht nga vlera dhe rëndësia e mbrojtjes dhe promovimit të një asemi të trashëgimisë kulturore, për sot dhe gjeneratat e ardhshme, që përmes zhvillimit të turizmit kulturor do të mundësonte edhe zhvillimin ekonomik të vendit.


**Gjendja e Indikatorit dhe krahasimi:** Sipas informatave që disponojmë për buxhetin e ndarë për trashëgimi kulturore, del se buxheti që nga viti 2008 ka pasur rritje graduale nga 1.9 mil.€ (në vitin 2008) në 3.4 mil.€ në 2016, që në përqindje është 0.18% në vitin 2008 ndërsa 0.20% në vitin 2016 nga i tërë buxheti i Republikës së Kosovës.

Vitet	Buxheti i Kosovës (miliardë €)	Trashëgimia kulturore (milion €)	Buxhetit Shteteror për TK (%)
2008	1.1	1,9	0.18
2010	1.1	2,6	0.23
2011	1.4	3,2	0.23
2012	1.5	2,6	0.17
2013	1.6	2,6	0.16
2014	1.6	2,6	0.16
2015	1.7	2,3	0.13
2016	1.7	3,4	0.20

**Fig.1.** Burimi i informacionit: MF/Buxheti qendror për periudhën 2008-2016

Investimet kapitale të parapara për trashëgimi kulturore nga viti 2008 deri në 2016 përmes projekteve kapitale dhe shumës së buxhetit të ndarë për secilin projekt, është paraqitur në hartën si më poshtë

## Investimet kapitale për Trashëgimi Kulturore në komuna për vitet 2008-2016



Në hartë shihet se shpërndarja hapësinore e projekteve nuk është e harmonizuar, buxheti është ndarë më së shumti në komunën e Prishtinës dhe Prizrenit, ndërkohë që kemi komuna në të cilat nuk ka pasur

ndonjë investim kapital që të ndikojë në forcimin e sektorit të trashëgimisë kulturore dhe ngritjen e vetdijes për trajtimin e duhur të saj.

Buxheti i shteteve të rajonit dhe buxheti i ndarë për Ministri të Kulturës për vitin 2016<sup>77</sup>

Vendi	Buxheti shtetëror (miliardë €)	Buxheti për MK nga buxheti shtetëror (milion € )	% e buxhetit për MK nga Buxheti shtetëror
Kosova	1.73	19.8	1.15%
Shqipëria	6.6	19.8	0.3
Maqedonia	2.9	7.3	0.25
Mali i Zi	2.1	6.8	0.32
Serbia	9.1	89.7	0.98
Kroacia	15.3	123.3	0.8

Duke krahasuar buxhetet e shteteve të rajonit për vitin 2016, Kosova është në pozitë të mirë sa i përket ndarjes së buxhetit për kulturë.


### **Konkluzione dhe rekomandime:**

- Sipas analizës së mësipërme përqindja e buxhetit e ndarë për sektorin e kulturës në Kosovë është pozitive me disa vende të rajonit. Edhe përkundër këtij fakti, është e sigurtë se duke e pasur parasysh gjendjen e trashëgimisë kulturore dhe nevojat reale për trajtimin e saj të duhur, buxheti në fjalë nuk është i mjaftueshëm;
- Duke i pasur këto informata parasysh rekomandohet që sektori i trashëgimisë kulturore të futet në agjendën e qeverisë si prioritet me rëndësi të lartë;
- Investimet kapitale dhe orientimi i buxhetit duhet të jetë më i balancuar në mënyrë që edhe në tërë territorin e Kosovës të ndihet roli dhe rëndësia e trashëgimisë kulturore dhe sektorit të saj përgjegjës;
- Rritja e buxhetit për Trashëgimi Kulturore, do të krijojë mundësi reale për zhvillimin e turizmit kulturor, i cili në mënyrë direkte do të ndikojë në hapjen e vendeve të reja të punës, në promovimin e nevojshëm të trashëgimisë kulturore dhe në përgjithësi do të ketë ndikim në zhvillimin e gjithëmbarshtëm ekonomik të vendit;
- Trashëgimia kulturore duhet të kuptohet si njëri ndër faktorët kyç për zhvillimin socio-ekonomik të vendit;

<sup>77</sup> Të dhënat për buxhetin e ndarë për kulturë për shtetet e rajonit janë marrë nga faqet zyrtare të Ministrive përkatëse.

<b>Indikator:</b>	<b>NUMRI I MONUMENTEVE TË TRASHËGIMISË KULTURORE</b>
<b>Synimi:</b>	MBROJTJA, RUAJTJA DHE PROMOVIMI I TRASHËGIMISË KULTURORE
<b>Objektivi:</b>	NGRITJA E NIVELIT TË VLERAVE TË MONUMENTEVE ME IDENTITET KULTURORE

**Përshkrimi i Indikatorit:** Ky indikator paraqet numrin e monumenteve, të objekteve dhe tërësive me vlera të Trashëgimisë Kulturore<sup>78</sup>, të cilat kërkojnë trajtim ligjor dhe profesional për mbrojtjen, ruajtjen dhe shfrytëzimin e tyre.



**Mënyra e matjes së Indikatorit:**

“Lista e Trashëgimisë Kulturore për mbrojtje të përkohshme<sup>79</sup>”, që publikohet rregullisht tri viteve të fundit, është instrumenti kryesor për matjen numrit të monumenteve të trashëgimisë kulturore (me përmbajtje të trashëgimisë të luajtshme dhe të paluajtshme kulturo-historike) në Kosovë, duke mundësuar azhurnim të kohë pas kohe të saj.

**Burimi i informatës/ave:**

Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit (MKRS) përkatësisht Departamenti për Trashëgimi Kulturore (DTK) duke përfshirë edhe njësitë e saja si Qendrat Rajonale për Trashëgimi Kulturore (QRTK), janë burimi kryesor i informatave.

**Fig.1. Harta me ZVM të definuara në PH të Kosovës.** Burimi: MMPH/IPH, nga PH i Kosovës, Prishtinë 2010.

**Kufizimet për matjen e Indikatorit:** Sipas përgjegjësi, të dhënat për vlerat e trashëgimisë kulturo-historike mblidhen nga Qendrat Rajonale të Trashëgimisë Kulturore (QRTK) përmes procesit të inventarizimit. Ndonjëherë, ndodh, që informatat të mos jenë në harmoni të plotë më gjenden ekzistuese të monumentit, që në mënyrë direkte ndikon në prezantimin korrekt të gjendjes.

**Rëndësia e Indikatorit për zhvillimin hapësinor:** Identifikimi dhe regjistrimi i të dhënave për numrin, gjendjen dhe shtrirjen e objekteve dhe tërësive me vlera të trashëgimisë kulturore, ndikon drejt arritjes së synimit për mbrojtjen e identitetit dhe të vlerave të trashëguara kulturore – historike dhe që përmes zhvillimit të turizmit kulturor të arrihet edhe zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik në nivelin lokal dhe qendror. Sigurimi i mjeteve financiare dhe i kapaciteteve njerëzore profesionale ndikon drejtpërdrejtë në shkallën e përgatitjes, trajtimit, planifikimit dhe të menaxhimit të projekteve dhe planeve në të dyja nivelet e qeverisjes për zhvillim të qëndrueshëm të vlerave të trashëgimisë kulturore me “status të mbrojtjes së shtetit”.

<sup>78</sup> Sipas Ligjit për TK janë ndërtime dhe struktura me vlera të veçanta arkeologjike, arkitektonike, historike, artistike dhe shkencore me interes shoqëror dhe shtetëror;


<sup>79</sup> MKRS: Lista e Trashëgimisë Kulturore për mbrojtje të përkohshme Prishtinë 2014.

**Gjendja e Indikatorit dhe krahasimi:** Në listat dhe diagramet në vazhdim paraqitet numri i objekteve dhe tërësive arkitektonike, të objekteve dhe lokaliteteve arkeologjike, të zonave historike dhe monumenteve, kishave dhe manastireve, etj, që janë të regjistruara në listën e trashëgimisë botërore. Edhe pse, Kosova, nuk është ende anëtare e UNESCO-s, katër (4) monumentet e saj për momentin (fig. 2 dhe 3) janë të evidentuara si të "Krahinës së Serbisë". Aktualisht ky status është në proces të ndryshimit, në kuadër të të cilit Kosova shumë shpejtë do të bëhet anëtare e rregullt në UNESCO.



**Fig. 2. Diagrami me nr. e monumenteve të trashëgimisë botërore në UNESCO, nga shtetet e rajonit.** Burimi: MMPH / IPH sipas Listës së UNESCO-s, nga Web: [www.http://whc.unesco.org/en/list/](http://whc.unesco.org/en/list/)

**Fig. 3. Tabela me monumentet e trashëgimisë botërore - UNESCO, nga Kosova dhe shtetet e rajonit.** Burimi: MMPH / IPH sipas Listës së UNESCO-s, nga Web: [www. http://whc.unesco.org/en/list/](http://whc.unesco.org/en/list/).



Kosova	Manastiri i Deçanit
	Patrikana e Pejës
	Kisha e Levishës
	Manastiri i Graçanicës
Shqipëria	Butrinti
	Zona historike e Beratit
	Zona historike e Gjirokastrës
Sërbia	Stari Ras Sopoçani
	Manastiri i Studenicës
	Lokalitet arkeologjik Gamzigrad - Romuliana
Mali i Zi	Regjioni natyror dhe kulturo-historik i Kotorit
	Parku Kombëtar Durmitor
Maqedonia	Trashëgimia natyrore dhe kulturore e Rajonit të Ohrit

**Fig. 4. Diagrami me numrin e monumenteve të TK nga listat e viteve 2012-2015.** Burimi: MKRS, Lista e monumenteve të TK-së në Kosovë.

Kategoritë	Trashëgimia Arkeologjike		Trashëgimia Arkitekturore		Trashëgimia Luajtshme
	Monument / Ansambël	Lokalitet arkeologjik / Rezervat	Monument / Ansambël	Fusha të konservimit arkitekturor	Objekte të luajtshme
Nën-kategoritë					
2012/2013	86	267	824	2	X
2013/2014	87	312	825	2	199
2014/2015	87	315	833	2	202
2015/2016	87	333	874	2	211
2016/2017	84	331	888	2	211

**Fig. 5. Tabela me numrin monumenteve të TK nga listat e viteve 2012-2015.** Burimi: MKRS, Lista e monumenteve të TK-së në Kosovë.

Përderisa, numri i përgjithshëm i monumenteve të Kosovës, në Listën Botërore të Trashëgimisë Kulturore në UNESCO-s është 4, ndërsaq në Listën e Mbrojtjes së Përkohshme të MKRS-së, me statusin e mbrojtjes ligjore nga shteti, të vitit 2014, janë gjithsejtë 1.438 objekte dhe tërësi. Këto Monumente, ndahen dhe kanë edhe numrin e veçantë sipas kategorisë dhe nënkategorisë që i përkasin, siç janë paraqitur edhe në fig. 4 dhe 5.

#### **Konkluzione dhe rekomandime:**

- Duke e analizuar numrin nga lista e trashëgimisë kulturore të Kosovës, vërehet një rritje graduale për këto tri vite, që është një tregues i mundshëm për arritjen e synimit që ka të bëjë me mbrojtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të Trashëgimisë Kulturore;
- Sipas informatave të mësipërme mund të konkludohet se indikator “Numri i Monumenteve të Trashëgimisë Kulturore nën Mbrojtje” është njëri ndër indikatorët më të rëndësishëm që duhet të trajtohet në procesin e hartimit të dokumenteve të planifikimit hapësinor të nivelit qendror dhe lokal. Të gjithë përgjegjësit duke përfshirë edhe hartuesit e dokumenteve të planifikimit hapësinor janë të obliguar që të marrin në konsideratë trajtimin e monumenteve që dalin nga Lista e Monumenteve nën Mbrojtje. Një veprim i tillë do të ketë ndikim direkt në ruajtjen e identitetit kulturo/historik për zonën e përfshirë në planin përkatës;
- Planet hapësinore dhe urbane duhet të shërbejnë si instrumente për zhvillimin e territoreve përkatëse dhe trajtimin e duhur të vlerave të trashëgimisë kulturore dhe natyrore;
- Në bazë të analizave që janë bërë për këtë indikator, rekomandohet që të punohet harta e Trashëgimisë kulturore, ku do të përfshihen kategoritë, nënkategoritë si dhe numri i objekteve me të dhënat e tyre përkatëse.



## INDIKATORËT PËR PLANIFIKIM HAPËSINOR NË KOSOVË

### Hartues të dokumentit:

**Instituti për Planifikim Hapësinor**

**Luan NUSHI**, arkitekt planer, Drejtor;

**Faton DEVA**, arkitekt planer, Udhëheqës i Divizionit për Planifikim dhe Bashkëpunim, Koordinator i projektit;

### Përgjegjës të zhvillimit të indikatorëve:

**Arbën RRECAJ** - arkitekt planer, Udhëheqës i Divizionit për Hulumtim dhe Vlerësim;

- Raporti në mes prodhimit dhe konsumit të energjisë elektrike;
- Përqindja e popullsisë që furnizohet me ujë të pijshëm;
- Përqindja e rrugëve të asfaltuara nga rrjeti i rrugëve;
- Dendësia e rrjetit rrugor të asfaltuar në Kosovë;
- Dendësia e rrjetit hekurudhor në Kosovë;
- VB dhe popullsia e përfshirë në shërbimet e largimit të mbeturinave;
- VB dhe popullsia që përdorin sistemin publik të ngrohjes;
- Territori dhe popullsia që mbulohet nga shërbimet e telekomunikimit;

**Faton DEVA**, arkitekt planer, Udhëheqës i Divizionit për Planifikim dhe Bashkëpunim;

- Shkalla e papunësisë (me përkrahjen e praktikanteve Etnike Dibrani dhe Albulena Murati);
- Raporti në mes popullsisë urbane dhe rurale (me përkrahjen e praktikantit Faton Morina);
- Potenciali i tokës bujqësore;
- Përdorimi (shfrytëzimi) i tokës;
- Kapaciteti dhe shtrirja e objekteve për shërbime shëndetësore (në 100 000 banorë) (me përkrahjen e praktikantes Fortesa Krasniqi);
- Remitencat nga diaspora në Kosovë (me përkrahjen e praktikanteve Donjeta Puraj dhe Tringa Shatri);
- Kapaciteti dhe shtrirja e objekteve edukative – arsimore (me përkrahjen e praktikanteve Donjeta Puraj dhe Tringa Shatri);
- Kapaciteti i shfrytëzuar i tokës bujqësore;

**Elvida PALLASKA**, arkitekthe, ish zyrtare në IPH;

- Vlera e eksport - importit dhe e bilanci tregtar;
- Pjesëmarrja e sektorëve në BPV;

**Shpend AGAJ**, gjeograf planer, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim;

- Kualiteti i ajrit;
- Kualiteti i ujërave sipërfaqësore;
- Degradimi i shtretërve të lumenjve dhe rreziku nga vërshimet;
- Pyllëzimi dhe ripyllëzimi si masë antierozion;
- Sasia e resurseve ujore (*Sasia e ujit për kokë banori*)

**Nexhmije KAMBERI**, biologe, ish zyrtare në IPH;

- Progresi në menaxhimin e zonave të ndotura;
- Zonat e mbrojtura natyrore;
- Llojllojshmëria bimore;

**Besim GOLLOPANI**, sociolog, ish zyrtar në IPH;

- Dendësia e popullsisë dhe shpërndarja e saj;
- Migrimet e jashtme në Kosovë;

**Zana MEHMETI**, arkitekt planere, Zyrtare e Lartë për Planifikim;

- Numri i vizitorëve të jashtëm dhe vendor;
- Ndërmarrjet bujqësore si aktivitete ekonomike në nivel vendi;
- Numri dhe shtrirja e zonave ekonomike;
- Ndarja e buxhetit dhe shpenzimet kapitale sipas sektorëve dhe komunave;

**Festa NELA**, arkitekt planere, Zyrtare e Lartë për Analiza Hapësinore;

- Numri i monumenteve të trashëgimisë kulturore nën mbrojtje;
- Mbulimi i territorit të Kosovës me plane hapësinore dhe zhvillimore komunale;
- Vlera e buxhetit të ndarë për mbrojtje dhe zhvillim të TK-së;

**Gëzime GRAJQEVCI**, arkitekt planere, Zyrtare e Lartë për Hulumtim;

- Bruto produkti vendor (BPV) për kokë banori;
- Shkalla e varfërisë;
- Numri i njësive të banimit;
- Numri i kërkesave për banim;

**Riza MURSELI**, gjeograf planer, Udhëheqës i Divizionit të GIS-it;

- Potenciali i tokës ndërtimore;
- Vendbanimet joformale;
- Numri i ndërtimeve pa leje;
- Mbulueshmëria e territorit Kosovës nga shërbimet e transportit publik;
- Zonat nën rrezik të vërshimeve;

**Mimoza KALLABA**, gjeograf planer, Zyrtare për Bazën e të Dhënave;

- Raporti i prodhimit të EE të prodhuar nga thëngjilli dhe burimeve të ripërtërishm;
- Raporti i energjisë elektrike të prodhuar nga thëngjilli dhe burimet tjera ripërtëritëse;

**Atdhe DESKU**, arkitekt planer, Zyrtar për Vlerësim;

- Popullsia, vendbanimet dhe njësitë e organizuara territoriale;

## Literatura dhe referencat për Indikatorët e trajtuar

- MMPH/IPH, Qershor 2010, "Plani Hapësinor i Kosovës 2010-2020+", IPH, Prishtinë;
- Agjencia e statistikave të Kosovës, Qershor, 2015; Seria 3: Statistikat Ekonomike/ Statistikat e Hotelierisë TM 1 – 2015;
- [www. http : //whc. unesco. org/en/ list](http://whc.unesco.org/en/list);
- Agjencia Statistike e Kosovës, dhjetor 2013, "Atlasi I regjistrimit të popullsisë në Kosovë, ESK, Prishtinë", Prishtinë;
- Seidel, M. A.2010, "Innovative Spatial Planning Instruments and their Contribution to European Integration", Conference-Paper, European Management Institute, University of Waterloo, 2010;
- The World Bank, "Knowledge Economy Index (KEI) 2012 Rankings" Available from <http://siteresources.worldbank.org/INTUNIKAM/Resources/2012.pdf> ;
- UNDP, 2012 "Raporti I zhvillimit njerëzor në Kosovë 2012", sektori privat dhe punësimi", Prishtinë;
- The World Bank, IBRD-IDA. World Development indicators, data by country. [online] Qasur ne: <http://data.worldbank.org/country/kosovo>[Qasur Tetor 2015];
- MKRS / DTK, 2012/2013/2014, "Lista e Trashëgimisë kulturore të Kosovës me mbrojtje të përkohshme", Prishtinë;
- AMMK, Raporti për Hotspotet Mjedisore në Kosovë, Prishtinë, 2011;
- IKMN, Raporti për Gjendjen e Natyrës 2010-2013, Prishtinë 2014;
- DMM, Raporti fillestar teknik i identifikimit të zonave Natyra 2000, në Kosovë;
- IKMN, Raporti i gjendjes së natyrës, 2006-2007;
- MMPH, Strategjia dhe plani i veprimit për Biodiversitetin, 2011 – 2020;
- Millaku F, 2013, Libri i Kuq i Florës Vaskulare të Republikës së Kosovës, MMPH, GIZ, UP - Prishtinë;
- Studimi i sektorit pyjor të Kosovës – 2013;
- Inventarizimi i Nacional i Pyjeve të Kosovës, 2012, 2013;
- Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), Shtator 2014, "Bruto produkti vendor në qasjen e shpenzimeve (2008-2013)", ASK, Prishtinë;
- Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Mars 2013, Strategjia për Zhvillimin e Sektorit Privat 2013-2017, MTI, Prishtinë;
- INSTITUTI RIINVEST, 2014, "Klima e Biznesit në Kosovë – Një Perspektivë Ndër-Rajonale, INSTITUTI RIINVEST, Prishtinë;
- MMPH. Regjistri kombëtar i ndërtimeve pa leje në Kosovë, Prishtinë 11 qershor 2015;
- MMPH. "Raporti i Gjendjes së Vendbanimeve Joformale në Kosovë", Prishtinë 2010;
- MMPH-EULUP. "Plani i Zonave Ndërtimore (PZN)", Prishtinë 2011;
- Qeveria e Republikës së Kosovës, Ministria e Infrastrukturës (MI), 2015, "Strategjia Sektoriale dhe Transportit Multimodal 2015-2025 dhe Plani i veprimit 5 vjeçar", MI;
- T. Kerni, 2015, "Region JIE s potencijalom, ali i pred izazovima", A.T.Kerni;
- Trainkos Sh.A, 2013, "Plani i biznesit 2014", Trainkos Sh.A;
- Infrakos Sh.A, 2014, "Ekspozeu i rrjetit", Infrakos Sh.A;
- Zyra Rregullatore për Ujësjellës dhe Kanalizim (ZRUK), 2014, "Raporti vjetor i performancës për ofruesit e shërbimeve të ujit në Kosovë në 2013", ZRUK;
- Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE), 2015, "Deklaratë mbi Sigurinë e Furnizimit në Kosovë (energji elektrike, gaz natyror dhe naftë)", ZRRE;
- S. E. Weishaar, S. Madani, 2015, "Report on the long-term economic viability of constructing new electricity capacities for electricity exports in the Western Balkan countries", CEE Bankwatch Network, The University of Groningen, The Netherlands, The Advisory House, Germany;
- Busurelo, I. Zgrabljic, M. Lenardic, S. Klanjic, 2015, "The Republic of Croatia: Energy, Potential and Projects";
- Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK): Atlasi i Regjistrimit të Popullsisë Kosovë 2011, Prishtinë 2013;
- Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK): Migrimi kosovar , Prishtinë 2014;
- ASK 2013 dhe <http://en.wikipedia.org/wiki/Balkans>;
- "Balkan vital Graphics" collection at <http://www.grida.no/publications/vg/balkan>;
- Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK): Atlasi i Regjistrimit të Popullsisë Kosovë 2011, Prishtinë 2013;
- Ramadani I, "Planifikimi Hapësinor dhe Urban", Prishtinë 2013;
- Burimi: [http://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php/Glossary:Revision\\_of\\_the\\_degree\\_of\\_urbanisation](http://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php/Glossary:Revision_of_the_degree_of_urbanisation);

- Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK): Atlasi i Regjistrimit të Popullsisë Kosovë 2011, Prishtinë 2013;
- INSTAT, “Njerëzit dhe puna në Shqipëri” faqe 28, Tiranë 2004;
- ASK, “Rezultatet e Anketës së fuqisë punëtore në Kosovë 2014” faqe 10, Prishtinë, Qershor 2014;
- Projekti Nr. 2010/230-489 i BE / ZNKE-së, EULUP - Mbështetje e Mëturjes dhe e Shfrytëzimit Tokës, Raporti Nr. 17 “Udhëzues për Planifikim Hapësinor”, Prishtinë 2012;
- APK / MBPZHR, “Inventarizimi Nacional i Pyjeve të Kosovës 2012”, Prishtinë 2013;
- Eurostat.



MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR



INSTITUTI PËR PLANIFIKIM HAPËSINOR

**INDIKATORËT  
PËR PLANIFIKIM HAPËSINOR NË KOSOVË**

Qershor, 2017

Prishtinë